

ENVER HOXHA

DITAR

PËR ÇËSHTJE NDËRKOMBËTARE

(1970-1971)

6

TIRANË, 1983

INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE
PRANË KQ TË PPSH

DEJAR

100 (1970) ADRES GJITHSHTETI

(1970 1970)

1970



E ENJTE
1 JANAR 1970

MONTEKATINI DUHET TË PËRFUNDOJË
KONTRATËN ME NE

Firmës italiane «Montekatini», e cila na shiti Uzinën e Azotikut në Fier, duhet t'i bëjmë një lajmërim që të dërgojë sa më parë specialistët dhe të vërë në efijencë të plotë uzinën, sipas kontratës, përndryshe duhet ta demaskojmë publikisht. Të gjitha shpenzimet që do të bëhen të jenë në kurriz të saj. Kapitalistë të poshtër! Përveç që morën më tepër se 15 milionë dollarë, duan të marrin edhe të tjerë.

KUJDES NË PUNËN ME PK TË POLONISË

Lexova një raport për punën e Partisë Komuniste të Polonisë dhe i rekomandova shokut Ramiz sa vijon:

1) Shokët tanë në Varshavë nuk kanë për detyrë të aktivizojnë grupet e vjetra të komunistëve polakë. Këto janë detyra të Partisë Komuniste të Polonisë dhe jo të përfaqësisë sonë tregtare, siç mendon Mijali. Kjo të jetë e qartë. Kurse në drejtim të punës së lidhjeve me miqtë e Shqipërisë është tjetër çështje, njerëzit tanë duhet të punojnë, por jo të bëjnë punën që duhet ta bëjë vetë Partia Komuniste e Polonisë.

2) Titulli i raportit është: «Nga aktiviteti i Partisë Komuniste të Polonisë», mirëpo aktiviteti i saj në këtë informacion është fare i paktë, për të mos thënë hiç. Vetëm informacion gazetaresk, marrë nga gazetatat. Gjendja, natyrisht, është shumë e keqe për regjimin e Gomulkës, por ç'do të bëhet më tej? Ç'po bëhet? A po përfitohet? Priten «s qarime suplementare» për qëllimet e kinezëve në lidhje me bisedimet sovjeto-kineze të Pekinit, nga ana e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Polonisë. Merret me mend atëherë se ç'po punohet atje!!

3) Megjithëse shoku Mijal i kritikon ashpër shokët e tij në Varshavë dhe një kritikë me një ton të tillë nuk është e rekomandueshme, mua më duket, dhe këtë duhet t'ia sugjerojmë në njëfarë mënyre, se udhëheqja e Partisë Komuniste të Polonisë do medoemos gjak të ri. Shokët

aktualë janë revolucionarë të vjetër, por të moshuar, të gjithë të njohur dhe nën kontroll të hapët dhe të vazhdueshëm të policisë. Pra, kjo udhëheqje, edhe po të dojë, nuk mund t'i japë ritmin e duhur luftës së Partisë dhe t'i shfrytëzojë si duhet këto situata kaq të favorshme revolucionare. Jo vetëm kaq, por ata nuk mundin dot të përgatitin disa shokë që të mbajnë kontaktet me jashtë, t'i dërgojnë një ose dy ndihmës shokut Mijal. Me këtë metodë pune partia mund të sklerozohet dhe aktiviteti i saj mund të paralizohet. Flitet shumë për konspiracionin në këtë parti, kurse udhëheqjen e saj e njuh policia dhe i ndjek lëvizjet e kontaktet e saj. Është e zorshme t'i shpëtosh darës, po s'u fute në masë, po nuk e zgjodhe një shumicë revolucionarësh militantë nga masa.

NJË DEKLARATË E BODNARASHIT

Emil Bodnarashi i tha ambasadorit tonë në Rumani se «mbrojtja e shkëlqyer që i bëri Shqipëria çështjes sonë, shpëtoi Rumaninë nga një invadim i revizionistëve sovjetikë. Këtë gjë e njohin dhe e thonë edhe jugosllavët». Kjo ka të ngjarë të jetë kështu se Bodnarashi është mik i Titos. Demaskimi i drejtë e sistematik që u bëmë ne planeve invaduese sovjetike dhe bullgare pati patjetër efektin e tij. Ua prishëm planet. Natyrisht jugosllavët dhe rumunët rezistuan, dhe duhet të vazhdojnë të rezistojnë, ne do t'i ndihmojmë për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së tyre.

S H Ë N I M

Përgatita skemën dhe tezat për një artikull tjetër në mbrojtje të Republikës Demokratike Gjermane. Ky artikull të dalë në shtypin tonë para se kancelari Brand të mbajë fjalimin e tij në Bundestag, më 13 ose më 14 janar, ku do të flasë edhe për Republikën Demokratike Gjermane.

DIPLOMACIA KINEZE PO LËVIZ

Diplomacia kineze ka filluar të lëvizë në Evropë. Biseda që i bëra Li Hsien Nienit në këtë drejtim, kur ishte këtu për festën e 25-vjetorit të Çlirimit, siç po duket, u është raportuar shokëve kryesorë, pse ambasadorët kinezë në kryeqytete të ndryshme po marrin kontakt me diplomatët tanë dhe shkëmbejnë mendime. Por, natyrisht, edhe tregtinë e aktivizojnë edhe me ato shtete borgjeze ose revizioniste që paraqitin «kundërshtime» me revizionistët sovjetikë.

Kinezët po bëjnë tregti edhe me titistët dhe po përdorin vaporët e tyre për transport. Titistët janë intrigantë të rafinuar, informacione kanë shumë dhe shumë nga këto ua japin kinezëve, të cilët janë të uritur, pse kanë qenë të mbyllur. Kinezët duhet të ruhen nga djallëzitë e titistëve.

KURRË NUK DO TA PAKËSOJMË NDIHMËN TONË PËR POPUJT ARABË

Në mbledhjen ndërkombëtare parlamentare që propozojnë arabët (me shtytjen e sovjetikëve), të mos marrim pjesë. T'ua arsyetojmë këtë dhe t'u themi që ne kurrë nuk do ta pakësojmë, por do ta shtojmë ndihmën tonë për popujt arabë që luftojnë për liri kundër Izraelit dhe imperializmit.

LOJË E NDRË E REVIZIONISTËVE SOVJETIKË E BULLGARË

Revizionistët bullgarë pretendojnë të kenë ndihmuar në çlirim të Jugosllavisë me trupat fashiste të car Borisit, kundër të cilave kanë luftuar partizanët jugosllavë dhe partizanët tanë, kur kaluan në Kosovë dhe në Maqedoni. Titistët janë ata që janë, por kjo lojë e ndyrë dhe e poshtër e revizionistëve sovjetikë dhe e lakenjve të tyre bullgarë, duhet të demaskohet. E drejta duhet mbrojtur.

S'KA TYM PA ZJARR

Shokët kinezë në Pekin u thanë shokëve tanë: «Tash disa vaporë tanë do të vijnë në Shqipëri nga portet kinezë të veriut, duke kaluar nëpërmjet ngushticës së Tajvanit»!! Tanët u thanë: «Si?! Po atje patrullon Flota e 7-të Amerikane dhe çankaishiste, mos ngjasin incidente?». Por shokët kinezë u përgjigjën: «Ne duhet të ndjekim mësimet e Maos dhe të mos kemi frikë nga imperialistët» etj. Siç duket, takimet e ambasadorëve, kinez e amerikan, në Varshavë kanë dhënë ndonjë rezultat të parë. S'ka tym pa zjarr. Agjencia japoneze e lajmeve, një natë, shkoi më larg, duke thënë: «Flota e 7-të Amerikane nuk do të patrullojë më në ujërat e Tajvanit»!!

E MARTË
6 JANAR 1970

UJËT FLE, ARMIKU NUK FLE. TË NDJEKIM ME VIGJILENCË ZHVILLIMIN E NGJARJEVE NË JUGOSLLAVI

Pavarësisht dëshirës që ka, Titoja, sa të jetë vetë gjallë dhe Jugosllavia në këtë situatë kaotike në të cilën e ka katandisur ai, nuk i ka mundësitë që të na shkatërrojë. Ai nuk i hyn dot kësaj valleje të rrezikshme për të. Tentoi disa herë më parë, por dështoi. Tash ai ndjek «politikën e bashkekzistencës paqësore».

Por ne nuk harrojmë për asnjë çast fjalën e popullit: «Ujët fle, armiku nuk fle». Titoja është armiku ynë, ai nuk fle, prandaj ne duhet të jemi kurdoherë zgjuar, edhe tash që rron, edhe nesër kur të vdesë. Ne duhet të jemi të përgatitur mirë për nesër, që të mos na gjejë asgjë në befasi. Ç'do të ngjasë në Jugosllavi pas Titos, kjo është një çështje që na preokupon edhe ne, pse jugosllavët i kemi në kufi. Ashtu si paraqiten situatat aktualisht, do të ketë me siguri përleshje. Të çfarë natyre? Luftë për hegjemoni serbe e kroate. Serbët do të dominojnë, por këtë dominim do ta imponojnë në mënyrë paqësore, apo me armë? Në qoftë se do të ketë përleshje në mes nacionaliteteve të ndryshme që jetojnë në Jugosllavi, do të vihet pikëpyetja mbi ekzistencën e Federatës Jugosllave. Atëherë ka rrezik për ndërhyrje të jashtme imperialisto-revizioniste. Revizionistët bullgarë, vegla qorre të imperializmit sovjetik, do të reklamojnë dhe s'do të rrinë pa

sulmuar Maqedoninë që e rivendikojnë si tokë dhe popull bullgar. Mirëpo ata harrojnë, ose bëjnë sikur harrojnë, se në Maqedoni ka toka dhe një popullsi shqiptare. Socialimperialistët sovjetikë do të jenë për një Federatë Jugosllave, në rast se klika që do të sundojë atje do të jetë qojle e tyre, në të kundërtën, ata do të nxitin bullgarët për pushtimin e Maqedonisë dhe armiqësitë serbo-bullgare. Shqiptarët e Kosovës janë një popull luftëtar, i vendosur, patriot, që me siguri ka për të thënë edhe ai fjalën e tij. Prandaj, përpara një situatë të ardhshme të turbullt, të paqartë dhe me plot të papritura, kufijtë e vendit tonë duhet të jenë të siguruar fort, nga ata të mos kalojë as miza.

MËSIMET E KOMUNËS (V.I.LENIN)¹

«Bashkimi i detyrave kontradiktore — të patriotizmit dhe socializmit — ka qenë gabimi fatal i socialistëve francezë. Që në Manifestin e Internacionales, në shtator të vitit 1870, Marksi e pat paralajmëruar proletariatin francez që të ruhej nga rreziku i një ideje kombëtare të rreme: ndryshime të mëdha u bënë që në kohën e Revolucionit të madh, dhe kontradiktat e klasës u acaruan, dhe në qoftë se atëherë lufta kundër reaksionit të gjithë Evropës bashkonte gjithë kombin revolucionar, tani proletariati nuk mund t'i bashkojë më interesat e tij me interesat e klasave të tjera armike; përgjegjësinë për poshtërimin e kombit le ta mbajë borgjezia — detyra e proletariatit është të luftojë për çlirimin socialist të punës nga zgjedha e borgjezisë».

1 Këto në Ditar janë shënuar në gjuhën frëngjisht. Për përkthimin në shqip shih: Marks-Engels-Lenin-Stalin «Mbi Komunën e Parisit», bot. shqip, 1980, f. 200-201.

BISEDIME KINO-AMERIKANE NË RANG AMBASADORËSH

Shokët kinezë rifilluan në Varshavë «bisedimet» në rang ambasadorësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat i kishin pezulluar prej kohësh gjatë Revolucionit Kulturor. Takimet nuk bëhen më në ndërtesën polake, domethënë nuk janë nën kontrollin dhe përgjimin polak, të paktën në parim, por bëhen në ambasadat respektive të Kinës dhe të SHBA-së.

Kjo, natyrisht, i intrigon shumë revizionistët sovjetikë, të cilët nuk i shohin me sy të mirë këto bisedime dhe kanë frikë. Ata shpejtuan të dërgojnë Kuznjecovin në Pekin. Të tri shtetet po manovrojnë për të intriguar. Kina, **po të mos lëshojë**, bën shumë mirë që u futet si pykë, shfrytëzon kontradiktat dhe u turbullon ujërat.

TITO TRADHTARI NDODHET NË HALL

Titoja, që dikur rrinte si gjel dhe u përgjigjej flakë për flakë sovjetikëve, kur këta e sulmonin, tash përgjigjet me zë shumë të mekur ose nuk përgjigjet fare. Siç po duket, Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk po ia varin shumë, e shtrydhën sa deshën limonin dhe tash lëvozhgën e kanë lënë në rezervë. Nga ana tjetër, Titoja situatën brenda e ka si mos më keq dhe, siç po duket, kësaj po i trembet shumë. Do të marrë masa kundër kundërshtarëve të tij, por këta janë të shumtë, mundet dhe të fortë, kanë edhe mbështetjen e jashtme. Tradhtari është në hall. Kështu do ta pësojnë të gjithë tradhtarët e marksizëm-leninizmit dhe të popujve të tyre: sot Titoja, nesër Gomulka, pasnesër Brezhnjevi e kompani.

SHËNIM

Afër Kunminit në Kinë ra një tërmet shtatë ballësh. U bëmë shokëve Mao e të tjerëve një telegram. Nuk dimë demet në njerëz, se në ndërtesa duhet të ketë pasur. Thuhet se epiqendra e tërmetit ka qenë në Birmani.

NJË ANALIZË QË MAOJA DUHET TA BËJË

Duhet bërë të qarta:

1) Cilat janë karakteristikat e Revolucionit Kulturor brenda Kinës dhe cilat janë karakteristikat e tij ndërkombëtare, ashtu siç i përcaktoi Lenini për Revolucionin e Madh Socialist të Tetorit.

2) Kur flitet për imperializmin duhet bërë analiza aktuale në vijim të analizës që i ka bërë Lenini imperializmit. Këtë gjë mendoj se duhet ta bëjë edhe Mao Ce Duni, veçanërisht për Revolucionin Kulturor.

E ka bërë tash këtë? Më duket se jo akoma. Asnjë material të tillë nuk kemi parë. Flitet se ai ka mbajtur në Kongresin e 9-të të partisë fjalime «të rëndësishme», por asgjë s'ka pipëtirë jashtë. Raporti i Lin Biaos në Kongresin e 9-të nuk është i kësaj natyre që mendoj unë, dhe as artikujt e zakonshëm që janë shkruar brenda këtyre tre vjetëve në shtypin kinez. Këtë gjë, më duket mua, Maoja duhet ta bëjë, meqë shokët kinezë flasin vazhdimisht se «ky revolucion ka një rëndësi ndërkombëtare dhe marksistë-leninistët duhet të frymëzohen prej tij».

SIMITET E RADIO MOSKËS

Mbrëmë lexova një «simite» nga ato të zakonshmet, që lëshon Radio Moska, në lidhje me «dashurinë e zjarrtë» që ushqejnë revizionistët për popullin shqiptar. Paskan bërë një film dokumentar me metrazh të gjatë, pikërisht për ta ilustruar këtë «dashuri». Por më tërhoqi vëmendjen diçka e re, që s'e kisha parë deri tash, reklama që i bënin ardhjes së flotës sovjetike në Shqipëri, «këngëve të korit të marinarëve dhe të admiralëve sovjetikë, që buçitnin me këtë rast në sheshin «Skënderbej»». Mos vallë kjo është demagogji e rastit si përherë, apo ndokush me mënyrën e vet do të na thotë: «Kini mendjen nga flota sovjetike në Mesdhe». Ne sidoqoftë nuk flemë.

TË SHPARTALLOHEN KOMPLOTET KRIMINALE KUNDËR INTERESAVE SOVRANË TË RD GJERMANE

Artikulli me titull: «Të shpartallohen komplotet kriminale kundër interesave sovranë të RD Gjermane» iu dërgua gazetës «Zëri i popullit»¹ që ta botojë në numrin e saj të nesërm.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 557.

RRUGA E VETME PËR TË SHPËTUAR NGA THUNDRA E KAPITALIT ËSHTË LUFTA E KLASAVE

Të ngrihen zorrët përpjetë kur dëgjon revizionistët toliatistë dhe «demokratët» saragatistë e deri te priftërinjtë e Moros dhe të Fanfanit të flasin për «demokracinë», për «të drejtat e punëtorëve», për «të drejtën e grevës» e një mijë «të drejta» të tjera për punonjësit dhe, nga ana tjetër, ata vënë çdo gjë në lëvizje për t'i shtypur dhe për t'i zhdukur këto të drejta.

Të ashtuquajturat sindikata punëtoresh nuk mbrojnë asnjë të drejtë të punëtorëve, bëjnë sikur i mbrojnë, bëjnë shumë llafologji, por ato manipulohen nga kapitali, nga patronati nëpërmjet njerëzve të tij, që ka sjellë në krye të tyre. Aristokracia punëtoresh që i drejton ata, prapa kurrizit të punëtorëve manipulon, intrigon, bie në ujdi me padronët dhe bën plane e merr vendime të atilla, që kanë për qëllim të degjenerojnë ndërgjegjen e klasës, qëllimet e vërteta të klasës punëtoresh, për të dobësuar luftën e saj kundër kapitalit.

E vetmja rrugë shpëtimi është zgjimi i ndërgjegjes së klasës, demaskimi i këtyre pseudodemokratëve që «premtojnë» për të gënjyer. Këta qen roje të kapitalit, në pamundësi të shuajnë antagonizmat e klasave, duan t'i zbutin këta, t'i sheshojnë, t'i rregullojnë për të shmangur pikërisht acarimin e luftës së klasave. I vetmi shpëtim nga thundra e kapitalit është lufta e klasës, lufta e pa-

mëshirshme dhe pa kompromis çdo ditë e në çdo fushë të jetës. Ajo duhet të ecë në ngritje dhe, kur interesat e proletariatit e kërkojnë, të shndërrohet në një luftë me armë, në një luftë civile, për të rrëzuar pushtetin e borgjezisë dhe për të vendosur diktaturën e proletariatit. Ky është qëllimi i luftës sonë, ky nuk është qëllimi i revizionistëve toliatistë dhe i plehrave të tjera pseudodemokrate.

Natyrisht, shokët tanë marksistë-leninistë italianë kanë një fushë të gjerë pune dhe detyra të mëdha për të kryer. Por ata po rrezikojnë të adoptojnë metodat burokratike të punës së revizionistëve toliatistë, s'po futen në masë si duhet, nuk organizojnë aksione hap pas hapi, grinden për «pushtet» që nuk e kanë, zihen kush të jetë në krye të «zyrës» së krimbur, për «lokalet», për «famën personale» ose për rrogën më të mirë dhe rehatinë!! Ç'revolucionarë mund të quhen këta?! Këta duhet t'i spastrojnë dhe të ruajnë të mirët.

Çdo muaj nga radhët e tyre po krijohen fraksione! U mbush Italia me «grupe marksiste-leniniste» që vetëquhen PKI (m-l) ose me pak ndryshime. Kjo është një krizë që duhet të kalohet, por vetëm me një punë të shëndoshë dhe luftë revolucionare.

E MARTË
13 JANAR 1970

VEPRIME TË DREJTA VETËMBROJTËSE TË KINEZËVE

Sovjetikët janë shumë të alarmuar nga demaskimet e fundit që po u bën propaganda kineze. Më e tmerrshmja për ta është se ashtu siç thotë populli «donin të trembnin kinezët, po tash po tmerrohen vetë». Sovjetikët, në vjesh-tën e vitit të kaluar, grumbulluan forca në kufirin kinez, thuhet 800 000 veta. Atëherë kinezët filluan të marrin kundërmasa, kanë ngritur tash tërë popullin në këmbë dhe po e përgatitin për luftë. Kudo në Kinë po bëhen strehime, përgatitje etj. «Do luftë, hajde se gati jam». Kjo është përgjigjja më e mirë dhe më revolucionare që mund t'u jepet tradhtarëve dhe imperialistëve. Kjo do të shkaktojë krizë në politikën e shantazhistëve revizionistë sovjetikë.

E PREMTE
16 JANAR 1970

«AL FATAHU» NUK DUHET TË BJERË NË KURTHIN E SOVJETIKËVE

Lufta e popujve arabë kundër Izraelit është reduktuar në të vetmen luftë partizane që bëjnë palestinezët kundër pushtuesve të atdheut të tyre. Të tjerët bëjnë si të thuash llafe, mbajnë diskure «të zjarrta», bëjnë konferenca e mbledhje të çdo niveli, vendosin e zhvendosin, por sidomos ato që vendosin i marrin vesh menjëherë Izraeli dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, kështu që çdo gjë mbytet që në vezë.

Izraeli qëndron mbi vendet arabe si skifter: një i vrasin, 20 u vret, një avion i dëmtojnë, 15 avionë u djeg në aerodrome, një rojë kufitare i zënë rob, 22 robër u kap të nesërmen. Një radiolokator sovjetik modern 7 tonësh ua çmontoi në brigjet e kanalit të Suezit, e ngarkoi në helikopter dhe e çoi në Tel-Aviv.

Naseri është futur tash kokë e këmbë nën urdhrat e sovjetikëve, ashtu siç janë nën urdhrat e anglezëve e të amerikanëve mbretërit dhe kryetarët e shteteve të Jordanisë, të Arabisë Saudite, të Kuvajtit, mundet edhe të Irakut, kurse të Libanit po e po. Pra, të vetmit që luftojnë realisht në botën arabe janë partizanët palestinezë. Këta janë bërë të rrezikshëm për të gjithë, prandaj një pjesë dëshiron dhe lufton që t'i zhdukë, pjesa tjetër do t'i futë në kthetrat e saj. Grupi i Naserit u buzëqesh, por do që t'i drejtojë ai, pse me anën e tyre dëshiron të tre-

gohet sikur lufton, por edhe t'i dominojë, se i prishin punë në tratativat oportuniste që bën. Sovjetikët, që janë zjarrfikësit e luftërave revolucionare nacionalçlirimtare, duan t'i hedhin në dorë «Al Fatahun» dhe grupimet e tjera partizane palestineze, t'i shtrydhin e t'i drejtojnë siç po bëjnë me Naserin, në interes të politikës së tyre imperialiste. Kudo ku zhvillohet luftë nacionalçlirimtare, kur agresorët thyhen e humbasin dhe popujt janë duke fituar, kështu ngjet, revizionistët sovjetikë ndërhyjnë me demagogji, gjoja premtojnë të japin armë dhe ndihma të tjera, po këtë e bëjnë për të shuar luftën, për të humbur fitoren dhe për të shpëtuar agresorët. Këtë bëjnë sovjetikët tash edhe me «Al Fatahun». Ata gjoja u duan të mirën palestinezëve, gjoja duan t'i ndihmojnë, por me siguri duan t'u bëjnë varrin. Duhet t'ua demaskojmë këtë veprim tjetër të poshtër. «Al Fatahu» s'duhet të bjerë në kurthin e tyre.

TAKIM ME DELEGACIONIN TREGTAR QEVERTAR KINEZ

Sot u takova me delegacionin tregtar qeveritar të RP të Kinës¹, që ka ardhur në Shqipëri për të përfunduar marrëveshjen tregtare të vitit 1970, e cila u firmos sot. Asistonte edhe Hysniu dhe shokë të tjerë. Nga ana e kinezëve asistonte edhe ambasadori i tyre Gën Biao. Marrëveshja tregtare doli mirë dhe bisedimet ishin shumë të ngrohta e të përzemërta.

¹ Delegacioni kryesohej nga Lin Haj Jun i ngarkuar me punët e ministrit të Tregtisë së Jashtme të RP të Kinës.

TAKIM I PARË I PËRFAQËSUESVE TË DHOMAVE TË TREGTISË TË SHQIPËRISË DHE TË GREQISË

Përfaqësuesi i Dhomës së Tregtisë sonë mori kontakt me përfaqësuesin e Dhomës së Tregtisë Greke në Paris, sipas marrëveshjes që pati Halim Budo në Nju-Jork me përfaqësuesin grek. Bisedimet shkuan mirë. Greku, Kanelopulos, u tregua «shumë i sjellshëm e miqësor». Yni po ashtu. Të shohim ç'do të dalë nga ky takim i parë.

LUFTA E ARMATOSUR E POPULLIT PALESTINEZ ËSHTË E PAMPOSHTUR

Ripashë artikullin: «Lufta e armatosur e popullit palestinez është e pamposhtur». I shtova edhe një paragraf në të cilin e bëj të qartë çështjen se revizionistët sovjetikë, duke dhënë disa armë, përveç të tjerave, do të përpiqen të hedhin në dorë drejtimin e luftës nacionalçlirimtare palestineze, sepse armët do t'i japin me kondita dhe tok me konditat do të venë edhe «këshilltarët», «specialistët», spiunët e sabotatorët. Artikulli do të botohet nesër në gazetën «Zëri i popullit»¹.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 565.

PROBLEME TË KLASËS PUNËTORE DHE TË KAPITALIT MONOPOLIST

Punova sot në shtëpi për disa probleme të klasës punëtoare dhe të kapitalit monopolist. Shënimet, që po i shkruaj më poshtë, mund të më shërbejnë më vonë, për raportin e Kongresit të 6-të të Partisë.

Në vendet kapitaliste haset sot fenomeni i akumulimit të kapitalit monopolist. Ky akumulim bëhet në shkallë të gjerë në të gjitha drejtimet dhe kapitali përqendrohet në disa duar të borgjezisë së madhe monopoliste. Mjetet e prodhimit, pronë private e borgjezisë së pasur, përqendrohen në pak duar. Kjo borgjezi e madhe monopoliste sa vete dhe identifikohet me shtetin kapitalist, qeveria atje përbëhet ose drejtohet prej saj drejtpërdrejt, ose nëpërmjet përfaqësuesve të saj të plotfuqishëm. Pra, veprimet e qeverive kapitaliste, si në politikë, si në ekonomi (investime, taksa, çmime, kredi etj.), si në kulturë e në arsim dhe si në ushtri, priren, në radhë të parë, drejt interesave të monopoleve; ato ndihmojnë koncentrimin e monopoleve që veprojnë si në sferën kombëtare, ashtu dhe në atë ndërkombëtare. Këto kanë edhe karakter kozmopolit gjë që u shërben për të korrur fitime në tregjet e jashtme dhe për të bërë presionet e nevojshme në tregjet e brendshme.

Akumulimi i kapitalit monopolist, natyrisht, bëhet me të gjitha format dhe metodat që disponon vetë dhe

shteti i tij, si me politikën e çmimeve, me supertregjet, me automatizimin, me mosdhënien kredi, me mosdhënien e veglave të punës, të farërave, të plehrave, me ngritjen e taksave etj., nëpërmjet shpronësimit të industrialistëve të vegjël, të fshatarësisë, të tregtarëve të vegjël, të artizanëve etj. Nga ana tjetër, ata që s'mund t'i likuidojnë shpejt, i vë «në bashkëpunim», që në fakt do të thotë se shpejt ose vonë «peshku i madh do ta hajë të voglin».

Akumulimi i kapitalit monopolist shton rrogëtarët, klasën punëtore, shton edhe inteligjencien. Por ai izolohet, gjithashtu, çdo ditë e më shumë borgjezinë e pasur nga klasat e tjera dhe çarjet e kontradiktat në fraksionet e ndryshme të klasës borgjeze (një nga klasat bazë në vendet kapitaliste), bëhen më të thella dhe më të ndjeshme. Kjo krijon situata dhe mundësi për klasën punëtore, që të organizojë më mirë luftën kundër borgjezisë monopoliste, të krijojë aleanca taktike, politike dhe ekonomike luftime kundër kësaj borgjezie, që ka hedhur në kontradikta të thella me të fraksione të mëdha të borgjezisë në përgjithësi, të borgjezisë së mesme dhe të vogël të qytetit dhe të fshatit.

Pra si konkluzion: përqendrohen mjetet e prodhimit, shtohen njerëzit me rrogë, izolohet borgjezia e madhe dhe shtohen të çarat e kontradiktat në gjirin e fraksioneve të borgjezisë; shtohen klasa punëtore dhe mundësitë për të për luftë dhe për aleanca.

Borgjezia, kapitali monopolist dhe shteti i tyre prodhorin çdo mjet, që nga demagogjia politike, nga propaganda arsimore e kulturore e deri te masat shtypëse, për të thyer çdo rezistencë të klasës punëtore dhe të masave punonjëse.

Armiku kryesor e i vendosur i borgjezisë është klasa punëtore. Kjo është varrmihësi i borgjezisë dhe strumbullari rreth së cilës duhet të organizohen forcat e luftës kundër kapitalit. Për këtë arsye shigjetat e kapitalit janë

drejtuar kundër saj, për ta gënjyer, për ta goditur e për ta penguar që të luftojë dhe të veprojë. Ato bëhen për ta mbajtur atë të përçarë, për t'i krijuar iluzionin se roli i saj ka ndryshuar, se tani është spostuar qendra e gravitetit, se po zhvillohet revolucioni tekniko-shkençor, se kapitalizmi ka ndryshuar, është zëvendësuar me teknokratizmin, se inteligjencia ka marrë rolin preponderant dhe drejtues të evoluimit të kapitalizmit në socializëm. Ato përpiqen ta bindin gjoja se ka ardhur koha që punëtorët të bëhen «minikapitalistë», duke blerë disa aksione të ndërmarrjes, se në udhëheqjen e ndërmarrjes mund të kooperohet me disa përfaqësues të punëtorëve dhe kështu të mund të evitohen grevat e të zhdukët lufta e klasave. Nga borgjezia dhe agjenturat e tyre të inkuadruara në sindikatat e ndryshme dhe në partitë revizioniste dhe socialdemokrate përhapen teoritë e vetadministritit titist që në Perëndim quhen «coogestion» e një mijë teori të tjera oportuniste dhe revizioniste, që ziejnë në vendet kapitaliste dhe në gjirin e klasës punëtore. Të tëra këto përbëjnë një lëmsh të madh të hekurt në këmbët e proletariatit në vendet kapitaliste.

Përcaktimi i proletarit nga Marksi

«Me fjalën «proletar» në kuptimin ekonomik duhet të kemi parasysh vetëm e vetëm punëtorin me mëditje, i cili prodhon dhe shton «kapitalin» dhe flaket në rrugë të madhe me t'u bërë i tepërt për nevojat e rritjes së vlerës së «zotit kapital». . .»¹.

Marksi thotë po ashtu se përbri punëtorëve ekziston personel (numerikisht i parëndësishëm) inxhinierë, mekanikë, zdrukthëtarë etj. që survejojnë mekanizmin e për-

¹ K. Marks. «Kapitali», vëllimi i parë, libri 3, shpjegimi 70, f. 74.

gjithshëm dhe bëjnë riparimet e nevojshme. Por këta, sipas Marksit, përfaqësojnë një shtresë përmbi punëtorët, disa të formuar shkencërisht, disa duke pasur një mjesh-tëri jashtë rrethit të punëtorëve të fabrikës të cilat janë ngjitur.

Me zhvillimin e ekonomisë, të industrisë, të bujqë-sisë, të arsimit, të kulturës dhe të shkencës, në përgjithë-si, si edhe të organeve shtetërore, qoftë te ne ku ndërto-het socializmi, qoftë në vendet revizioniste, qoftë në ato kapitaliste, këto shtresa janë shtuar shumë, por klasa pu-nëtoare është klasa dominuese, asgjë nuk mund ta ndry-shojë këtë natyrë, as edhe rolin e saj udhëheqës në luftë për shkatërrimin e pushtetit të borgjezisë e të kapitalit. Vetëm borgjezia dhe revizionistët përpiqen të ndryshojnë natyrën, funksionet dhe rolin historik të klasës punëtoare.

Pikërisht këtë pjesë do ta zhvilloj në vija të trasha një herë tjetër për të vënë më mirë në dukje tezat tona marksiste-leniniste në këtë çështje dhe tezat e borgjezisë dhe të revizionistëve nga ana tjetër dhe të konfrontohen këto në zhvillimin në praktikë, në zhvillimin dialektik marksist-leninist të ne dhe në procesin antimarksist tek ata.

E DIEL
25 JANAR 1970

KINEZËT PO PUNOJNË PËR RIORGANIZIMIN E PARTISË SË TYRE

Sipas informatave që na dërgon ambasadori ynë nga Pekini, shokët kinezë punojnë aktivisht për riorganizimin e partisë në bazë, për zgjedhjen e komiteteve, bile në disa rajone kanë filluar edhe riorganizimin e rinisë. Kjo është puna e parë dhe më e rëndësishmja.

E HËNË
26 JANAR 1970*

HAPJA E POLITIKËS SË JASHTME KINEZE

Mendoj se një nga objektivat kryesorë të Kinës në Azi duhet të jetë hapja e politikës së saj në radhë të parë drejt Japonisë. Japonia është Gjermania e Bonit në Lindjen e Largme. Amerikanët, që në kohën e Luftës së Dytë Botërore, edhe pas saj, kanë punuar dhe janë përpjekur ta mbajnë Japoninë nën zarin e tyre. «Zapi» vazhdon dhe është shndërruar në influencë politike dhe në marrëdhënie të ngushta e të ndërlidhura ekonomike. Megjithatë, Japonia i ka thyer deri diku kornizat amerikane dhe bën përpjekje për depërtimin ekonomik në vende të ndryshme të botës, duke konkurruar dhe vetë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Po ajo nuk bën po atë zhurmë «pavarësie» që bën Gjermania Federale në Evropë. Sigurisht Japonia nuk rri qetë, por bën hapa të matur.

Sovjetikët po i bëjnë avanca Japonisë, po i marrin kredi, po i japin koncesione në Siberi. Atyre u intereson kjo edhe ekonomikisht, por edhe politikisht e ushtarakisht, se izolojnë Kinën. Japonezëve kjo u intereson ekonomikisht, se gjejnë një vend ekspansioni, bëjnë presion mbi Kinën dhe, duke përfituar nga aleanca sovjeto-amerikane, përpiqen t'i shpëtojnë, kështu, darës amerikane.

Amerikanët nuk mund ta mbajnë dot tërë jetën nën zinxhir Japoninë. Por, duke dashur ta kenë një pion shahu e si të vetmen bazë strategjike serioze në përgatitjet e tyre për një luftë eventuale kundër Kinës, janë të dety-

ruar të punojnë për të bërë të paefektshme planet dhe synimet sovjetike ndaj Japonisë. Mirëpo ka probabilitet që Japonia të mos bëhet vegël as e njërit, as e tjetrit, duke ditur se në këtë rast, si imperialist agresor i tretë, fitimet e tij do të jenë hipotetike.

Pikërisht, po të pranojmë këtë probabilitet, Kina, si fuqi e madhe me një potencial të madh politik, ekonomik dhe ushtarak, duhet ta hapë politikën e saj të jashtme në drejtim të Japonisë. Kjo ka nevojë të bëjë tregti, ka nevojë për tregje dhe Kina është për Japoninë vendi që ajo ëndërron për këtë punë. Në rast se kinezët fillojnë dhe lëvizin me Japoninë, me anën e tregtisë në radhë të parë, pastaj duke shkëmbyer edhe ambasadorë, statukoja aktuale në Lindjen e Largme fillon të priset. Në murin sovjeto-japonez, por edhe në atë amerikano-japonez fillojnë të çarar. Kina del aktivisht në arenën politike dhe ekonomike, gjë që do të ketë rrjedhime edhe në strategjinë e luftës që po përgatitin revizionistët sovjetikë dhe imperialistët amerikanë. Me këto veprime të kinezëve, pioni japonez nuk është më i manovrueshëm, siç ka qenë më parë, do të dobësohen mundësitë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës ta përdorin Japoninë si të duan dhe kur të duan, si një bazë sulmi kundër Kinës, siç e përdorën në luftën e Koresë. Kjo avancë e kinezëve drejt Japonisë është e përshtatshme tash, se ata filluan edhe bisedimet, në rang ambasadorësh, në Varshavë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo gjë mund të lehtësojë edhe avancimin e japonezëve.

Revizionistët sovjetikë, sic e dimë, bënë provokacionet ushtarake në kufijtë me Kinën dhe për shantazh e frikësim dërguan 1 milion trupa në Mongoli e në kufi me Sinkiangun. U bë takimi midis Çu En Lait dhe Kosiginit (për të cilin ne nuk ishim dakord, kurse Çu En Lai kishte shpresa dhe u zemërua me ne etj.), por nuk dha asgjë. Atëherë Maoja dha urdhrin e përgatitjes të të gjithë po-

pullit për luftë kundër një agresioni revizionist sovjetik dhe imperialist. Dhe përgatitjet janë të mëdha. Kjo po i tmerron sovjetikët. Bile jo vetëm po i ngatërron brenda, por krijon për ta kriza edhe jashtë. Sovjetikët ose duhet të përgatiten seriozisht për të sulmuar, dhe atëherë brenda vendit, ekonomikisht e politikisht, do të ngjasin gjëra të çuditshme, ose do të tregojnë që gjithë kjo ishte një bluf. Zaten gjithë politika e revizionistëve sovjetikë është në krizë, brenda në Evropë, në Lindjen e Afërt dhe në Lindjen e Largme.

Kina duhet dhe i ka të gjitha mundësitë që t'ia thellojë revizionizmit sovjetik krizën që e ka mbërthyer. Ajo duhet të veprojë gjallërisht, në mënyrë të zgjuar dhe me të gjitha mjetet, në të gjitha anët e botës, për ta dënuar revizionizmin sovjetik dhe jo vetëm në drejtim të Japonisë nga mund t'i vijin rreziqe ushtarake, por edhe në drejtim të Indisë, e cila është më pak e rrezikshme ushtarakisht, shumë e dobët ekonomikisht dhe ushtarakisht. Atje mjaft që të dozohen marrëdhëniet për të ruajtur rellatat e mira me Pakistanin, i cili është në konflikt me Indinë. Me Bashkimin Sovjetik Kina ta vazhdojë këtë vijë të ashpër, ta izolojë atë nga çdo pikëpamje, bile mund t'i studiojë dhe t'i thellojë akoma më shumë kontradiktat midis Bashkimit Sovjetik e Polonisë, sido që në dukje grupi i Gomulkës paraqitet sikur e ka mirë me sovjetikët, por në fakt ka kundërshtime me ta. Zënkat me Poloninë ua çrregullojnë krejt planet sovjetikëve. Këto çështje do të gjej momentin t'ia sugjeroj ambasadorit kinez, që t'ia raportojë Pekinit.

E PREMTE
30 JANAR 1970

**PËR ARTIKULLIN «POLITIKA E RP TË KINËS PËR
MBROJTJEN E ATDHEUT DHE PËRGATITJET
PËR RAST LUFTE — POLITIKË E DREJTË
REVOLUCIONARE»**

Lexova artikullin me titull: «Politika e RP të Kinës për mbrojtjen e atdheut dhe përgatitjet për rast lufte — politikë e drejtë revolucionare», që duhet të botohet nesër në gazetën «Zëri i popullit». Ia dërgova Ramizit që ta japë për botim. Por porosita që më përpara, aty para paragrafit të fundit, krahas përgatitjeve për mbrojtje të shkruhet për sukseset në ekonomi dhe të shfaqet solidariteti ynë me popullin kinez.

NJOFTIM LAKONIK I KINEZËVE

Kinezët po na informojnë në mënyrë lakonike se bisedimet e tyre zyrtare me sovjetikët në Pekin, për problemet e kufirit, nuk po japin gjë, kanë mbetur në vend.

KUJDES NGA PROVOKATORËT RANKOVIÇIANË

Nga një radiogram që na bën ambasadori ynë në Bukuresht, të ashtuquajturit marksistë-leninistë jugosllavë nuk duhet të jenë veçse provokatorë rankoviçianë ose njerëz të sovjetikëve, pse, në bisedat që kanë bërë dhe në kërkesat e tyre tregohen gjoja si antititistë dhe në fakt flasin po nga pozitat e Rankoviçit dhe të sovjetikëve dhe duan nga ne «ndihma morale dhe materiale» për të aktivizuar luftën kundër Titos, pse, sipas tyre «Titoja është dakord me Brezhnjevin, që t'i lërë këtij të lirë korridorin e Maqedonisë për të na sulmuar ne». Kjo është e qartë, e servirur nga sovjetikët, për të na e servirur dhe ne ta hamë. Po ne nuk i hamë të tilla provokacione dhe jemi në gjendje të bëjmë deduksione nga koniunkturat aktuale dhe të së nesërme së Jugosllavisë. Aktualisht Titoja nuk e lejon një gjë të tillë, bile ai do t'ua kundërshtojë dhe e ka kundërshtuar. Nga ana tjetër, këta farë marksistë janë të lidhur me të famshmin aventurier Dapçeviç, agjent i sovjetikëve e i shumë të tjerëve. E udhëzuar ambasadorin t'i rrallojë, në mos t'i presë, lidhjet me ta, se asnjë kërkesë e tyre nuk pranohet dhe, po të piqet me ta, t'u bëjë disa pyetje politike për t'u dhënë të kuptojnë këtyre agjentëve të revizionizmit se ne s'na gënjejnë dot.

MONTEKATINI I ULI PENDËT

Shtrengesa e rreptë dhe e drejtë që i bëmë firmës monopoliste italiane «Montekatini» për të vënë në efikasitet të plotë Uzinën e Azotikut në Fier, zuri vend. Firma i uli pendët, ajo iu tremb demaskimit dhe dërgoi me vrap specialistët, të cilët kanë ardhur dhe janë shfaqur me «qëllime të mira», që uzina të vihet «medoemos» në efikasitet të plotë, të japë të paktën 120 000 tonë plehra në vit.

Të shohim. Nuk ekskludohet që edhe nga ana jonë duhet të bëhen përpjekje të mira për ngritjen e kuadrit dhe për evitimin e avarive. Ç'janë të furnitorëve dhe të ndërtuesve t'ua lëmë atyre, por ç'janë tonat, janë tonat. Kështu është e drejta.

ARTIKUJT TANË NË MBROJTJE TË RD GJERMANE BËNË EFEKTIN E DUHUR

Dy artikujt tanë, për mbrojtjen e Republikës Demokratike Gjermane, siç duket kanë bërë efekt në këtë vend dhe në udhëheqjen e saj, pse ambasadorët e Gjermanisë Lindore s'mungojnë t'u shfaqin tanëve kënaqësinë e vet, duke u thënë: «Ju, shqiptarët, jeni të vetmit që i kuptoni dhe i mbron drejt e me konsekuencë të drejtat e Republikës sonë». Ndryshe nga çdo herë tjetër, shtypi borgjez perëndimor i injoroi krejt këta dy artikuj, nuk i leverdiste t'i trajtonte se ata u zbulonin keqas qëllimet. Brandi s'është veç kukull në mëshirën e votës së reaksionit të Bonit, ai mund të thyejë qafën në çdo moment që do ta duan reaksioni dhe revanshistët gjermanë.

PK E FRANCËS (M-L) KËRCËNOHET NGA PËRÇARJA

Shokët e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Francës (m-l) dhe posaçërisht Marti dhe Zhyrke na lajmërojnë se partia e tyre ndodhet përpara një grupi fraksionist të udhëhequr nga Kombë. Ai ka rreth tij dy-tre shokë të Komitetit Qendror dhe është «inkurajuar» sipas tyre edhe nga qëndrimet e Kazasë që «është shok i mirë, po ca liberal». Shigjetat e fraksionistëve i drejtohen Zhyrkes, i cili akuzohet se «monopolizon punën, nuk mbledh Komitetin Qendror» etj. Por fakt është se udhëheqje nuk ka ose ajo është e paqenë, pse Zhyrke qe për dy muaj në Kinë, Marti rri në Perpinjan, Berzhëroni interesohet më shumë për librarinë, edhe një a dy të tjerë kështu vep-rojnë. Pra partia nuk drejtohet, nuk ndihmohet sa duhet, prandaj ngjasin gjëra të tilla.

Marti dhe Zhyrke në takimin e parë me shokët tanë u paraqitën të tronditur dhe u kishin thënë se kjo gjë «i kishte dëshpëruar shumë dhe një herë kishin menduar të jepnin dorëheqjen nga udhëheqja, por e mblodhën veten dhe vendosën të luftonin». Sa keq! Ç'do të bëhet më tej, kur do të nxehet lufta nga të katër anët? Shokët tanë i inkurajuan, u folën për rreziqet që ka kaluar Partia jonë dhe se me luftë i ka kapërcyer, se ajo asnjëherë nuk ka njohur dëshpërime, jo përpara rreziqeve të tilla, por as përpara luftës së madhe me nazistët. Shokët më vonë u kthyen prapë më të qetë, më optimistë dhe të bindur se do ta zgjidhin këtë çështje. Të shohim si do ta zgjidhin.

PROBLEME TË KLASËS PUNËTORE DHE TË KAPITALIT MONOPOLIST

Shënime¹

Kapitali monopolist shtetëror synon mbajtjen në skllavëri të plotë të popullit, varfërimin e masave punonjëse, mbajtjen në injorancë dhe shfrytëzimin sa më të thellë e barbar të tyre. Ai synon të krijojë e të forcojë çdo ditë mjete dhe forma të ndryshme për të shtypur, për të shpartalluar ose për të çoroditur rezistencën dhe luftën e masave punonjëse kundër shfrytëzimit kapitalist.

Drejtimet shtetërore të ekonomisë, të kulturës dhe të ushtrisë në vendet kapitaliste, vetëm etiketat e jashtme kanë «demokratike», atje sundon thundra e egër e kapitalit, ligji i tij i xhunglës. Atje ka «demokraci» për të pasurit dhe jo për të varfrit. Të varfrit duhet t'u nënshtrohen ligjeve të kësaj lloji demokracie, e cila, natyrisht, përpiqet të krijojë përshtypjen në të varfrit se kjo lloji «demokracie» e votës «popullore», që zgjedh senatorët amerikanë, «është demokracia më e përsosur në botë». Kurse realiteti është krejt i ndryshëm, asnjëri nga senatorët amerikanë, qofshin këta «demokratë» apo «republikanë», nuk del nga gjiri i shtresave punonjëse, por ata

¹ Këto shënime autori i ka pasur parasysh kur ka hartuar tezat e raportit të Kongresit të 6-të të Partisë.

s'janë as edhe nga çdo lloj fraksioni i borgjezisë. Ata janë nga ato fraksione të shtresave të larta të borgjezisë kapitaliste të formuar, posaçërisht, për të ardhur në vendet kyç drejtuese të shtetit kapitalist. Kjo është ajka, aristokracia e kapitalit, *de jure* dhe *de facto*. Këta ministra e senatorë vijnë dhe janë udhëheqës ose anëtarë në këshillat e konsorciumeve dhe të bankave më të mëdha të vendit. Deri tash statistikat amerikane nuk japin asnjë rast të ndonjë senatori o ministri me prejardhje nga klasa punëtore, për këtë as që bëhet fjalë, por as nga shtresat e mesme të borgjezisë. Në këtë pasqyrë është ndërtuar trupi i piramidës në të gjitha drejtimet kyç. Kuptohet lehtë për çfarë regjimi bëhet fjalë në këtë rast dhe për çfarë «demokracie» propagandohet.

Në vende të tjera kapitaliste format e jashtme mund të mos jenë plotësisht të njëjlojta me ato të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por në brendi, në esencë dhe në praktikë të gjërave, është njësoj. Në parlamentin anglez ka edhe laburistë, përfaqësues të «tredunioneve». Këta hiqen si përfaqësues të klasës punëtore angleze, por në realitet janë elementë të aristokracisë punëtore, përfaqësues të borgjezisë në shërbim të plotë të kapitalit dhe të imperializmit anglez. Kjo parti gjoja në opozitë, «Labour Party», vjen edhe në pushtet, por në realitet në pushtet nuk është në fuqi klasa punëtore angleze, po kapitali anglez. **Laburistët janë administratorët servilë të kapitalit imperialist anglez, ata janë, si me thënë, shtresa e teknokracisë politike në shërbim të kapitalit monopolist.**

Në Francë ndodh e njëjta gjë, por këtu më e theksuar është gjoja demokracia. Në parlamentin francez vijnë edhe komunistë, në qeveri vijnë edhe socialistë, formohen qeveri të përziera me përfaqësues të partive të ndryshme borgjeze. Tash revizionistët francezë, që predikojnë marrjen e pushtetit nëpërmjet rrugës paqësore parlamentare dhe me koalicione antimarksiste me borgjezinë,

përpiqen të futen edhe ata në qeverinë e ardhshme. Me gjithë këto ndryshime, edhe në këto vende sundon kapitali monopolist dhe këto lloj ndryshimesh që japin përshtypjen e njëfarë demokracie, në qoftë se klasa punëtore dhe masat punonjëse nuk i analizojnë, nuk i thellojnë, atëherë mbeten iluzione të kota që i lejon, deri në njëfarë shkalle, edhe vetë kapitali për të zgjatur jetën e sundimit të tij.

Zhvillimi i kapitalit monopolist dhe përqendrimi i tij në pak duar shkaktojnë ndryshime në gjendjen e klasave dhe veçanërisht në fshatarësinë dhe në shtresat e mesme të borgjezisë.

Kapitali futet në fshat, ai shpronëson tokat dhe i hedh fshatarët në rrugë, duke krijuar kështu rezervën e proletariatit të qyteteve. Këtë e bën me të gjitha mjetet e fuqishme financiaro-ekonomike që disponon si dhe me anë të shtetit të tij të monopoleve. Ai krijon ferma të mëdha me mekanizim të madh, me rendiment të lartë, lë toka të gjera djerrë, i shpopullon ato, i varfëron, krijon supertregjet dhe dikton çmimet e prodhimeve bujqësore e blegtorale. Kështu fermat bujqësore private, të reduktuara ose të dobëta, duhet të pajtohen te kapitalisti dhe ta furnizojnë atë me çmimet që u cakton ai, ndryshe janë të destinuara të zhduken.

I njëjti fenomen ngjet në qytete me tregtarët e mesëm e të vegjël, me fabrikantët e vegjël ose të mesëm, me artizanët. Të gjithë këta janë futur në darën e hekurt të monopoleve të mëdha kapitaliste, që, ose i zhdukin, ose i detyrojnë të prodhojnë nën drejtimin e tyre, natyrisht, derisa u intereson atyre. Tregtarët e mesëm dhe të vegjël po ashtu nuk mund të rrojnë dot përpara konkurrencës së madhe që u bëhet nga zgjerimi i rrjetit tregtar shtetëror.

Të gjitha këto ndryshime, i gjithë ky zhvillim krijon një numër kolosal njerëzish me rrogë, krijon edhe një

shtresë njerëzish që punojnë e që shfrytëzohen nga kapitalistët, por që nuk prodhojnë drejtpërdrejt. Këta nuk mund të quhen punëtorë sepse nuk i kanë karakteristikat e klasës punëtore.

Këtu qëndron një çështje me rëndësi të madhe parimore që filozofët borgjezë dhe revizionistët modernë, me një numër teorish të ndryshme, me këto zhvillime në struktura të klasave që kanë shkaktuar zhvillimin kapitalist, kontradiktat e mëdha që ka krijuar ai dhe që e brejnë, përpiqen të vërtetojnë se karakteri i klasës punëtore ka ndryshuar, se parimet e marksizëm-leninizmit janë kapërcyer. Sipas tyre klasa punëtore është kthyer «në një klasë konservatore» dhe inteligjencia, studentët janë në pararojë të «periudhës së zhvillimit tekniko-shkencor» të shoqërisë etj., etj. Këta teoricienë kapitalistë dhe socialdemokratë e revizionistë, që kanë për qëllim të vetëm të ruajnë privilegjet e kapitalit mbi klasën punëtore dhe mbi punonjësit, ashtu siç duan të mbytin me teoritë e tyre oportuniste, përpiqen, gjithashtu, të skurjasin mprehtësinë revolucionare të klasës punëtore, duke dashur ta mbytin atë në pellgun e një amalgame shtresash të borgjezisë së shpronësuar nga kapitali monopolist ose të edukuar me teknikë dhe me shkencë, në mënyrë tendencioze, për t'i shërbyer asaj.

Dihet se zhvillimi kapitalist i ka dhënë një hov edhe zhvillimit të arsimit, të kulturës dhe të shkencës, sidomos në periudhat e ngritjes së tij. Por nuk duhet të harrojmë se ky arsim, kjo kulturë dhe kjo shkencë zhvillohen me tendencë dhe me qëllime e kufij të caktuar mirë nga borgjezia. Fëmijët e borgjezisë ishin në gjendje të ndiqnin dhe të vazhdonin shkollat deri në fund, shtresa të veçanta të borgjezisë orientoheshin në sektorë të ndryshëm e të caktuar, ku zinin kyçet e drejtimit e të prodhimit. Fëmijët e punëtorëve mbeteshin pa shkollë, mbeteshin punëtorë të thjeshtë, bënë me një mijë halle ndonjë

kurs kualifikimi dhe rrallë e tek çante ndonjë murin e hekurt, por atëherë ai i humbiste karakteristikat e klasës së tij. Puna në shërbim të borgjezisë dhe mënyra borgjeze e jetesës ose e zbutnin luftën e tij ose e degjeneronin. Kjo natyrisht duhet marrë në përgjithësi.

Për sa u përket revizionistëve çështja qëndron këtu. Ata, për t'i hedhur ujë verës, bëjnë shumë llafe, bëjnë be e rrufe për besnikërinë ndaj klasës punëtore, ndaj teorisë së Marksit, por nga ana tjetër orvaten që kufirin që vë Marksi në mes klasës punëtore dhe inxhinierëve, midis klasës punëtore dhe inteligjencies së prodhimit, ta zhdukin. Sipas tyre duke qenë se inxhinierë e punëtorë «punojnë së bashku për krijimin e kapitalit», «se të dy palët janë të shfrytëzuara nga kapitalisti», «të dy janë rrogëtarë të kapitalisti», përbëjnë një klasë të vetme.

Koncepte të tilla, natyrisht janë pjesë përbërëse e teorive borgjeze, kapitaliste e revizioniste të teknokratizmit, «të transformimit aktual të karakterit të kapitalit», sipas të cilave «sot në fuqi nuk janë më kapitalistët si qëmoti», po teknikët, inxhinierët, «shokë të një shtrese me punëtorët e fabrikave, që bashkëpunojnë së toku» etj. Këto koncepte kanë për objekt të shuajnë luftën e klasave, rezistencën e punëtorëve kundër kapitalit, kufizimin në kërkesa ekonomike, jo vetëm drejtpërdrejt me ngritjen e mëditjeve, për aristokracinë punëtore, por duke shkuar edhe më tej: ngjitjen shkallë-shkallë në disa «privilegje të mjeshtërve ose të ndihmësinxhinierëve», në «blerjen e ndonjëfarë aksioni në fabrikë për t'u bërë minikapitalistë». Kështu përpiqen të krijojnë iluzionin e plotë se po shkojnë në socializëm, me të famshmin vetadministrim të Titos.

Ndryshimi në mes kapitalizmit dhe «socializmit» titist e revizionist në tërësi, qëndron në faktin që ndërsa në vendet perëndimore shtresa e kapitalistëve monopolistë dhe piramida e saj ekzistojnë, në Bashkimin Sovjetik,

në Jugosllavi dhe në vendet e tjera ku sundojnë revizionistët, ato u shkatërruan nga revolucioni. Por në këto vende është krijuar një borgjezi e re kapitaliste.

E para kërkon të krijojë iluzionin se në vendet kapitaliste po shkohet me evolucion drejt socializmit. E dyta, me «vetadministrimin» dhe me reformat ekonomike do të japë iluzionin se «janë kokë e këmbë në socializëm, bile po ndërtojnë shoqërinë komuniste». Fokusi ka të njëjtin qëllim: mashtrimin e klasës punëtore, luftën kundër marksizëm-leninizmit shkencor, shtypjen e revolucionit botëror dhe zgjatjen e jetës së kapitalizmit, të kolonializmit dhe të shtypjes së popujve.

Të gjitha teoritë e mësipërme, që përmenda shkurtimisht e që përbëjnë thelbin e shumë debateve të pseudo-filozofëve, që e heqin veten marksistë, nuk mund të errësojnë tezën e Marksit mbi përcaktimin e proletarit dhe të klasës punëtore. «Puna kolektive», puna e përbashkët e inxhinierëve, e teknikëve dhe e punëtorëve nuk mund të çojë në shkrirjen e klasës punëtore me inteligjencien e prodhimit; inxhinierët dhe inteligjencia teknike nuk mund të zëvendësojnë klasën punëtore. Punëtorët përbëjnë një klasë më vete që përcaktohet nga raportet e saj me pronën dhe me prodhimin kapitalist, ndërsa inxhinierët e të tjerë, i afrohen klasës punëtore, punojnë me klasën, po nuk mund të shkrihen me klasën.

Si qëndron kjo çështje te ne?

Te ne është ndërtuar me sukses socializmi, nëpërmjet luftës së armatosur është shkatërruar që nga themelet pushteti i vjetër i feudalëve dhe i borgjezisë. Revolucioni vendosi diktaturën e klasës punëtore. Hegjemoni te ne është klasa punëtore, e cila, në aleancë të ngushtë me fshatarësinë punonjëse, drejton të gjitha masat punonjëse të vendit në ndërtimin e plotë të socializmit dhe pastaj të komunizmit. Pra, te ne çdo gjë është nën drejtimin e klasës punëtore, formimi i së cilës fillon me she-

kullin e 19-të në mos edhe më parë. Ajo u krijua nga artizanët, punëtorët e varkave, proletarët pa tokë, argatë arash, hyzmeqarë, loparë e të tjerë. Më vonë, me zhvillimin e tregtisë, të manufakturave të vogla, të disa punishteve të vogla industriale, me zgjerimin e ndërtimeve, të rrugëve e të urave, me hapjen e disa minierave e dhënien e koncesioneve të huajve, në shekullin e 20-të, ajo filloi të zmadhohej dhe të kuptojë pak nga pak rolin e madh të saj. Por, ishin Lufta Nacionalçlirimtare dhe fitorja e revolucionit, nën udhëheqjen e Partisë Komuniste të Shqipërisë që sollën në fuqi klasën punëtore, e bënë atë hegjemone. Me zhvillimin ekonomik-shoqëror të vendit tonë, me krijimin e industrisë dhe ndërtimin e minierave, klasa jonë punëtore u rrit, u forcua e u kalit nga çdo pikëpamje.

Që nga dita e Çlirimit, kur Partia jonë Komuniste, sot Partia e Punës, parti e klasës punëtore, filloi rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta dhe ndërtimin e socializmit, ajo u mbështet, u frymëzua, zbatoi drejt dhe u qëndroi besnike parimeve marksiste-leniniste në çdo gjë, natyrisht, duke i aplikuar këto parime me korrektësi në kushtet objektive të vendit tonë. Natyrisht, ndryshime rrënjësore u arritën në strukturë dhe në superstrukturë. Duke i vënë rëndësi të dorës së parë industrisë, sidomos asaj të rëndë, që për vendin tonë është zhvillimi i minierave, krahas dhe në mënyrë të harmonishme, iu vu rëndësi bujqësisë dhe zhvillimit të degëve të saj.

Shkatërrimi i pushtetit të feudo-borgjezisë u bë i plotë. Klasat shfrytëzuese u shpronësuan. Prona kapitaliste u shndërrua në pronë të popullit punonjës. Fshatarësisë iu dhanë toka dhe mjetet e tjera të punës nga Reforma Agrare. Më vonë, kjo pronë, nga forma individuale, ashtu siç na mëson marksizëm-leninizmi, me rrugën e bindjes, u shndërrua në pronë socialiste kolektive, grupi.

Zhvillimi i vrullshëm ekonomik i vendit pas luftës u

shoqërua edhe me lëvizje të popullatës, gjë kjo e natyrshme. Nevoja ishte e madhe për punëtorë ndërtime, minierash, industrie, artizanati. Qytetet morën një zhvillim të madh, por pushteti tregoi kujdesin më të madh që të mos braktisej bujqësia, e cila ishte në gjendje të keqe. Klasa jonë punëtorë i shtoi radhët e saj kryesisht nga fshatarët, kështu që Partisë i duhej ta edukonte, ta kaliste politikisht dhe ideologjikisht dhe ta ngrinte nga ana profesionale këtë klasë punëtorë relativisht të re, por që duhej të kryente një detyrë të rëndë e me përgjegjësi kolosale. Këtë detyrë ajo e bëri me durim dhe e kreu me sukses, si në ditët e vështira të fillimit, ashtu edhe më vonë dhe vazhdon kurdoherë ta kryejë gjithnjë e më mirë.

Rritja e klasës punëtorë, zvogëlimi i peshës specifike të fshatarësisë dhe rritja e numrit të nëpunësve e të inteligjencies është bërë dhe vazhdon të bëhet te ne në mënyrë të studiuar, të harmonishme, të kontrolluar, në bazë të nevojave të çdo sektori, të zgjerimit të tyre, duke pasur parasysh kurdoherë luftën e pandërprerë kundër parazitizmit, burokratizmit, duke vendosur marrëdhënie të drejta në punë, duke nxitur automatizimin, duke zbatuar metodat shkencore në punë dhe në studim, duke zhvilluar në rrugë të drejtë revolucionin tekniko-shkencor. I gjithë ky kompleks ka për qëllim ndërtimin e plotë të socializmit, zhvillimin e forcave prodhuese, përsosjen e vazhdueshme të marrëdhënieve të reja në prodhim. Klasa punëtorë edukohet me normat marksiste-leniniste në çdo gjë, qoftë në organizimin e punës, në teknikën e prodhimit, në teknologji, në zhvillimin e makinave, në marrëdhëniet ekonomike e politike të klasave, në zhvillimin dhe në përparimin e tyre tekniko-kulturor, politiko-ideologjik dhe në kuptimin e vendit të gjithsecilit në shoqëri, qoftë si individ, qoftë si grup ose kolektiv, qoftë si anëtar i një klase të caktuar.

Populli ynë ka disa dekada që u fut në revolucion,

që triumfoi. Te ne, sot, vendi drejtohet nga diktatura e proletariatit, nga ligjet përparimtare marksiste-leniniste të saj. Populli ynë udhëhiqet dhe edukohet nga një parti marksiste-leniniste. Nga gjiri i këtij populli është ngritur sot një brez i ri i fuqishëm, i lindur, i rritur, i edukuar dhe i kalitur nga rendi socialist. Por te ne as që bëhet fjalë dhe as që mund të bëhet fjalë, se roli i klasës punëtorë dhe i Partisë së saj kanë ndryshuar, janë reduktuar, siç thonë revizionistët, se inteligjencia është tash në pararojë. Shkrirja e inteligjencies me klasën punëtorë dhe aq më tepër shndërrimi i inteligjencies në forcë kryesore drejtuese, në hegjemone, nuk mund të ngjasë kurrë në vendet ku sundojnë kapitali dhe revizionizmi, por edhe te ne, ku po ndërtohet socializmi me sukses, do të ruhen gjatë gjithë periudhës së kalimit nga kapitalizmi në komunizëm dallimet klasore dhe lufta e klasave, sidomos mentaliteti mikroborgjez e mbeturinat e tij në ndërgjegjen e njerëzve.

Te ne revolucioni dhe zhvillimi i prodhimit, i shpërndarjes së drejtë e të shpejtë, likuiduan përfundimisht tregtarët e vegjël dhe tregtia e brendshme tash është në duart e shtetit proletar dhe bëhet nga nëpunës me pagë. Është fakt se shtresa e tregtarëve të vegjël, ashtu si prona e vogël e fshatarësisë u zhdukën nga mesi, por mentaliteti, botëkuptimi mikroborgjez nga ndërgjegjja e njerëzve, me gjithë përparimet, akoma nuk janë zhdukur, për këtë do të duhet një luftë e madhe ideopolitike e gjallë dhe revolucionare.

Shndërrimi i kooperativave bujqësore nga pronë grupi, në pronë të të gjithë popullit, është perspektiva e bujqësisë. Por kthimi i kooperativave bujqësore në ndërmarrje bujqësore shtetërore është një perspektivë jo e afërt. Kjo nuk bëhet dhe nuk do të bëhet me dekrete nga lart, do të duhet të krijohen situata objektive, konkrete, për një shndërrim të tillë, për një hop të tillë

cilësor. Ky hop cilësor natyrisht, do të ndërrojë edhe gjendjen e kooperativistëve, të cilët faktikisht do të shndërrohen në punëtorë të ndërmarrjeve bujqësore. Por këto ndryshime, në bazë, në strukturë, do të bëhen relativisht më shpejt nga ndryshimet në botëkuptimet e punëtorëve të rinj të bujqësisë me prejardhje nga klasa punëtore, mikroborgjeze, megjithëse gjatë rendit socialist ato kanë pësuar ndryshime cilësore ideologjike. Asaj do t'i duhet një kohë relativisht e gjatë që të fitojë tiparet karakteristike bazë të klasës punëtore.

Ka dhe do të ketë te ne shtresa njerëzish që punojnë, po nuk prodhojnë. Këto, natyrisht, bashkëpunojnë me klasën punëtore dhe ndihmojnë prodhimin. Këto shtresa nuk mund dhe nuk duhet të quhen punëtore e të bëjnë pjesë në klasën punëtore. Këto e ndihmojnë klasën punëtore, punojnë nën drejtimin e saj dhe të diktaturës së klasës. Këto nuk lejohen as të shfrytëzohen, as të shfrytëzohen, **shfrytëzimi i njeriut nga njeriu te ne është zhdukur.**

Po kështu ndodh te ne edhe për inxhinierët dhe specialistët e ndryshëm të këtij rangu, që bashkëpunojnë me klasën punëtore, i shërbejnë asaj, por nuk janë punëtorë, megjithëse te ne këta njerëz, në përgjithësi, edhe nga origjina, edhe nga përbërja janë të mirë, janë pjesëtarë të brezave të rinj të socializmit. Shumë nga këta janë me origjinë punëtore, ose kanë ardhur nga radhët e klasës punëtore. Por unë mendoj, dhe këtu interpretoj Marks-in, këta nuk duhen konfunduar me klasën, këta janë «ata që janë afër klasës», që i shërbejnë asaj, marrin pjesë në prodhimin e të mirave materiale, por nuk prodhojnë drejtpërdrejt. Punëtori prodhon drejtpërdrejt, i përdor vetë, me duart e tij mjetet e prodhimit. Partia jonë, duke u qëndruar besnike parimeve marksiste-leniniste, krahas edukimit masiv kulturor dhe teknik të klasës punëtore, të fshatarësisë, i kushton një kujdes të

veçantë edhe edukimit të të gjitha masave punonjëse. Të gjitha ato shtresa që punojnë dhe nuk prodhojnë drejtpërdrejt, gjithë inteligjencien pa përjashtim, inxhinierët e të tjerë, Partia i edukon edhe të drejtojnë, edhe të ndihmojnë, por edhe të marrin pjesë drejtpërdrejt në prodhim. Këtij qëllimi i ka shërbyer dhe i shërben pjesëmarrja e nëpunësve dhe e inteligjencies një muaj në vit në punë prodhuese. Kjo është një edukatë komplete proletare, që bëhet vetëm atje ku është vendosur diktatura e proletariatit.

Të punosh që inxhinieri, agronomi, intelektual i jo vetëm të rrojnë te makina, te traktori, por edhe të kapin makinën, traktorin, të krijojnë, por njëkohësisht edhe të prodhojnë drejtpërdrejt, kjo është rruga më e drejtë e edukimit klasor, që zhduk intelektualizmin dhe tendencat e teknokratizmit, që çon drejt ngushtimit të dallimeve midis punës mendore e punës fizike.

Te ne, ku ndërtohet socializmi, ku në fuqi është klasa punëtore, mësimi, dituria, shkenca, teknika, çmohen shumë, ndihmohen, zhvillohen dhe vihen në shërbim të shoqërisë socialiste, kurse në vendet kapitaliste dhe revizioniste të gjitha këto, të ngritura në teori të intelektualizmit dhe të teknokratizmit, shërbejnë për të shtypur klasën punëtore dhe punonjësit dhe për t'i zgjatur jetën kapitalizmit.

Socializmi krijon të gjitha kushtet që punëtori të zgjerojë horizontin profesional, shkencor e kulturor, të ngjitet në nivelin e punonjësve të punës mendore, dhe në të njëjtën kohë kudeset e krijojnë kushtet që punonjësit e punës mendore të edukohen vazhdimisht me ideologjinë e klasës, të mendojnë e të punojnë si klasa punëtore.

**EDHE PARTIA KOMUNISTE E ITALISË (M-L)
NDODHET PËRPARA FRAKSIONIT TË PESHES**

Peshe është një i ri megaloman i tërbuar, një sektar që s'e ka shokun, një njeri që nuk ka kuptimin e partisë, po frymën e grupazhit dhe grupin e tij të të rinjve të Milanos, me gjithë formimin e partisë, vazhdon ta mbajë nën ndikimin e drejtpërdrejtë dhe drejtimin e tij. Ai nuk kupton as centralizmin demokratik, as vijën e masave. Ai s'i ka të qarta as luftën e klasave dhe as aleancat e mundshme dhe të domosdoshme të klasës punëtore. Puna e tij prepotente në udhëheqje, mungesa e demokracisë dhe brutaliteti bënë që mjaft shokë të shkëputen nga partia me arsye e pa arsye, bënë që elementë të turbullt, që ishin infektuar në radhët e partisë, të përfitonin dhe të provokonin çarje. Përveç asaj Peshe dhe shokët e tij hidhnin poshtë çdo propozim që vinte nga baza për t'i rishqyrtuar me gjakftohtësi dhe në bazë marksiste-leniniste mosmarrëveshjet e lindura dhe të procedonin në baza të shëndosha marksiste-leniniste të unitetit ideologjik dhe politik-organizativ të të gjitha këtyre grupeve «marksiste-leniniste». Peshe u bë pengesë për një punë të tillë të domosdoshme dhe, siç u kishte thënë Fosko Dinuçi shokëve tanë, Peshen e kanë pezulluar nga udhëheqja derisa çështjen e tij ta vendosin definitivisht.

**LIBRA TË SHKRUHEN PËR POPULLIN, PËR PARTINË
DHE PËR ATDHEUN SOCIALIST**

Megjithëse e kam refuzuar dy herë kategorikisht, ambasadori ynë në Paris vazhdon të propozojë që të pres gazetare francezë, të cilët duan të shkruajnë biografinë time. Porosita shokët që t'i shkruajnë edhe një herë e t'i thonë se «shoku Enver nuk dëshiron në asnjë mënyrë të shkruhen libra për të». Libra të shkruhen për popullin, për Partinë dhe për atdheun socialist.

Një librari në Paris, ofrohet të rishtypë fjalimet e mia që kemi botuar këtu në një botim të përmbledhur në frëngjisht. Unë i autorizova shokët, por më parë duhet të informohen për seriozitetin dhe «ngjyrën» politike të saj.

Ç'DISKUTOHET NË MBLEDHJET KINO-SOVJETIKE

Shokët e Ministrisë së Jashtme të RP të Kinës vunë në dijeni ambasadorin tonë (për herë të parë), se bisedimet me sovjetikët «as që kanë filluar konkretisht», ndër-
sa në të vërtetë ato kanë 100 ditë që kanë filluar. Marrë-
veshja Çu En Lai - Kosigin, sipas kinezëve «tash as që
pranohet dhe as që do të pranohet në asnjë pikë nga
sovjetikët», domethënë sovjetikët refuzojnë të tërheqin
trupat nga vijat e kufirit, nga vendet e kontestuara dhe
të evitohen goditjet, pastaj të fillohen bisedimet. Sovje-
tikët, pra, duan të fitojnë kohë të përgatitin «sulmin». Edhe kinezët po përgatiten dhe, më vonë, «do t'i demas-
kojnë edhe hapur». Atëherë çka thuhet tash në këto mble-
dhje llogjesh?

SOVJETIKËT PO E KTHEJNË EGJIPTIN NË NJE KOLONI

Sovjetikët i kanë hedhur thonjtë në grykë Egjiptit dhe Naseri nuk është veçse një «Faruk» gjoja demokrat dhe president, jo më shërbëtor i anglezëve, por i sovje-
tikëve. Këta po e kolonizojnë Egjiptin dhe manovrojnë në
një mënyrë të atillë sa që Naseri as kundër Izraelit nuk
lufton dot, as këmishën nuk e ndërron dot kollaj.

**REVIZIONISTËT PO INFILTRONË NË GJIRIN
E «AL FATAHUT»**

Revizionistët sovjetikë po infiltrohen edhe në lëvizjen e luftëtarëve të «Al Fatahut». Dje Jaser Arafati udhëheqësi i organizatës palestineze «Al Fatah», në krye të një delegacioni shkoi në Moskë, siç na thonë, nëpërmjet ambasadorëve tanë, për të kërkuar «ndihma» në armë. Ata u thonë tanëve se «i njohim sovjetikët dhe qëllimet e tyre dhe ne do të jemi vigjilentë». Kjo është një fjalë. Po u futën në allishverish me revizionistët sovjetikë, filloi mbarimi i luftës partizane të palestinezëve. Revizionistët sovjetikë s'do të mungojnë t'u japin disa armë, por me anë të këtyre ata do t'i dominojnë, do t'i drejtojnë drejt kapitullimit, siç po bëjnë me Naserin. Do t'i bëjnë kështu vegla të lodrës së tyre të ndyrë.

**ANIJE TË FLOTËS DETARE SOVJETIKE NË PORTET
JUGOSLLAVE**

Më informojnë se në Kotor të Jugosllavisë vijnë dhe riparohen anije të flotës luftarake sovjetike të Mesdheut. Sipas këtyre informatave, sovjetikët ua kanë kërkuar këtë gjë edhe algjerianëve dhe këta gjoja s'kanë pranuar. Lajmin për Kotorin dhashë urdhër që ta verifikojnë mirë, pse bëhet për ne një rrezik, po të jetë e vërtetë. Titistët për të fituar para, shesin atdheun.

SHQIPTARËT NË KOSOVË E NË MAL TË ZI E MANIFESTOJNË HAPUR DASHURINË E TYRE PËR SHQIPËRINË

Informatat që na vijnë nga Kosova tregojnë për dashurinë e madhe që kanë shqiptarët e Kosovës për Shqipërinë. Këtë dashuri ata e manifestojnë hapur. Vendimet që morën autoritetet e Gjakovës për të dënuar grupin kosovar, që mori pjesë në festimet e 25-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, jo vetëm që kundërshtohen nga të gjithë, por shtëpitë e tyre janë bërë vende pelegrinazhi.

Në mal të Zi, në Ulqin e në vende të tjera të kësaj republike ku ka shqiptarë, shikohen emisionet e televizionit të Tiranës dhe shtëpitë e atyre që kanë televizorë, bëhen si salla kinemaje. Atje venë, bile, për të parë, një-rëz edhe nga Kosova, kaq sa autoritetet mendojnë të gjejnë mënyrat për të penguar emisionet tona.

SHËNIM

Bisedë me Ramizin për problemin e marrëdhënieve me Greqinë.

REVIZIONISTËT FRANCEZË IU NËNSHTRUAN PLOTËSISHT REVIZIONISTËVE SOVJETIKË

Revizionistët francezë, në kongresin e tyre të fundit që mbajtën javën që kaloi në Nanterre, afër Parisit, u rreshtuan plotësisht si lakenj të bindur të revizionistëve sovjetikë. Në të gjitha çështjet, ata iu nënshtroan milio-nave që u japin kapitalistët sovjetikë.

Partia revizioniste franceze është një parti me «apar-çatçikë», të cilët marrin rroga të majme, bëjnë propagan-dë demagogjike për të gënjyer klasën punëtore. Ky aparat burokratik kapitalist, antimarksist, administron, gjitha-shtu, firma tregtare dhe industriale, prona të partisë, të maskuara. U bë «luftë» gjoja kundër ultrarevizionistit Garodi, u trumbetua «besnikëria ndaj klasës punëtore e leninizmit» për të fshehur sadopak tradhtinë e tyre. Ky ishte qëllimi dhe rezultati i kongresit.

KURDOHERË KEMI DASHUR MARRËDHËNIE TË FQINJËSISË SË MIRË ME POPULLIN GREK

Shtypi grek flet në mënyrë të ndryshme, sipas rry-mave politike që përfaqëson, për marrëveshjen e shkëm-bimeve tregtare në mes Dhomës së Tregtisë Greke me tonën. Të parët qenë ata që kërkuan këtë marrëveshje dhe ne nuk e refuzuam.

Sigurisht diçka lëviz në Greqi, që kërkojnë të bëjnë tregti me ne. Tregtia nuk është kryesorja, as për ata, as për ne. Ne kurdoherë kemi dashur të kemi marrëdhënie të fqinjësisë së mirë me popullin grek. Monarko-fashistët s'donin. Neve aq na bënte. Ata na provokonin, ne i vinim në vend. Regjimi i kolonelëve nuk e ndien veten të fortë, as brenda, as jashtë dhe as me aleatët e tij. Atëherë si duket (kjo do të shihet më vonë dhe ne jemi në përgjim) ai do ta ndërrojë qëndrimin absurd të marrëdhënieve të armiqësisë me Republikën Popullore të Shqipërisë. Ne s'jemi kundër.

Në datën 11 të këtij muaji gazeta qeveritare greke «Eléftheros kózmos» në mes të tjerash shkruante për çështjet e marrëdhënieve me Shqipërinë. Pasi flet për marrëveshjen tregtare në fjalë, gazeta jep arsye të ndry-shme që, sipas saj, flasin në favor «të domosdoshmërisë për ta konsideruar Shqipërinë ashtu siç është. . . Shqipëria nuk është nën ndikimin e asnjë vendi ballkanik ose evropian që mund të përdoret kundër nesh».

Në lidhje me të ashtuquajturat rivendikime tokësore, gazeta thotë se «Greqia nuk e ngre këtë çështje, por nuk e ka lënë atë pas dore dhe ka të drejtë t'i kërkojë Tiranës që të marrë masa të efektshme mbrojtëse për grekët që banojnë atje».

Dhashë udhëzime që të na sjellin kupytrat e plota të shtypit grek mbi këtë problem dhe nga ana jonë me ndonjë artikull¹ të shkurtër dhe konciz e jopolemik duhet të bëjmë një hap tjetër përpara. Prandaj i dhashë Ramizit këtë tekst, projekt provizor, për një koment të shkurtër për shkëmbimet tregtare për ta pasur parasysh për këtë eventualitet: ... është një veprim i arsyeshëm dhe reciprokisht i dobishëm për të dy popujt. Asnjëherë populli shqiptar nuk i ka dashur të keqen popullit fqinj grek, por është përpjekur të rrojë kurdoherë në miqësi të sinqertë me të dhe me mundësitë e veta e ka ndihmuar në luftërat e pavarësisë së tij. Natyrisht, populli shqiptar, ashtu si edhe populli grek, nuk mund të durojë që t'i shkelet liria, pavarësia, sovraniteti dhe uniteti i tij tokësor. Shqipëria, ashtu si dhe Greqia, kanë luftuar shumë dhe kanë triumfuar kundër shkelësve të huaj. Historia e ka vërtetuar këtë ndodhi të madhe. Popujt bëjnë historinë e tyre dhe një nga këta popuj, populli shqiptar, çau nëpërmjet luftërave të përgjakshme dhe e bëri veten dhe atdheun e tij të fortë e të paprekshëm.

Fatet e Shqipërisë ndryshuan, jo pse kështu ishte dëshira e ndokujt dhe as mund të ndryshohet rruga socialiste e Shqipërisë së re, pse kështu i dashka qejfi ndokujt.

Ne besojmë se mësimet e zhvillimit të historisë së njerëzimit duhet t'u shërbejnë të gjithëve. Ne, shqiptarët, asnjëherë nuk kemi dyshuar në miqësinë e popullit grek

¹ «Një marrëveshje tregtare në dobinë reciproke të popujve shqiptar e grek». «Bashkimi», 17 shkurt 1970.

ndaj popullit shqiptar, pse populli ynë, edhe në momentet e tij më të vështira, më fatkeqe, ka ushqyer një miqësi të sinqertë për popullin grek. Ai nuk i ka konfunduar ndjenjat e tij të drejtësisë me ato të rrymave reaksionare dhe shoviniste kundër vendit tonë. Këto rryma jo vetëm janë antipopullore dhe çojnë në konflikte të përgjakshme, por synimet e tyre nuk mund të fitojnë kurrë kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, nga çdo anë që të vijë dhe në çdo formë që të paraqiten.

Ne i kemi thënë dhe i themi kurdoherë popullit grek: rruga më e drejtë është rruga e fqinjësisë së mirë, e miqësisë në mes dy popujve tanë, të bazuar në mos-ndërhyrje etj., etj., (pesë parimet).

Ne i themi popullit grek: në rast se ndokush te ju mendon se ne duam të jemi miq me ty vetëm për çështje koniunkturore, ose se kemi frikë nga të ashtuquajturat koniunktura, ai gabohet. Asgjë nuk na tremb ne, kur mbrojmë të drejtat tona, ashtu sikundër edhe populli grek nuk trembet kur mbron të drejtat e tij.

MBI GJENDJEN NË PK TË FRANCËS (M-L)
DHE TË ITALISË (M-L)

Te shokët e ambasadës sonë në Paris vanë e u qanë për Zhyrkenë dhe Martinë, Kazas e Kombë që cilësohen nga dy të parët si «fraksionistë». Tanët i dëgjuan dhe në mënyrë të thatë u thanë se «këto janë çështje të brendshme tuajat».

I thashë Ramizit të lajmërojë njerëzit tanë që shokët që janë në hall, t'i presin ngrohtë, të mbajnë shënim për çdo gjë që thonë dhe t'u thuhet se do të vënë në dijeni Partinë e Punës të Shqipërisë, pse për atë shokët francezë kanë shkuar te tanët, të cilët duhet të na lajmërojnë ne më parë, pastaj të veprojnë sipas udhëzimeve që do t'u japim.

Nga Italia na lajmërojnë se Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Italisë (m-l), në mbledhjen e tij të fundit, mori në studim, përfundimisht, çështjen e fraksionit të Peshes dhe i përjashtoi këtë dhe disa shokë të tij nga partia. Nga sa na kanë informuar shokët italianë, Peshe ishte njeri i keq, ai qe bërë pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të partisë. Kur është kështu, bëjnë mirë që i spastrojnë radhët.

GREKËVE U PËRKET TË MARRIN INICIATIVA
PËR MARRËDHËNIET DIPLOMATIKE ME NE

Bëmë një artikull të parë jopolemik në drejtim të Greqisë në lidhje me shkëmbimet tregtare, por në të linim të kuptohet se ata duhet të marrin iniciativa të mëtejshme për lidhjen e marrëdhënieve diplomatike, duke hequr pengesat absurde që vetë kanë ngritur. Në shtypin grek të këtij muaji ka tendenca në këtë drejtim. Ne presim. Ata le të bëjnë hapa dhe ne do t'u përgjigjemi, në rast se duan me të vërtetë të heqin pengesat.

PËR MARRËDHËNIET SOVJETO-KINEZE

Sipas informatave që marrim, bisedimet në Pekin në mes kinezëve dhe sovjetikëve numërojnë në vend, asgjë nuk është arritur dhe as nuk do të arrihet. As marrëveshja tregtare nuk po përfundon. Sovjetikët janë keq për mish. Ata kërkojnë mish nga kinezët, por këta s'u japin, u thonë: «Doni mish të ushqeni një milion ushtarë që keni në kufijtë tanë? Jo, ne nuk do t'ju japim».

Siç po duket mishin e Mongolisë sovjetikët e kanë përçarë.

IZRAELI PO DISKREDITON BASHKIMIN SOVJETIK

Duke bombarduar vazhdimisht pozicionet e egjiptianëve, izraelitët njëkohësisht diskreditojnë Bashkimin Sovjetik, i cili hiqet si «mbrojtësi i Egjiptit dhe i popujve arabë». Në fakt, Bashkimi Sovjetik u jep arabëve armatim të vjetër mbrojtës dhe jo sulmi, dhe në çdo avion, pale në repartet ushtarake, ka nga një aviator sovjetik, që nuk e lë avionin të ngrihet pa urdhrin e shtabit sovjetik në Egjipt.

**GRINDJET NË GJIRIN E PK TË FRANCËS (M-L)
MUND TË ZGJIDHEN VETËM DUKE ZBATUAR
RREGULLAT ORGANIZATIVE**

Bisedova me Hysniun dhe me Ramizin për mënyrën parimore se si t'u përgjigjemi shokëve të Partisë Komuniste të Francës (m-l) në lidhje me «fraksionin» që po u ndodh, siç thonë ata.

Të dyja palët, që kritikojnë njëra-tjetrën kanë gabime. Gabime organizative për të cilat kritikohen kanë bërë edhe kryesorët. Që të dyja palët, nuk ulen t'i ndreqin ato në rrugë partie, por kritikën i kanë degjeneruar në rrugë subjektiviste, në sharje, në goditje personale. Ne u themi se këto çështje duhen zgjidhur në rrugë partie, në bazë të rregullave organizative dhe të centralizmit demokratik, me kritikë dhe me autokritikë të shëndoshë nga të dyja palët.

POLITIKË REVIZIONISTE

Politika tradhtare e Kim Ir Senit po lëkundet sa andej-këtej. Siç duket këta muajt e fundit nuk e ka dhe aq grurë me sovjetikët dhe ka filluar diçka të lëvizë për Kinën. Po kjo është nga zori, është politikë e një revizionisti, që vërtitet si të fryjnë erërat.

**REVIZIONISTËT SOVJETIKË PËRPIQEN TË KRIJOJNË
NJËSI TË MËDHA MIKSTE USHTARAKE
ME SATELITËT E TYRE**

Revizionistët sovjetikë, nën pretekste të ndryshme e në kuadrin e Traktatit të Varshavës, nxorën teorinë e krijimit të njërive të mëdha mikste ushtarake, të përbëra nga kontingjente të çdo shteti anëtar të këtij Traktati. Thuhet se Rumania nuk ka pranuar. Këto njësi, në fakt, sipas të dhënave, janë krijuar. Flitet, gjithashtu, se të tilla janë dërguar edhe në kufijtë me Kinën, gjë që duhet vërtetuar. Është e qartë se revizionistët sovjetikë e bëjnë këtë për të zhdukur pavarësinë e çdo ushtrie, nënshtrimin e secilës nën komandën e plotë sovjetike, krijimin e trupave mercenare për aventura ushtarake, demoralizimin e kuadrove ushtarakë të çdo shteti dhe shpartallimin e çfarëdo rezistence nga ana e tyre.

**HALLKË E RE E ZINXHIRIT TË ROBËRISË
SOVJETIKE**

Monedha e re e përbashkët, që revizionistët sovjetikë kërkojnë të vendosin me satelitët e tyre dhe roli që do të luajë ajo, nuk është veçse një kopje më e keqe e rolit që luan dollari në vendet kapitaliste. Revizionistët duan nga të gjitha anët t'i lidhin satelitët me zinxhirë të rëndë robërie.

GREKËT NA FALËNDEROJNË

Grekëve u erdhi mirë që marina jonë pardje shpëtoi ekuipazhin e një vapori të tyre tregtar, 8 veta, i cili mori zjarr, ndërsa po udhëtonte në Adriatik, afër brigjeve tona. Qeveria jonë i kërkoi qeverisë greke të dërgojë t'i marrë sa më parë. Grekët na falënderuan.

SHËNIM

Njoftimet e agjencisë franceze të lajmeve thonë se policia ka bërë arrestime në radhët e Partisë Komuniste të Francës (m-l). Konfirmim nga ambasada jonë në Paris nuk kemi.

TË DEMASKOJMË PËRÇARËSIT E LËVIZJES REVOLUCIONARE

Revizionistët modernë sovjetikë, socialdemokracia, tizmi etj., janë bërë rrymat më reaksionare në lëvizjen punëtore ndërkombëtare, përçarësit e kualifikuar të lëvizjes revolucionare, të komunistëve, ndihmësit e klasit të parë të imperializmit dhe të kapitalizmit botëror në ideologji, në politikë, në ekonomi, në organizim. Në kongresin e ardhshëm të Partisë duhet ta sqarojmë këtë mjegull të dendur dhe helmuese që shfrytëzon dhe falsifikon Marks, Lenin, Stalin, që errëson revolucionin dhe e pengon, që errëson socializmin dhe komunizmin.

ASHPËRSOHEM VEPRIMTARIA SHOVINISTE E TITISTËVE NDAJ SHQIPTARËVE TË KOSOVËS

Situata e shqiptarëve të Kosovës po rëndohet. Në parim lëshimet që bëri Titoja është zor të shlyhen. Megjithatë, në praktikë, titistët dhe UDB-ja e tyre, po i shtojnë dhe po i ashpërsojnë masat shtrënguese të egra kundër kosovarëve përparimtarë, kundër popullit, kundër nxënësve, studentëve dhe pedagogëve. Me një fjalë, të ashtuquajturat liri, që aprovuan, titistët përpiqen t'i futin në kallëpe antishqiptare dhe çdo manifestim i natyrshëm nacional nga ana e kosovarëve quhet «irredentizëm» dhe «punë e sigurimit shqiptar». Shumë pedagogë dhe turistë kosovarë persekutohen, pse flasin për atë realitet objektiv që kanë parë në Shqipëri. Kjo gjendje do të ndiqet me kujdes nga ne dhe do të mbajmë edhe qëndrim, kur të lypet.

TË PËRSHËNDETIM KRIJIMIN E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Rekomandova që rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës t'i bëjë një përshëndetje të ngrohtë Universitetit të Prishtinës, që u krijua i ri. Në këtë përshëndetje, përveç të tjerave, t'i thotë që universiteti ynë do të jetë kurdoherë i gatshëm të ndihmojë mbarëvajtjen e tij me ndihmën dhe me përvojën e vet, në tekste dhe në fusha të ndryshme, kurdoherë që t'i kërkohet. Kjo përshëndetje besoj do të ketë një jehonë të mirë në studentët dhe në pedagogët shqiptarë të Kosovës.

TRAKTATI I VARSHAVËS KRIJON «REPARTET SPECIALE USHTARAKE TË PËRBASHKËTA»

Informohemi se në mbledhjen e fundit të Traktatit të Varshavës është vendosur krijimi i «reparteve speciale ushtarake të përbashkëta», një lloj «brigadash ndërkom-bëtare», të cilat formohen në fakt nga shumë brigada të këmbësorisë së motorizuar, brigada tankiste, brigada desantësh ajrorë dhe brigada të forcave ajrore të vendeve anëtare të këtij Traktati. Këto do të përdoren kundër Shqipërisë, Jugosllavisë, Rumanisë (?) në Evropë dhe kundër Kinës në Azi. Duhet të jemi vigjilentë! Në Jugosllavi elementi prosovjetik po lëviz, po hedh parulla, flitet për organizime ilegale dhe për puçe. Këto të fundit duhen vërtetuar, po tym pa zjarr nuk ka.

TË SIGUROHEN NEVOJAT MATERIALE TË SHTYPSHKRONJËS NË GJUHËN GREKE NË GJIROKASTËR

Rekomandova që të studiohen nevojat materiale të Shtypshkronjës së vjetër të Gjirokastrës, ku shtypen të gjitha materialet, që duhen botuar në gjuhën greke për minoritetin, dhe të merren masa të veçanta, sidomos për ato materiale si shkronja etj., që nuk mund të sigurohen veçse në Greqi. Kjo gjë mund të bëhet tash më e volitshme me shkëmbimet tregtare, që do të vendosen në mes dy vendeve.

TITISTËT PËRPIQEN TË NDALOJNË KALIMIN E LIBRAVE TANË NË KOSOVË

Na informojnë se librat shqip, që bleu Kosova, zyrtarisht nga ne, autoritetet jugosllave, i bëjnë të kalojnë nëpërmjet Maqedonisë, e cila i bllokoi dhe nuk i lejon të arrijnë në destinacion, domethënë në Kosovë. Kjo çështje është bërë problem edhe në autoritetet e Kosovës, po nuk ka gjetur zgjidhje. Nga ana e Ministrisë sonë të Jashtme ne duhet të bëjmë një protestë me gojë, duke u thënë jugosllavëve që ky qëndrim pengon zhvillimin e marrëdhënieve dhe, në rast se librat nuk shkojnë në destinacion, ne do të flasim në shtyp e në radio.

ITALIA NË KRIZË

Italia ndodhet në krizë të brendshme dhe të jashtme. Të katër partitë e shumicës po japin e po marrin për të formuar qeverinë e qendrës së majtë. Partia revizioniste u mban ison, lëshon nga një komunikatë, po nuk përbën asnjë kërcënim serioz për borgjezinë, e cila është në konflikt me Vatikanin që mban qëndrim kundër divorcit, për politikën fetare mesjetare dhe për një qeveri monokolore. Italia, shërbëtoare e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nuk e sheh me sy të mirë dhe e kundërshton politikën mesdhetare të Francës, nuk do që kjo t'u shesë avionë «Mirazh» Libisë, Greqisë etj. Duhet ndjekur nga ne me vigjilencë koniunkturat.

PAKËNAQËSI NË BULLGARI NDAJ KLIKËS SË ZHIVKOVIT

Në Bullgari pakënaqësia është në kulm kundër klikës tradhtarë të injorantit e të xhandarit Zhivkov. Revolucionarët kanë filluar të lëvizin. Kudo në shtëpi po vihen portrete të Stalinit, po shtypen dhe po shpërndahen shkrime të tij.

Zhivkovi po shahet haptazi, kudo po bëhen arrestime çdo ditë.

ISHËNIM

Rishikova artikullin¹ mbi «Ushtrinë e Bashkuar»² të Traktatit të Varshavës. I shtova disa ide të reja për Jugosllavinë, për kufirin kinez dhe konkluzionin për qëndrimin tonë kundër kësaj ushtrie prej mercenarësh.

1 «Një hap tjetër i revizionistëve sovjetikë në rrugën e aventurave ushtarake». «Zëri i popullit», 6 mars 1970.

2 Repartet speciale ushtarake të përbashkëta.

MBI KONTRADIKTAT FRANKO-AMERIKANE

Shënime

Kontradiktat franko-amerikane janë kontradikta në mes dy fuqive imperialiste. Ato herë acarohen, shumë herë duken sikur zbuten disi, por asnjëherë nuk zhduken dhe nuk mund të zhduken plotësisht. Këto janë kontradikta në mes të një imperializmi të fuqishëm, siç është ai i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që lufton të vendosë hegjemoninë e tij në botë dhe imperializmit francez, që nuk ka më as forcën dhe as mundësinë agresive të mëparshme, që të mund jo vetëm ta sfidojë si duhet imperializmin amerikan, por as edhe të mund të kurdisë aleanca të qëndrueshme në favorin e vet.

Që të dyja këto fuqi imperialiste flasin për «miqësinë e tyre tradicionale», po kjo farë miqësie nuk përfaqëson veçse mbrojtjen e interesave të tyre kapitalistë, në koniunktura të caktuara krize, kur interesat e tyre kërcënoheshin me zhdukjen e plotë nga një fuqi e tretë imperialiste, që ndërmerre një luftë botërore imperialiste, për rindarjen e botës dhe të sferave të influencës. Në të dyja krizat e fundit të mëdha, në Luftën e Parë dhe në Luftën e Dytë Botërore, imperializmi amerikan u erdhi me të vërtetë në ndihmë «aleatëve të tij» anglo-francezë, por në analizën e fundit, fitimet e tij ishin përsëri kolsale përpara humbjeve minimale në njerëz dhe në ma-

teriale. Në të kundërtën, dy luftërat e mëdha botërore dhe gjaku i të tjerëve që u derdh si lumë e pasuruan dhe e fuqizuan imperializmin amerikan. Në një kohë kur Franca, Anglia dhe vendet e Evropës me ekonominë e tyre u dogjën dhe u shkatërruan, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ekonomia e tyre jo vetëm nuk pësuan as më të voglin dëm, por u pasuruan dhe u zhvilluan jashtëzakonisht shumë.

Nga Lufta e Parë Botërore Franca dhe Anglia dolën fituese mbi Gjermaninë e Gjykomit¹. Sido që lufta u shkaktoi humbje, prapëseprapë këto dy fuqi imperialiste ruajtën epërsinë e tyre në Evropën kapitaliste, ruajtën perandoritë e tyre koloniale, të cilat do të bëheshin edhe për një periudhë, deri në luftën e fundit botërore, burim të ardhurash kolosale për metropolet. «Miq të e tyre amerikane» natyrisht nuk lidhën duart në këto koniunktura të favorshme për ta, ku kishte «miq» fitues dhe «miq» të humbur. «Miqve» fitues, po të dobët ekonomikisht, sa të ishte e mundur u duheshin hedhur fre të hekurit, sa të ishte e mundur kapitali amerikan të depërtonte sa më shumë në metropolet dhe në kolonitë e tyre. Kështu që Shtetet e Bashkuara të Amerikës dolën nga izolimi i mëparshëm dhe politika e dollarit, lufta për akaparimin e burimeve të lëndëve të para dhe e tregjeve në botë, po bëheshin çdo ditë e më të ashpra. Po flitej për zonën e sterlinës, zonën e frangut, po zona e dollarit po merrte preponderancën më të madhe.

«Miku» më i afërt edhe «nga gjaku», të cilit i shkuleshin qimet më kollaj, ishte «luani britanik». Do të duhej të bëhej dhe Lufta e Dytë Botërore që Daj Sami, si të thuash, në *grosso modo*² t'i kalonte ish-kolonitë angleze nën sundimin e tij, nën shfrytëzimin e tij neokolonialist. Anglia nga halli dhe jo nga dëshira, bëri transferimin e

1 Vilhelmi II.

2 Italisht – në përgjithësi.

pasurive të saj të grabitura në duart e imperializmit amerikan jo në formën e kolonive të mëparshme, por të shteteve të ndryshme që ajo u dha «bujarisht pavarësinë dhe vetëqeverisjen» e që gati formalisht për të ruajtur fasadën, por edhe interesat ekonomikë natyrisht të reduktuar, i quante vazhdimisht «Komonuelth» dhe «zonë e sterlinës». Sidoqoftë imperializmi anglez, pas të dyja krizave botërore, u bë dhe mbeti «miku» i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, miku i bindur i tij, kushëriri i varfër, po i afërt i tij.

Kurse imperializmi francez nuk iu nënshtrua me aq lehtësi presioneve të imperializmit amerikan. Borgjezia franceze me Traktatin e Versajës dhe me aleancat që kurdisi, sidomos në Evropë, u përpoq të mbante nën zap ringjalljen e militarizmit gjerman, armikun e saj më të fortë dhe tradicional, sidomos, në Evropë. Njëkohësisht, si fuqi që doli fituese nga Lufta e Parë Botërore, imperializmi francez vuri të gjitha forcat që t'i konservonte të paprekura nga lakmitë e të tjerëve dhe t'i shfrytëzonte deri në palcë popujt e robëruar të kolonive të tij të shumta. Imperializmi amerikan gjente vështirësi të mëdha për të depërtuar dhe për ta dobësuar këtë fuqi të vjetër imperialiste dhe kolonialiste. Për të realizuar këto qëllime, për të dominuar «mikun», imperializmi amerikan do të përdorte investimet e kapitaleve brenda në Francë e në kolonitë e saj, si dhe financimin «e mikut» të mundur, revanshizmit gjerman, armik tradicional i Francës imperialiste.

Një sërë rrethanash, krizat, ringjallja e militarizmit gjerman me forma, në ideologji dhe në organizime, më të egra të ish-Raihut nazist hitlerian, bënë që borgjezia franceze të dobësohet dhe ta humbasë Luftën e Dytë Botërore, pa luftuar fare. Franca kapitulloi, perandoria koloniale e saj perëndoi, Afrika u pushtua nga ushtritë amerikane, do të pushtohej edhe vetë Franca për të go-

ditur ushtritë e okupacionit gjerman. Pas Luftës së Dytë Botërore Shtetet e Bashkuara të Amerikës mendonin dhe shpresonin se Franca, si fuqi imperialiste dhe kolonialiste, kishte marrë fund dhe do të ndiqte e bindur dhe e përlulur diktatin amerikan.

Sigurisht Franca e dalë nga lufta, e dërrmuar ekonomikisht dhe moralisht, nuk mund ta kishte as prestigjin, as peshën e mëparshme dhe as mund të luante një rol të dorës së parë në arenën ndërkombëtare. Forcat partizane dhe goliste, që morën pjesë në luftë, nuk ishin në gjendje dhe as dhanë atë kontribut në luftë që t'i jepnin Francës «madhështinë» e vjetër. Forcat e «Francës së lirë» ishin nën komandën dhe nën urdhrat e aleatëve, me gjithë frymën «madhështore» të Dë Golit. Por rrethanat e krijuara në Evropën e çliruar e kërkonin që Franca si një fuqi borgjeze të mëkëmbej. Këmbëngulja e Dë Golit dhe intransigjenca e tij në luftë, sidomos me imperializmin amerikan, me Rusveltin dhe pastaj me Trumanin, ndihmoi në këtë drejtim. Kundërshtimet e Francës me imperializmin amerikan, pra, janë të vjetra, gjatë luftës u thelluan, pse Rusvelti kishte shpresa të mëdha te Peteni dhe te Vishia dhe nuk i përfillte gati fare Dë Golin dhe lëvizjen e tij.

Pas luftës kjo Francë pranoi dhe përfitoi nga «Plani Marshall». Borgjezia kapitaliste franceze, për të forcuar pasuritë e saj, me ndihmat amerikane, dhe për të ruajtur perandorinë e vet të tronditur nga themelitë, u shfaq e dispozuar në bashkëpunimin Atlantik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në të gjitha format. Natyrisht kapitalet amerikane vërshuan në Francë dhe në kolonitë e saj më lirisht. Antisovjetizmi ishte në kulm, NATO-ja u krijua, Franca ishte pjesëtare e rëndësishme e saj dhe vendi ku ndodhej edhe komanda e kësaj organizate.

Faktet tregojnë se ekonomia kapitaliste franceze po mëkëmbej, Franca filloi të tregohej më e pavarur në

politikën e vet, filloi të trashë lidhjet politiko-ekonomike me Bonin, të luajë rolin kryesor në Tregun e Përbashkët Evropian dhe, natyrisht, gjatë këtij zhvillimi, kontradiktat e saj me imperializmin amerikan jo vetëm nuk ishin zhdukur, por u thelluan derisa arritën në kulmin e acarimit, me Dë Golin si president i Francës. Mirëpo, gjatë kësaj kohe kolonitë franceze morën zjarr, filloi lufta çlirimtare në Vietnam e në Algjeri, filluan trazirat në Marok, në Tunizi e kudo. Perandoria koloniale franceze po shembej. Franca borgjeze dërgonte ushtarë të vriteshin për ta mbajtur atë me zor në këmbë, por më kot. Filloi kështu tërheqja, «të shpëtojmë ç'të shpëtojmë». Shtete të pavarura borgjeze lindën, disa prej të cilave ruajtën lidhjet politike dhe ekonomike me Francën, disa të tjera jo.

Sidoqoftë, kudo ku kishte boshllëk u futën Shtetet e Bashkuara të Amerikës me baza ushtarake, me investime kapitalesh, me kredi dhe me agjenturën e tyre. Kolonializmi i vjetër francez po zëvendësohej me neokolonializmin e fuqishëm amerikan. Kjo, natyrisht, i acaroi akoma më shumë kontradiktat në mes imperializmit francez dhe atij amerikan.

Dë Goli u orvat të kristalizojë aleancat, në radhë të parë, me Bonin, me qëllim që në këtë aleancë të dominonte Franca dhe të dy tok të neutralizonin influencën amerikane në Evropë. Në këtë synim Dë Goli e konsideronte Anglinë, ashtu siç ishte, të varur nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, prandaj përpiquej ta mbante jashhtë politikës së tij të shumanshme evropiane ose të bëhej partneri «fukara» i kësaj aleance.

Njëkohësisht Dë Goli, në situatat kur Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kishin hyrë në fazën e një aleance të shëndoshë në mes tyre, u orvat të afrohej me Bashkimin Sovjetik për dy qëllime, si presion edhe mbi Gjermaninë e Bonit, edhe mbi Shtetet

e Bashkuara të Amerikës. Por as Boni, as Moska nuk iu përgjigjën si duhet avancave të Dë Golit. Ata e hodhën çapin aq sa u interesonte. Boni, nuk mund të prishte as interesat e tij me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Anglinë dhe, duke ruajtur miqësinë me Francën, ndërmerre ekspansionin e vet imperialist në botë, por sidomos në shtetet revizioniste e, në radhë të parë, në Bashkimin Sovjetik. Kështu filloi era e bisedimeve të hapëta e të fshehta sovjeto-gjermanoperëndimore, nën ombrellën e aleancës sovjeto-amerikane.

Për të arritur qëllimet politike me Bashkimin Sovjetik, Dë Goli në politikën e brendshme mendonte, gjithashtu, të bënte disa fokuse për të gënjyer klasën punëtore dhe opozitën. Por, përpara dështimit të politikës së tij, borgjezia e madhe kapitaliste franceze ia hoqi besimin Dë Golit, ajo manovroi dhe e rrëzoi atë, duke e zëvendësuar me Pompidunë. Ky duket si përfaqësues i borgjezisë së madhe franceze afariste dhe ashtu është. Kjo borgjezi aktualisht duket sikur adopton një politikë më pak intransigjente ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës sesa ajo e Dë Golit, më pak intransigjente ndaj Anglisë etj. Kjo është në sipërfaqe. Shtetet e Bashkuara të Amerikës po i tatojnë pulsën, ato përpiqen të shohin deri ku politika franceze është zbutur.

Por, po ta shohim çështjen thellë, në thelb dhe jo në format, kontradiktat ekzistojnë dhe thellohen. Ne shohim, aktualisht, që këto kontradikta të acarohen në dy drejtime: në kërkesat e politikës franceze që flotat amerikane dhe sovjetike të largohen nga Mesdheu dhe, e dyta, në pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të Francës në konfliktin arabo-izraelit. Kjo pjesë e dytë paraqit dy aspekte: aspektin anti-amerikan dhe aspektin antisovjetik. Franca po futet për influencë në Afrikë dhe në Lindjen e Afërt në krah gjoja të arabëve, pa qenë hapur kundër Izraelit. Kjo situatë, natyrisht, do t'i acarojë edhe më shu-

më kontradiktat dhe konfliktet në mes të tre këtyre imperialistëve, gjë që është në interes të revolucionit, pse dobësohen forcat agresive të imperialistëve që goditen nga popujt.

Zhvillimin e këtyre situatave duhet ta ndjekim me kujdes. Detyra jonë është të ndjekim me kujdes zhvillimin e këtyre kontradiktave, t'ua bëjmë të qarta popullit tonë dhe miqve dhe të demaskojmë pa mëshirë demagogjinë e armiqve, që fsheh gjithë këtë vepër mizore në kurriz të popujve, që luftojnë dhe derdhin gjak për lirinë e tyre.

SI TA KUPTOJMË E SI TA ORGANIZOJMË PUNËN TONË ME PARTITË (M-L) DHE ME GRUPET REVOLUCIONARE

Dje bisedova me Ramizin e disa shokë që punojnë në Drejtorinë e Jashtme të KQ se si ta kuptojnë dhe si ta organizojnë punën me partitë komuniste (m-l) dhe me grupet revolucionare. Duhet të kenë parasysh se ne nuk kemi asnjë të drejtë dhe nuk duhet të ndërhyjmë në punët e tyre të brendshme. Ne duhet të jemi të gëzuar kur na e kërkojnë eksperiencën e Partisë sonë, ta japim atë sa më mirë e sa më qartë, ata po të duan, le ta shfrytëzojnë. Ne t'u japim çdo ndihmë të mundshme e që mund të na kërkojnë dhe të forcojmë lidhjet internacionaliste me ta. Të jemi, gjithashtu, të gëzuar që edhe ata të na japin eksperiencën e partive dhe të grupeve të tyre, si edhe pasqyrën e gjendjes social-ekonomike të vendeve të tyre ku organizojnë luftën. Kjo do ta ndihmojë Partinë tonë në luftën që bën në shkallë ndërkombëtare kundër imperializmit, revizionizmit dhe rrymave të tjera ideologjike borgjeze.

VËREJTJE PËR LISTAT E MATERIALEVE QË DO TË KËRKOJMË NGA KINA

Në listat e materialeve që do të kërkojmë me kredi nga Kina bëra sot disa vërejtje. Specialistët të rishikojnë kapacitetin e fabrikës së gomës, pse do të punojë me kauçuk importi dhe mund të shtojmë aty prodhimin e këpucëve edhe me materiale të tjera më të lira; të rishikohet, gjithashtu, numri i sondave dhe i skarpellave etj., se mos listat janë përgatitur kaluar, pa marrë parasysh kritikën e fundit që u bënë, po kështu për pompat, traktorët (për akselerimin e transportit të sondave); të shikohet edhe zëvendësimi i disa mallrave të konsumit, të kalojnë me klering dhe të zëvendësohen me ato që tash janë vënë me klering, po mund të arsyetohen me kredi.

BISEDË E PËRZEMËRT ME PARTIZANEN E VJETËR BIJE VOKSHI

Kishim sot për drekë Bije Vokshin nga Gjakova, ish-partizane e vjetër, që në formimin e Partisë. Shtëpia e saj në Tiranë ka qenë qendër ilegale e punës sonë. Ishte për drekë edhe shoku Xhafer Spahiu.

Gjatë bisedës që bëmë, Bija na shprehu gëzimin dhe habinë e saj të madhe për ndërtimin me sukses të socializmit në Shqipëri. Ajo ishte larguar që në kohën e luftës ose aty nga mbarimi i saj, në rast se nuk gabohem, dhe kishte qëndruar në Kosovë pa ardhur në Shqipëri gjatë një jete të tërë, mundet rreth 20 vjet. Kjo ndodhi nga situatat armiqësore që krijoi klika Tito-Ranković kundër vendit tonë.

Bija nuk ka ndryshuar, është ajo e para siç ka qenë, e vendosur për socializmin, më duket nuk hyri në parti në titiste. Bija ushqen një dashuri dhe një besim shumë të madh për Partinë tonë¹.

¹ Përmbajtja e kësaj bisede gjendet në Arkivin Qendror të Partisë.

RRETH ZËRAVE PËR NJË KRIZË POLITIKE MIDIS KRERËVE TË KREMLINIT

Agjencitë perëndimore të lajmeve po bëjnë zhurmë për gjoja një krizë që ekziston në Kremlin në mes të Brezhnjev-Kosiginit nga njëra anë dhe Suslov-Mazurov-Shelepinit e Polianskit nga ana tjetër.

Mosmarrëveshje, grindje dhe përgatitje për t'u ngritur këmbët njëri-tjetrit ka atje sa të duash, por sa është e vërtetë që të jetë pjekur kriza, kjo nuk dihet. Tým pa zjarr nuk ka, por edhe korrentet e ndryshme të politikës kapitaliste i fryjnë e i zmadhojnë gjërat pa arsye të dokumentuara. Një krizë e tillë në Kremlin do të jetë e mirë, por revizionistët e Moskës kanë bërë çmos ta mbytin atë që në vezë. Të shohim, të ndjekim gjendjen.

SHËNIM

Ministria e Jashtme e Italisë kërkoi largimin e një diplomatit tonë të rangut të ulët, duke e akuzuar se gjoja merrej me spiunazh. Ambasada jonë e hodhi poshtë këtë trillim dhe e nisi për në Shqipëri funksionarin në fjalë.

PUNONJËSIT E AMBASADAVE TONA TË JENË NJERËZ POLITIKË E SHUMË TË KUJDESSHËM

Bisedova me Kadri Hazbiun¹ për provokacionin që kurdisi policia italiane kundër njërit prej shokëve të personelit të ambasadës sonë në Romë. E këshillova posaçërisht që të evitojë «punëra» që rrezikojnë influencën politiko-ideologjike dhe autoritetin që ka krijuar Republika Popullore e Shqipërisë në Itali e gjetkë. Ky autoritet në asnjë mënyrë nuk duhet të errësohet në sy të shokëve dhe të miqve të huaj të Shqipërisë për gjëra të vogla dhe pa vlerë të madhe. Njerëzit që punojnë në ambasada, në radhë të parë, duhet të jenë njerëz politikë dhe shumë të kujdesshëm.

¹ Atëherë ministër i Punëve të Brendshme, tani dhënë organeve të diktaturës së proletariatit si armik i popullit dhe i Partisë.

SITUATA NË KAMBOXHIA PO KEQËSOHET

Princi Sihanuk, «neutralist», u rrëzua nga një grusht shteti i përbërë nga njerëz në shërbim të amerikanëve. Princi «neutralist» po bënte turizëm në Francë, lëshonte deklarata kundër komunizmit, kundër «trupave të Vietnamit të Veriut dhe të Vietkongut», që gjoja ndodheshin në tokën kamboxhiane dhe tash shkon në Moskë dhe në Pekin, nga lëshon deklarata «të zjarrta». Do të shohim se si do të zhvillohen ngjarjet, por rriten vështirësitë për luftën çlirimtare të Vietnamit. Kukullat e Sajgonit dhe ato të Pnom-Penit do të veprojnë në akord të plotë nën drejtimin e amerikanëve. Kufiri në mes Vietnamit të Jugut dhe Kamboxhias, në parim, hyri në duart amerikane. Në praktikë duhet të zhvillohet lufta edhe në tokën e Kamboxhias, luftë partizane për rrëzimin e klikës amerikane të Pnom-Penit. Pjesëmarrësit e kësaj lufte duhet të bashkëpunojnë ngushtë me partizanët e Laosit dhe të Vietkongut. Nuk duhet lejuar që të izolohehen partizanët e Vietnamit të Jugut dhe të dobësohet lufta partizane në Laos. Kjo është me rëndësi të madhe për suksesin e mëtejshëm të luftës antiimperialiste në gadishullin e Indokinës.

ÇFARË DO TË SJELLË TAKIMI MIDIS PËRFAQËSUESVE TË TË DY SHTETEVE GJERMANE

Bisedimet në mes dy shteteve gjermane në Erfurt u bënë. Ç'u arrit nuk tregohet. Natyrisht, jo shumë gjëra, por edhe duhet të konsiderohet si kontakti i parë zyrtar. Që diçka është thënë dhe është vendosur atje, për këtë s'ka dyshim. Një gjë është e sigurt që nga ana e Republikës Demokratike Gjermane, asgjë nuk bëhet akoma në këtë drejtim, pa qenë e koordinuar dhe pa marrë pëlqimin e Moskës në radhë të parë dhe të Traktatit të Varshavës. Tjetër punë ç'do të rezultojë më vonë, kur marrëdhëniet e të dy shteteve gjermane do të konsolidohen. Bashkimi Sovjetik do të përpiqet t'i mbajë satelitët në kapistër dhe t'i lëshojë të kullosin aq sa të mos hanë çajret e tij. Por dikur kapistra do të këputet.

E MARTË
24 MARS 1970

KRIZA NË UDHËHEQJEN REVIZIONISTE SOVJETIKE

Shënime

Këta 10-15 vjetët e fundit në Bashkimin Sovjetik ka pasur dhe do të ketë vazhdimisht kriza. Ky është rezultat logjik i restaurimit të kapitalizmit, i kalbëzimit të regjimit aktual në këtë vend. Kontradiktat antagonistë midis grupeve në udhëheqje dhe kontradiktat antagonistë në mes këtyre grupeve dhe popullit, po thellohen, po acarohen. Po shkohet drejt konflikteve. Kriza e regjimit kapitalist revizionist sovjetik është e brendshme dhe e jashtme, shfaqet në politikën e brendshme dhe në atë ndërkombëtare. Në fushën ideologjike ajo ka çuar në degjenerim me pasojat e saj më të këqija dhe në fushën ekonomike në degjenerim me pasojë katastrofike. E gjithë kjo sjell krizën dhe degjenerimin e strukturës, çon në restaurimin e forcave ushtarake fashiste, i vetmi mjet i borgjezisë kapitaliste për të shtypur demokracinë, rezistencën, popullin dhe për të përgatitur aventura ushtarake jashtë, kundër vendeve e popujve të tjerë.

Rruga që ndjekin revizionistët sovjetikë është ajo e militarizimit me sforcë të Bashkimit Sovjetik. Kjo natyrisht, nuk shkon pa ndeshje, pa kontradikta dhe pa cenuar interesat jetësorë të punonjësve. Në këtë rrugë ata janë në aleancë dhe ndihmohen nga imperializmi amerikan dhe kapitalizmi botëror.

Fakt është se kapitalet amerikane dhe të vendeve të tjera kapitaliste po vërshojnë në Bashkimin Sovjetik. Kjo ngjet njëjloj si në çdo vend tjetër kapitalist dhe në kolonitë e tyre, ngjet siç ngjau në Gjermaninë kapitaliste të pasluftës së Parë dhe të Dytë Botërore. Kjo do të thotë se kapitalistët perëndimorë, që investojnë në Bashkimin Sovjetik, janë të sigurt për atë që bëjnë: ndihmojnë revizionistët sovjetikë për një qëllim të madh të përbashkët që është antikomunizmi. Por duke ndihmuar në zhvillimin e industrisë së Bashkimit Sovjetik, aq sa u intereson ata, në të njëjtën kohë, revizionistëve u krijojnë mundësi që të shtojnë edhe armatimet. Kjo duket si një paradoks, por është një realitet. Këtu s'ka asnjë enigmë.

Sigurisht kapitali botëror, me atë amerikan në krye, me investimet që bën në Bashkimin Sovjetik, synon të nxjerrë përfitime të mëdha ekonomike dhe në fakt nxjerr. Investimet që ky kapital bën në Bashkimin Sovjetik janë rentabël për të në mjaft drejtime. Kështu, për shembull, përveç të tjerave, pavarësisht se ekonomia sovjetike është e fuqishme, sidomos, në lëndë të parë, kapitali ndërkombëtar ndikon në orientimin e ekonomisë së Bashkimit Sovjetik dhe e frenon atë në ato drejtime që atij nuk i interesojnë. Në të njëjtën kohë kapitalet e huaja që vërshojnë në Bashkimin Sovjetik kanë përgatitur dhe përgatitin çdo ditë e më shumë bashkëpunimin në mes trusteeve dhe koncerneve kapitaliste me trustet dhe koncernet sovjetike. Këto të fundit janë në këmbë dhe vetëm maskën kanë socialiste, kurse përmbajtjen, organizimin e kanë sipas modelit të koncerneve kapitaliste, bilë po e perfeksionojnë atë. Reformat ekonomike revizioniste që po bëhen kanë pikërisht këtë qëllim, perfeksionimin e regjimit kapitalist, që t'u përgjigjet partnerëve kapitalistë të tjerë, mundësisht t'i kalojë ato, por duke gjetur dhe duke ruajtur maskat e domosdoshme të gjoja një ekonomie socialiste. Tradhtia e marksizëm-lenin-

nizmit dhe kalimi i udhëheqjes renegate sovjetike në revizionizëm do të sillte, sikundër solli, degjenerimin e Bashkimit Sovjetik, degjenerimin moral, politik, ideologjik dhe në struktura. Në këto të fundit, tradhtarët hrushovianë janë përpjekur dhe do të përpiqen vazhdimisht të ruajnë disa tipare të jashtme të pandryshueshme për arsye taktike, por në brendi do t'i zhveshin krejtësisht nga thelbi i tyre marksist-leninist.

Aktualisht ky degjenerim ka marrë forma monstruozë në Bashkimin Sovjetik me krijimin e një klase të korruptuar që sundon në ekonomi, në politikë, në ideologji dhe në lëmin ushtarak. Ingranazhet e makinës së tradhtisë janë kurdisur dhe po vajisen në mënyrë të tillë që kapitali botëror të shohë e të ketë në Bashkimin Sovjetik një siguri dhe një të ardhme të lulëzuar për veten e tij.

Kapitalizmi botëror ka arritur në konkluzionin se me tradhtinë e hrushovianëve, siguroi një agjenturë të fuqishme me ndihmën e së cilës do të jetë në gjendje të luftojë «me sukses» komunizmin dhe revolucionin botëror. Këtë ai nuk ishte në gjendje ta bënte dot vetë as me demagogji sociale, as me forcën e armëve. Kapitalizmi botëror e kupton se tradhtarët revizionistë sovjetikë për një kohë të gjatë do të mundin të shfrytëzojnë për veprën e tyre minuese, kundërrevolucionare, autoritetin dhe prestigjin e madh të Bashkimit Sovjetik, autoritetin botëror të Leninit, të leninizmit, të marksizëm-leninizmit.

Por në të njëjtën kohë kapitalizmi botëror e di se kjo, domethënë ardhja në fuqi e revizionizmit hrushovian në Bashkimin Sovjetik, është një fitore e përkohshme. Megjithatë ai përpiqet ta konsolidojë këtë fitore.

Çfarë të mirash i solli revizionizmit hrushovian kapitalizmi botëror?

— Mbolli farën e përçarjes në gjirin e partive komuniste, në gjirin e lëvizjes punëtore ndërkombëtare.

— Luan rolin e grevëthyesit në revolucion dhe të zjarrfikësit në zhvillimin e luftërave nacionalçlirimtare që shtypen me zjarr nga xhandari botëror, imperializmi amerikan.

Pra, kapitalizmi botëror dhe revizionizmi modern luftojnë së bashku kundër revolucionit, kundër komunizmit, kundër socializmit dhe kundër popujve që janë ngritur në këmbë dhe luftojnë për lirinë e tyre.

Në krye të armiqve të popujve janë imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik. I pari ecën në rrugën e fashistizimit të jetës. I dyti ecën, gjithashtu, me hapa të mëdhenj dhe të sigurt në këtë drejtim. Të dy luftojnë kundër popujve e vendeve të tjera, kundër forcave revolucionare. Ky objektiv i përbashkët i afron, i bashkon. Por, si imperialistë që janë ata kanë edhe synime të veçanta që i ndajnë dhe i vënë kundër njëri-tjetrit. Një synim i tillë është sundimi i botës, ndarja e sferave, e zonave të influencës, silurimi në mënyrë të heshtur i pozitave të njëri-tjetrit në zonat ekzistuese të influencës. Midis tyre ekzistojnë, pra, edhe kontradikta, të cilat ashpërsohen vazhdimisht. Këto kontradikta as nuk duhet të harrohen, as nuk duhet të nënvleftësohen. Ato bile mund të acarohen aq shumë, sa të shpërthejnë në konflikte të armatosura, në luftë imperialiste në mes tyre.

Aktualisht ekzistojnë marrëveshje të heshtura ushtarako-politike në mes dy blloqeve, atij të Atlantikut me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye dhe atij të Varshavës, me Bashkimin Sovjetik në krye. Brenda këtyre blloqeve ekziston një rrjetë merimange aleancash të shumëllojta, por ama ekzistojnë, gjithashtu, edhe kontradikta të panumërta që i minojnë këto lidhje. Në fakt konstatojmë se jashtë blloqeve e aleancave dhe brenda-përbrenda tyre, po zhvillohen bisedime, po përfundohen kontrata, po nënshkruhen traktate, po jepen kredi, po investohen kapitale, po bëhet osmoza kapitalisto-re-

vizioniste. Më të rëndësishmet nga këto janë ato që firmosen në mes dy krerëve të imperializmit botëror, sovjetikëve dhe amerikanëve. Vërtet që Shtetet e Bashkuara të Amerikës i japin ndihmë me kredi Bashkimit Sovjetik revizionist, por në të njëjtën kohë e nëpërmjet saj ata përpiqen ta neutralizojnë, mundësisht edhe ta dobësojnë e ta mbajnë në një nivel inferior forcën ushtarake sovjetike, në krahasim me forcat ushtarake agresive të tyre. Këtu e kanë qëllimin edhe traktatet që kanë nënshkruar ose përpiqen të përfundojnë, si në lëmin e atomit ashtu edhe të armëve të tjera. Qëllimi i tyre i vërtetë nuk synon as në ruajtjen e paqes, as në zhdukjen e armatimeve, as në zhdukjen e luftërave, por në evitimin e përkohshëm të konflikteve në mes të dyja fuqive imperialiste, në ruajtjen e statukuosë, të dominimit të botës nga dy fuqitë e mëdha.

Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik po përgatiten për luftë. Në këtë kuadër ata minojnë e pengojnë luftërat nacionalçlirimtare të popujve, që janë ngritur dhe që do të vazhdojnë të ngrihen në luftën e armatosur kundër tyre. Njëkohësisht ata janë të detyruar të zhvillojnë një luftë të brendshme kundër popujve të tyre që ngrihen në revolucion, në greva politike dhe ekonomike; janë të detyruar të luftojnë kundër forcave centrifugale brenda të ashtuquajturave blloqe të tyre, ku ziejnë pakënaqësia, revolta dhe kryengritja iminente.

Imperializmi i Shteteve të Bashkuara e ndien veten «më të fortë» në perandorinë e tij. Ai është plotësisht i përgatitur ideologjikisht dhe ushtarakisht për agresion, të cilin e ka në gjak dhe e zhvillon në të gjitha format, në të gjitha kontinentet.

Që kur hrushovianët tradhtuan socializmin, u vunë, siç e deklaruan vetë, në rrugën «për të arritur dhe për

të tejkaluar Shtetet e Bashkuara të Amerikës». Natyrisht kjo «do të bëhej» në rrugën antisocialiste, kapitaliste. Hapur një gjë e tillë ishte e pamundur pse hrushovianëve do t'u duhej të kalonin nga rruga e shkatërrimit të Bashkimit Sovjetik, e transformimit të tij nga një vend socialist në një vend kapitalist. Prandaj atyre u duhej të rrëmonin dhe të gjenin forma kapitaliste të tilla që të ruanin maskën e tradhtisë së këtyre transformimeve. Tradhtia s'paguan, tradhtia nuk forcon, po dobëson, tradhtia nuk rindërton, po shkatërron. Ky proces është ligj dhe nuk pyet nëse je shtet i madh apo i vogël, shtet i fuqishëm apo i dobët ekonomikisht. Këtu vetëm koha llogaritet, procesi i degjenerimit, i dobësimit, i transformimit bëhet shpejt apo me vonesë. Këtë proces e ndalon dhe e shpartallon vetëm kryengritja e armatosur, revolucioni.

Tashmë, Bashkimi Sovjetik ka hyrë kokë e këmbë në këtë proces shkatërrimtar. Kudo, në çdo sektor, ai është në krizë. Bujqësia është në krizë të madhe, industria e lehtë dhe e rëndë po ashtu, organizimi strukturor i shtetit dhe i ekonomisë gjithashtu, reformat ndjekin reformat. Bashkimi Sovjetik, siç thotë populli, po «ha trupin e vet». Investime kolosale po bëhen për militarizimin e vendit dhe për përgatitje agresive ushtarake imperialiste. Fonde kolosale janë investuar për kërkimet kozmike. Por këto fonde, tash që u është hapur drita jeshile Shteteve të Bashkuara të Amerikës në këtë fushë, s'mjaftojnë më.

Krizë e madhe ka përfshirë Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Ajo nuk është më një parti marksiste-leniniste. Ajo ka degjeneruar në një aparat burokratik pa vlerë ku asnjë normë leniniste s'qëndron në këmbë, ku bëhet vetëm demagogji dhe propaganda shërbën vetëm për të thënë se «ruhet tradita».

E gjithë superstruktura e Bashkimit Sovjetik ka hy-

rë në kaosin e degjenerimit borgjez të lyer me një cipë të rreme gjoja marksiste. Mirëpo bashkimi i kombësive dhe i republikave të ndryshme që formojnë Bashkimin Sovjetik u arrit në rrugën marksiste-leniniste. Tash ky bashkim i drejtë nuk mund të ruhet më në rrugën e kapitalizmit. Revizionizmi modern nxit nacionalizmin dhe shovinizmin rusomadh, nxit sundimin e nacionaliteteve të vogla nga ato të mëdhatë, shtyp çdo liri demokratike, pse ka zhdukur diktaturën e proletariatit, ka krijuar shtresën e shfrytëzuesve me aparatet shfrytëzuese ekonomike kapitaliste dhe forcën shtypëse ushtarake në shërbim të këtij regjimi të ri që po restaurohet.

Klika revizioniste në Bashkimin Sovjetik mbahet, pra, në fuqi me anën e dhunës kundërrevolucionare. Jashtë kjo klikë revizioniste nuk dominon më plotësisht në kampin e revizionistëve. Unitet nuk ekziston, ky është një unitet formal, unitet parade. Edhe në mes Bashkimit Sovjetik dhe shteteve revizioniste, gjoja aleate të tij, nuk ekziston unitet, por ka ndërhyrë dhe do të ndërhyjë dhuna e revizionistëve sovjetikë me anën e forcës së armatosur.

Metodat, pra, të dhunës militaristo-fashiste sovjetike kanë hyrë në veprim, ato janë rrjedhim logjik i vendosjes së regjimit kapitalist në Bashkimin Sovjetik. Dhuna militaristo-fashiste vepron brenda në Bashkimin Sovjetik, vepron në vendet e tjera revizioniste aleate të tij kundër klikave ultrarevizioniste antisovjetike dhe klikave prosovjetike nga një anë dhe kundër revoltës popullore që shfryn e që përgatitet kundër tyre.

Në arenën ndërkombëtare forca militaristo-fashiste sovjetike ka filluar të dalë në Lindjen e Afërt dhe të vendosë bazat në Egjipt dhe gjetkë, nën maskën gjoja të ndihmës ushtarake për popujt. Flota sovjetike agresive ka filluar të duket dhe të bëjë manovra në dete dhe në oqeanë, manovra që kanë karakterin e theksuar të për-

gatitjes së një lufte botërore. E gjithë kjo përgatitje është e koordinuar me imperializmin amerikan, sido që maskohet me parulla bombastike.

Revizionistët sovjetikë, të vendosur të ecin në rrugën e aventurave dhe të luftërave imperialiste, kalojnë përmes vështirësish të mëdha dhe krizash politiko-ekonomike etj. Ata bëjnë përpjekje të mëdha për t'i kapërcyer ato, por më kot, bëjnë përpjekje të mëdha t'i fshehin ose t'i zvogëlojnë. Ata nga të katër anët gjejnë rezistencë dhe luftë të madhe brenda dhe jashtë shtetit të tyre. Shqipëria dhe forcat e tjera revolucionare janë armiqtë e pamposhtur të revizionistëve dhe të imperialistëve, prandaj tehu i tyre kryesor jashtë drejtohet kundër nesh dhe revolucionarëve në gjithë botën.

Flitet se ka krizë në udhëheqjen revizioniste sovjetike. S'ka asnjë dyshim që ka dhe vazhdimisht do të ketë. Ushtarakët janë në fuqi dhe do ta forcojnë pushtetin e tyre militaristo-fashist. Pushteti në Bashkimin Sovjetik revizionist do të shkojë kurdoherë nga e djathta, derisa atë ta përllajë revolucionin i ri proletar, i organizuar brenda në Bashkimin Sovjetik, nga një parti e re dhe e vërtetë marksiste-leniniste-staliniane.

**E SHTUNË
4 PRILL 1970**

RËNDËSIA E LUFTËS NACIONALÇLIRIMTARE NË HISTORINË E POPUJVE TË JUGOSLLAVISË

Lexova artikullin që është përgatitur të botohet nesër në gazetën «Zëri i popullit» për rëndësinë e luftës nacionalçlirimtare në historinë e popujve të Jugosllavisë. I bëra disa rregullime të nevojshme e të domosdoshme dhe në fund i shtova edhe paragrafin që vijon: Revizionistët imperialistë rusomëdhenj, në aleancë të fshehtë me agjentët e tyre shovinistë serbomëdhenj, gabojnë rëndë kur mendojnë se do t'i gjejnë në gjumë popujt e Jugosllavisë, të të gjitha nacionaliteteve, përpara rrezikut që mund t'i kërcënojë. Popujt e Jugosllavisë do t'ua bëjnë varrin të gjithë atyre që do të tentojnë t'u shkelin lirinë dhe independencën.

Artikulli mban titullin: «Rëndësia e luftës nacionalçlirimtare në historinë e popujve të Jugosllavisë».

**E HËNË
6 PRILL 1970**

ÇU EN LAI VIZITON KORENË

Dje paradite Çu En Lai arriti për një vizitë miqësore në RDP të Koresë.

VLORE, E MËRKURË

8 PRILL 1970

VIZITA E ÇU EN LAIT NË KORE

Shënime

Këto ditë Çu En Lai shkoi zyrtarisht për një vizitë miqësore në Republikën Demokratike Popullore të Koresë, i ftuar nga Kim Ir Seni. Ky është një akt politik me rëndësi për marrëdhëniet midis Kinës dhe Koresë.

Politika e Maos dhe e qeverisë kineze rezultoi me fitore përballë qëndrimeve revizioniste, oportuniste, megalomane të Kim Ir Senit dhe të grupit të tij në udhëheqjen e Partisë së Punës të Koresë dhe të qeverisë së kësaj republike «socialiste». Kim Ir Seni dhe grupi i tij, që në daljen në dritë të grupit tradhtar revizionist të Hrushovit, filloi të mbante një qëndrim oportunist karakteristik, të lëkundur. Partinë e Punës të Shqipërisë, që u atakua aq egërsisht nga hrushovianët, ai që në fillim as e mbrojti dhe as e sulmoi haptazi. Megjithatë dihet që Kim Ir Seni i shprehu haptazi animet e tij nga hrushovianët. Ai nuk e aprovonte aspak qëndrimin e drejtë dhe militant marksist-leninist të Partisë sonë dhe haptazi i tha shokut Manush «...ju këshilloj që të shkoni në Moskë, të pajtoheni me ta, t'u jepni dorën dhe t'u ngrini kapelën, se ndryshe do të dëmtoheni», pra të venim në Moskë te Hrushovi dhe të bënim autokritikë.

Nga ana jonë kuptohej qartë se me ç'njeri politik kishim të bënim. Kim Ir Seni ishte një revizionist, që

përpiqej të hiqej i maskuar, të mos afishohej drejtpërdrejt dhe haptazi me hrushovianët, por të mbante të gjitha lidhjet me ta, të mënjanohet nga Kina dhe nga ne, që luftonim revizionizmin modern, me revizionistët sovjetikë në krye. Kim Ir Seni dhe grupi i tij mendoi se gjeti kështu rrugën e vërtetë ekuilibriste, atë «të mesmen», «të arbitrit të madh e të pagabuar, marksist-leninistit të vërtetë». Kjo është pozita e tij në dy karrige. Por, kjo politikë revizioniste oportuniste as në teori dhe as në praktikë s'do të qëndronte gjatë në këmbë pa u demaskuar nga ngjarjet që precipitonin, nga lufta revolucionare që Partia e Punës e Shqipërisë dhe partitë e tjera marksiste-leniniste i bënin revizionizmit modern.

Marrëdhëniet tona në rrugë partie dhe shtetërore me Korenë u fishkën jo për fajin tonë. Ne i ruajtëm lidhjet diplomatike dhe vazhduam të bënim atë tregti të vogël që lejonin koreanët. Këta ne nuk i atakuam hapur për qëndrimet e tyre revizioniste, por në disa artikuj, me raste, bënim aluzione për këtë vijë, pa përmendur emra, por nga ai që donte të kuptonte, kuptohej kujt i drejtoheshin. Nga ana tjetër, ne e mbrojtëm Republikën Demokratike Popullore të Koresë në çdo rast të vështirë që i krijonin kësaj imperialistët amerikanë, japonezët dhe kukullat e Koresë së Jugut. Ne mbështetnim kurdoherë bashkimin e Koresë, në shtyp dhe në OKB.

Me Kinën, aleaten, çlirimtaren dhe miken e Koresë, klika e Kim Ir Senit filloi t'i acarojë marrëdhëniet dhe të armiqësohet me të.

Nga ana e saj Kina mbajti ndaj Koresë një qëndrim dinjitoz, të pjekur, miqësor, edhe duke mos qenë aspak dakord me qëndrimet revizioniste të Kim Ir Senit. Kina jo vetëm publikisht nuk i dha shkak as më të voglës polemikë, megjithëse arsyet ishin të shumta dhe provokuese nga ana e koreanëve, por në fakt, sa dimë ne, ajo vazhdoi kurdoherë ta mbronte Korenë e Veriut në arenën

ndërkombëtare, t'i jepte ndihma ekonomike dhe ushtarake.

Arroganca dhe mendjemadhësia e Kim Ir Senit kanë shpërthyer pa kufi. Kulti i Kimit filloi të ngrihet në Kore në mënyrë skandaloze, jo vetëm si «udhëheqës i lavdishëm dhe brez pas brezi i Koresë», por edhe i popujve të Azisë, si «marksist-leninisti më i madh». Maoja ishte një «mizë» para tij. Paturpësia shkonte deri atje sa qenkësh «rreshteri Kim» që filloi luftën partizane çlirimtare të Kinës! Kulmi i poshtërsisë së tij ishte mohimi i luftës së madhe dhe i sakrificave të mëdha të vullnetarëve kinezë, në sajë të të cilëve u çlirua Koreja e Veriut nga invadorët amerikanë dhe nga ushtarët e koalicionit fashist. Koreanët filluan bile të prishnin deri edhe varret e vullnetarëve kinezë.

Kina mbajti gjakftohtësi ndaj këtyre poshtërsive të revizionistëve koreanë, ajo ruante lidhjet e miqësisë me popullin korean. Lidhjet me popullin kurdoherë janë të shenjta, mbi to mund të kalojnë valë dhe furtuna, por nuk i këputin dot këto lidhje.

Me fillimin e Revolucionit Kulturor Proletar në Kinë, grupi i Kimit e ashpërsoi më tepër qëndrimin e tij armiqësor kundër Kinës, ai mbronte kështu miqtë e tij të fshehtë me Liu Shao Çinë në krye, mbështeste miqtë e tij revizionistët sovjetikë.

Kur Kina po sulmohej, Kim Ir Seni afrohej ditë-ditës me revizionistët e Moskës, që venin e vinin në Kore. Kimi merrte prej tyre ndihma ekonomike dhe ushtarake, aktivizohej si «politikani dhe revolucionari më i madh i Azisë dhe i botës». Ai afishoi me bujë lidhjet me Kastron si dy promotorët e «revolucioneve botërore».

Mirëpo zjarri ishte prej kashte, shpresat revizioniste u venitën, revizionistët modernë sovjetikë u demaskuan keq dhe po shkonin drejt katastrofës. Imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik, të dobësuar dhe të rre-

thuar nga të katër anët nga lufta dhe nga mëria e popujve, hynë në aleancë të shenjtë për të mbrojtur perandoritë e tyre të tronditura. Gjelit Kim Ir Sen filluan t'i bien pendët. Sovjetikët i kërkonin atij çmime të mëdha për sadakatë që i jepnin dhe gjatë kësaj kohe gjendja ekonomike e popullit korean ishte e mjeruar. Çdo gjë ai e merrte me triska dhe me racione mizerje.

Por presioni i imperializmit japonez dhe amerikan po dukej hapur kundër Kinës, kundër Koresë, kundër gjithë gadishullit indokinez dhe gjithë popujve të Azisë. Në këto situata dukej qartë plani i revizionistëve sovjetikë. Këta filluan provokimet në Usuri e gjetkë, afruan forcat me militarizmin japonez, marrin kredi prej tyre dhe u japin koncesione të mëdha në Siberi.

Flitet se sovjetikët u kërkojnë koreanëve veriorë që të miqësohen me japonezët, të cilët nga ana e tyre përgatiten të zënë vendin e amerikanëve në Korenë e Jugut, ashtu siç kanë në mend të bëjnë dhe në Tajvan dhe të vënë në zbatim doktrinën e Niksonit: «Aziatikët të luftojnë kundër aziatikëve». Sovjetikët detyruan po ashtu koreanët të lirojnë ekuipazhin e «Pueblos», anijes spiune amerikane, duke u thënë koreanëve se «ju na prishni punë». Sovjetikët dënuan veprimin e drejtë të koreanëve që rrëzuan një avion amerikan në hapësirën ajrore koreane.

Presione si këto revizionistët sovjetikë bëjnë vazhdimisht mbi koreanët, këta nuk i furnizojnë as me armë dhe as mbajnë angazhimet e furnizimeve ekonomike ndaj Koresë. Këto janë që dimë ne, po kush e di ç'komplete të tjera bëjnë sovjetikët në Kore derisa «thika mbërriti në palcë». Kim Ir Seni i bëri thirrje Kinës. Ai u detyrua të bënte një kthesë prej 180 gradësh. Kina iu përgjigj thirrjes së koreanëve. Fjalimet e Çu En Lait dhe të Kim Ir Senit, si edhe komunikata e përbashkët që u lëshua, tregojnë se bisedimet u mbyllën mirë dhe me sukses.

Siç duket nga fjala e Kim Ir Senit, ai e sheh jo vetëm rrezikun amerikano-japonez, por edhe atë të revizionistëve sovjetikë. Derisa Kim Ir Seni arriti të flasë me terma «të ngrohtë dhe elozhiozë» për Revolucionin Kulturor, për Maon, për socializmin që po ndërtohet në Kinë, për miqësinë me popullin kinez dhe për ndihmën e madhe që i ka dhënë popullit të Koresë, ai flet në fakt kundër revizionistëve sovjetikë.

A ndërroi Kimi? A u bë ai njeri i mirë? Unë mendoj se duhet të kalojë shumë ujë nën urë pa ndoshta të përmirësohet ai diçka. Por fakt është se kjo që po bën, mund të konsiderohet një kthesë politike me prirje të drejtë, por jo me bindje ideologjike. Qëndrime konsekuente edhe të theksuara në rrugën marksiste-leniniste mund ta korrigjojnë disi këtë megaloman oportunist. Konjunkturat e bënë atë të bëjë kthesën. Të shohim tash a do të vazhdojë ta konsolidojë këtë pozitë, apo do të vazhdojë si kurdoherë të sillet si xhirueta që vërtitet nga fryn era.

Sidoqoftë, këtë veprim të shokëve kinezë ne e aprovojmë dhe e mbështetim. Kjo ishte një fitore për kinezët dhe një disfatë e një demaskim për revizionistët sovjetikë. Podgorni, që po atë ditë do të shkonte zyrtarisht në Tokio të piqej me mikun e tij Mikadon, u bë i sëmure dhe nuk shkoi. Sëmundje diplomatike. Vajtja e Çu En Lait në Kore i demaskoi haptazi karakterin dhe qëllimet e kësaj vizite të kryetarit të shtetit revizionist të Krem-linit.

E SHTUNË
11 PRILL 1970

SHËNIME PËR KAMBOXHIAN

Sot shpallëm deklaratën e Qeverisë¹ sonë në mbrojtje të popullit të Kamboxhias, në mbështetje të deklaratave zyrtare të princit Sihanuk, që ka lëshuar nga Radio Pekini, kundër klikës reaksionare të Lon Nolit, agjenturë e CIA-s.

Ambasadori ynë në Pekin u takua me Sihanukun dhe i dorëzoi këtë deklaratë. Ky, përveç fjalëve entuziaste dhe vlerësimit shumë të lartë që u bëri Shqipërisë dhe politikës sonë, në mes të tjerash i tha ambasadorit: «Deklarata e Qeverisë suaj është një dokument historik për Kamboxhian, është i pari dhe i vetmi qëndrim i drejtë që duhet të ndiqet nga të gjitha qeveritë mike të Kamboxhias».

Është e qartë se grushti i shtetit u kurdis nga amerikanët, të ndihmuar me siguri edhe nga francezët, të cilët e tërhoqën princin borgjez në Paris dhe shtynë klikën e Lon Nolit të vepronte. Francezët s'ka se si të lajnë duart nga ky grusht shteti, për arsye të interesave ekonomikë e të tjerë që kanë atje dhe për arsye se janë oficerë instruktorë francezë ata që mësojnë dhe stërvitin ushtrinë e Sihanukut. Sihanuku si borgjez e kishte mendjen të fjetur nga Franca, e konsideronte këtë mike dhe ishte po ky Sihanuk që i kishte dhënë frerët e drejtimin Lon Nolit, i cili i bëri varrin.

¹ Shih: «Zëri i popullit», 12 prill 1970.

Sihanuku pas kësaj që i ngjau do të mendohet dhe ka filluar të mendohet. Kalimi i tij nga Moska bëri që ai akoma të mos prononcohej, pse me siguri revizionistët sovjetikë u përpoqën ta bënin atë veglën e bindur të tyre. Por përvoja e fituar e ndihmoi për rrugën e drejtë në luftën që duhej të ndiqte kundër imperializmit amerikan dhe agjentëve të tij në kamboxhia. Rezultati: deklaratat e tij të drejta, thirrja për kryengritje popullit të Kamboxhias, thirrja për unitet në një front të përbashkët, thirrja për unitet në luftën kundër amerikanëve, me Vietnamin e Veriut, me Vietkongun dhe me Patet Laosin.

Kjo rrugë është e drejtë, në rast se princi nuk lëkundet dhe nuk lëviz, pse princ dhe borgjez është. Por këtë vijë aktuale të drejtë ne duhet ta mbështetim. Sihanuku ka kërkuar ndihmën tonë në OKB dhe ne kemi qenë dakord t'ia japim. Kështu që çdo deklaratë e tij paraqitet dhe shpërndahet nga përfaqësuesit tanë në OKB. Qëndrimet tona ndaj Kamboxhias propagandohen edhe nga Kina, domethënë se ajo është dakord me to.

Të shohim tash se si do të zhvillohen lufta, rezistenca dhe aleancat e Sihanukut brenda dhe jashtë vendit të tij. Shpëtimtare për çlirimin e Kamboxhias nga thonjtë e amerikanëve është, në radhë të parë, lufta e vetë popullit kamboxhian. Rëndësi ka edhe koordinimi i ngushtë i luftës së popullit kamboxhian me luftën e Vietnamit të Veriut, të Vietkongut, të Patet Laosit dhe të partizanëve tajlandezë. Sipas mendimit tim, duhet të krijohet fronti i përbashkët luftarak dhe politik i popujve të gadishullit indokinez, kundër invadorëve amerikanë dhe intrigave të revizionistëve sovjetikë. Mendoj se këta do të intrigojnë shumë, drejtpërdrejt dhe tërthorazi.

Influenca e Sihanukut në vend nuk duhet të jetë e vogël, por çështja është se sa do të jetë ai në gjendje ta shfrytëzojë atë. Rëndësi kanë veprimet e shpejta dhe të

thella politike dhe ushtarake për të mos u lënë kohë Lon Nolit dhe amerikanëve të konsolidojnë pozitat. Këtu qëndron maratona e luftës, këtu duhen luftuar e duhen shtypur lëkundjet dhe hezitimet e Sihanukut dhe intrigat e revizionistëve sovjetikë.

SIHANUKU ÇMON PËRKRAHJEN QË NE I JAPIM LUFTËS SË POPULLIT KAMBOXHIAN

Norodom Sihanuku na ktheu përgjigjen e deklaratës së Qeverisë sonë, që bëmë në lidhje me Kamboxhian. Ishte një mesazh i ngrohtë, i zjarrtë, plot mirënjohje për qëndrimet parimore të Qeverisë sonë. Mesazhin tonë ai e quan «një dokument historik për Kamboxhian dhe për luftën çlirimtare të popullit të tij».

Kemi marrë masa që në OKB ta mbrojmë çështjen e Kamboxhias. Sihanuku për këtë gjë mbështetet te ne në radhë të parë, na e ka kërkuar këtë ndihmë dhe ne i jemi përgjigjur se jemi kurdoherë gati.

DEFEKT NË ANIJEN KOZMIKE «APOLO-13»

Anija kozmike amerikane «Apolo-13» me tre kozmonautë brenda, që u nis për në Hënë, pësoi një defekt. Pjesa e shërbimeve kryesore mbeti pa energji elektrike, pa oksigjen, pa ujë. Arsyeja nuk dihet. Thuhet se mund të jetë goditur nga ndonjë meteorit, thuhet të ketë ndodhur qark i shkurtër. Pjesa kryesore e trenit spacial u bë e papërdorshme. Siç po thonë radiot, në Hënë nuk do të shkohet dhe u dha urdhër që anija të kthehet në Tokë.

«APOLO-13» PO KTHEHET NË TOKË

Anija kozmike «Apolo-13» po vazhdon rrugën e kthimit drejt Tokës. Ka shumë rreziqe për astronautët. Puna qëndron në atë që t'u mjaftojnë energjia elektrike, oksigjeni, uji për pije dhe për motorët, si dhe ushqimet. Alarm i madh në opinionin botëror për jetën e tre astronautëve. Në rast se çdo gjë shkon në rregull, të premtën ata duhet të zbresin në oqeanin Paqësor.

SHËNIME

Këshillova shokët e Ministrisë së Tregtisë që në furnizimin e kleringut në asnjë mënyrë të mos u krijohet deficit nga ana jonë vendeve revizioniste. Kjo ka, veçanërisht, rëndësi politike.

Po lexoj fjalimin që do të mbahet në mbledhjen solemne me rastin e 100-vjetorit të lindjes së Leninit.

SYNIMET E TITISTËVE

Pas artikullit të fundit, me rastin e përvjetorit të sulmit fashisto-hitlerian mbi Jugosllavinë, ku ne bënim vlerësimin e drejtë të luftës së popujve të Jugosllavisë, jugosllavëve, natyrisht, u erdhi mirë dhe përnjëherë u përgjigjën, reciprokisht, me rastin e 7 prillit 1939, dhe po me atë frymë për luftën tonë.

Por me këtë rast titistët theksonin se duhej shkuar më tej në përmirësimin e marrëdhënieve në mes dy vendeve tona. Ata, duke theksuar se ekzistojnë kontradikta ideologjike në mes nesh, sugjeronin që «këto t'i linim mënjanë». Taktikë e vjetër titiste, sepse ne i kemi zgjeruar disi më shumë marrëdhëniet tregtare, kemi bërë disa shkëmbime në fushën e arsimit e të kulturës me Kosovën, dhe sidomos libra shkollorë, por në këtë çështje titistët pengojnë shumë dhe atë pak që lejojnë, e bëjnë nga zori.

Çfarë dëshirojnë titistët? Të «hapen» kufijtë dhe të shkëmbehen turistë. Për ata kjo do të thotë të futin te ne «fitoret e titizmit», korrupsionin, dekadencën në letërsi e në art, spiunazhin, mënyrën e jetesës amerikane dhe perëndimore, idetë e tyre revizioniste, antimarksiste, tradhtarë.

Është e kuptueshme, titistët s'do të futen kurrë te ne me këto gjëra.

Titistët mendojnë të përfitojnë nga koniunkturat ak-

tuale kur revizionizmi sovjetik bën kërcënime kundër lirisë dhe independencës së popujve të Jugosllavisë, dhe ne jemi solidarë me këta të fundit për mbrojtjen e sovranitetit të tyre. Titistët përpiqen të çajnë rrethimin politik-ideologjik marksist-leninist që po u bëjmë, që kur ata tradhtuan. Ata duan, dhe këtë na e kanë propozuar, ta ngrenë legatën e tyre në Tiranë në rang ambasade, dhe ne tonën po ashtu në Beograd. Janë titistët, ata që e hoqën të parët ambasadorin nga Tirana, tani marrin iniciativën.

Ne, megjithëse në parim mund t'i ngremë, nuk do të ngutemi.

Kinezët e bënë një gjë të tillë, duke e marrë jugosllavët iniciativën. Kinezët thonë se duan të nxitin kontraktat që ekzistojnë në mes titistëve dhe sovjetikëve.

Po pse nuk ngutemi ne për këtë çështje?

a) Për të mos i dhënë asnjë ndihmë në lëmin ndërkombëtar Titos, kur ai e ndien veten të dobësuar.

b) Për të mos e lejuar titizmin, që edhe nëpërmjet këtij akti politik, që për ne është dhe do të qëndrojë formal, të hiqet se «ai qenkësh i pagabuar» dhe ja edhe «Shqipëria i rregulloi punët me të më në fund».

c) Për të mos i dhënë mundësi titizmit që «në forcën e tretë» ku hiqet sikur ai e drejton, të thotë «ja edhe me Kinën e me Shqipërinë unë u pajtova».

Titoja dhe titizmi janë demaskuar dhe janë diskredituar si brenda ashtu dhe jashtë.

Titizmi me Titon në krye është një agjenturë e kualifikuar e kapitalit botëror, e revizionizmit modern dhe në veçanti e imperializmit amerikan, të cilit i ka bërë dhe vazhdon t'i bëjë shërbime të mëdha.

Me krerët revizionistë aktualë të Kremlinit ka kontraktat. Këto kontraktat janë në kuadrin e kontraktave amerikano-sovjetike, por me specifikën e tyre jugosllave. Këto kontraktat herë acarohen, herë zbuten.

Unë mendoj se nuk do të degjenerojnë në konflikt të armatosur sovjeto-jugosllav. Me gjithë kërcënimet që revizionistët e Moskës i bëjnë Titos pse ky kundërshton dominimin absolut të tyre mbi vendet e tjera revizioniste, ata i ruhen një konflikti me armë me Jugosllavinë edhe për arsye të komplikacioneve të rënda që duhet të përballojnë nga shumë anë.

Nga këto qëndrime të sovjetikëve, Titoja nxjerr përfitime për të vazhduar punën e tij tradhtare. Ai hiqet sikur është «kundër revizionistëve sovjetikë», dhe derisa hiqet si «antirevizionist sovjetik», na qenka, për ata që duan ta besojnë, «një leninist i vërtetë», që «nuk ka gabuar kurrë»! Dhe që të besohet kjo gënjeshtër e madhe, Titoja kritikon haptazi imperializmin amerikan për agresionin në Vietnam, për ndihmën që ky i jep Izraelit kundër popujve arabë e të tjera qëndrime e profka të tilla. Megjithëkëtë imperializmi amerikan i jep Titos kredi me dhjetëra milionë dollarë. Kjo duket si kontradiktë, por fakt është se Titoja i shërben imperializmit amerikan, veçanërisht në vendet e Afrikës.

Pavarësisht se Titoja njihet botërisht si njeriu i amerikanëve, ai u shërben këtyre si ndërmjetës në tratativa që amerikanët bëjnë me krerët borgjezë të shteteve të ndryshme. Titoja u përgatit terrenin, rrumbullakos qoshet e mosmarrëveshjeve, propozon ujdite dhe kompromiset amerikane. Këtu e kanë kuptimin çeqet që ai merr dhe demagogjia që ai bën, duke kritikuar amerikanët dhe duke u hequr si i persekutuar i sovjetikëve. Që të plotësojë tablonë dhe të ngrejë rolin dhe personalitetin e tij, Titoja do të hiqet sikur edhe me Kinën dhe me Shqipërinë tash i ka punët grurë, i rregulloi pse ngriti ambasadat.

Titoja e di se prestigji i Kinës dhe i Shqipërisë është i madh, në botë e në popuj. Prandaj që të paraqitet në popujt që luftojnë imperializmin dhe revizionizmin, që kanë besim të madh dhe na duan ne, Kinën dhe Shqi-

përinë, Titoja bën përpjekje sikur i ujdisi punët me kundërshtarët më të rreptë politikë dhe ideologjikë të tij, shqiptarët dhe kinezët. Prandaj këtë armë, ne nuk duhet dhe nuk ia japim këtij agjenti antikomunist.

Ne do të jemi vigjilentë.

Ne në asnjë rast nuk duhet të bëjmë ndonjë akt që të ndihmojë veprimtarinë armiqësore të titizmit qoftë brenda te ne, qoftë në arenën ndërkombëtare. Vija jonë ndaj popujve të Jugosllavisë është e drejtë, këtë duhet ta ndjekim me shkathtësi dhe kurdoherë në interes të vendit tonë, të marksizëm-leninizmit dhe të revolucionit.

E MARTË
21 PRILL 1970

SHËNIM

Shtypi ynë duhet të mbrojë çështjen e popullit kambodxian dhe të Sihanukut që qëndron mirë. Të demaskohen në shtyp e në radio vrasjet barbare të vietnamezëve nga ana e Lon Nolit dhe e mercenarëve të tij.

E MARTË
21 PRILL 1970

MBLEDHJE SOLEMNE KUSHTUAR 100-VJETORIT TË LINDJES SË V.I.LENINIT

Sot pasdite në sallën e Teatrit të Operës e të Baletit të Pallatit të Madh të Kulturës u mbajt mbledhja solemne kushtuar 100-vjetorit të lindjes së Leninit. Mbledhjen e hapa unë me një fjalim të shkurtër. U këndua Internacionajla, pastaj foli shoku Ramiz. Pas pushimit u dha një koncert.

NE JEMI MARKSISTË-LENINISTË TË SINQERTË

Dje në mbledhjen solemne për 100-vjetorin e Leninit u takova me të ngarkuarin me punë të Kinës. I thashë atij t'i transmetojë, nga ana ime, falënderimet gjithë udhëheqjes kineze që mori pjesë në banketin e ambasadës sonë në Pekin¹. I thashë, gjithashtu, ta urojë Çu En Lain për vizitën që bëri në Kore.

Të shohë kështu Çuja që ne jemi marksistë-leninistë dhe të sinqertë. Kur u takua me Kosiginin, ne i thamë se nuk ishim dakord, kurse tash që vajti në Kore, jemi dakord dhe e përgëzojmë për këtë sukses të çështjes sonë të përbashkët.

1 Më 19 prill 1970, ambasadori i RPSH në RP të Kinës Xhoxhi Robo dha një pritje për udhëheqësit e Partisë e të Qeverisë të RP të Kinës në të cilën morën pjesë Çu En Lai, Çen Po Ta, Kan Shen, Çan Çun Çiao, Huan Jun Shen, Li Hsien Nien, Vu Fa Hsien dhe Li Te Shen si dhe një numër anëtarësh e kandidatësh të KQ të Partisë e të tjerë.

MBI BURIMIN KRYESOR TË TEKNOKRATIZMIT

Shënime

Shkenca dhe teknika, thonë teoricienët borgjezë, nuk bëjnë dallime midis rendit socialist dhe atij kapitalist. Ato udhëheqin progresin dhe jo luftën e klasës, pra ç'na duhet revolucioni proletar, na mjafton revolucioni tekniko-shkencor. Kjo është aksioma kryesore e teorive teknokratike, burim i reformizmave të ndryshëm borgjezo-revizionistë.

Teoritë borgjeze dhe mjetet që borgjezia përdor për ta mbajtur veten gjallë, për të mos dhënë shpirt, synojnë të vërtetojnë se zhvillimi i shkencës dhe i teknikës, domethënë, revolucioni tekniko-shkencor, çon në aplikimin e tyre dhe andej në prodhime, pra, nuk kërkon të përcaktojë «raportet e prodhimit». Sipas këtyre teorive reformiste qoftë koncernet, qoftë shteti kapitalist monopolist që drejtohet prej tyre dhe punon për to, çon shkencën përpara dhe prodhon.

Mirëpo, në radhë të parë, kush i ka këto mjete në dorë? Këto mjete përdoren për t'u sjellë fitime trusteve, apo për të mirën e masave punonjëse? Këto përdoren për zhvillimin e shkencës apo për zhvillimin e atyre degëve dhe mjeteve që sjellin fitime të shpejta?

Natyrisht të gjitha këtyre pyetjeve, vetëm marksizëm-leninizmi u përgjigjet në mënyrë korrekte, vetëm

lufta e klasave dhe revolucionit proletar me dhunë i vënë pikat mbi i për të gjitha këto probleme kardinale, teorike dhe praktike, të teorisë, të shkencës, të revolucionit tekniko-shkencor.

Zbatimi i shkencës në prodhimin e të mirave materiale, që mbetet decizive në jetën shoqërore, varet nga marrëdhëniet në prodhim dhe me gjithë automatizimin, kibernetikën apo ordinatorët elektronikë, ajo nuk mund as të dominojë, as të eliminojë punëtorin; ndryshohet vetëm raporti i prodhuesit, me objektivin e prodhimit, domethënë «karakterit i punës», siç thotë Marksi në «Kapitali», vëllimi II, libri I, kapit. XV.

Makina, mjet pune i punëtorëve, natyrisht, më e kualifikuar nga ana teknike se vegla e thjeshtë e punës, është perfeksionuar, por prapë kjo nuk mund të ecë, nuk mund të vihet në punë pa ndërhyrjen e punëtorit. «Analiza ekonomike» pa politikë, është një analizë që u pëlqen dhe e bëjnë teoricienët e borgjezisë e të kapitalit, kurse për ne marksistë-leninistët ekonomi politike nuk mund të ekzistojë **pa politikë**.

Idealizmi

Pragmatizmi

Prakticizmi

Panteizmi.

E PREMTE
24 PRILL 1970

SHËNIM

Bisedova me hollësi me Çeno Nushin për gjendjen dhe për punën e Partisë Komuniste të Italisë (m-1).

E SHTUNË
25 PRILL 1970

KINA HODHI SATELITIN E PARË TË TOKËS

Fitore e madhe e Kinës, hodhi satelitin e parë të Tokës me një peshë mbi 170 kg.

E MARTE
28 PRILL 1970

SATELITI I PARË KINEZ DHE JEHONA NË BOTË

Jehona e lëshimit të satelitit kinez është shumë e madhe. Borgjezia kapitaliste dhe shtypi i saj flet «me admirim» sikur zbuloi Amerikën, sikur çuditet dhe nuk çuditet, por mbi të gjitha në këto komente tregohet frika e madhe e saj.

Janë çoroditur kapitalistët dhe presin të papritura akoma më të frikshme për ta. U ka hyrë frika në palcë nga fuqizimi i Kinës.

E MËRKURË
29 PRILL 1970

**MBËSHTETIM DEKLARATËN E PËRBASHKËT
TË KONFERENCËS SË NIVELIT TË LARTË
TË POPUJVE TË INDOKINËS**

Agjencia kineze e lajmeve HSINHUA njoftoi se më 24 dhe më 25 prill është mbajtur konferenca e nivelit të lartë e popujve të Indokinës, me pjesëmarrjen e udhëheqësve të Kamboxhias, të Laosit, të Republikës së Vietnamit të Jugut dhe të RD të Vietnamit. U botua edhe deklarata e përbashkët, që kanë aprovuar këto delegacione pas bisedimeve në konferencë. Ne do ta mbështetim nga ana qeveritare dhe do ta propagandojmë me shtyp e me radio.

E MËRKURË
29 PRILL 1970

SHËNIM

I dhashë Ministrisë së Jashtme aprovimin tim për një sërë veprimesh diplomatike me Rumaninë, me Pakistanin, me Vendet Skandinave, me vendet e Afrikës dhe Italinë, si edhe për një ndarje më të drejtë të akreditimit të ambasadorëve tanë, meqë lidhjet diplomatike po shtohen me shumë shtete të reja.

SHENJË E MIRË E PALËS KINEZE

Shokët kinezë nga Pekini na lajmërojnë që njerëzit tanë të bisedojnë në detaje me të ngarkuarin e tyre me punë në Tiranë për veprat e fundit që kemi kërkuar me kredi. Kjo është shenjë e mirë.

FASHISTI NIKSON SULMOI KAMBOXHIAN

Niksoni tregoi edhe një herë tjetër fytyrën e përfaqësuesit luftënxitës të imperializmit amerikan dhe vetë-demaskoi gënjeshttrat dhe demagogjinë e tij pseudopacifiste. Dy-tri ditë më parë ai deklaroi se do të tërhiqte 150 mijë trupa nga Vietnam. Ky ishte një bluf si gjithë të tjerët, por, nga ana tjetër, ai tregon pozitat shumë të vështira në të cilat përpëlitet imperializmi amerikan, i cili është futur në një ingranazh të tmerrshëm dhe tash, me hyrjen e trupave të tij në Kamboxhia, u fut më thellë në një det zjarri më të gjerë, më të dendur, më kompakt. Tash imperializmit amerikan i duhet të hedhë në furrë forca të reja më të mëdha dhe të përballojë forca më të shumta të bashkuara dhe që kanë mundësi të mëdha manovrimi.

Popujt e Indokinës po bashkohen si një trup kundër armikut të përbashkët dhe do t'ia bëjnë më shpejt varrin. Kina do t'i ndihmojë ata si kurdoherë edhe më mirë. Deklaratat e udhëheqjes kineze janë të qarta. Imperialistët amerikanë dhe miqtë e tyre, revizionistët sovjetikë, janë në ethe dhe kanë pse të jenë. U prishën dhe do të prishen planet e tyre.

Revizionistët sovjetikë janë kapur si miu në dhokan, s'dalin dot nga kllapat e tradhtisë dhe po futen më thellë në batac. Deklaratat e tyre për Kamboxhian janë bajate, false, cinike. Ambasadori i tyre vazhdon të ketë lidhje

të ngushta me Lon Nolin. Pozitive është që Sihanuku nuk ndodhet në kthetrat e tyre. Sihanuku po fillon t'i njohë kush janë revizionistët sovjetikë dhe miqtë e tyre në Vietnam që me siguri do të orvaten të bëjnë shumë veprime për të dobësuar frontin e bashkuar të popujve të Indokinës.

Por me hyrjen e amerikanëve në Kamboxhia vietnamezët e Veriut duhet të kenë me siguri shumë deziluzione nga gënjeshttrat e sovjetikëve, të cilët patjetër i shtynin të hynin në bisedime me amerikanët, të tregoheshin «paqësorë» etj.

Imperialistët amerikanë filluan përsëri bombardimet e Vietnamit të Veriut. Kjo është një disfatë e madhe për revizionistët sovjetikë, një demaskim i tmerrshëm për ta, si miq të imperializmit amerikan. Vietnamezët duhet të nxjerrin mësimet e duhura, në qoftë se nuk duan disfatën.

E DIEL
3 MAJ 1970

SIHANUKU KËRKON MBËSHTETJEN TONË

Princi Sihanuk takoi ambasadorin tonë në Pekin, e vuri në dijeni për formimin e qeverisë së Kamboxhias dhe kërkoi mbështetjen dhe njohjen e saj nga ana jonë. Ne lajmëruam ambasadorin që t'i deklarojë se e mbështetim dhe e njohim qeverinë që formon ai.

E MARTE
5 MAJ 1970

TAKIM ME DELEGACIONIN E PUNËTORËVE KINEZË

Prita në selinë e Komitetit Qendror të Partisë delegacionin e punëtorëve kinezë që mori pjesë në festimet e 1 Majit në vendin tonë¹.

¹ Delegacioni kryesohej nga anëtari i Komitetit Qendror të PK të Kinës dhe nënkryetar i komitetit revolucionar të Shangait, Van Hun Ven.

E ENJTE
14 MAJ 1970

SHËNIM

Ramizi më raportoi për punën e bërë nga delegacionet tona të Bashkimeve Profesionale në Kongo (B), në Siri, në Algjeri dhe në Marok.

E ENJTE
14 MAJ 1970

REVIZIONISTËT SOVJETIKË NË LËMSHIN E KONTRADIKTAVE TË PAZGJIDHSHME

Sot iu dërgua redaksisë së gazetës «Zëri i popullit» artikulli me titull: «Revizionistët sovjetikë në lëmshin e kontradiktave të pazgjidhshme»¹. Do të botohet nesër.

¹ Shih: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 582.

E SHTUNË
30 MAJ 1970

POLITIKA DHE QËNDRIMET TONA NË MARRËDHËNIET SHTETËRORE ME JUGOSLLAVINË DHE NË MBROJTJE TË VËLLEZËRVE TANË KOSOVARË JANË PARIMORE, TË VENDOSURA DHE TË PANDRYSHUESHME

Sot mbërrita në qytetin «Bajram Curri» për një vizitë në rrethin e Tropojës. Rrugës dhe në qytet, m'u bë një pritje shumë e nxehtë, patriotike dhe revolucionare. Dashuria e malësorëve kreshnikë të Tropojës për Partinë, ashtu si e gjithë malësorëve dhe e gjithë popullit tonë, është me të vërtetë e madhe dhe e thellë.

Në qytet ishte organizuar, me këtë rast, një miting i madh, në të cilin përshëndeta edhe unë me një fjalim. Përveç problemeve të zhvillimit e të jetës së brendshme, në fjalim u ndala dhe përcaktova edhe një herë, në përgjigje të akuzave, të shpifjeve e të veprimeve shoviniste e antishqiptare të udhëheqjes titiste ndaj vendit tonë dhe ndaj kosovarëve, politikën dhe qëndrimet tona parimore, të vendosura e të pandryshueshme, në marrëdhëniet në rrugë shtetërore me Jugosllavinë. Brenda kësaj vije fola edhe për qëndrimin tonë të njohur e të drejtë ndaj popujve të Jugosllavisë si dhe për interesimin e natyrshëm e të ligjshëm ndaj vëllezërve tanë të shumëvuajtur kosovarë. Lidhur me këto dy çështje, midis të tjerave për të parën, theksova se populli shqiptar, në rast rreziku, do të përkrahë popujt e Jugosllavisë, ashtu siç ka bërë edhe në

të kaluarën, kundër cilitdo agresor që do të kërcënonte lirinë, sovranitetin dhe pavarësinë kombëtare të popujve tanë. Për të dytën, midis të tjerave, theksova se do të ishte antimarksiste dhe një tradhti kombëtare në qoftë se ne do ta neglizhonim faktin që në Jugosllavi jeton, në tokat e veta, një popullsi e madhe shqiptare, në qoftë se nuk do të pyetnim për fatin e saj. Mbrojtjen e vëllëzërve tanë kosovarë dhe të të drejtave të tyre ne e kemi bërë dhe do ta bëjmë, gjithnjë, brenda normave ndërkombëtare e njerëzore, brenda normave të fqinjësisë së mirë midis dy shteteve tona.

E MËRKURË
10 QERSHOR 1970

SHËNIM

Me Ramizin bisedova për Partinë Komuniste të Polonisë dhe për dërgimin e një delegacioni të Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë në OKB, për të marrë pjesë në Kongresin Botëror të Organizatave të Rinisë të shteteve anëtare të kësaj organizate¹.

¹ Delegacioni, i kryesuar nga Rudi Monari, në atë kohë sekretar i Komitetit Qendror të BRPSH, u nis për në Nju-Jork më 6 korrik. Kongresi i zhvilloi punimet nga data 9 deri më 18 korrik 1970.

KINEZËT BISEDOJNË MBI «PLANET RUMUNE NË BALLKAN»

Kadri Hazbiu u kthye nga Kina dhe na raportoi.

Ai pati bisedime me Çu En Lain dhe me Kan Shenin, nga më kryesorët që e pritën, pastaj edhe me udhëheqës të tjerë më të ulët. Pritja ka qenë e ngrohtë, miqësore; u thanë fjalë të mira për Shqipërinë dhe për Partinë tonë.

Biseda e bërë nga Çu En Lai, ku ishte i pranishëm edhe Kan Shenin, nuk kishte asgjë të re, fraza dhe ide të përgjithshme, që zhvillohen më gjatë në gazetën «Zhen-minzhibao», megjithëse takimi kishte karakter të nivelit të lartë. Asnjë konsideratë politike nuk u tha nga kinezët mbi disa probleme kryesore në veprimtarinë e tyre:

- 1) Asgjë për vajtjen në Kore dhe konsideratat e tyre për këtë çështje.
- 2) Asgjë për bisedat me rumunin Bodnarash.
- 3) Asgjë për gjendjen e bisedimeve me sovjetikët dhe për zhvillimin e mëtejshëm të tyre.
- 4) Asgjë për zhvillimin e situatës në Indokinë.

Për të katër këto probleme, në mos për të tjera, ne duhej të ishim vënë në korent, derisa kinezët morën mundimin dhe organizuan një takim të nivelit të lartë. Pse u bë ky takim, për të mos na thënë gjë? Veçanërisht për bisedimet me sovjetikët dhe me rumunët shokët kinezë kishin detyrë të na informonin.

Me Bodnarashin ne mendojmë se kanë bërë biseda

politike dhe organizative të gjata, bile edhe të përzemërta. Çu En Lai duhet të jetë entuziast për politikën «e shkathtët dhe të vendosur» revizioniste që i parashtrroi Bodnarashi. Derisa kinezët neve nuk na thonë gjë, por tërthorazi morëm vesh se rumunëve u dhanë rreth 50 milionë juanë, derisa kanë në plan t'u japin fabrika armësh (këtë e tha Kan Shenin, i cili shtoi se «ju (shqiptarët) mund t'i merrni pastaj armët nga rumunët», kemi arsye të mendojmë se të dyja palët kanë biseduar gjatë mbi «planet rumune në Ballkan». Këto plane konsistojnë në «aleancën rumuno-jugosllavo-shqiptare» e të tjera poshtërsi revizioniste të papranueshme nga ne, por të këndshme për Çu En Lain, mjaft që këto aleanca dhe miqësira të jenë kundër sovjetikëve, pa kush janë Titoja dhe Çausheku, aq i prish punë Çusë.

Mirëpo ne nuk e hamë gjellën e Çusë, i cili mendon se, nga qëndrimet tona të drejta parimore marksiste-leniniste të koniunkturës aktuale, ne po rrëshqasim atje ku dëshiron ai. **Çuja i merr dëshirat e tij për realitet, por ato nuk do të realizohen kurrë, se ne nuk do të shkelim asnjëherë në dhogë të kalbur.** Titoja dhe titizmi janë armiq të marksizëm-leninizmit, janë antisocialistë dhe anti-shqiptarë. Si revizionistë, titistët bashkëpunojnë ngushtë me amerikanët. Sot kanë disa kontradikta me revizionistët sovjetikë, nesër i sheshojnë ato. Qëndrimet tona aktuale ndaj popujve të Jugosllavisë janë të drejta e parimore, ato ndihmojnë edhe shqiptarët e Kosovës për të forcuar pozitën e tyre kundër shovinizmit serbomadh, duke u bërë njëkohësisht një mbrojtje edhe për Republikën Popullore të Shqipërisë.

Sigurisht ne nuk do të pranojmë që revizionistët rumunë të na «furnizojnë me armë», se fatin e mbrojtjes sonë nuk mund ta varim në qafën e atyre, që tash janë të lidhur ngushtë me Titon, me amerikanët dhe nesër e ujdisin (se mos e kanë të prishur në fakt) edhe me revizio-

nistët sovjetikë. Të gjitha shpresat e Çu En Lait në këtë drejtim janë të kota.

Nuk ishte i drejtë, bile ishte një mendim krejt revizionist, ai që Çu En Lai tha në këtë takim, se «ne luftojmë revizionizmin sovjetik duke luftuar imperializmin amerikan». Një gjë e tillë s'tregon tjetër veç zigzageve tradicionale të Çu En Lait. Na vjen shumë keq. E megjithatë polemikën me sovjetikët ata e vazhdojnë. Pse flitet kështu, pa kontroll, kurse për gjëra të tjera bëhet kontroll i madh, me qëllim që të mos flitet për asgjë?

Sidoqoftë, këto janë mendimet e tyre, ne kemi tonat. Ne do të përipiqemi t'i bindim edhe në ato çështje për të cilat nuk jemi dakord me shokët kinezë.

E SHTUNË
27 QERSHOR 1970

SHËNIM

Ramizi më parashtrori mënyrën se si do të jepet në radio në gjuhët e huaja fjalimi që kam mbajtur në Mbledhjen e 81 partive në Moskë¹.

¹ Më 18 korrik 1970 u vu në qarkullim në gjuhët frëngjisht, anglisht e spanjisht. Në shqip u botua në librin: «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. III, f. 414. Tiranë, 1970.

NE NUK E FUTIM ATDHEUN NË GRACKA REVIZIONISTE

Çaushesku i Rumanisë, aleat i Titos, ka marrë përsipër të luajë rolin e atij që është i vetmi në gjendje të realizojë «unitetin e vendeve socialiste në diversitetin ideologjik të tyre».

Ky revizionist, në një nga fjalimet e tij të fundit, lëshoi këtë *ballon d'essai*¹, për të mashtruar.

Revizionistët sovjetikë po vazhdojnë në ethe orvatjet për të rrethuar e për të gllabëruar Rumaninë, kurse nga ana e tij Çaushi pretendon se është «arkitekti i unitetit» aq të dëshiruar revizionist. Natyrisht, aleanca dhe mbështetja të Titoja dhe të «komunizmi» i këtij të fundit nuk ia lyen me flori paranë kallp Çausheskut, por ky mbështetet të «miqësia e kinezëve». Këtu qëndron çështja e «unitetit» për revizionistët: **kush prej tyre do të arrijë «të zbutë» politikën e Kinës dhe ta afrojë këtë në brazdën e vet.**

Kina po udhëhiqet nga parimi: «Kush është antisovjetik duhet afruar, të shfrytëzohen kontradiktat». Shfrytëzimi i kontradiktave nuk duhet neglizhuar, por kjo duhet bërë pa harruar asnjëherë se me kë ke të bësh dhe jo të mos marrësh parasysh koniunkturat e të mendosh se shfrytëzon kontradiktat duke e shtyrë këtë ose atë revizionist.

1 Frëngjisht — sprovë sondazhi.

zionist të jetë në kundërshtim të përkohshëm me revizionistët sovjetikë. Këto kundërshtime të revizionistëve në mes tyre mund të jenë dhe të vazhdueshme, se ata janë kapitalistë; megjithatë shfrytëzimi i tyre në favorin tonë duhet të ketë për qëllim jo forcimin e njërit ose të tjetrit në dëm të socializmit, por dobësimin e të dyja palëve dhe demaskimin e tyre.

Revizionistët rumunë zhvillojnë një politikë të qartë antimarksiste, të brendshme dhe të jashtme. Ata janë krimbur në borxhe ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Gjermanisë Perëndimore, Francës dhe vendeve të tjera kapitaliste. Natyrisht, këto shtete japin kredi kur shohin se do të kenë përfitime ekonomike dhe politike. Këtu qëndron politika «e pavarur» e Çausheskut. E pavarur përballë kujt? Përballë revizionistëve sovjetikë, të cilët nuk pajtohen me këtë gjendje. Kurse Çaushesku, që kërcënohet në konsolidimin e regjimit të tij kapitalist «të pavarur» nga kapitalistët revizionistë sovjetikë dhe të varur nga kapitalistët amerikanë e perëndimorë, pretendon se gjoja socializmi në Rumani kërcënohet dhe prandaj kërkon miqësinë dhe mbështetjen e Kinës, tonën etj.

Për ne është e qartë kjo situatë, kurse për kinezët jo aq fort. Këta kujtojnë dhe besojnë se udhëheqësit rumunë janë «burra të mirë, burra të fortë, antisovjetikë të vendosur». Ne do ta mbështetim popullin rumun në qoftë se do të kërcënohet me invadim nga sovjetikët, por në gjërat e tjera, në propozimet e panumërta që bëjnë udhëheqësit rumunë në politikën ballkanike e ndërkombëtare, nuk do t'i mbështetim aspak. Ata janë revizionistë në çdo gjë, ata janë të politikës së Titos dhe përpiqen të arrijnë dhe të futen atje ku nuk arriti dhe nuk u fut dot Titoja. Çaushesku është një kartë akoma e padjegur si duhet në duart e amerikanëve. (Ku ta dish? Ndoshta dhe e sovjetikëve.)

Kinezët kanë qenë dhe janë entuziastë për rumunët.

Këto kohë vajti atje Bodnarashi dhe i përrallosi mirë, bile aq mirë, sa, kur Emili i tha Maos se «ne, në rast se na sulmojnë rusët, do t'i lëmë të futen brenda, pastaj t'i dërrmojmë» (teza e Maos) ky i dha edhe një «bravo».

Pas vizitës në Kinë, Bodnarashi na doli jo vetëm një «politikan dhe strateg ushtarak i mbaruar», por edhe «prokinez i zjarrtë», «antisovjetik i thekur» dhe sigurisht mori zotime për ndërmjetësime edhe te miku i tij i ngushtë, Titoja. Kështu që «Emili i varfër» siguroi miqësinë e Kinës, siguroi 50 milionë juanë, siguroi fabrika armësh, i hapi rrugën ministrit rumun të Mbrojtjes që të vejë të kërkojë ndihma të tjera në Pekin etj., etj. Mund të vijë në Rumani edhe Çu En Lai, siç po flitet andej-këtej. Të gjitha këto e të tjera veprime të kinezëve janë në vijën e Çausheikut dhe nuk përbëjnë një mbështetje të matur, të studiuar dhe që ndihmon strategjinë tonë.

Haptas të padrejta janë edhe ideja e vjetër e Çu En Lait sipas së cilës «ju, shqiptarët, në platformën antisovjetike, kur sovjetikët kërcënojnë Jugosllavinë, mund të lidheni me marrëveshje ushtarake me Titon», — ide që ne ia hodhëm menjëherë poshtë, si dhe propozimi i furnizimit me armë nga Rumania që na e bëri Kan Shenin, gjoja si njeri që merret me çështje partie (por me sugjerimin e Çusë, për të lënë të kuptohet se ky mendim nuk është vetëm i Çu En Lait por i gjithë udhëheqjes, kuptohet, në radhë të parë, edhe i Maos). **Pra kinezët ëndërrojnë dhe planifikojnë një ujdi Jugosllavi-Rumani-Shqipëri kundër sovjetikëve. Ne nuk e hamë këtë, more shokë kinezë, nuk biem në këto gracka revizioniste, nuk e futim atdheun në gojën e ujqve. As ju, as Titoja, as Çausheiku s'na gënjeni dot. Do të përpiqemi t'ju hapim sytë në këto plane të gabuara, ose në këto taktika të gabuara, që ne të paktën mund të themi se po zhvillonin dhe që duhet t'i braktisni e të jeni më vigjilentë.**

Vetë Kan Shenin i tha ambasadorit tonë: «Ju mos u

çuditni që ne i bëjmë pritje madhështore ndonjë princi, mos u çuditni që ne presim delegacione të qeverisë franceze, mos u çuditni, në rast se ne do të presim dhe ndonjë delegacion sovjetik, por me ju, shqiptarët, jemi shokë armësh!» Pse bëhen këto deklaratime nga Kan Shenin?! Ç'po përgatitin?! Zbutje? Shuarje të luftës?

Konstatojmë se kinezët me zell po dërgojnë ambasador në Jugosllavi, në Bashkimin Sovjetik e gjetkë. Kjo në dukje është normale, por çfarë fshihet prapa tyre?

Kim Ir Seni për kinezët tash u bë «udhëheqës i madh». Kinezët entuziazmohen shpejt. Kim Ir Seni aktualisht mund të ketë disa kontradikta me sovjetikët, që natyrisht duhen shfrytëzuar, por ai vazhdon të mbajë lidhje normale me revizionistët sovjetikë dhe nuk duhet të çuditemi që ai e shfrytëzon këtë afrim me kinezët kundrejt sovjetikëve.

Flitet dhe në praktikë duket krijimi i njëfarë «fronti antiimperialist» kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës i përbërë nga kinezët, koreanët, vietnamezët, kambodhianët, laosianët e të tjerë. «Front antiimperialist», por tani pa revizionistët sovjetikë, jo siç thuhej dhe kërkohej të bëhej në kohën e Liu Shao Çisë. «Fronti antiimperialist» në të vërtetë nuk është një gjë e keqe sepse të gjithë këta popuj janë në luftë me imperializmin amerikan, por kinezët nuk duhet t'i harrojnë pikëpamjet ideologjike të Kim Ir Senit, manovrimet e sovjetikëve në udhëheqjen e Vietnamit, princin Sihanuk, që nesër mund të lëkundet shpejt si Sukarnoja. Sovjetikët patjetër manovrojnë në këtë mes.

Të gjitha këto, natyrisht, na detyrojnë të jemi shumë vigjilentë dhe t'i matim mirë hapat që hedhim, se në situatat që krijojnë revizionistët dhe shokët tanë kinezë, qëndrimet tona të drejta u duken sektare. S'ka si të mos duken të tilla nga ata që shikojnë me syze liberale dhe revizioniste, nga ata që taktikat i shndërrojnë në strategji

të gabuar dhe që, në një mënyrë ose në një tjetër, kërkojnë që edhe të tjerët të veprojnë si ata. Jo, ne nuk do të biem në gabime, u pëlqen ose nuk u pëlqen kjo disave. Ne do të ecim drejt, në rrugën marksiste-leniniste.

DURRËS, E MËRKURË
15 KORRIK 1970

NJË PËRPJEKJE RUMUNE QË NUK KALOI

Këtu ka ardhur një delegacion i Bashkimeve Profesionale të Rumanisë i kryesuar nga presidenti i tyre Florian Dënëlake. Ne e ftuam këtë delegacion për të forcuar disi më tej lidhjet e ftohta me Rumaninë dhe për ta ndihmuar këtë sadopak në këto momente. Shoku Rita dhe gjithë shokët tanë të Bashkimeve Profesionale u bënë atyre një pritje të ngrohtë shoqërore dhe një program pune e vizitash të shumta. Por rumunët kishin ardhur me qëllime politike të tjera. Kur shokët tanë u paraqitën programin, ata ishin dakord me të, po vunë pyetjen: «S'ka gjë tjetër?». Tanët u thanë: «Le të shfaqin dëshirën miqtë».

Dëshira e miqve ishte që t'i pritja unë në audiencë dhe ambasadori i tyre këtu u tha tanëve se Dënëlake «është dërguar nga Çaushesku, ka edhe një mesazh për shokun Enver».

Këtë «dëshirë» të paraqitur në këtë mënyrë dhe pa marrë aprovimin tonë, miqtë e shoqëruan menjëherë me deklarata në fjalimet e tyre të para, duke thënë përpara punëtorëve, në mes të tjerash se «kanë ardhur në emër të Partisë Komuniste të Rumanisë që t'i sjellin përshëndetjet Partisë së Punës të Shqipërisë» etj., etj. U duk qartë për ne ku ishte qëllimi i rumunëve dhe unë i thashë Ritës se nuk do t'i pres, ta lërë në heshtje këtë çështje, derisa vetë kryetari i delegacionit t'ia kërkojë një

gjë të tillë. Atëherë Rita t'i thotë se do t'ia komunikoj dëshirën tuaj shokut Enver, i cili është në pushime, por e shoh ca si të zorshme një takim të tillë.

Dënëlake nuk e kërkoi vetë, personalisht, por në fjalimin e tij kryesor të bashkëbisedimeve ai tha se «në Kinë delegacioni i Asamblesë Kombëtare, me Bodnarashin në krye, u transformua në delegacion partie, bisedoi në rrugë partie, e priti edhe Mao Ce Duni» etj. Me fjalë të tjera, ai donte të thoshte, bëni dhe ju si kinezët dhe transformojeni delegacionin tim në delegacion partie. Ne e parashikuam këtë dhe Rita në fjalimin e tij, sido që foli para rumunit, i dha të kuptojë se në mes dy partive tona ka shumë çështje në kundërshtim dhe mjaft çështje të veçanta që partia rumune duhet më parë t'i ndreqë, pse ka gabuar rëndë ndaj Partisë sonë.

Pse nuk i prita unë dhe asnjë nga shokët e tjerë të Byrosë veç Ritës?

Ishte e qartë për mua që më parë, duke ditur se ç'revizionistë janë udhëheqësit rumunë, me Çausheskun në krye, se ç'politikë titiste ndjekin ata, se nga ç'pozita (nacional-shoviniste) janë antisovjetikë dhe, pavarësisht se i rezistojnë presionit të sovjetikëve (dhe në këtë çështje ne i mbështetim), ishte, pra, e qartë se rumunët donin të piqeshin me mua, qoftë edhe pesë minuta siç u shprehën, për ta shfrytëzuar këtë politikisht, si brenda vendit të tyre, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Çaushesku me një të shtënë mendonte të vriste shumë zogj, po nuk vrau dot asnjë. Ai donte të vendoste lidhje partie dhe të likuidonte me një vizitë prej pesë minutash gjithë punën e qelbur që kishin bërë kundër Partisë sonë në kohën e Dezhit. Donte të tregonte me këtë takim, i cili do të propagandohej në gazeta, se «u arrit marrëveshja në mes kinezëve, jugosllavëve, shqiptarëve dhe rumunëve» dhe arkitektët e kësaj ishin rumunët, të cilët, si miq të Titos, bënë që ky «të dërgojë ambasador në Pekin», vetë ru-

munët u lidhën me kinezët nëpërmjet Bodnarashit dhe me shqiptarët, që ishin të detyruar të bënin si kinezët, hynë në këtë valle të organizuar nga Çaushesku, pikërisht në ato ditë kur Bodnarashi bisedonte me Titon në Brioni dhe gazetatat jugosllave propagandonin me të madhe perspektivën që çelte në miqësinë rumuno-shqiptare vajtja e delegacionit të sindikatave në Tiranë. E tërë kjo manovër nuk u kaloi.

E HËNË
20 KORRIK 1970

BISEDE PËR ÇËSHTJEN E KOSOVËS

Bisedova me Hysniun dhe me Ramizin për çështjen e Kosovës dhe të kosovarëve.

E MARTE
21 KORRIK 1970

TAKIM ME DELEGACIONIN E ASAMBLESE KOMBËTARE TË VIETNAMIT TË VERIUT

Sot, në Pallatin e Brigadave, prita delegacionin e Asamblesë Kombëtare të Vietnamit të Veriut, të kryesuar nga shoku Hoang Van Hoan, anëtar i Byrosë Politike. Shokun Hoang e njohim, se ka ardhur tri-katër herë në Shqipëri. Privatisht shprehet kundër revizionistëve sovjetikë, por, kur është me shokë, mban vijën oportuniste të udhëheqjes vietnameze: «Miq me të gjithë, armik vetëm me amerikanët».

Edhe këtë herë, duke folur, natyrisht, mirë për Partinë dhe për vendin tonë, na foli për luftën dhe për fitoret që po korrin në vendin e tij mbi amerikanët. Ai theksoi se vija e tyre kryesore është vetëm lufta, se kjo do t'u sjellë fitoren dhe s'do ta pushojnë deri në çlirimin e plotë. Shumë nuk foli për «politikën», për «mbledhjet e Parisit», pse, siç u duk, nuk u dha gjë lodra e sovjetikëve. Ai nuk foli as për Kinën, as për Bashkimin Sovjetik, foli për miqtë, duke thënë «ka miq që na ndihmojnë deri në fund, ka miq që na lënë në mes të rrugës». Foli po ashtu, shkurtimisht, për ngjarjet në Kamboxhia.

Unë i fola ngrohtë për miqësinë dhe dashurinë që kemi për popullin e Vietnamit dhe shpreha admirimin tonë për luftën heroike të tij, i thashë se ne kemi besim në fitoren dhe luftojmë e ndihmojmë në mënyrë modeste për këtë fitore.

I vura në dukje se nga ana materiale ndihma jonë për luftën e Vietnamit është shumë e vogël. Ne dëshirojmë ta shtojmë këtë ndihmë dhe, brenda mundësive tona, e kemi shtuar, megjithëkëtë kjo përsëri është e vogël, pse vetë ekonomia jonë është e vogël. Por ndihma jonë është e vlefshme në politikë, në ideologji, në luftën e ashpër që ne i bëjmë agresorit imperialist amerikan dhe dhelprës revizioniste sovjetike.

Revizionistët sovjetikë, i thashë, juve ju japin armë dhe ju thonë se i keni miq. Ju mund të thoni çfarë të doni, por nga njëra anë ata ju japin disa armë dhe krijojnë përshtypjen se ju ndihmojnë, nga ana tjetër ata janë miq e aleatë me agresorët dhe me vrasësit tuaj. Ata merren vesh me njëri-tjetrin, janë në ujdi që lufta të vazhdojë në Vietnam, pavarësisht se revizionistët sovjetikë japin disa armë dhe amerikanët pësojnë disfata. Qëndrimi tradhtar i revizionistëve sovjetikë e bën luftën të zgjatë në Vietnam, pse ndihma që ata u japin amerikanëve, në arenën ndërkombëtare, është shumë e madhe. Për një ndihmë të tillë politike kanë nevojë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, se ekonomikisht dhe në armatime ata janë në rregull.

I vura në dukje shokut vietnamez se ndihma e Kinës është një ndihmë e shumanshme, ekonomike dhe me armatime. Por të supozojmë për një moment se Kina nuk kishte mundësi t'ju jepte, atëherë ju ç'do të bënit? Si e mundët ushtrinë franceze, ushtarët e së cilës nuk ishin të frikshëm, pa eksperiencë dhe të paarmatosur? Kush jua dha armët? Askush! Ju ia morët ato armikut, i fabrikuat vetë në male dhe fituat. Ju fituat kundër imperializmit francez, se ishit të vendosur për luftë dhe udhëhiqeshit nga një parti marksiste-leniniste, me Ho Shi Minin në krye.

Që të mos i gjejnë revizionistët sovjetikë nga «ndihma» që u japin atyre, por t'i gjejnë se ç'janë ata

në thelb në arenën ndërkombëtare dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare, shokëve vietnamezë u zhvillova ide të e mëposhtme:

— T'i gjykosh këta tradhtarë në prizmin e ngushtë të «ndihmës» që të japin (domethënë siç bëjnë vietnamezët), do të thotë t'i ndihmosh ata në veprën e tyre tradhtarë.

— E ashtuquajtura ndihmë që japin, revizionistëve sovjetikë nuk u kushton gjë materialisht përpara fitimeve politike që nxjerrin prej saj.

— Në këtë mënyrë ata i shpëtojnë, deri diku, demaskimit të tyre si grevëthyes.

— Me këtë ndihmë ata bëjnë që të vazhdojë lufta në Vietnam dhe përpiqen të realizojnë planet e tyre të fshehta për të ngulur këmbët në këtë zonë.

— Revizionistët sovjetikë nuk veprojnë kështu vetëm në Vietnam. Të njëjtën politikë ata ndjekin edhe në Lindjen e Mesme. Vietnami është një kuti e fushës së shahut, ku amerikanët janë angazhuar dhe sovjetikët gjoja japin armë. Në Vietnam amerikanët, pa ikur andej, kërkojnë të organizojnë më fort luftën e aziatikëve kundër aziatikëve, pa humbje të mëdha në njerëz, pa telashe brenda në vendin e tyre dhe që të tjerët t'ua nxjerrin gështenjat nga zjarri.

Në këtë drejtim në Lindjen e Mesme Izraeli është një kobure e leverdishme që vepron në interes të imperializmit amerikan.

— Imperializmi amerikan ndihmon Izraelin me armë dhe ky mban nën zap tokat e arabëve dhe popujt arabë. Revizionistët sovjetikë gjoja i japin armë Naserit, por në të vërtetë ata përpiqen të forcojnë dominimin në vendet arabe dhe të depërtojnë në kontinentin afrikan. Po bëhen shumë pallavra në OKB, në Uashington e në Moskë për Lindjen e Mesme, por në vend numëro qëndrohet dhe kështu do të vazhdojë derisa ujdinë amerikano-sovjetike të mos e prishë lufta e popujve.

— Gjithë këto intriga të mëdha, që po bëhen në kuriz të këtyre popujve, ne i demaskojmë çdo ditë.

— Të marrim çështjen e «Sigurimit evropian» që përgatitin dhe trumbetojnë sovjetikët. Kjo emrin ka «Sigurim evropian» dhe që gjoja bëhet nga «vullneti i popujve të Evropës», por babai dhe nëna e saj janë amerikanët dhe sovjetikët. Për këtë manovër të djallëzuar sovjetike, të përkrahur nga amerikanët, vetëm ne, shqiptarët, jemi kundër dhe e hedhim poshtë. Naivët çuditën dhe thonë: Si kështu? Shqipëria do luftë? Ç'humbet Shqipëria që Evropa të sigurohet me paqe?

— I tërë ky «kujdes për paqen e sigurimin evropian» është një gënjeshtëri. Këtu, dy fuqitë e mëdha përpiqen të dominojnë pa kundërshtim Evropën dhe të kenë duart e lira të godasin popujt e të gjitha kontinenteve, që ngrihen në luftë për liri kundër imperializmit, revizionizmit modern dhe reaksionit. Këtë qëllim ka edhe marrëveshja e mossulmimit që përgatitin revizionistët sovjetikë dhe njerëzit e Bonit.

— Si konkluzion, u thashë shokëve vietnamezë, të mos e shikosh rrezikshmërinë e revizionistëve sovjetikë në këtë shkallë të gjerë, bëhet gabim i madh.

Natyrisht, në bisedën time përdora terma të tillë që edhe ata e kuptojnë drejt këtë gjë. U ndamë mirë.

DURRËS, E PREMTE

24 KORRIK 1970*

SOT ALEANCË KINO-RUMUNE, MË VONË MUNDET EDHE ALEANCË KINEZE ME TITON

Në Pekin shkoi ministri rumun i Mbrojtjes. Ky revizionist po pritet me nderime të mëdha nga kinezët.

Ambasadori rumun në Pekin i tha të ngarkuarit tonë me punë se ministri i Mbrojtjes më parë ishte parashkuar që të rrinte tri ditë në vizitë thjesht kortezie, pasi të kthehej nga Koreja, por u kërkua nga shokët kinezë që të qëndronte dhjetë ditë, se do të bëhen bisedime të rëndësishme.

Një ditë më parë, njëfarë drejtori i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kinës i tha të ngarkuarit tonë me punë se «është vendosur që tash që vjen ministri rumun i Mbrojtjes, Rumanisë do t'i jepen nga ana jonë fabrika armatimesh për avionë, tanke, raketa, topa, mitraloza të rëndë etj. **Do të bëhet me rumunët edhe një marrëveshje e fshehtë».** Deri te marrëveshja e fshehtë ka ardhur çështja! Por çfarë marrëveshjeje dhe e çfarë karakteri është kjo, nuk dimë gjë, se nuk na e thanë.

Siç po duket, kinezët nuk po qëndrojnë vetëm në dhënien e një ndihme të vogël Rumanisë, por e zgjerojnë atë sigurisht edhe në sfera politike, pse jo edhe ideologjike, derisa e furnizojnë me armë, bëjnë bile edhe marrëveshje të fshehta?

Natyrisht, gjithçka do të merret vesh sa më parë. Iluzionet e kinezëve janë të kota, sepse rumunët për arma-

timet që po marrin dhe për marrëveshjet që po nënshkruajnë kanë interes që t'i marrin vesh revizionistët sovjetikë në radhë të parë. Që revizionistët sovjetikë do të tërbohen, kjo s'do mend dhe kinezët mund të themi se kanë gjetur njerëz «të sigurt dhe të përshtatshëm» për t'i përdorur këto armë.

Për sa i përket mbajtjes sekret, Bodnarashi shkoi dhe i raportoi Titos për tratativat e tij me kinezët dhe ka shumë mundësi që ai të ketë mbrojtur te kinezët kauzën e Titos, për të cilën që më 1956 Maoja na foli me dashamirësi dhe ne ia kundërshtuam. Ka shumë mundësi që Titoja të ketë pjesë për sa i përket fabrikimit të këtyre armatimeve ose **më vonë ne mund të shohim edhe një aleancë kineze me Titon**, e cila të avancojë krahas me aleancën kino-rumune. Çdo gjë bën vaki, kur futesh në ujërat e qelbëta revizioniste. S'janë pa synime buzëqeshjet e Titos dhe të jugosllavëve ndaj nesh. Ata duan të avancojnë sa më parë në përmirësimin e marrëdhënieve me ne. Ambasadori rumun që shoqëronte një delegacion të bashkimeve profesionale të Rumanisë, u tha shokëve tanë, në një darkë, se kush e ka mirë me Shqipërinë, ai e ka mirë edhe me Kinën.

Kuptohet, gjithashtu, kthesa e menjëhershme e kryetarit të delegacionit rumun të bashkimeve profesionale, i cili, megjithëse ne nuk e pritëm, bëri një mijë elozhe për mua, sikur nuk kishte ngjarë gjë. Rumunët kanë qëllime që sillen kështu, por ne ua kuptojmë. Këto qëllime ne ua kuptojmë edhe shokëve kinezë, pavarësisht se për çështje të vijës së tyre ata ose nuk na informojnë ose na informojnë tërthorazi, ose në këmbë në qoshe e ndonjë korridor nga ana e ndonjë funksionari të dorës së dhjetë të Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Anëtari i një delegacioni rumun i tha një shokut tonë: Në kohën kur po kërcënohej Rumania për invadim nga sovjetikët, u takuan në Gjerdap Titoja me Çaushe-

kun, të cilët nënshkruan një marrëveshje sekrete, sipas së cilës Titoja do të hynte me ushtri në ndihmë të Rumanisë deri në Bukuresht. Sa është e vërtetë kjo, unë dyshoj, se Titoja i njeh mirë udhëheqësit rumunë dhe nuk riskon aq lehtë për ta. Mbrojtje simbolike, me llafe bën Titoja, por të hidhet kundër sovjetikëve me armë për rumunët, këtë ai s'e bën. Ky është mendimi im për këtë revizionist dinak.

Sidoqoftë, këtë që rumuni na e tha neve «në konfidencë», Bodnarashi ua tha në konfidencë edhe Maos, Çu En Lait dhe Lin Biaos dhe jam i sigurt se ata e kanë ngrënë, bile kanë thënë: «Bravo Tito». Mund të kenë ndërtuar edhe taktika e strategji të reja pune me këta revizionistë të kapardisur dhe «armiqtë të tërbuar» të revizionistëve sovjetikë, të cilët me njëri-tjetrin sot kanë grindje, por nesër do të puthen dhe do të flenë bashkë. Vetëm kinezët do të mbeten me gisht në gojë. Ata mund të thonë: Çfarë humbëm në këtë mes? Vetëm disa fabrika armësh.

Jo, nuk është këtu çështja! Po të jetë për fabrikat e armëve, sido që ato nuk venë në duar të mira, as nga ana e trimërisë dhe e qëndresës, as nga ana politiko-ideologjike, ne nuk kemi kundërshtim që t'u jepen rumunëve. Në qoftë se Kina ka, le t'u japë; por e drejta është që ajo të llogaritet më parë miqtë e saj të vërtetë. Çështja qëndron te shpresat që vihen, te besimi që kanë, që krijohet dhe forcohet nga ana e kinezëve për këta udhëheqës revizionistë, tradhtarë të marksizëm-leninizmit. Dhe pse? Vetëm se ata kanë kontradikta me revizionistët sovjetikë! Këto kontradikta rumunët i fshehin nën maskën e marksizmit, por kinezët nuk duan ta kuptojnë këtë. Është e domosdoshme t'i shfrytëzosh kontradiktat, si ato rumuno-sovjetike, si ato franko-amerikane, por drejt, në rrugën marksiste-leniniste.

Betankuri¹, që ishte në Kinë, deklaroi në Paris se në të ardhmen Çu En Lai do të bëjë një vizitë në Francë. Kjo është një çështje tjetër, të cilën ne do ta ndjekim se si do të zhvillohet. Të gjitha do t'i ndjekim, për të gjitha do të jemi vigjilentë, pse këtë e kërkojnë interesat e lartë të popullit dhe të Partisë.

DURRËS, E DIEL
26 KORRIK 1970*

TITOJA E LUAN BUKUR KARTËN E TIJ «PROKINEZE»

Revizionistët flasin me entuziazëm: «Po përmirësojmë marrëdhëniet me Kinën, shkojmë duke zhdukur mosmarrëveshjet. Kështu duhet, se kemi një armik të përbashkët, imperializmin. Duhet të lëmë mënjanë ç'na ndan dhe të ndjekim ç'na bashkon». Me këtë gjuhë flasin hungarezët, po kështu edhe gjermanolindorët dhe çekët.

Natyrisht, rrugën e këtyre «perspektivave» e hapi shkëmbimi i ambasadorëve të rinj në mes Kinës me Bashkimin Sovjetik, Jugosllavinë, Hungarinë e Poloninë dhe nesër me Bullgarinë, Gjermaninë Lindore, Çekosllovakinë. Hungarezët, për të mos folur për rumunët dhe për jugosllavët, janë entuziastë. Ata janë të kënaqur që tregtia e tyre u shtua me Kinën, tek e cila shohin një treg ku do të zbrazin mallrat që nuk u shkojnë, dhe të ushqejnë kështu te kinezët iluzionet e thellimit të kontradiktave me sovjetikët, kontradikta që ekzistojnë në fakt, por që u shërbejnë vetëm antimarksistëve hungarezë për t'u lidhur më shumë me Titon dhe me perëndimorët.

Titoja e luan bukur kartën e tij «prokineze» dhe «antisovjetike», me një fjalë kartën e tij të vjetër të minimit të komunizmit, të minimit të perandorisë revizioniste sovjetike dhe të forcimit të të ashtuquajturit grupim të «grupit të tretë» me imperializmin amerikan.

Shokët kinezë udhëhiqen dhe ushqejnë iluzione nga

¹ Andre Betankur, në atë kohë ministër pranë kryeministrit për çështjet e planifikimit dhe të zhvillimit të Francës.

antisovjetizmi i gjithë këtyre revizionistëve, që nuk i sjell ndonjë fitim ideologjik dhe politik çështjes sonë të madhe.

Që dobësohen revizionistët sovjetikë me divergjencat që kanë me antimarksistët e tjerë, ky është fakt dhe duhet nxitur, por lajkave të antimarksistëve nuk u duhet besuar, nuk u duhet besuar premtimeve e gënjeshtreve të tyre. Të gjithë këta gënjejnë dhe fakt është se politikën e tyre nuk mund ta fshehin dot. Një ministër bullgar i tha një diplomatit tonë se «Bashkimi Sovjetik i ofroi Kinës një kredi prej një miliard dollarësh, por Kina s'e pranoi. Ajo nuk bëri mirë, siç nuk bëtë mirë edhe ju, shqiptarët, që nuk iu përgjigjët pozitivisht propozimit sovjetik për të bërë tregti».

Çdo gjë mund të ketë ngjarë në këtë situatë të fillimit të zbutjes në qëndrimet kineze.

Dërgimin e ambasadorëve kinezë në këto vende ne e konsiderojmë një gjë të rregullt nga ana e Kinës, por të arrihet deri atje sa këta ambasadorë t'u besojnë lajkave që u bëjnë revizionistët vendës dhe t'u thonë tanëve se në udhëheqjet e këtyre vendeve flitet në favor të Kinës, kjo do të thotë të kesh predispozicion të dëgjosh me dashamirësi dhe të besosh tradhtarët. Këtu mund të qëndrojnë e keqja dhe rreziku. Ka mundësi që këto të jenë edhe dispozicione të ambasadorëve, po të tilla dispozicione, po të jenë subjektiviste, nuk duhet të na serviren.

Detyra jonë e përhershme ka qenë dhe është: Beso dhe kontrollo, vigjilo dhe zbato me rigozitet vijën marksiste-leniniste të Partisë sonë!

DURRËS, E MARTË

28 KORRIK 1970

TË VAZHDOJË POLITIKA JONË E DREJTË PËR LINDJEN E MESME

Dhashë udhëzime për qëndrimin tonë në lidhje me fillimin e kompromisit midis Naserit dhe amerikanëve për paqe me Izraelin. Të vazhdojë puna jonë propagandistike në mbrojtjen e tezave tona të mëparshme, në demaskimin e «Planit Roxhers», të komplotit sovjetiko-amerikan dhe për mbrojtjen e luftës çlirimtare të popullit palestinez për të drejtat e veta. Konfliktin në mes Naserit dhe vendeve të tjera arabe ta pasqyrojmë realisht, me tendenca në disfavor të Naserit, pse ai kapitulloi.

E MËRKURË
29 KORRIK 1970

NE KEMI SIMPATI DHE RESPEKT PËR POPULLIN ARAB TË PALESTINËS

Këto ditë vjen te ne për vizitë zyrtare një delegacion i lëvizjes për çlirimin kombëtar të Palestinës, «Al Fatah». Dërgimin e këtij delegacioni e kërkoi në ambasadën tonë të Kajros vetë Jaser Arafati.

Ne kemi simpati dhe respekt për popullin arab të Palestinës, pse është një popull i mjeruar dhe trim. Ai është i vetmi popull arab që lufton aktualisht në të katër anët e kufijve të Izraelit, kurse udhëheqësit arabë, që nga ata të Egjiptit dhe deri tek ata të Libanit, bëjnë llafe, mbajnë konferenca, përgatiten... për kompromise etj.

Palestinezët, të dëbuar nga tokat e tyre nga qeveria kolonialiste angleze, nga OKB-ja në favor të Izraelit, rrojnë në çadra e në mjerim të madh në kampe, në Jordani, në Liban, në Siri e gjetkë. Agresioni i fundit izraelit bëri që refugjatët palestinezë të shtohen. Atëherë rruga e vetme e shpëtimit për ta mbeti ajo e luftës partizane. Dhe ia filluan asaj, duke goditur izraelitët agresorë si nga jashtë, nga Jordania, nga Siria, nga Libani dhe brenda, në territorin e pushtuar nga Izraeli. Kështu që çështja palestineze, në sajë të luftës së palestinezëve, u bë një problem i rëndësishëm kombëtar dhe ndërkombëtar, problem që miqtë dhe armiqtë e popullit palestinez duhet ta kenë parasysh dhe nuk mund të mos e llogaritin.

Organizata «Al Fatah», me gjithë prirjet naciona-

liste, është demokrate përparimtare dhe më e madhja e më e fuqishmja organizatë, që ka një vijë të drejtë të luftës revolucionare për çlirimin e Palestinës, për shkaktërrimin e shtetit të Izraelit të alambikuar nga sionizmi ndërkombëtar dhe të mbështetur nga imperialistët. Kjo organizatë nuk është kundër masave të popullsisë çifute, të cilat ajo në programin e saj i pranon si qytetarë të shtetit të ri të Palestinës, këtë herë arab, që duhet të zëvendësojë shtetin e Izraelit.

Por klikat në fuqi në vendet arabe, edhe pse e heqin veten pro luftës së palestinezëve, nuk e shohin me sy të mirë këtë lëvizje të rezistencës dhe, në pamundësi ta likuidojnë, dëshirojnë ta kenë nën kontroll. Rezistenca e palestinezëve është bërë për këto klika një pengesë serioze politike dhe ushtarake. Këto klika janë të detyruara ta llogaritin atë.

Mbreti i Jordanisë, spiun i anglezëve, dy-tri herë u orvat t'i likuidonte partizanët palestinezë, të cilët janë më të fortë nga ky mbret i shitur. Në këto momente të rrezikshme për gueriljet palestineze, këto duhet ta rrezikojnë atë dhe të marrin fuqinë në Jordani për të vazhduar luftën kundër Izraelit dhe imperializmit amerikan.

Sovjetikët dhe amerikanët po bëjnë ligjin në Lindjen e Mesme. Naseri është bërë shërbëtor i sovjetikëve dhe bën si i diktojnë ata. Hysejni i Jordanisë e ka në gjak vetë tradhtinë, sirianët bëjnë sikur janë ca «të shqetësuar», kurse libanezët shiten çdo ditë për dollarë.

Naseri në vija të trasha pranoi të diskutojë «Planin Roxhers», që do të thotë të hyjë në bisedime, në kompromise dhe, më në fund, «të bëhet paqja» aq shumë e dëshiruar nga Izraeli në favorin e tij dhe të padronit amerikan dhe në disfavor të popujve arabë e veçanërisht të popullit palestinez, kundër të cilit do të fillojnë më vonë goditjet e egra të xhandarëve të klikave që janë në fuqi të shitura te të huajt. Me nënshkrimin e «paqes» sovje-

tikët do ta kthejnë këtë në një «fitore kolosale» për veten e tyre. Ata do të qëndrojnë dhe do të dominojnë në Egjipt. Naseri do të vazhdojë të jetë njeriu i tyre. Portet egjiptiane do të bëhen portet e tyre për flotën sovjetike të Mesdheut, të cilën e nxorën me këtë rast nga Deti i Zi. Që nga Mesdheu revizionistët sovjetikë mendojnë të zgjerojnë, në «mënyrë paqësore», kolonitë e tyre në Afrikë, për të kaluar detet dhe për të arritur këndeje në Indi. Ata ëndërrojnë të realizojnë kështu perandorinë e Aleksandrit të Madh, duke zaptuar popujt, nga toka dhe nga deti me kërcënimin e armëve, me rubla dhe me demagogjinë e një socializmi të falsifikuar.

«Paqja sovjeto-amerikane» në Lindjen e Mesme është një disfatë për popujt arabë, në përgjithësi, dhe një pengesë e madhe për popullin palestinez, në veçanti. Kjo lloj «paqeje» është një fitore për imperialistët sovjeto-amerikanë në përgjithësi dhe për Izraelin në veçanti.

Për popullin palestinez do të ngjasë, siç ngjau para Luftës së Parë Botërore me Shqipërinë. Siç dihet atëherë pjesë të mëdha të Shqipërisë u ndanë nga imperialistët e Evropës në mes Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë dhe, mbasi e copëtuan atdheun tonë mirë e mirë në Konferencën e Londrës dhe me traktate të fshehta, Sazanovi, ministri i carit, për të kënaqur më tej oreksin e car Nikollës së Malit të Zi, kërkoi që t'i akordohej këtij edhe qyteti i Shkodrës. Me këtë rast, një nga ujqit e tjerë, përfaqësuesi i imperializmit francez tha një fjalë, që mbeiti në histori: «Sazanovi kërkoi t'i vërë zjarrin Evropës për të pjekur një omëletë për Malin e Zi».

Kështu do të veprojnë e do të thonë edhe qentë imperialistë amerikanë dhe revizionistë sovjetikë kur të vijë çështja e të drejtave territoriale të popullit heroik palestinez.

Vetëm lufta me armë deri në fitore i qëron hesapet me ujqit që u turren popujve.

DURRËS, E MËRKURË
29 KORRIK 1970

VIGJILENT NDAJ POLITIKËS KINEZE

Pasdreke prita ambasadorin tonë në Pekin, Xhoxhi Robon, me të cilin bisedova për marrëdhëniet aktuale të Kinës me shtetet e ndryshme të botës dhe në veçanti për marrëdhëniet diplomatike që Kina ka filluar të lidhë me shtetet revizioniste.

Natyrisht, i thashë mendimin tim provizor, aq sa na lejojnë të gjykojmë faktet e pakta që disponojmë, prandaj e këshillova që miqësia jonë të forcohet çdo ditë e më shumë, por të jetë vigjilent dhe të na informojë për politikën kineze. E këshillova që në çdo rast, të mos fshehë pikëpamjen e Partisë sonë për çështjet parimore, duke u shqetësuar për miqësinë me Kinën. Parimet janë parime.

VLORE, E PREMTE
31 KORRIK 1970*

KINEZËT BËJNË DASHURI ME REVIZIONISTËT. VIGJILENÇË!

Shfaqjet e dashurisë vazhdojnë haptazi në mes kinezëve dhe revizionistëve, bile përpara shokëve tanë. Kjo, pra, është një vijë e re që është adoptuar nga udhëheqja kineze. I ngarkuari ynë me punë në Kinë na njofton për bisedën që u zhvillua në praninë e tij në një pritje ambasadorësh midis përfaqësuesit bullgar në Pekin dhe përfaqësuesit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kinës. Flitnin të dy aq ëmbël me njëri-tjetrin sikur të ishin dy dashnorë, përgëzonin njëri-tjetrin për rivendosjen e marrëdhënieve «vëllazërore» diplomatike. «Së shpejti, i thoshte kinezi, do të dërgojmë ambasadorin tonë në Sofje; çdo gjë do të rregullohet, po të ekzistojë dëshira e mirë e të dyja palëve». Bullgari ia priste: «Nga ana jonë jo vetëm që ekziston dëshira e mirë, por kjo kurdoherë ka ekzistuar» etj. Dhe në këtë frymë vazhdoi biseda për një kohë të gjatë. Me bullgarët deri dje kinezët kishin marrëdhëniet më të këqija, se udhëheqja bullgare konsiderohej prej tyre si shërbëtorja më e ndyrë dhe më e bindur e revizionistëve sovjetikë. Dhe kështu është. Në këtë rast shokët kinezë nuk mund të luajnë me «thellimin e kontradiktave në mes sovjetikëve dhe revizionistëve bullgarë», siç kanë qejf ata ta arsyetojnë kthesën. Në këtë rast Bullgaria mund të shërbejë si urë dhe shembull i mirë për afrim më të shpejtë me revizionistët sovjetikë.

Jo vetëm kaq, por kinezët kanë filluar të luajnë edhe një rol jo të hijshëm, atë të provokatorëve, dhe këtë lodër të ndyrë e bëjnë njerëzit e sigurimit kinez.

Shokët na lajmërojnë nga Pekini se në një darkë ku ishte ftuar një shok i Ministrisë sonë të Punëve të Brendshme, zëvendësministri i Jashtëm i Kinës në fjalimin që mbajti, në mes të tjerash, tha: «Kur Partia e Punës e Shqipërisë, e udhëhequr nga Enver Hoxha, sulmoi e para revizionistët sovjetikë, të gjithë e dënuan Shqipërinë, përveç Kinës, por tash e njohin se Shqipëria ka pasur të drejtë. Dhe nga këto vende e parti që i japin të drejtë Shqipërisë janë Rumania dhe Jugosllavia».

Kinezët kanë marrë, kështu, një rol të turpshëm: të rehabilitojnë tradhtarët dhe të përpiqen të na gënjejnë ne. Kjo tregon se duhet të kesh hyrë thellë në koniunktura shumë të dyshimta, sa të mos përmbahesh dot, por të bësh edhe të tilla propozime. Dhe kujt? Neve!

Vigjilencë! Në rast se udhëheqësit kinezë vazhdojnë kështu dhe nuk frenohen në këtë të tatëpjetë që kanë filluar të marrin, rruga e Kinës do të jetë një kthesë katastrofike. Ne, me qëndrimet tona, do të përpiqemi t'i ndihmojmë, në qoftë se ata na dëgjojnë ndopak dhe në qoftë se këta janë hapa të parë të pamatur nga ana e tyre, por këtë unë nuk e besoj.

VLORE, E HËNË
3 GUSHT 1970

TAKIM ME DELEGACIONIN E «AL FATAHUT»

Prita sot këtu delegacionin e lëvizjes për çlirimin kombëtar të Palestinës «Al Fatah»¹.

¹ Delegacioni kryesohej nga anëtari i Komitetit të lartë Qendror të Lëvizjes «Al Fatah» dhe anëtar i udhëheqjes së përgjithshme të forcave të «Al Asifasë», Abu Xihad. Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 607.

VLORE, E MARTE
11 GUSHT 1970

MIQËSIA MIDIS REVIZIONISTËVE SOVJETIKË DHE MILITARISTËVE GJERMANË NËN PATRONAZHIN E IMPERIALIZMIT AMERIKAN

Revizionistët sovjetikë nënshkruan me revanshistët e Bonit Traktatin e mospërdorimit të forcës kundër njëri-tjetrit¹ dhe çelën perspektivat e një bashkëpunimi të gjithanshëm në mes të dy shteteve imperialiste.

Kjo marrëveshje u arrit në një kohë rekord, gjë që tregon se në thelb socialdemokracia, që ndodhet aktualisht në fuqi në të dy vendet nënshkruese, i sheshoi shpejt mosmarrëveshjet. Interesat e revanshizmit gjerman dhe të socialimperializmit sovjetik u takuan në rrugëkryq dhe kishin nevojë që të dy për një pauzë pak a shumë të gjatë për t'u përgatitur për aventura të reja dhe për të ndihmuar shoqi-shoqin.

Gjermania Perëndimore do të ketë kështu mundësi të forcojë potencialin e saj ushtarak, ekonomik dhe politik akoma më shumë se ç'e ka forcuar, ndërsa revizionistët sovjetikë do të kenë një kohë qetësie relative në Evropë, për të stabilizuar në baza relativisht pak më të forta pushtetin e tyre të diktaturës borgjeze brenda në Bashkimin Sovjetik në disfavor të socializmit, të cilit ata

¹ Traktati midis BRSS dhe RFGJ, nënshkruar në Moskë më 7 gusht 1970. Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 630.

i kanë vënë kazmën, do të kenë mundësi më të mëdha të përqendrojnë fuqitë e tyre kundër Kinës në Azi, të veprojnë kundër revolucionit botëror dhe luftërave nacional-çlirimtare të popujve në përgjithësi.

Kjo miqësi e revizionistëve sovjetikë me Bonin zhvillohet me pëlqimin e llogaritur të imperializmit amerikan. «Të tre këta miq» janë dakord derisa interesat e tyre veç e veç nuk preken. Aktualisht në këtë aleancë dominon, bile duke qëndruar sipër, imperializmi amerikan. Imperializmi gjerman po ngjitet, po forcohet, ky është futur si veshka në mes të dhjavit. Të dy, e në radhë të parë Bashkimi Sovjetik, ia kanë nevojën këtij. Bashkimi Sovjetik ia ka edhe nevojën, po edhe frikën. Të dy këta faktorë të rëndësishëm po veprojnë për të koordinuar fuqinë e Bashkimit Sovjetik, si nga ana e Bonit drejtpërdrejt, ashtu edhe nga Boni e Uashingtoni së toku (duke qëndruar në gjykimin e rrethanave të traktatit).

Fitorja e revanshistëve të Bonit është e konsiderueshme. Republika Federale e Gjermanisë është pjella revanshiste e Raihut hitlerian të mundur nga koalicioni i madh i popujve antifashistë. Kjo republikë fashiste e ndihmuar nga imperializmi botëror dhe veçanërisht nga ai amerikan, u bë partnerja më e fuqishme në NATO, pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ekonomia e saj u bë jashtëzakonisht e fuqishme dhe është nga ato që bëjnë ligjin në Tregun e Përbashkët Evropian. Ajo financon Shtetet e Bashkuara të Amerikës në ruajtjen e stabilitetit të dollarit, kapitalet e saj po shfryjnë kudo në Evropë e në kontinente të tjera për të zënë vende «në diell».

Për Bonin, natyrisht, çdo pozitë e fituar nuk mund të jetë e plotë pa aneksimin e Republikës Demokratike Gjermane. Rrethanat e krijuara nuk mund t'ia lejonin ta bënte këtë pa përdorimin e forcës. Ca më shumë aleanca sovjeto-amerikane e largonte këtë perspektivë me të tilla

mjete. Imperializmi amerikano-gjerman ndërroi taktikë për t'ia arritur qëllimit strategjik. Tradhtarët revizionistë sovjetikë pranuan taktikën e re dhe arritën në përfundimin e traktatit në fjalë, i cili favorizon imperializmin gjermano-amerikan në dëm të Bashkimit Sovjetik, në dëm të popujve të Evropës dhe të botës, në dëm të paqes dhe të revolucionit.

Imperialistët, revizionistët modernë dhe kapitalizmi botëror në krizë, po i bëjnë tash një zhurmë dhe një reklamë shurdhuese këtij traktati. «Ky traktat, sipas tyre, largoi luftën nga Evropa, siguroi statukuonë e kufijve të shteteve të Evropës, ashtu siç u vendosën pas Luftës së Dytë Botërore. Republika Federale e Gjermanisë dhe Bashkimi Sovjetik morën zotim të mos i prekin këta kufij» etj., etj. Plot eufori, plot demagogji, plot gënjeshtër dhe mprehje thikash në prapaskenë. «S'ka njeri që të propozojë një zgjidhje tjetër më të mirë se kjo që bëri ky traktat», tha afërsisht tradhtari revizionist Kosi-gin në fjalimin e tij para Vili Brandit.

Ky traktat imperialist mori nëpër këmbë të drejtat e popujve që luftuan kundër Gjermanisë hitleriane. Ai eliminon për Republikën Federale të Gjermanisë dhe për Republikën Demokratike Gjermane Traktatin e Paqes, që ishin të detyruara ta firmosnin si shtete të mundura me shtetet e tjera që fituan. Ky traktat ia bëri këtë koncesion Bonit fashist dhe revanshist. Kjo nuk ngjau as për Italinë, as për Japoninë e mundur. Stalini mbrojti gjakun që derdhën popujt kundër bishave fashiste dhe militariste, kurse tradhtarët revizionistë hrushovianë tradhtuan edhe gjakun, edhe të drejtat e popujve dhe ndihmuan me këtë traktat revanshistët e Bonit.

Kështu Gjermania hitleriane nuk u ndëshkua, ajo nuk u detyrua t'i nënshtrohej vullnetit të popujve nëpërmjet klauzolave të një traktati, ajo jo vetëm «kaloi e larë në histori», por tok me tradhtarët sovjetikë nënshkroi

një traktat me të cilin «marrin nën mbrojtje të gjitha shtetet e Evropës».

Këta imperialistë, pas nënshkrimit të këtij traktati po trumbetojnë me të madhe: «Shtete të Evropës, flini të qeta, kufijtë e Evropës jua kemi siguruar ne të dy!». Ujqit u bënë çobanët e deleve! Kjo nuk na gënjen ne. Historia e largët, e afërt dhe ajo e sotmja është plot me ngjarje katastrofike për popujt. Në rast se këta i zë gjumi dhe gabohen nga demagogjia e imperialisto-revizionistëve, katastrofa të reja do të ngjasin për ta.

Po këtë gjë bëri kapitalizmi botëror dhe, në veçanti, ai amerikan kur financoi dhe armatosi Gjermaninë e mundur të Kaizerit, që nga regjimi i Noskëve arriti te Hitleri. Edhe tash kjo gjë po ngjet me Gjermaninë e Adenauerit e të Vili Brandit. Këtë herë ata po i ndihmon edhe Bashkimi Sovjetik revizionist për të arritur në një Hitler të ri që t'i vërë zjarrin botës.

Stalini nuk i ndihmoi kurrë as imperializmin, as fashizmin hitlerian. Ai ishte një marksist-leninist i lavdishëm dhe armik i betuar i tyre. Traktati sovjeto-gjerman as që mund të barazohet me këtë të tanishmin. Stalini e dinte fare mirë me kë kishte të bënte, e dinte që nesër do të ndeshesh në një luftë për jetë a për vdekje me hitlerianët, prandaj Molotovi nënshkroi traktatin për të fituar kohë dhe këtë e bëri kur pa se «demokracitë» përrëndimore, Anglia dhe Franca, ishin kundër një aleance me Bashkimin Sovjetik dhe shtynin Hitlerin të nisej sa më parë nga Lindja. Kurse traktati që firmosi Kosigini është një traktat miqsh ideologjikë, është një traktat ku janë vënë shpresa të mëdha për të financuar Bashkimin Sovjetik.

Vili Brandi theksoi disa herë, në fjalimin e tij zyrtar në Moskë dhe me gazetarët, me rastin e nënshkrimit të traktatit, se ky do të ketë sukses dhe do t'ua arrijë qëllimeve për të cilat u nënshkrua, në rast se në Evropën

Qendrore krijohet, si të thuash, një situatë për zhvillimin e marrëdhënieve të mira. Me fjalë të tjera ai u ritheksonte sovjetikëve se duhet të lehtësohen shtrëngesat dhe presionet ndaj Çekosllovakisë, Hungarisë, Bullgarisë dhe Rumanisë.

Kapitalistët e Bonit duan të bëjnë invadimin e këtyre vendeve në rrugë të tjera: në rrugë politike, ekonomike, ideologjike. Çështjet e tjera vijnë më vonë, si konsekuencë e të parave. Gjermania e Bonit dëshiron dhe do t'ia arrijë qëllimit, në bazë të këtij traktati, për të shtrirë influencën në këto vende, për të zëvendësuar influencën sovjetike që urrëhet, për të zhdukur çdo influencë të komunizmit dhe për të bërë rrethimin e Republikës Demokratike Gjermane, për arritjen e bashkimit të të dy shteteve gjermane.

Kundërrevolucionarët revizionistë sovjetikë kanë frikë nga popujt dhe nga revolucioni, prandaj nuk bëjnë shumë iluzione për mbajtjen nën një zgjedhë të fortë dhe sidomos politike e ideologjike të satelitëve të tyre, të cilët shpejt ose vonë do t'u lënë pendët. Puna e tyre me ta konsiston të korruptojnë këto klika, të kenë klika zëvendësuese, t'i mbajnë këto të varura sa të jetë e mundur e më shumë ekonomikisht dhe ushtarakisht. Natyrisht do të ketë dhe do të thellohen kontradiktat në mes tyre. Boni, Uashingtoni etj., do të përfitojnë për të hedhur ganxhat e tyre. Sovietikët duhet të bëjnë lëshime ndaj tyre dhe vetë ky traktat i detyron, pse Bashkimi Sovjetik do të zhytet në një bashkëpunim të shumanshëm me Bonin, bashkëpunim që do të kërkojë koncesione para kapitaleve të huaja, që do të vërshojnë në BS.

Klika kapitaliste e Bashkimit Sovjetik do t'i shikojë problemet me syze të tjera nga ç'i shikon tash, ajo do të hyjë në furtunën kapitaliste, me ciklet e krizave politike, ekonomike, ushtarake, me mënyrën e jetesës e të të menduarit, të zgjidhjes së problemeve politike dhe të

aleancave, ashtu siç bëjnë dhe fuqitë e tjera kapitaliste. Këtu kërkonin ta sillnin Bashkimin Sovjetik fuqitë imperialiste dhe këtu e solli Bashkimin Sovjetik klika tradhtarë hrushoviane.

Duke bërë sakrificat të mëdha, aktualisht imperializmi revizionist sovjetik, me anën e këtij traktati dhe, më vonë me atë të «Sigurimit evropian», në qoftë se do të arrihet, tok me imperializmin gjerman mendon të dominojë Evropën, të bëjnë këtu ligjin të dy, të dobësojnë NATO-n, të bëjnë pushtime dhe të shtojnë influencën e tyre në anët e tjera të botës.

Pra euforia aktuale që po shfaqet në botë për këtë traktat imperialist, nuk është reale për të gjithë. Për vendet satelite të Bashkimit Sovjetik është «një gëzim» që fsheh dëshirën e klikave të shkëputura nga tutela sovjetike për t'u lidhur me Perëndimin. Vendet kapitaliste të Evropës kanë gjetur dhe do të gjejnë me të vërtetë mundësi për investime kapitalesh në vendet e Lindjes, nga të cilat do të nxjerrin fitime, por për një kohë derisa ta lejojnë peshqit e mëdhenj. Sigurisht, Franca që tash, në mos më vonë, e sheh veten të izoluar dhe të rrethuar, në rast se nuk vepron. Vendet e tjera kapitaliste ose do të vazhdojnë të mbeten skllave të bindura të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ose do të hyjnë nën tutelën e re të të dyja superfuqive evropiane. Statukuoja dhe qetësia në Evropë, ku vërtiten ujtit më të mëdhenj kapitalistë, është një gënjeshtër për gogotë.

Borgjezia kapitaliste franceze është në rrugëkryq. Ose kjo duhet të aktivizojë politikën intransigjente të Dë Golit, ose duhet të kapitultojë përpara fuqive imperialiste, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Republikës Federale të Gjermanisë dhe Bashkimit Sovjetik që aktualisht dominojnë në Evropë dhe thurin zinxhirë të rinj. Natyrisht, imperializmi amerikan përpara një rreziku gjermano-sovjetik në Evropë, mund të kthehet në alian-

cat e vjetra me Anglinë dhe me Francën. Këtë do ta tregojë koha. Por koha, aktualisht, tregon një gjë që lëvizja revolucionare në Evropë është vënë nën këmbë nga imperialisto-revizionistët, revolucioni në Evropë është gati i topitur, jo se popujt i durojnë zgjedhat që u kanë hedhur armiqtë e tyre shekullorë, por revizionistët sovjetikë dhe aleatët lakenj të tyre i kanë vënë në gjumë me propagandë dhe po i shtypin me zjarr. Prandaj, më tepër se kurrë, duhet të luftojmë për të zhvilluar një luftë dhe një propagandë të shumanshme, ta demaskojmë Traktatin sovjeto-gjerman!

**TRAKTATI SOVJETO-GJERMAN — NJË KOMPLOT
I RREZIKSHËM KUNDËR POPUJVE TË EVROPËS
DHE GJITHË BOTËS**

Sikurse kam shkruar disa ditë më përpara në këtë Ditar revizionistët sovjetikë nënshkruan me revanshistët e Bonit Traktatin e mospërdorimit të forcës kundër njëri-tjetrit. Ky traktat përbën një komplot shumë të rrezikshëm për jetën e popujve të Evropës dhe të të gjithë botës. Për demaskimin e qëllimeve të vërteta të këtij traktati, kam përgatitur një artikull me titull: «Traktati sovjeto-gjerman — një komplot i rrezikshëm kundër popujve të Evropës dhe gjithë botës». Ia dërguam redaksisë së gazetës «Zëri i popullit» për ta botuar nesër.

SHËNIM

I thashë Ramizit që «Zëri i popullit» të bëjë një artikull në lidhje me komunikatën e Plenumit të 2-të të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës.

KUJDES, SHOKË KINEZË, MOS BINI NË KURTHET E ARMIQVE!

Në një bisedë që pati ambasadori ynë në Rumani me Emil Bodnarashin, ky i zhvilloi drejtimet kryesore të politikës së tyre. Edhe një herë vërtetohet ajo që kemi gjykuar ne: Rumunët janë antimarksistë, revizionistë, nacionalistë, antisovjetikë (në baza shoviniste), antistalinistë. Ata janë titistë, jo vetëm pse kanë marrëdhënie të mira në të gjitha fushat me revizionistët jugosllavë dhe bashkërendojnë veprimet, por se edhe ideologjikisht mendojnë si ata. Të dyja këto rryma antimarksiste, duke u hequr si antisovjetike, me format dhe me metodat e tyre, përpiqen të polarizojnë forcat revizioniste (disidente nga sovjetikët) dhe të bëjnë rehabilitimin e tyre gjoja në lëvizjen komuniste botërore. Këtë moment të kontradiktave në gjirin e revizionizmit, siç duket, rumunët ua kanë shtruar edhe kinezëve si «kontradiktë» me sovjetikët dhe kanë marrë përsipër, përpara tyre, që t'i thellojnë ato dhe «dhentë e zgjebosura t'i futin në stan». Kinezëve dyshoj se u ka pëlqyer një gjë e tillë dhe duhet të kenë marrë masa të përbashkëta, të cilat rumunët i kanë vënë në veprim, si, për shembull, kontaktet me partinë komuniste franceze, italiane e të tjera. Duhet të vërejmë veprimet e kinezëve.

Bodnarashi tërthorazi këshilloi se «nuk duhet sharë Brezhnjevi». Edhe kjo duhet të jetë biseduar me kinezët,

se këta s'po flasin më me emër as për Brezhnjevin, as për socialimperializmin sovjetik. Kurse Titon, Jugosllavinë titiste, ai i ngre në qiell dhe predikon aleancën Jugosllavi-Rumani-Shqipëri, aleancë që, sipas Emil Bodnarashit, «do të ndryshojë gjendjen në Evropë».

Në këtë drejtim punojnë edhe titistët. Ribičiç¹ i tha ambasadorit kinez në Beograd, dhe ky na e tha neve: «Ne, jugosllavët, kemi bërë gabime të mëdha kundër Shqipërisë, kemi dashur me çdo mjet të rrezonim regjimin, por kemi qenë nxitur nga sovjetikët (Stalini), kurse tash do të përpiqemi t'i përmirësojmë marrëdhëniet» etj. Çfarë «autokritike»!, tipike për kinezët që këta të mendojnë se «titistët janë burra të mirë», se «Stalini i ka fajet». Bodnarashi shkoi edhe më tej, kur i tha ambasadorit tonë: «Pavarësinë tonë ne ia detyrojmë Rusveltit dhe Çërcillit, të cilët e kundërshtuan Stalinin, që ishte kundër (në Jaltë)».

Është e qartë se kinezët rrezikohen të hyjnë në një ingranazh të gabuar dhe antimarksist; ata po trajtojnë probleme me revizionistët rumunë, që janë të shitur tek imperializmi amerikan. Por kinezët po bëjnë një gabim të madh që nuk e vlerësojnë si duhet natyrën dhe peshën e vërtetë të këtyre revizionistëve. Këta revizionistë janë aq të frikshëm sa edhe mendjemëdhën, janë aq dinakë në budallallëqet e tyre, saqë, siç e kam thënë edhe herë të tjera, kanë bindjen se luajnë dhe do të luajnë rolin e një primadone në politikën evropiane, botërore dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Na hiqen sikur zbuluan Kinën dhe sikur politika e tyre drejton edhe politikën e Kinës.

Bodnarashi i fliste ambasadorit tonë me një ton kryelartësie, sikur janë ata që e rrotullojnë politikën! E ashtuquajtura rezistencë kundër sovjetikëve, që mund të jetë edhe një taktikë e re e Titos, e imperializmit amerikan

1 Në atë kohë kryetar i Veçes Ekzekutive Federative të Jugosllavisë.

dhe e sovjetikëve, për një aksion me valë të gjata kundër Kinës, dhe në përgjithësi kundër marksizëm-leninizmit, për revizionistët rumunë po shërben, ashtu siç shërbeu edhe për Titon dhe titizmin, si një atù për të ngritur prestigjin e tyre «për trimërinë», «për principlialitetin» etj., etj. Në këtë rrugë revizionistët rumunë do të gënjejnë, aq sa gënjeu dhe gënjen Titoja, por qëllimi ideologjik qëndron në atë, që këta revizionistë mundohen të arrijnë të komprometojnë Kinën, ta futin këtë në rrugën e tyre, duke ushqyer anët e saj të dobëta dhe të paqarta, të arrijnë sidomos që, gjoja për të shfrytëzuar kontradiktat që ekzistojnë në mes të sovjetikëve dhe të tjerëve, t'i bëjnë kinezët të humbasin toruan dhe të shkelin parimet. Këtu qëndron rreziku i madh: Revizionistët sovjetikë, për të fshehur mirëkuptimin e paqen me amerikanët, thonë për ta: «S'kanë ç'na bëjnë, ne jemi vend i madh». Revizionistët rumunë thonë: «Le të krimbemi në borxhe, imperialistët neve s'kanë ç'na bëjnë». Kinezët mund t'i nënvleftësojnë taktikat e gabuara në politikë, por ata do të bien në gabime të rënda parimore. Kujdes, shokë kinezë, mos bini në kurthet e armiqve!

Fakt është se shokët kinezë deri tash nuk na kanë vënë në korent për bisedimet që bënë me Bodnarashin dhe më vonë me ministrin e Mbrojtjes të Rumanisë. Kjo nuk është normale në mes miqsh. Kurse Bodnarashi i po-hoi ambasadorit tonë se «Biseda me Çu En Lain e me Maon ishte shumë e përzemërt, ne biseduam për gjithë ato probleme dhe ishim dakord». Qosheve, në korridoret e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kinës, në fund të ndonjë shëtitjeje me varkë (që të mos ketë kohë njeriu ynë t'i bëjë pyetje), një personalitet i rangut të tretë i thotë një shokut tonë disa gjëra të përgjithshme, bile në të ikur i tha se «me Jonicën¹ nënshkruam edhe një ma-

¹ Në atë kohë ministër i Mbrojtjes i Rumanisë.

rrëveshje të fshehtë!»! Të gjitha këto bëhen për të mos na thënë gjë dhe për të qenë njëkohësisht brenda.

Ambasadori kinez në Tiranë ka thyer këmbën, por u bë një vit pa ambasador nga ana e Kinës dhe nuk kemi kujt t'ia shprehim pikëpamjet tona për shumë probleme. Mundet që shokëve kinezë u pëlqen pikërisht një gjendje e tillë, sepse ne ua themi hapur mendimet.

Tek ambasadorët kinezë në vendet revizioniste vërejmë tendencën për të folur për «ekzistencën e kontradiktave në parti dhe në shtet kundër sovjetikëve». Puna e Bodnarashit dhe e Titos po bën efekt!

Ambasadori kinez në Beograd deri tash «harroi» (ose nuk ka marrë udhëzime nga Pekini çfarë të thotë dhe sa të thotë) t'i flasë ambasadorit tonë për takimin që pati me Titon, kurse çfarë i tha Ribičiçi për ne, nuk mungoi t'ia thoshte shpejt e shpejt. Koordinim i bukur Bodnarash-Tito: luftë kundër Stalinit, «fjalë të mira» ndaj nesh. Bile Bodnarashi i tha ambasadorit tonë se Titoja në Mal të Zi duhej të fliste edhe më mirë për Shqipërinë. Bodnarashi, kur u kthye nga Kina, shkoi e i raportoi Titos dhe bashkë koordinuan veprimet. Ne qorra nuk jemi. Mjerë ata që nuk duan të shohin!

E HËNË
21 SHTATOR 1970

KOMPLOTI I MADH KUNDËR POPULLIT PALESTINEZ DHE REVOLUCIONIT TË POPUJVE ARABË

Ngjarjet në Lindjen e Afërt ngjasin dhe zhvillohen ashtu siç bisedova me delegacionin e «Al Fatahut» kur e prita në Vlorë.

Mbreti Hysejn i Jordanisë, agjent i amerikano-anglezëve po përgatit grushtin dhe po godet partizanët palestinezë. Ai është i njohur si këlysh i anglezëve, i sjellë tok me babën e tij Abdullahun dhe me vëllezërit e tjerë nga fundi i fiseve të Gadishullit Arabik, nga Lavrensi dhe Alenbia dhe i vënë në krye të mbretërive arabike për t'i pasur çifligje të tyre. Është e qartë se sovjetikët, Naseri, Hysejini kanë qenë dakord që të pushohet lufta me Izraelin, ishin dakord me amerikanët dhe me «Planin Roxhers», se duhej vënë në fre dhe duhej shtypur rezistenca e palestinezëve.

Shtypjen e palestinezëve e morën përsipër Naseri, Hysejini dhe sovjetikët. Burgjet dhe fushat e përqëndrimit të Naserit u mbushën me palestinezë, Hysejini u orvat disa herë për çarmatimin e tyre, por më kot. Sovjetikët bënë presion të fortë mbi ta, mbi algjerianët, sirianët, iranianët. Atëherë u kurdis provokacioni i kthimit piratesk të disa avionëve nga njerëzit e Habashit, fraksioni i rezistencës palestineze. Ky ishte një provokacion i kurdisur nga CIA dhe nga agjentura e ameri-

kano-anglezëve për t'i dhënë gjoja një atù në dorë agjentit të tyre Hysejn që të godiste. Dhe ai goditi forcat e rezistencës palestineze në Aman dhe kudo ku ato janë përqendruar në Jordani.

Mbreti i poshtër lëshoi tanket mbi palestinezët. Shtetet e Bashkuara të Amerikës lëvizën Flotën e 6-të drejt brigjeve të Sirisë dhe kërcënojnë për ndërhyrje të armatosur në mbrojtje të mbretit Hysejn, në rast se sirianët vazhdojnë të ndihmojnë vëllezërit palestinezë që mbrohen. Xhandari ndërkombëtar i bëri, gjithashtu, thirrje akolitit të tij, zjarrfikësit të Kremlinit, që të shuanin rezistencën e palestinezëve dhe ndihmën e sirianëve. Revizionistët sovjetikë lëshuan komunikata të njëpasnjëshme në këtë drejtim, me të cilat nuk linin asnjë dyshim se janë në përkrahje të mbretit Hysejn, të klikës së tij reaksionare dhe të «Planit Roxhers».

Komploti është i madh dhe i qartë. Çështja është të mos dorëzojnë armët palestinezët, të vazhdojnë luftën në dy fronte. Në frontin e brendshëm kundër reaksionit të armatosur arab dhe në plan të jashtëm, kundër armiqve të betuar të popujve arabë, imperialistëve amerikanë, socialimperialistëve sovjetikë dhe sionizmit izraelit etj. Çështja është, gjithashtu, nëse Siria, Iraku, Algjeria, sidomos, do të qëndrojnë deri në fund në mbrojtje të kauzës së përbashkët arabe, apo do të tërhiqen. Në rast se do të qëndrojnë, ndërgjegjja e popujve arabë do të shkojë drejt revolucionit, në qoftë se do të tërhiqen, do të përçahen, atëherë lëvizja dhe revolucioni i popujve arabë do të pësojnë një tronditje të rëndë dhe veçanërisht rezistenca palestineze.

Bisedova me shokët e Ministrisë së Jashtme që në fjalimin tonë në OKB t'i shtjellojmë këto mendime dhe të mbrojmë me zjarr çështjen arabe dhe palestineze, të demaskojmë komplotin amerikano-sovjetik dhe të reaksionit arab, duke përmendur me emër mbretin Hysejn.

Bisedova me Ramizin që propaganda jonë me anën e shtypit dhe të radios të bëjë po këtë punë, kështu ne i përgjigjemi edhe kërkesës që na drejton vetë Jaser Arafati.

Ë HËNË
21 SHTATOR 1970

**NUK MBËSHTETIM KAPITULLIMIN DHE
KOMPROMISËT E REVIZIONISTËVE
VIETNAMEZË ME IMPERIALISTËT
AMERIKANË**

Vietnami i Jugut na njoftoi deklaratën e tij zyrtare, e cila u drejtohet amerikanëve dhe thotë afërsisht:

Në rast se amerikanët tërheqin trupat nga Vietnami deri në qershor të vitit 1971, atëherë Vietkongu do të pushojë luftën dhe goditjet.

Në këtë rast Vietkongu pranon të formojë një qeveri të koalicionit, ku të bëjnë pjesë një e treta nga Vietkongu, një e treta budistë dhe një e treta nga njerëzit e Sajgonit, po me përjashtim që nga këta të mos marrin pjesë tre veta: presidenti Van Thieu, Kao Ki dhe një tjetër. Me një fjalë këtë «sihariq» ua bëri Bini amerikanëve në konferencën e Parisit. Përfaqësuesi amerikan iu përgjigj Binut: «Kjo është verë e vjetër në poçe të re».

Vietnamezët, me anën e përfaqësuesve të tyre në Tiranë, kërkuan që ne t'i mbështetim.

Ne i kishim parashikuar këto rezultate kapitulluese të revizionistëve vietnamezë. Bisedimet e Parisit këto gjëra do të sillnin, pavarësisht nga demagogjitë që thoshin se çështjen do ta vendosë lufta.

Në fakt, kur publikisht bëhej kjo demagogji, bisedimet e fshehta vazhdonin dhe vazhdojnë. Dhe ja rezultatet e bisedimeve të fshehta: Niksoni ka filluar të tërhe-

që disa kontingjente ushtarësh amerikanë, kurse nga ana e Vietkongut është ngadalësuar shumë lufta: hidhet nga një predhë, kanë abandonuar territore dhe kanë nxjerrë parullën: «Kjo është një taktikë e re, godasim vetëm oficerët, djegim depo dhe përgatitemi për sulmin e fundit vendimtar». Kurse tërheqjen e kontingjenteve të Niksonit e shpjegojnë me vështirësitë që ai ka brenda në SHBA dhe se zbaton politikën «aziatikët të luftojnë kundër aziatikëve». Por kjo tërheqje trupash është bërë në marrëveshje. Pra kjo fazë e marrëveshjes ecën. Tash amerikanët dhe aleatët e tyre, sovjetikët, u thonë vietnamezëve: «Ecni përpara!»! Nga kapitullimi në kapitullim dhe propozimet aktuale janë një kapitullim i ndyrë, një tradhti që i bëhet popullit të Vietnamit.

Konkretisht vietnamezët propozojnë të pushojnë luftën kundër amerikanëve dhe kanë bindjen se edhe këta do ta pushojnë e do të largohen nga Vietnami. As Franca goliste nuk u tërhoq pa disfatën e Dien Bien Fusë. Por gjatë kësaj kohe zotërinjtë kapitullantë vietnamezë do t'i lënë rehat Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe klikën e Sajgonit të marrin frymë, të forcohen dhe t'u ngulin akoma thika të mprehta në grykë.

«Bëjmë edhe luftë», thonë zotërinjtë udhëheqës të Vietkongut, «po bëjmë edhe politikë». «Me këtë dobësojmë pozitat e Niksonit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në zgjedhjet e afërme dhe i themi popullit amerikan se ja, ne jemi për paqen, kurse presidenti juaj do luftën!»! Po i zbatojnë bukur vietnamezët mësimet e revizionistëve sovjetikë.

Ç'tragjedi! Pas kaq luftërash heroike dhe sakrificash kolosale të popullit vietnamez, pas kaq goditjesh të rënda që i dhanë imperializmit amerikan, udhëheqja revizioniste vietnameze po kapitullon. Ajo shkel gjithë këtë gjak të derdhur, kërkon të bëjë një kompromis të ndyrë me imperializmin amerikan dhe të ndajë pushtetin me armiq-

të e betuar që vranë dhe dogjën popullin e vendin e tyre. Armiku vendës u reduktua vetëm në tre veta! Dhe këta që bëjnë këto tradhti e quajnë veten patriotë dhe marksistë-leninistë! Ç'tradhtarë!

Lufta kundër renegatëve u zuri këmbët, prandaj duan ta likuidojnë atë me çdo kusht. Ata do t'i bëjnë lëshime akoma më të mëdha armikut. Ata, duke u mbuluar me luftën heroike të popullit, do të përpiqen të mashtrojnë naivët, se amerikanët do të mbledhin plaçkat dhe do të largohen, duke u kënaqur që u formua një qeveri simbolike me vetëm një të tretën anëtarë të Vietkongut. Dhe pasi të ikin amerikanët, me forma «demokratike», do t'ia dredhin shpejt kokën reaksionit të Sajgonit!

Taktikë gjeniale?! «Me siguri Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të bien në kurth!». Kurthi nuk kurdiset për amerikanët, por për popullin vietnamez. Udhëheqja revizioniste vietnameze është lodhur nga lufta çlirimtare, ajo dëshiron të pajtohet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe «të ndihmohet prej tyre» që Vietnami të rindërtohet dhe nga kush? Nga agresorët e egër amerikanë!

Imperialistët amerikanë kurrë nuk largohen nga Vietnami pa luftë dhe, në qoftë se do të ecet në rrugën e kompromisit dhe të tradhtisë, çdo transformim në këtë vend do të bëhet vetëm në favorin e amerikanëve dhe të reaksionit. Revizionistët do venë te këta dhe jo këta te revizionistët.

Në asnjë mënyrë ne nuk do t'i ndihmojmë revizionistët vietnamezë në këtë rrugë të tradhtisë së popullit dhe të luftës së tij çlirimtare. S'kanë aspak turp, kur vij-në dhe kërkojnë që ne t'i mbështetim! S'kanë aspak turp kur vijnë e na thonë se «Sihanuku lëviz dhe mund të bjerë në ujdi me Lon Nolin». Fundi i fundit Sihanuku një mbret është, por ç'të bësh kur bie në ujdi me amerikanët ti që vetëquesh marksist!!

Situatën duhet ta ndjekim. Ne ua thamë hapur vietnamezëve mendimin tonë, se nuk jemi dakord dhe nuk do t'i mbështetim në këtë rrugë, se ne do t'i mbështetim vetëm në rrugën e luftës çlirimtare.

1970
23 SHTATOR 1970

E MËRKURË
23 SHTATOR 1970

SHËNIM

U thashë shokëve që Qeveria jonë të botojë një deklaratë në mbrojtje të palestinezëve dhe të luftës së tyre të drejtë.

ARDHJA E NIKSONIT NË EVROPË

Shënime

1) Kurdoherë dhe kudo që pozitat e imperializmit amerikan tronditen apo rrezikohen, sipas rastit, herë presidenti, herë nënpresidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dalin nga strofka e tyre.

2) Këtë herë, me një suitë impresionante, vetë presidenti Nikson vjen në Evropë, por shumë i preokupuar.

3) Vetë objektet e vizitës së tij, Italia, Jugosllavia, Spanja, Flota e 6-të në Mesdhe, takimi në Napoli me ambasadorët amerikanë në këtë pellg dhe, më në fund vizita në Angli, lënë të supozohen qartë hallet dhe objektivat e Niksonit.

4) Niksoni do të takohet e do të bisedojë me Saragatin, me Titon dhe me Frankon, miq dhe aleatë besnikë të imperializmit amerikan, pasi pozitat strategjike, ekonomike dhe ushtarake amerikane në këto vende në koniunkturaturat aktuale janë të tronditura dhe atyre u duhet dhënë një «impuls presidencial».

5) Italia është «aeroplanmbajtësja» kryesore amerikane në Mesdhe, ajo është mbushur me baza të saj dhe Amerika dikton ligjin, nënkuptohet në rrugë dhe me forma të stërholluara «demokratike». Por kjo e famshme «demokraci» në Itali me vite të tëra është në krizë të rëndë. Me

vite dhe çdo ditë të vitit bëhen greva të punëtorëve dhe përleshje me policinë. Partitë borgjeze e revizioniste janë të gjitha të shitura, të përçara dhe në luftë me njëra-tjetrën për pushtet. Janë të njohura qarqet që të famshmen «demokraci» duan ta transformojnë në diktaturë fashiste. Këtë e subvencionon Amerika. Këtë po vjen ta fuqizojë, ta inkurajojë tani Niksoni.

Mjaft më me pallavra, do t'u thotë Niksoni Saragatit e Papës në Itali. Unë nuk mund të lejoj të rrezikohen interesat amerikanë, në atë që e quajnë «botë e lirë».

Pra qëllimi i ardhjes së tij në Itali është:

a) Të forcojë bazat ushtarake amerikane.

b) Të inkurajojë dhe të ndihmojë miqtë, agjenturën amerikane, që të mbajnë fort pushtetin dhe, në rast rreziku, «De Lorencot» të jenë gati.

c) Të mbajë nën kontroll të tij tendencat e gjalla të nostalgjisë për «boshtin Romë-Berlin», aktualisht Romë-Bon, të mbajë, gjithashtu, nën një dush të ftohtë shpresat e revizionistëve për një puthje të tepruar me aleatin e tyre moskovit.

6) Përveç këtyre, interesat ekonomikë amerikanë në Itali janë të mëdhenj. Ata duhen mbrojtur me çdo kusht, me anë të politikës, me anë të bursës, me anë të kryeministrit Kolombo, njeri besnik i amerikanëve.

7) Spanja është një vend ku mbretëron fashizmi i hapët, atje nuk ekziston as «demokracia e maskuar». Por Spanja, ashtu si dhe Italia, është në krizë, populli, punëtorët, atje luftojnë, janë në grevë. Spanja rron me kreditë e amerikanëve, por tani aty Boni po futet mirë, ndërsa sovjeti po flirton me të. Niksoni natyrisht është i shqetësuar për këtë vend plot me baza dhe me aerodrome amerikane, plot me interesa politikë dhe ekonomikë. Imperializmi amerikan ka interes të madh që fashisti Franko dhe diktatura e tij të jenë plotësisht në duart e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pse Spanja është Mesdheu,

është presioni mbi Francën, është siguria e Flotës së 6-të dhe paralizimi i flotës franceze, është një nga pionët më të rëndësishëm të NATO-s në këtë zonë.

8) Është e kuptueshme se në bisedën me ambasadorët e tij në vendet e pellgut të Mesdheut, Niksonit nuk i intereson shëndeti i tyre, por «shëndeti» i vendeve ku ata janë akredituar, për t'u rekomanduar atyre se s'janë momentet për të qenë optimistë, as për fuqinë politike, as për fuqinë e intrigave, as për atë të dollarit dhe të tankeve e të kanonierave amerikane. Popujt janë ngritur dhe luftojnë kundër tyre. Prandaj Niksoni do t'u theksojë se lodra e tyre diplomatike duhet të jetë e shtrënguar, se për amerikanët nuk ka pasur dhe nuk do të ketë kurrë vlerë fjala latine: «Heshtin topat se këndon muza». Diplomacia amerikane do t'i nënshtrohet forcës ushtarake të Flotës së 6-të.

9) Inspektimi i Niksonit mbi këtë flotë agresive nuk do të jetë për të kaluar në paradë mërinsët, po për t'i nxitur ata për luftë kundër popujve, për të qenë të gatshëm të ndërhyjnë dhe të goditin popujt dhe luftërat nacionalçlirimtare, të jenë gati të mbrojnë pasuritë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe natyrisht për të impresionuar popujt e pakënaqur të së ashtuquajturës botë e lirë. Niksoni do t'u tërheqë vëmendjen mërinsëve amerikanë se përbri tyre ndodhet edhe një flotë tjetër, ajo e revizionistëve sovjetikë, e cila për ta më mirë të mos ishte, por ja që erdhi, se ajo ka qëllime të pushtojë «botën tonë të lirë», prandaj hapni sytë, i bëni katër, ne do të bëjmë cmos që atë ta neutralizojmë dhe më në fund, kur të vijë koha, ia punojmë si në Trafalgar dhe në Abukir.

10) As Jugosllavinë, as Titon nuk mund t'i harronte Niksoni. Në Jugosllavi imperializmi amerikan nuk ka baza ushtarake, por atje kapitali amerikan është shtruar pajdash dhe interesat ekonomikë dhe politikë të Shteteve

të Bashkuara të Amerikës në këtë vend janë të mëdhenj. Kjo i detyrohet Titos dhe titizmit, që e shndërroi Jugosllavinë, nga një vend ku kishte filluar të ndërtohej socializmi, në një vend kapitalist.

Borxhet kolosale që Shtetet e Bashkuara të Amerikës i kanë dhënë dhe po i japin, e kanë bërë Jugosllavinë një apendiks kaotik të imperializmit amerikan. Kjo e ka bërë atë që të rrojë në kriza të mëdha ekonomike dhe politike të pashërueshme.

Por Titoja, me politikën dhe me ideologjinë e tij antimarksiste, jo vetëm e shkatërroi vendin e tij dhe rrezikon pavarësinë dhe sovranitetin e Jugosllavisë, por i bëri dhe po i bën shërbime të mëdha imperializmit amerikan, i cili iu gjend përkrah, kur braktisi marksizëm-leninizmin. Ky imperializëm i gjendet përsëri në krah tash kur Jugosllavia është në rrëmujë dhe në vigjiljen kur Titoja do të tërhiqet nga posti i presidentit të republikës jugosllave dhe do të merret me «punë të tjera», siç tha vetë ai.

Sigurisht «këto punë të tjera», me të cilat është marrë dhe më parë e do të merret edhe paskëtaj, Titoja, ky mik i ngushtë e besnik i amerikanëve, i interesojnë shumë Niksonit. Prandaj me takimin e këtyre dy miqve të ngushtë, do të përcaktohen plane pune të reja, të brendshme për Jugosllavinë, po edhe ndërkombëtare.

Nuk është pa qëllim që ky antimarksist, i cili hiqet si marksist, po pompohet si një personalitet politik ndërkombëtar për punë speciale të së ashtuquajturës botë të tretë, si specialist i punëve ballkanike dhe evropiane, si specialist i punëve sovjetike, si specialist dhe mik i popujve arabë. Për imperializmin amerikan Titoja është njeriu i përgatitur «për të gjitha gjellët», prandaj Niksoni shpalli se do të marrë bile edhe mundimin të vejë të vizitë fshatin e lindjes së «këtij njeriu të madh».

Vajtja e Niksonit në Jugosllavi nuk ka vetëm këto

qëllime, ai mendon, gjithashtu, edhe për mbrojtjen e posteve pararojë të NATO-s. Por popujt e Jugosllavisë janë armiq të NATO-s dhe të Traktatit të Varshavës dhe ne kemi bindjen e plotë se ata do të luftojnë kundër të gjithë atyre imperialistëve që do të guxojnë t'u cenojnë lirinë dhe pavarësinë. Popujt lirishtasë e patriotë të Jugosllavisë nuk do të shkojnë kurrë as në anën e imperializmit amerikan, as në anën e socialimperializmit sovjetik.

11) Fundi i udhëtimit të Niksonit është Anglia, aleati tradicional, i afërt i zemrës, por të cilit i kanë rënë pendët. Megjithatë, ajo është thirrur, si kurdoherë, të luajë një rol në Evropë dhe, sidomos, në momente të rënda krize, për të vënë në lëvizje diplomacinë e fshehtë të Intelixhens Servisit. Edhe ky aleat i Shteteve të Bashkuara të Amerikës rron në kriza, influenza e tij në kontinentin evropian ka rënë, pesha e tij në botë nuk ndihet. Kështu gjermani bëhet «kërcënues», sovjeti «rrethues», Franca e izoluar edhe nga Amerika.

Ç'rol do t'i caktohet Anglisë për Francën, si do t'i zhduket frika nga Boni e sovjetikët, si duhet ta mprehë vigjilencën? Të gjitha këto, të dy kushërinjtë, amerikan dhe anglezi, do t'i rrahin, do t'i bisedojnë, si në mes ungjit të pasur dhe nipit të varfër.

Konkluzion: Ardhja e Niksonit ka për qëllim kontrollin dhe mbajtjen në gatishmëri të forcave detare amerikane në Mesdhe, të forcave ajrore dhe tokësore në territoret evropiane, kontroll, ndihmë dhe sqarime forcave politike që mbështetin Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Evropë dhe në politikën e tyre globale, «paralajmërim» nga ana e Niksonit (në shkallët e duhura) sovjetikëve, Bonit dhe Francës, nxitje për përkrahje më të madhe Italisë, Spanjës dhe Jugosllavisë, penetrimin amerikan në kontinentin afrikan dhe neutralizimin e dobësimin atje të penetrimit sovjetik.

Për fuqizimin e NATO-s në Mesdhe dhe për të

bllokuar flotën sovjetike, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i vënë rëndësi të madhe këtij pellgu dhe kontinentit afrikan. Rivaliteti sovjeto-amerikan në këtë zonë do të rritet. Sovjetikët, aktualisht, janë në pozita shumë më të dobëta.

VDIQ NASERI

Radio Kajroja lajmëroi sonte vdekjen e presidentit të RA të Bashkuar, Gamal Abdel Naserit nga një krizë zemre.

KINEZËT JANË TË NJË MENDJEJE ME KAPITULLUESIT VIETNAMEZË

Siç rezultoi nga bisedimet e ambasadorit kinez bërë me Javer Malon, ambasadorin tonë në Paris, Kina është dakord me propozimet e fundit për paqe e tratativa që u bëri qeveria e Vietkongut Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kinezët janë dakord me arsyetimet që japin vietnamezët, që këto janë vetëm një «ofensivë politike» për të dobësuar pozitat e Niksonit në zgjedhjet e ardhshme etj., pse kryesorja mbetet lufta e armatosur, e cila do të vazhdojë më me forcë. Koha do të na vërtetojë çdo gjë.

SHËNIM

Shënimet që kam shkruar në Ditar më 27 shtator, për vizitën e Niksonit në Evropë, i përfshiva në një artikull. Ia dërguam gazetës «Zëri i popullit», që ta botojë nesër¹.

¹ «Ç'kërkon Niksoni në Evropë!». «Zëri i popullit», 30 shtator 1970.

NË PRITJEN E DHËNË NGA AMBASADA KINEZE

Ishim në pritjen zyrtare që dha ambasadori kinez me rastin e 21-vjetorit të shpalljes së Republikës Popullore të Kinës.

Në bisedim me ambasadorin i shtjellova mendimet tona për qëllimet strategjike të Niksonit në Evropë, kontradiktat në mes shteteve kapitalisto-revizioniste, metodat dhe planet eventuale që mund të kurdisin. S'mungova t'i vë në dukje, tërthorazi, për rolin dhe interesimin që duhet të luajë dhe duhet të tregojë Kina në Evropë e në Mesdhe në këto koniunktura, se si duhet të forcojmë bashkëveprimin politik të të dy shteteve dhe partive tona dhe se si të jemi vigjilentë ndaj revizionistëve, veçanërisht ndaj atyre rumunë e titistë, se sovjetikët njihen prej tyre.

VDEKJA E NASERIT

Gamal Abdel Naseri ishte një personalitet me rëndësi i borgjezisë egjiptiane dhe i botës arabe. Ai fitoi popullaritet me puçin për likuidimin e monarkisë së Farukut dhe likuidimin e kolonializmit anglez në Egjipt dhe në kanal in e Suezit. Naseri ishte një nacionalist egjiptian që u propagandua, u pompua dhe veproi për nxitjen e nacionalizmit arab dhe për vënien e personit të tij në vendin e udhëheqësit të popullit egjiptian. Ai pësoi disfatë në përpjekjet për bashkimin e Egjiptit me Sirinë. Politika e tij e brendshme ishte e rëndë mbi popullin, të cilit nuk i solli ndonjë përmirësim ekonomik. Përkundrazi, borgjezia egjiptiane, me Naserin në krye, e keqësoi edhe më tepër gjendjen e varfër të vendit, duke e futur atë në borxhe të rënda tek imperialistët e ndryshëm. Forca e tij e armatosur bëri skifo të turpshme në sulmin e fundit të Izraelit dhe disfata që pësoi ia uli prestigjin. Por Naseri gjatë kësaj kohe diti të manovronte në mes amerikanëve dhe sovjetikëve dhe ta ngrinte autoritetin e tij në udhëheqjet e zbehta e të paqëndrueshme të vendeve të tjera arabe. Disfata në luftën me Izraelin e hodhi në prehrin e sovjetikëve dhe vdiq, në përgjithësi, njeriu i tyre, po jo pa manovruar nën rrogos me synimin që, në momentet e volitshme, t'ua kthente fletën.

Sidoqoftë, vdekja e tij lë një boshllëk të konsiderueshëm dhe me plot të papritura në Lindjen e Mesme, e

cila është krejt në krizë të rëndë. Sovjetikët humbën një mbështetje të tyre. Zëvendësi, që do të pasojë Naserin, i kujt do të jetë? Sigurisht i popullit jo, as i revolucionit, por i borgjezisë, i reaksionit arab, i shitur te njëra ose te tjetra fuqi imperialiste. Gjithë reaksioni arab do të jetë në lëvizje për të shtypur kryengritjen, për të vendosur «paqen Roxhers-Gromiko» dhe padronët e këtyre të dyve të forcojnë pozitat strategjike në këtë zonë.

Ç'mund të kishte «revolucionare» në nacionalizmin arab do të hajë një grusht të rëndë me vdekjen e Naserit, jo se ky ishte një revolucionar, por në qoftë se mund të diktoje një fije të tillë, në thonjëza, tek ai, te mbretërit arabë ose tek udhëheqësit kozmopolitë të Libanit dhe të Tunizisë, nuk ekziston fare.

Udhëheqësit algjerianë... Bumediëni, kanë bërë luftën çlirimtare, ata janë më revolucionarë se Naseri, por nëse këta do t'i imponohen botës arabe, do t'i frymëzojnë masat arabe në luftën kundër imperializmit, kjo është një çështje që do të shihet. Këtë do ta tregojnë puna, lufta, qëndrimet. Palestinezët janë në pozita të vështira, jo pse Naseri mbronte kauzën e tyre, po ai ishte i detyruar t'i llogariste, në rast se nuk pranonte të demaskohej fare. Tash me vdekjen e Naserit, kuptohet se forcohet pozita e Izraelit, ndërsa pozita e arabëve dhe veçanërisht e palestinezëve dobësohet.

Mrekulli imediate në këto koniunktura të rënda mund të bëjnë vetëm kryengritja popullore në vendet arabe dhe qëndresa e patundur dhe luftarake e palestinezëve, e sirianëve dhe e algjerianëve, në radhë të parë dhe, në shembullin e tyre, edhe e popujve të tjerë.

E ENJTE
1 TETOR 1970

REAKSIONI BOTËROR PUNON PËR LIKUIDIMIN E LËVIZJES PALESTINEZE

Sulmi barbar i mbretit të vogël dhe agjentit të imperializmit, Hysejnit të Jordanisë, ishte pa dyshim i organizuar nga CIA dhe nga Izraeli. Me siguri agjentura sovjetike ishte në dijeni, siç mund të ishte deri në njëfarë shkalle edhe Naseri. Gjithë kjo bandë ishte e interesuar që luftëtarët palestinezë të pushonin rezistencën e tyre të armatosur. Për t'ia arritur qëllimit, natyrisht, mjetet dhe mënyrat, sipas rrethanave dhe interesave që kishte secila nga këto palë, ishin të ndryshme, por objektivi ishte i njëjtë, shuarja e rezistencës palestineze, e cila kundërshtonte politikisht dhe me armë «Planin Roxhers» e agresorin izraelito-amerikan dhe mbante gjallë e frymëzonte kryengritjen arabe, zgjimin e ndërgjegjes arabe.

Imperializmi amerikan do të rrezikonte pozitat e tij në Lindjen e Mesme, në rast se nuk i jepej fund kësaj situatë revolucionare, kurse Izraeli jo vetëm rrezikonte të humbiste luftën, në qoftë se kjo do të vazhdonte për shumë kohë me arabët, por rrezikonte edhe ekzistencën e tij si shtet. Mbreti Hysejn dhe reaksioni jordanëz rrezikonin fronin, jetën dhe fuqinë. Prandaj i tërë ky grup zgjodhi «rrugën e likuidimit të plotë fizikisht» dhe në mënyrë barbare të gjithë rezistencës palestineze.

Hysejnit sulmoi me artileri, me tanke e me këmbësori qendrat e partizanëve në Aman dhe në veri të tij.

Lufta vazhdoi e egër me ditë të tëra, u vranë e gosën, pa dallim, me mijëra njerëz, partizanë, gra, dhe ushtarë të Hysejnit. Megjithëkëtë, palestinezët tuan, luftuan burrisht në Aman dhe në zonat e në veri të kryeqytetit jordanëz, në kufi me Sirinë. I erdhi në ndihmë palestinezëve. Iraku, i cili kishte edhe forca ushtarake të tij në Jordani, mbajti një qëndrim shumë të dyshimtë dhe më shumë pro Hysejnit.

Opinionit arab dhe ai botëror u ngritën në këmbë. Mbreti reaksionar dhe vrasës Hysejn u demaskua. Qëllimit nuk iu arrit dot. Bile, me zgjatjen e konfliktit, humbitnin shpresat e rimarrjes në bisedim të «Planit Roxhers», rrezikohej të prishej «armëpushimi» dhe të fillohej lufta, Hysejnit rrezikohej t'i hidhej fronti në erë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërcënuan me shantazhe e me ndërhyrje me armë në ndihmë të Hysejnit. Kjo i tmerroi sovjetikët dhe Naserin. Që të dyja këto fuqi ishin për likuidimin e rezistencës palestineze me nuanca të ndryshme. Sovjetikët ishin për çarmatosjen e plotë dhe nënshtrimin e tyre, por duke e ditur se kjo s'po arrihej, ata, në heshtje dhe që e provuan më vonë, ishin dakord me veprimin e Hysejnit. Kurse Naseri donte t'i kishte palestinezët nën drejtimin e tij dhe si një mjet shantazhi veprues kundër Izraelit e si një mjet pazarllëku me amerikanët. Likuidimi i plotë i palestinezëve nga Hysejnit nuk i leverdiste Naserit edhe për prestigjin e tij personal në botën arabe. Ai do të kalonte si vrasës i arabëve, ndihmës i Hysejnit, i amerikanëve dhe i Izraelit.

Të gjitha këto dhe, në radhë të parë, dështimi i planit të CIA-Hysejnit dhe shantazhi amerikan për ndërhyrje i detyruan sovjetikët dhe Naserin të bënin presione te palestinezët, te Hysejnit dhe te sirianët, që të ndalonin luftën në Jordani dhe të bëhej mbledhja e Kajros, ku u nënshkrua «armëpushimi» në mes fedainjve të «Al Fatahut» dhe Hysejnit.

Naseri dhe sovjetikët kërcënuan Sirinë dhe e detyruan të pushonte «ndërhyrjen e armatosur» në favor të «Al Fatahut», ndërhyrje që sirianët publikisht nuk e njohnin si të vërtetë. Naseri u është përgjigjur sirianëve se nuk do të përzihet në ngatërresat që do të ngjasin, në rast se do të ndërhyjnë amerikanët në Jordani.

Është e qartë se borgjezia nacionale arabe është e lëkundshme, e frikshme dhe e gatshme për kompromise. Reaksioni arab, i mbështetur nga sovjeto-amerikanët, reagon me forcë, po lëvizja revolucionare arabe nuk i ka hedhur armët. Prova është e gjallë: palestinezët po luftojnë, rezistojnë dhe janë në pararojë të luftës. «Marrëveshja e armëpushimit» me Hysejnin i gjeti ata në vëshirësi, por, si duket, nuk do të respektohet prej tyre. Ata, në fakt, vazhdojnë goditjet kundër Izraelit. Lufta e tyre vazhdon. Natyrisht, kjo do t'i acarojë konfliktet me reaksionin arab dhe goditjet me të do të jenë të pashmangshme. Fakt është se masat arabe janë revolucionare dhe të guximshme, po janë të përçara, jo të ngritura politikisht dhe të paorganizuara për luftë, pse mungon udhëheqja progresiste, revolucionare, e cila do të dalë patjetër nga lufta revolucionare.

E SHTUNË
3 TETOR 1970

ÇU EN LAI DËSHIRON TË VIJË NË VENDIN TONË

Na lajmërojnë nga Pekini se Çu En Lai, delegacionit tonë ekonomik qeveritar që ndodhet në Kinë, në mes të tjerash, i kishte thënë: «Kam katër vjet që nuk jam pjekur me shokun Enver dhe kur të bëj turneun për në vendet e Afrikës dhe në Evropë do të vij edhe në Shqipëri. Por këtë do ta vendosim pas mbledhjes së Asamblesë».

DELEGACIONI YNË, QË MORI PJESË NË VARRIMIN E NASERIT, U KTHYE NË ATDHE

Spiro Koleka u kthye nga Egjipti, ku shkoi për të marrë pjesë në varrimin e Naserit. Pritja që iu bë në Kajro ishte korrekte. Ai i paraqiti ngushëllimet Ali Sabriut¹, i cili foli me simpati për vendin tonë.

Nga varrimi s'panë gjë, u bë rrëmujë e madhe. Ne pamë më shumë në televizor.

¹ Në atë kohë nënpresident i Egjiptit.

TITOJA AMBASADOR SHËTITËS I IMPERIALIZMIT

Niksonit iu bë një pritje shumë e ngrohtë në Jugosllavi me popull të organizuar, i cili ishte nxjerrë nëpër rrugë, por, sidomos nga Titoja dhe nga klika e tij.

Ai ndenji atje plot dy ditë, shkoi në Zagreb, vizitoi fshatin e Titos, deri edhe shtëpinë e tij të lindjes. Dy ditë bisedime të vazhdueshme, publike dhe kokë më kokë. Sigurisht të gjitha problemet kyç ndërkombëtare u morën në shqyrtim, u caktuan rruga, puna dhe detyrat e paskëtajme të Titos në shërbim të imperializmit amerikan. Niksoni as nuk gabohej dhe e kishte peshuar mirë, kur në fjalimin që mbajti në darkën e dhënë për nder të tij nga Titoja, ku merrnin pjesë më tepër se 2 000 veta, e mburri Titon, duke thënë se «është i vetmi udhëheqës i kalibrit botëror me një eksperiencë kaq të madhe dhe që ka njohje me kaq shumë udhëheqës shtetesh të botës... Unë marr këshillat e tij». S'ka ku vete më tutje, një krehje bishti për një njeri që është në shërbim të plotë të plutokracisë amerikane.

Titoja, ky agjent shëtitës i kualifikuar i amerikanëve, ka krijuar një personalitet specifik në Evropë dhe në botë, që u shërben më së miri kapitalizmit amerikan dhe botëror, kundër komunizmit, revolucionit dhe socializmit. Personaliteti kryesor i pakontestueshëm në Jugosllavi, u bë udhëheqësi revizionist kryesor kundër Bashkimit

Sovjetik në kohën e Stalinit, u bë frymëzuesi i puçit revizionist hrushovian, pjesëtarët e të cilit, me Hrushovin në krye, deshën s'deshën e pompuan Titon, i dhanë famë, i ngritën autoritetin në sy të botës kapitaliste dhe të borgjezisë antikomuniste, pse me të drejtë, me luftën e tij, me intrigat e tij, me ndihmën e padronëve të tij, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Titoja është pjesëtar nga më kryesorët në disfatën e Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera ku në fuqi erdhën revizionistët.

Titoja, pra, ishte shumë rentabël për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që nuk ia kursyen as ndihmën politike, morale dhe ushtarake dhe as atë ekonomike. Titoja duhej të vazhdonte likuidimin e komunizmit në Evropë, likuidimin e fuqisë sovjetike dhe nënshtrimin e saj ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, likuidimin e lidhjeve të vendeve «socialiste» me revizionistët sovjetikë dhe Jugosllavia të ndiqej si shembull për transformime rrënjësore kapitaliste. Natyrisht kjo politikë e Tito-amerikanëve nuk mund të zhvillohej si në vaj, ajo kishte të përpjetat dhe të tatëpjetat e saj.

Tito-amerikanët perfeksiononin taktikat; Titoja krijoi taktikën e vet specifike për t'i shërbyer sa më mirë strategjisë globale amerikane.

Ai duke përforcuar lidhjet e fshehta me amerikanët, sajoi pozitat e tij të sipërfaqes «antibloqe», «neutraliste» dhe luftoi e lufton për të frymëzuar dhe për të udhëhequr «botën e tretë». «Bota e tretë» e Titos, me fjalë të tjera, do të thotë t'i futësh vendet që bëjnë pjesë në këtë «botë» në suazën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pikërisht, edhe ca më keq, në ato forma që është futur edhe Jugosllavia nën sundimin amerikan. Titoja ka sajuar edhe demagogjinë e përshtatshme për këtë politikë, demagogji, e cila nga një anë bën sikur është kundër kolonializmit të ri, kundër imperializmit, por nga ana tjetër ndih-

mon dhe lehtëson punën dhe depërtimin e imperializmit amerikan dhe lufton depërtimin e ndikimit të socialimperializmit sovjetik.

Në këto kushte Titoja është bërë një agjent i kualifikuar i amerikanëve, një «ministër i jashtëm» i dytë i tyre. Atje ku nuk mund të shkojë dot as presidenti amerikan, as ministri i jashtëm i vërtetë amerikan, pse kanë hije të rëndë dhe janë të papranueshëm, shkon ambasadori shtetitës i tyre, Titoja dhe kurdoherë që kthehet nga udhëtimi, me paturpësinë më të madhe merr çekun me miliona dollarë nga amerikanët. Kuptohet qartë sa me vlerë janë për amerikanët raportimet që u bën Titoja për gjendjen e vendeve që viziton, për udhëheqësit e tyre, për dëshirat, për mundësitë e shitjes e të blerjes së ndërgegjes së tyre.

Puna e Titos, në favor të amerikanëve, kuptohet që është një punë agjenturore e kualifikuar. Kuptohet, gjithashtu, se me mburrjen publike që Niksoni i bëri Titos u thoshte të gjithëve se «ata që mbështetin dhe ndjekin këshillat e Titos, kanë mbështetjen dhe ndihmën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës». Kjo, pra, ishte një paraqitje publike e Titos si emisar i kualifikuar i amerikanëve.

Duke marrë parasysh gjendjen kaotike që ekziston në Jugosllavi, duke marrë parasysh edhe rolin që duhet të luajë Titoja, edhe paskëtaj, si agjent shtetitës, ai do të largohet dhe nga presidenca, siç e tha vetë. Niksoni, përveç forcimit të pozitave të Titos, përveç kredive dhe investimeve të reja që do të bëjnë amerikanët në Jugosllavi, nuk mungoi të ekzaltojë në mënyrë flagrante edhe kroatët kundër Serbisë (natyrisht pa i përmendur asnjëherë këta), pse tradicionalisht janë sllavë dhe «prorusë».

Me t'u larguar Niksoni shtypi jugosllav dhe ai botëror deklaroi se Titoja do të shkojë për vizitë zyrtare në tetor në Holandë, në Belgjikë, në Luksemburg, në Republikën Federale të Gjermanisë, në Poloni, në Francë dhe

në RAB. Vihet pyetja: ku nuk do të shkojë? Sigurisht, ai që tash ka mbi kokë edhe kurorën me dafina të Niksonit, në këto vende do të lypë nga Tregu i Përbashkët Evropian kredi për vendin e tij që po falimenton, do të intrigojë në favor të amerikanëve dhe të anglezëve dhe në disfavor të Francës për ta sjellë këtë nën zgjedhën amerikane, për të qortuar sa të ketë mundësi Bonin që të mos afrohet shumë me sovjetikët, por të dobësojnë së toku ndikimin e tyre në Hungari, në Poloni, në Çekosllovakë dhe më në fund në Republikën Demokratike Gjermane. Titoja ka deklaruar se do të shkojë edhe në Itali, ku vajti edhe Niksoni, i cili ishte e zorshme të gjente atje një personalitet si Titoja. Në Itali të gjithë janë të shitur, por borgjezia dhe reaksioni janë të përçarë dhe trustet italiane, duan edhe ato vetë të bëjnë një politikë ca të pavarur në Mesdhe dhe të kenë një copë diell kolonial në Afrikë që ua ka zënë reja amerikane dhe ajo sovjetike.

Veprimet e paskëtaime të Titos, të amerikanëve dhe të sovjetikëve do t'i ndjekim me vigjilencë të madhe, se janë shumë të rrezikshme.

E HËNË
5 TETOR 1970

Ç'FSHIHET PRAPA VIZITËS SË POMPIDUSË NË MOSKË

Sot Pompiduja¹ nisët për një vizitë zyrtare në Bashkimin Sovjetik. Në një intervistë që dha disa ditë më parë, ai theksoi se ndaj Bashkimit Sovjetik dhe, në përgjithësi, do të ndjekë politikën e Dë Golit. Ky udhëtim i tij është kuptimplotë dhe bëhet pikërisht të nesërmen e largimit të Niksonit nga Evropa. Niksoni e injoroi fare Francën në turneun e tij evropian, gjë që tregon kontradiktat që ekzistojnë në mes kësaj dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pompiduja i përgjigjet zjarr për zjarr Niksonit, duke shkuar në Bashkimin Sovjetik dhe duke theksuar se ndjek politikën e Dë Golit, domethënë rezistencën ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, eliminimin e ndikimit të tyre në Evropë. I vetmi karshillëk, që mund t'u bëjë Franca Shteteve të Bashkuara të Amerikës është «aleanca» e saj me «aleatin» e amerikanëve, Bashkimin Sovjetik. Prandaj Pompiduja mendon të nxjerrë përfitime politike nga kontradiktat që shfaqen dhe që do të thellohen në mes të dyja superfuqive imperia-liste botërore, Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në fakt, Anglia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe satelitët e tyre në Evropë e shohin me shqetësim, të pa-

¹ Në atë kohë president i Francës.

shfaqur haptazi, puthjen Bon-Moskë dhe kanë filluar veprimet e nëndheshme të vënies së minave njëri-tjetrit. Sigurisht Boni dhe Moska po manovrojnë të dominojnë Evropën, natyrisht në kurriz të ndikimit amerikan. Formimi i këtij blloku do të thotë dobësim i NATO-s, gjë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk e dëshirojnë, por Niksoni foli haptazi se nuk do ta lejojë kurrë; ai deklaroi se do të shtojë forcën luftarake në Mesdhe; deklaroi se do të vazhdojë ndihma ushtarake për Greqinë gjë që do të thotë që ajo të bëhet një aeroplanmbajtëse e dytë a e tretë në Mesdhe; deklaroi haptazi se Izraelit Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t'i akordojnë kredi për armatime pa kufizime.

Është e qartë, pra, se pozitat amerikane në Evropë dhe në Mesdhe janë të lëkundura dhe kjo lëkundje u detyrohet manovrimeve Moskë-Bon, rezistencës goliste në Francë, dobësisë së Anglisë dhe mbi të gjitha hovit revolucionar antiamerikan dhe antirevizionist që po ngrihet në këtë kontinent, në Afrikë dhe në kontinente të tjera.

Franca goliste nuk do, pra, të humbasë autobusin në këtë kurs, ajo dëshiron të bëhet partneri i tretë në këtë koalicion të ri evropian, antiamerikan që po vijëzohet. Sigurisht edhe Boni, edhe Moska, dëshirojnë që Francën ta kenë në anën e tyre, por jo një partner të barabartë, por si një partner shfrytëzues edhe të pozitave ekonomike, por sidomos të pozitave politike dhe strategjike në Evropë, në Mesdhe dhe në Afrikë. Prandaj Moska, me bujë po e propagandon vajtjen e Pompidusë në Bashkimin Sovjetik.

Evropa dhe Mesdheu me Lindjen e Mesme, sipas mendimit tim, janë qendra të zjarrta të kontradiktave aktuale të mëdha në mes fuqive imperialisto-revizioniste. Në Evropë, po zien kazani për dominim. Niksoni erdhi të forconte pozitat e ndikimit amerikan. Rezultatet e tij

janë të dobëta, pse as Italia, as Jugosllavia, as Spanja nuk mund të luajnë rolin që kërkojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Niksoni e dinte, prandaj vuri theksin mbi Flotën e 6-të dhe kërcënimin ushtarak. Ai shkoi në Angli dhe lënia pas dore nga ana e tij e Francës dhe e Bonit tregon për kontradiktat që kanë filluar. Boni vepron i heshtur e pa zhurmë. Niksoni, në pamundësi të vazhonte vetë rrugën e bisedimeve, vuri Titon t'i vazhdojë ato në vend dhe në emër të tij. Nuk ishte e rastit që po në një ditë, kur Pompiduja nisët për Moskë, Titoja, për karshillëk, nisët për në Belgjikë, pastaj për në Holandë dhe në Luksemburg. Pra, Titoja, si emisar i Niksonit, shkon në këto vende të flasë, të punojë dhe të konkludojë forcimin e bllokut të këtyre vendeve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Anglinë, kundër Francës, Bonit dhe Moskës. Gjendja është, pra, mjaft e koklavitur dhe problemet që ndërlikohen s'kanë vetëm karakter evropian, por edhe botëror.

Franca, natyrisht, nuk do vetëm të dominojë në Evropë, por edhe në Mesdhe, edhe në kontinentin afrikan. Ajo e shikon rrezikun në Mesdhe, prandaj kërkon që të largohen të dyja flotat: e Bashkimit Sovjetik dhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga Mesdheu. Po ajo e di që kjo nuk arrihet, prandaj i vihet detyrë të forcojë flotën e saj të pavarur, të japë shembullin dhe të infektojë sa të jetë e mundur në këtë drejtim, edhe flotat e Italisë dhe të Spanjës, që të bëhen edhe ato «të pavarura» dhe, sidomos, të miqësohet me flotën sovjetike brenda kuadrit të miqësisë që mund të arrihet edhe në tokë. Pra, në qoftë se arrihet një ujdi e tillë edhe në Mesdhe, në mes Francës dhe Bashkimit Sovjetik, atëherë Flota e 6-të amerikane vihet në vështirësi akoma më të mëdha: Flota sovjetike bllokun Turqinë dhe Dardanelet, flota franceze rrezikon bazat spanjolle dhe ato italiane. Një perspektivë të tillë të zymtë Shtetet e Bashkuara të Amerikës e pa-

rashikojnë dhe këtu e ka kuptimin vënia e theksit të Niksonit mbi Flotën e 6-të dhe Mesdheun.

Nga ana tjetër, Franca kapitaliste është shumë e interesuar në Afrikë dhe në Lindjen e Mesme. Këtu puqen përsëri interesat e tyre me ata të sovjetikëve, të cilët, mendoj unë, nuk e shohin me sy të keq ndërhyrjen në këto zona të një partneri «mik» të tyre, po shumë më të dobët, më pak të rrezikshëm se amerikanët dhe, në rast ballafaqimi me ta, të mos ndodhen vetëm, por të kenë në krah edhe Francën kolonialiste. Në kontinentin afrikan do të ketë ndeshje edhe të fuqive të tjera kapitaliste, si Republika Federale e Gjermanisë, Italia, Spanja, që do të veprojnë për interesat e tyre, por edhe për interesat e aleancave që kanë, ose të atyre që mund të rikrijohen.

Sigurisht këto konkluzione që po nxjerr do t'i vërtetojë ose do t'i përgënjeshtrojë koha, prandaj detyra jonë është t'i ndjekim dhe t'ia vëmë në dukje opinionit tonë të brendshëm që të jetë i përgatitur, po edhe për opinionin e jashtëm.

Nuk dimë ç'mendon Kina për këto probleme të mëdha botërore? Por Maoja nuk u tha absolutisht asgjë shokëve të delegacionit tonë ekonomik qeveritar. Kur u takua me ta u bëri vetëm pyetjen e thjeshtë: «A ka kontradikta në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës?», dhe në përgjigjen që mori se «ka», ai nuk u lodh shumë dhe e aprovoi: «Po, ka». Çu En Lai shtoi: «Faktet tregojnë për këtë në Lindjen e Mesme».

Sigurisht shokët kinezë bëjnë analiza më të thella, por me miqtë si ne, që luftojnë në kushtet që dihen, duhet të jenë më të hapur.

E SHTUNE
10 TETOR 1970

PLAN DJALLËZOR I NIKSONIT

Presidenti amerikan Nikson në një fjalim që mbajti këto ditë bëri kundërpropozime për problemin e Vietnamit.

Meqë verivietnamezët dolën më parë me deklaratën e përbashkët për unitetin luftarak të popujve të Indokinës (Vietnamit të Veriut, Vietnamit të Jugut, Laosit dhe Kamboxhias), kurse në Paris Vietnami i Jugut doli me kushtet e tij për pushimin e zjarrit lidhur me tërheqjen e trupave amerikane nga Vietnami deri në qershor etj., etj., edhe Niksoni e zgjeroi sferën, domethënë, «armëpushimi të zgjerohet në gjithë Indokinën dhe të kontrollohet nga organizma ndërkombëtarë, pastaj të fillojë tërheqja dhe të mblidhet një konferencë për paqen dhe rregullimin e ardhshëm të gjendjes në gjithë Indokinën. Pastaj në bazë të vendimeve të tërhiqen trupat amerikane» etj., etj. Kjo do të thotë që amerikanët të mos tërhiqen kurrë.

Ambasadori kinez në Hanoi i tha tonit se «lufta në Vietnam vazhdon dhe bisedimet politike që bën Vietkongu venë me sukses dhe zhvillohen me zgjuarsi». Mendime të thella!!!

Kurse vietnamezët e veriut, ashtu siç i thonë ambasadorit tonë, preokupohen se «vajzat nuk po gjejnë burra, pse djemtë janë ushtarë».

Vetëm lufta, vetëm lufta, do të sjellë fitoren. Planin

e Niksonit Vietnami i Veriut dhe Vietkongu e hodhën poshtë që ditën e parë. Sovjetikët flasin me dy kuptime, mundet që edhe ata ta dënojnë në sipërfaqe, po ne do të shohim ç'do të bëhet nën rrogëz, nga vietnamezët dhe nga sovjetikët. Kina e demaskoi këtë plan. S'ka dyshim që ne do ta demaskojmë menjëherë.

E DIEL
11 TETOR 1970

NJË DELEGACION I RP TË KONGOS NË VENDIN TONË

Mbërriti në vendin tonë një delegacion qeveritar i RP të Kongos me ministrin e Vulës, të Drejtësisë dhe të Punës në krye¹. Duan të marrin eksperiencë nga legjislacioni ynë.

¹ Aloiz Mudileno-Masengo.

TAKIM ME DELEGACIONE KINEZE

Prita sot delegacionin e Akademisë së Shkencave dhe delegacionin e punonjësve të shtypshkronjave të RP të Kinës, që ndodhen në vendin tonë¹. U fola një orë, kurse të dy kryetarët e delegacioneve m'u përgjigjën me tri fjalë: «Ngremë dollinë për shëndetin tuaj».

Qëndrime si prej Li Hsien Nieni, po aq na bën, ne bëjmë punën tonë të drejtë.

¹ Delegacioni i Akademisë së Shkencave kryesohej nga i ngarkuari me funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm të Akademisë, Jue Çi Çien. Delegacioni i punonjësve të shtypshkronjave kryesohej nga kryetari i komitetit revolucionar të shtypshkronjave të Pekinit në gjuhë të huaja, Xhan Mjao Y.

TAKIM ME DELEGACIONIN E REPUBLIKËS POPULLORE TË KONGOS (BRAZAVIL)

Sot paradite prita delegacionin e Republikës Popullore të Kongos¹ që ka ardhur në vendin tonë për të marrë eksperiencë në fushën e legjislacionit.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 644.

SHËNIM

Në Pekin u nënshkruan marrëveshjet ekonomike midis vendit tonë dhe Kinës. Delegacioni ynë nesër, herët në mëngjes, nisët për t'u kthyer në Tiranë.

SAJIME TENDENCIOZE TË TITISTËVE

Atasheu ushtarak i ambasadës jugosllave në Bullgari për të influencuar mbi ambasadorin kinez në Sofje, i ka thënë se, «me rastin e manovrave të përbashkëta greko-turke-NATO në kufijtë e Bullgarisë, manovra ushtarake greke po bëhen edhe në kufirin me Shqipërinë dhe Beogradit interesohet shumë për to».

I gjithë ky informacion është fals. Aktualisht manovra në kufirin tonë nuk ka, asnjë lëvizje forcash greke nuk duket. Këto gjëra sajohen nga jugosllavët pranë kinezëve për t'u thënë atyre se «Shqipëria qenka në rrezik dhe se Jugosllavia qëndron zgjuar dhe është e gatshme në mbrojtje të saj».

SHËNIM

Bisedova me Ramizin rreth shkrimit të njëfarë Kastriati, transmetuar nga agjencia Tanjug¹. I thashë ta demaskojnë atë si falsifikator i kësaj agjencie².

1 Skënder Kastriati «vëzhgues» i agjencisë Tanjug. Shkrimi i tij mbante titullin: «Për një stimul më të madh material në Shqipëri», transmetuar nga Tanjugu më 15 tetor 1970.

2 «Dezinformatorët nga Tanjugu», artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit», 21 tetor 1970.

KINA NA AKORDOI KREDINË PËR VITET 1971-1975

Sot në mbledhjen e Byrosë Politike, dëgjuam raportin e delegacionit ekonomik qeveritar për punën e kryer në Kinë. Ndihma në kredi që na akordoi Kina për vitet 1971-1975 do të fuqizojë investimet që do të bëjmë për një zhvillim të mëtejshëm të ekonomisë sonë. Tash i kemi të gjitha të dhënat për të vendosur përfundimisht për planin e ri pesëvjeçar, e kam fjalën më shumë në drejtim të industrisë, kurse pjesën e bujqësisë jemi duke e mbaruar.

E MARTË
20 TETOR 1970

**TË STUDIOHEN KËRKESAT E DELEGACIONIT
TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS**

Ramizi më raportoi për mbledhjen e parë që bënë shokët e universitetit tonë me ata të Universitetit të Prishtinës. Këta ishin shumë të kënaqur dhe bënë një numër kërkesash. Këto kërkesa duhet të studiohen nga ana jonë dhe t'u plotësohen sa të jetë e mundshme.

E MARTË
20 TETOR 1970

SHËNIM

Lexova procesverbalin e bisedimeve që delegacioni ynë ekonomik qeveritar ka pasur me Mao Ce Dunin dhe me Çu En Lain. Kashtë!

E MËRKURË
21 TETOR 1970

SHËNIM

Ndaluam vajtjen e skuadrës sonë të basketbollit në Stamboll, për arsye se dëgjuam sikur ka pasur raste kolere.

E DIEL
25 TETOR 1970

PROFESORËT KOSOVARË JANË SHUMË TË KËNAQUR NGA VIZITA NË VENDIN TONË

Profesorët kosovarë, anëtarë të delegacionit të Universitetit të Prishtinës, kanë mbetur «shumë të kënaqur» nga pritja dhe nga përmbushja e kërkesave të tyre nga ana jonë dhe «shumë të mahnitur» nga përparimet. «Këtu ndërtohet me të vërtetë socializmi», kanë thënë ata.

SHËNIME

Shoku Rita Marko më kërkoi mendim për t'i kthyer vizitën presidentit të Bashkimeve Profesionale të Rumanisë. I thashë se mund ta planifikojë një vizitë të tillë nga dhjetori.

I dhashë dorën e fundit fjalimit që do të mbaj në 8 nëntor në Shkollën e Partisë «V.I. Lenin».

SHËNIM

Isha dakord me letërfalënderimin që do t'i dërgohet Çu En Lait nga ana e Qeverisë sonë për kreditë që na akordoi Kina. I këshillova shokët që të mos ketë shumë shprehje superlative, por falënderimet të jenë të matura, reale e dinjitoze.

E HËNË
2 NËNTOR 1970

RRITET AUTORITETI I VENDIT TONË

Prita shokët e delegacionit të Ministrisë së Jashtme që mori pjesë në punimet e sesionit të sivjetëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Më raportuan për punën që bëri delegacioni në Nju-Jork. Autoriteti i vendit tonë është ngritur shumë, si në OKB, ashtu edhe në koloninë e shqiptarëve të Amerikës.

E MARTË
3 NËNTOR 1970

TË SHKRUAJMË PËR FIASKON E VETADMINISTRIMIT JUGOSLLAV

Shkëmbeva mendime me Ramizin për një artikull ideologjik që duhet të bëjmë për fiaskon e vetadministrimit jugosllav në dritën e diskutimeve që sapo mbaruan në konferencën e LKJ.

SHQIPËRIA SOCIALISTE I URREN SHANTAZHIERËT

VALIPODJI TUMTRIZIKIMITSY R

Përfaqësuesi i RAB-it në OKB, në emër të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Arabe të Bashkuar shkoi i tha përfaqësuesit tonë në këtë Organizatë se «në rast se ju nuk votoni për «Planin Roxhers», të cilin e përkrah edhe RAB-i, ne nuk do ta konsiderojmë Shqipërinë një vend mik».

Lajmëruam shokun tonë që përfaqësuesit të RAB-it t'i thotë: «Shqipëria ka qenë dhe do të votojë kundër «Planit Roxhers», pse ky është një plan imperialist, në dëm të popujve të botës, në dëm të popujve arabë dhe veçanërisht në dëm të RAB-it. Ju duhet ta dini se Republika Popullore e Shqipërisë nuk ka frikë, ajo i urren shantazhierët e çfarëdollojtë dhe s'ka forcë në botë që ta pengojë atë të ecë në rrugën e saj të drejtë dhe sovranë. Pavarësisht se ç'do të mendoni dhe si do të veproni ju, Republika Popullore e Shqipërisë dhe populli shqiptar ka luftuar dhe do të luftojë me të gjitha forcat kundër imperialistëve amerikanë, sionizmit izraelit dhe revizionistëve sovjetikë dhe do të jetë kurdoherë mik i ngushtë armësh i popujve arabë dhe veçanërisht i popullit egjiptian. Ju duhet të dini se qëndrimet tona në OKB i çmonte shumë dhe drejt edhe Gamal Abdel Naseri».

SHËNIM

Sot është festa e Revolucionit Socialist të Tetorit. Ç'dhimbje kur mendon se si u bë Bashkimi Sovjetik i Leninit e i Stalinit!

E HËNE
9 NËNTOR 1970

SHËNIM

Bisedova përsëri me Ramizin lidhur me artikullin që po përgatitim për demaskimin e vetadministrimit titist.

E PREMTE
13 NËNTOR 1970

PËRPJËKJE TË KOTA TË NJË AMBASADORI SOVJETIK

Ambasadori ynë në Rumani na lajmëron se ambasadori sovjetik në Bukuresht përpiqet t'i japë dorën e të bëjë një shkëmbim, qoftë edhe të vogël, muhabeti.

**E SHTUNË
14 NËNTOR 1970**

TAKIM ME NJË UDHËHEQËS KOMUNIST INDIAN

Prita anëtarin e Byrosë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste (m-l) të Indisë, shokun Gosh¹.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1968-1970», f. 654.

**E HËNË
16 NËNTOR 1970**

TË NDIHMOJMË POPULLIN E VIETNAMIT TË JUGUT

Vietkongut përveç ndihmave të përvitshme që i japim për luftën duhet t'i japim ndihmë edhe për përmbytjet që kanë ndodhur në Vietnamin e Jugut.

TË NDIHMOJMË POPULLIN PAKISTANEZ

Edhe ne duhet të japim një ndihmë për katastrofën e madhe që ngjau në Pakistan (gjiri i Bengales, ku flitet se nga tufani u mbytën mbi 200 000 veta).

DËSHMI TË FALIMENTIMIT TË PLOTË TË VIJËS REVIZIONISTE TË VETADMINISTRIMIT JUGOSLLAV

Artikullin me titull: «Dëshmi të falimentimit të plotë të vijës revizioniste të vetadministrimit jugosllav», po ia dërgojmë redaksisë së gazetës «Zëri i popullit» për ta botuar nesër.

E PREMTE
20 NËNTOR 1970

BISEDË ME SHOKUN RITA MARKO PËR VIZITËN E TIJ NË RUMANI

Bisedova me Ritën për vajtjen e tij më 10 dhjetor në Rumani, në kthim të vizitës që bëri këtu presidenti i Bashkimeve Profesionale të Rumanisë.

Parashikuam disa eventualitete. Ai do të kërkojë t'i bëhet një program i ngjashëm, siç i bëmë edhe ne rumunit këtu. Natyrisht Rita do të flasë mirë për miqësinë me Rumaninë, pa asnjë formë polemike, do të përmendë vetëm revizionizmin modern.

Në qoftë se i thonë që Çausheku dëshiron të piqet me të, të mos refuzojë, të vejë dhe t'i flasë për miqësinë. Në qoftë se ai i thotë që «të vijë shoku Enver në Rumani», t'i përgjigjet nga ana e tij, personale, që nuk i bie Enverit të vijë, këtu, se ai ka ardhur në Rumani, në të kundërtën asnjë udhëheqës rumun nuk ka vizituar Shqipërinë, duke mos harruar edhe qëndrimet armiqësore që janë mbajtur kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, të cilat, natyrisht, duhet të korrigjohen. Po të thuhet se është gati të vijë Çausheku, t'i thuhet se në këtë rast duhet pasur parasysh se në komunikatë disa qëndrime bazë parimore nuk do të përkohjnë dhe nga ana jonë ato do të vihen, ashtu siç do të vihen mirë në dukje edhe anët që na lidhin, siç është miqësia e madhe në mes popujve tanë që ne duhet ta zhvillojmë.

Komunikatë të shkurtër mund të lëshojnë, ashtu siç bëmë edhe këtu, e asgjë tjetër, duke ditur se rumunët të gjitha këto i bëjnë për bujë e për kredinë e tyre.

E MËRKURË
25 NËNTOR 1970

DO TË DËRGOJMË NJË DELEGACION TË LIDHJES SË SHKRIMTARËVE NË KOSOVË

Diskutuam dhe vendosëm që në përgjigje të ftesës që na kanë bërë, të dërgojmë në Kosovë një delegacion të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve për të marrë pjesë në një përvjetor jubilar¹ për Naim Frashërin. Vendosëm që delegacionin ta kryesojë Dhimitër Shuteriqi.

¹ Është fjala për të marrë pjesë në një mbledhje solemne kushtuar 70-vjetorit të vdekjes së Naim Frashërit.

E MËRKURË
25 NËNTOR 1970

NË JUGOSLLAVI ÇDO GJË ECËN DREJT GREMINËS

Gjendja ekonomike, financiare dhe politike në Jugosllavi është si mos më keq, Titoja u çka së foluri dhe së luturi për «unitet», por më kot. Çdo gjë shkon drejt greminës, ashtu siç e kemi thënë shumë herë.

Bisedova me Ramizin që të bëhet një artikull¹ për festën e çlirimit të popujve të Jugosllavisë.

¹ «Një datë e shënuar për popujt e Jugosllavisë». «Zëri i popullit», 28 nëntor 1970.

E ENJTE
26 NËNTOR 1970

PËRKUJTOJMË 150-VJETORIN E LINDJES SË ENGELSIT

Erdhi përvjetori i 150-të i lindjes së Frederik Engelsit, i shokut dhe i bashkëpunëtorit më të ngushtë të Karl Marksit.

Me këtë rast, në Shkollën e Partisë «V.I. Lenin» do të organizohet një sesion jubilar ku do të mbahen referate dhe kumtesa.

E DIEL
29 NËNTOR 1970

LË MOND BOTON PJESE NGA FJALIMI I MBAJTUR NË MBLEDHJEN E MOSKËS TË VITIT 1960

Ambasada jonë në Paris njofton se gazeta «Lë Mond», me rastin e 10-vjetorit të Mbledhjes së 81 partive komuniste e punëtore në Moskë, boton pjesë të gjera nga fjalimi që mbajta unë atje.

E HËNË
30 NËNTOR 1970

MBI QEVERINË E RE TË SIRISË

Qeveria siriane e Asadit, që erdhi tash së fundi në fuqi, duke rrëzuar me grusht shteti atë të Atasit, duket se është edhe më e djathtë se e djathta e Atasit, të dyja të partisë «Baas». Të paktën Atasi ndihmonte në lëvizjen palestineze dhe ishte kundër mbretit të reaksionit jordanez, Hysejnit.

Asadi, siç po duket është në disfavor të luftëtarëve palestinezë, shkoi të «bashkohet me konfederatën Egjipt-Libi-Sudan» që besoj nuk do të bëhet kurrë. Sovjetikët dhe amerikanët vazhdojnë të heqin vallen e «paqes e të kompromisit me Izraelin».

Qeveritë e Lindjes së Mesme u bënë si ato të Amerikës Latine, por me një ndryshim se në këtë zonë të botës ka «dy kamberë në një derë», amerikanët dhe sovjetikët, që kanë hedhur thonjtë, bëjnë ligjin, rrëzojnë dhe formojnë qeveritë e këtyre vendeve.

SHËNIM

Shkuam me Hysniun e Ramizin për të uruar shokun K. Mijal për 5-vjetorin e themelimit të Partisë Komuniste të Polonisë.

SHENJA «TË FITORES» SË REVIZIONIZMIT MODERN NË KINË

Ambasadori kinez në Tiranë, në një bisedë në Ministrinë e Punëve të Jashtme kishte thënë se, aktualisht nuk ka luftë në mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik.

Kina tash do të bëjë me të gjithë një politikë të «bashkekzistencës paqësore», do të përpiqet që «edhe Hungarinë ta sjellë në pozitë e Rumanisë». Për Jugosllavinë titiste nuk zuri gjë fare në gojë se çfarë planesh kanë, por me siguri edhe atje «Planin Rumun». «Plani Rumun» do të triumfojë dalgadalë në gjithë këtë politikë të tyre të «bashkekzistencës paqësore». Kjo me siguri për një kohë do të shtrihet edhe me Bashkimin Sovjetik dhe me mongolët, se me koreanët u arrit. Do të arrihet dhe me revizionistët e tjerë evropianë. Natyrisht, do të ruhen disa distanca, disa aparenca të rrezikshme do të evitohen, por polemika politiko-ideologjike do të pushojë, siç ka pushuar.

Kjo është një fitore për revizionistët modernë, të tjera do të vijë më pas. Ne duhet të jemi vigjilentë dhe të mos i pushojmë për asnjë çast luftën dhe polemikën.

SHËNIM

Shoku Rita Marko u nis sot për në Bukuresht, në krye të një delegacioni të Bashkimeve Profesionale.

NJË ORVATJE E DËNUESHME PËR TË PENGUAR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË FIERZËS

Ka nja dy javë që ka ardhur këtu zëvendësministrja e Energjetikës e Kinës me një ekip, për të parë dhe për të na ndihmuar në çështjen e hidrocentraleve tona. Disa ditë më parë ajo pati dy-tri takime me shokun Rahman Hanku, që merret me këto probleme dhe i shtroi atij këto çështje:

1) Hidrocentrali i Fierzës nuk mund të ngrihet atje ku është vendosur dhe po punohet, se terreni nuk është i sigurt, ka zgavra të pambyllshme, se duhet të bëjmë kërkime të reja, se duhet të ndërrohet aksi i punimeve, se diga nuk mund të bëhet me dhe (argjil) siç është vendosur dhe, meqë nga liqeni që do të formohet, uji do të shtrihet edhe në territorin jugosllav, mund të ketë të papritura.

2) Hidrocentralin «Mao Ce Dun» nuk do ta mbaroni dot në datën që keni caktuar ju; diga e tij nuk është e sigurt dhe mund të rrezikojë emrin e Maos.

Të gjitha këto Rahman Hanku ia hodhi poshtë kategorikisht si të pabazuara dhe të papranueshme nga ana jonë.

Ajo u kthye për të dytën herë me po ato mendime, po Rahmani nuk lëvizi dhe i kërkoi asaj që të ballafaqohet me specialistët kinezë, të cilët, siç pretendonte ajo, janë të një mendimi me të, ndërsa në realitet kanë qenë vazhdimisht dakord për çdo gjë me specialistët tanë.

Kurse herën e tretë ajo i kërkoi ndjesë Rahmanit se ishte gabuar gjoja nga dy inxhinierë, se vetë ajo është plotësisht me pikëpamjet tona mbi çdo gjë, se çdo gjë është vendosur drejt e të tjera, e të tjera elozhe për ne.

E çuditshme!! Kjo vjen nga Pekini dhe jo e dërguar nga dy inxhinierët me të cilët u justifikua! Kjo është një orvatje e dënueshme për të penguar ndërtimin e Hidrocentralit të Fierzës. Mënyra shumë të këqija veprimi, jo-shoqërore. Me gjithë miqësinë ne duhet të jemi vigjilentë.

E PREMTE
11 DHJETOR 1970

SHBA RIFILLUAN BOMBARDIMET NË VIETNAMIN E VERIUT

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë rifilluar bombardimet në Vietnamin e Veriut dhe Niksoni deklaroi se është e drejta e tij ta bëjë një gjë të tillë derisa bateritë e Vietnamit qëllojnë aeroplanët e vrojtimit amerikan, të cilët «duhet të patrullojnë qiellin e Vietnamit», pse ashtu u pëlqen amerikanëve.

Sigurisht, asnjëherë Shtetet e Bashkuara të Amerikës s'kanë hequr dhe nuk do të heqin dorë nga agresioni dhe mjerë ata që besonin se mund të arrinin me bisedime «paqësore», që imperialistët amerikanë të tërhiqeshin nga Vietnam. Miqtë vietnamezë këtë gjë nuk e thoshin hap-tazi, por shumë shpresa kishin. Edhe revizionistët sovjetikë që i pasojnë në Vietnam sa s'hidheshin përpjetë nga gëzimi për rezultatet pozitive që do t'u sillte Konferenca e Parisit. Kjo, sipas tyre, do të sillte «disfatën» e Niksonit në zgjedhjet e nëntorit, kurse solli bombat në Vietnam. Tash miqtë vietnamezë u rizgjuan, po rimarrin «vendime» për luftë dhe për mbrojtje, si në Jug dhe në Veri. Neve na bëjnë thirrje të mbështetim veprimet e tyre dhe do t'i mbështetim me të gjitha forcat, si kurdoherë. Sipas ambasadorit kinez në Tiranë, sovjetikët u kanë prerë krejt ndihmën vietnamezëve dhe janë kinezët që tash i furnizojnë totalisht.

Lufta në Jug ka rënë shumë. Në qoftë se kjo do të vazhdojë kështu, do të jetë katastrofike dhe në favor të imperialistëve amerikanë e të revizionistëve sovjetikë.

DEKLARATË POZITIVE E QEVERISË GREKE

Sami Baholli nga OKB-ja na lajmëron se përfaqësuesi i qeverisë greke i ka thënë se «...qeveria e tij e ka ngarkuar t'i lutet që t'i transmetohet Qeverisë Shqiptare, se ajo (qeveria greke) i ka parë me sy shumë dashamirës gjestet e Qeverisë Shqiptare, si lirim të avionit, të varkave etj., dhe do të bëjë përpjekje të përmirësojë marrëdhëniet deri në vendosjen e marrëdhënieve diplomatike».

Kjo është pozitive, ta studiojmë dhe t'i përgjigjemi pozitivisht.

SHPREHJE E KALBËZIMIT TË REGJIMIT REVIZIONIST POLAK

Në Gdansk (Dancig), Zopot e në qytete të tjera polake shpërthyen demonstrata që vazhduan për tri ditë rresht kundër pushtetit dhe klikës së Gomulkës në fuqi. Demonstruesit ishin punëtorë të porteve, studentë. Me ta u bashkuan dhe qytetarët. Ata në fillim marshuan në mënyrë paqësore, duke hedhur parulla, është e qartë kundër pushtetit dhe klikës së Gomulkës. Demonstratat e protestat s'ka dyshim që kishin karakter politik, ato morën zjarr nga pakënaqësia e madhe që shkaktoi vendimi i qeverisë për ngritjen e çmimeve të mallrave ushqimore deri në 25 për qind. Demonstruesit u drejtuan nga komitetet e partisë dhe nga radiostacionet lokale. Kur ndërhyri policia me shkopin, atëherë filloi përleshja, pastaj ndërhyrë ushtria dhe milicia, ndërhyrë edhe tanket, kërciti pushka, u vranë 20 veta dhe u plagosën me qindra.

Këto janë fakte të para me sy, nga njerëz që u ndodhën në vendin e ngjarjeve, dhe që na thonë edhe shokët e ambasadës sonë në Varshavë. Qeveria polake i njohu ngjarjet, por demonstruesit i cilësoi «huliganë», «provokatorë» etj. Në rrëmujë e në mjegull ka dhe ujë, por të tillë, të mëdhenj dhe të egër, janë në fuqi në Poloni.

Gjithë çka ngjau këto ditë, në qytetet e Baltikut, tregon kalbëzimin e regjimit revizionist të Gomulkës dhe ngjalljen e reaksionit polak, i cili do të shkojë edhe më

tutje, duke përfituar nga degjenerimi i gjithanshëm i Polonisë. Natyrisht, këto janë frytet e tradhtisë hrushoviane dhe gomulkiane, novotniane etj. Për reaksionin botëror (që me të drejtë po bën bujë dhe do të vazhdojë të bëjë bujë e presione), Hungaria, Çekosllovakia dhe Polonia janë gurët e shahut kundër socializmit dhe komunizmit, që revizionistët sovjetikë dhe lakenjtë e tyre i hodhën kaq baltë. Sovjetikët ndodhen në hall të madh brenda dhe jashtë ku janë vendosur ushtritë e tyre. Ata janë vetë në gjendje ekonomike të vajtueshme, aq sa miqtë e tyre në krizë nuk mund t'i ndihmojnë veçse t'u japin urdhër tankeve të marshojnë mbi popujt në greva, siç bënë në Çekoslovakia.

Në Poloni, sipas informatave të ambasadës sonë, ka gati shtetrrëhim. Fabrikat, universitetet, radiot, shtypshkronjat private, deri dhe makinat e shkrimit janë bllokuar nga ushtria dhe nga milicia. Tanët dëgjuan me veshët e tyre dy shpërthime bombe natën në ambasadën sovjetike, e cila u rrethua menjëherë nga ushtria.

Banditët revizionistë nuk lanë gjë pa shpifur kundër Stalinit, por i marrshin të keqen. Stalini nuk qëlloi kurrë mbi popullin, siç bëjnë këta tradhtarë. Populli dhe partia e donin dhe e respektonin atë, pse rroi dhe luftoi për popullin. Kurse këta janë armiq të popullit, shtien mbi popullin, pse populli revoltohet kundër tyre.

Sigurisht kjo do të ketë rrjedhime në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet revizioniste, ata do të shkojnë duke u bërë lëshime imperialistëve, të cilët do t'u bëjnë presione nga ana e tyre.

Kina duhet të qëndrojë fort kundër revizionistëve dhe imperialistëve, nuk duhet të zbutë qëndrimet përpara krizave të tyre. Për sa na përket neve, do ta ngremë zërin dhe do t'i demaskojmë revizionistët modernë si agjentë të imperializmit ndërkombëtar.

E DIEL
20 DHJETOR 1970

KLIKËN REVIZIONISTE TË GOMULKËS E RRËZUAN

Radio Varshava sonde, në mbrëmje, njoftoi se Komiteti Qendror i Partisë Punëtore të Bashkuar Polake rrëzoi Vladislav Gomulkën nga detyra e sekretarit të parë dhe e anëtarit të Byrosë Politike. Tok me të hoqi edhe Spihalskin dhe nja katër të tjerë. Në vend të Gomulkës erdhi njëfarë Giereku si sekretar i parë. Si anëtar i byrosë erdhi po ashtu gjenerali Moçar i «grupit partizan».

Me një fjalë klika revizioniste «grupi i Gomulkës» u qërua. Në fuqi erdhi një grup tjetër revizionist. Kjo u shkaktua nga demonstratat e punëtorëve në Dancig e në qytetet e tjera të Baltikut, për shkakun e ngritjes së çmimeve që u bë disa ditë më parë. Natyrisht ky është preteksti ekonomik i rëndësishëm, por jo kryesor. Për sa i përket grupit që erdhi në fuqi do të duket qartë më vonë ç'rrugë do të marrë, por kuptohet se do të jetë më liberal se ai i Gomulkës, sigurisht shovinist si i Gomulkës, në mos më shumë, antisemit dhe, natyrisht, antisovjetik, në fillim i maskuar ca, pastaj do të shohim.

Sidoqoftë fashisti Gomulka (që revizionisti Hrushov nuk mungoi të ma cilësonte si të tillë mua në kohën e zënkës në mes tyre, pavarësisht se më vonë u puthën e u shtrënguan fort dhe u vërsulën së toku kundër nesh), e theu qafën nga demonstratat e punëtorëve, ashtu siç thuhej dy vjet më parë në artikullin e «Zërit të popullit»: «Klasa punëtore në vendet revizioniste duhet të zbrësë në

fushën e betejës dhe të rivendosë diktaturën e proletariatit»¹.

Gomulka, aq sa ishte, ishte «pro» sovjetik. Tash vihet pyetja: sovjetikët pse nuk e mbështetën atë? S'mundën dot? Korrenti i kundërshtarëve të tij ishte aq i fortë sa s'guxuan të ndërhyjnë dot, siç e kanë zakon. Apo ndërhyjnë dhe nuk u ndriti te kundërshtarët e Gomulkës, të cilët kishin shembullin e këtij vetë që u preu hovin e ndërhyrjes hrushovianëve në vitin 1965? Apo sovjetikët e lanë Gomulkën në baltë si Novotnin për një Dubček të ri, me emrin Gierek? Mirëpo me polakët s'bëhen lodra, se nuk janë çekë.

Thuhet se ekipi që zëvendësoi Gomulkën është «pro» sovjetik. Mund të jetë kështu, por unë nuk e besoj dhe aq. Në fakt shqetësimet janë të mëdha për revizionistët sovjetikë. Ka shumë mundësi që grupi i Gierekut të marrë rrugën «titiste të Çausheskut», po çfarë Çaushesku se, jo rumun, por polak. Në Moskë ka dimër dhe dimër të madh politik, si brenda dhe jashtë. Zhvillim të bukur po u merr politika me Brandin, me «Sigurimin evropian», me Lindjen e Mesme etj. Gjermania e Ulbrihtit, do të vihet në mes thikave më keq se ç'është vënë, megjithëse me siguri Ulbrihti është kënaqur që «miku» i tij Gomulka e theu qafën. Ulbrihti do t'i forcojë patjetër presionet në drejtim të sovjetikëve për të çliruar darën që e ka mbërtëyer, po çështja polake asgjë nuk zgjidh as për Ulbrihtin, as për Kosiginin. Përkundrazi, pisk e më pisk do të shkojë puna në të dy këto vende dhe në të gjitha vendet ku sundojnë revizionistët.

Pavarësisht kush erdhi në fuqi në Poloni, në këto vende ngjau për herë të parë diçka e re, që nuk kishte ngjarë asnjëherë: demonstratat dhe goditjet në rrugë rrëzuan udhëheqjen dhe një udhëheqje revizioniste që pa-

faqitej nga më të fortat, më dinaket dhe më me eksperiencë. Kjo është një ngjarje që do të merret patjetër si shembull. Sëmundja është ngjitëse, sidomos në trupat e krimbur.

Kina deri tash s'po flet. Kur erdhi Gomulka në fuqi, të mos harrojmë se Kina (Çu En Lai) e mbrojti atë nga ndërhyrjet sovjetike. Ç'do të thonë tash shokët kinezë për këtë jezuit revizionist?

Çështja polake është me shumë rëndësi. Të shohim si do të zhvillohet.

¹ Shih: Enver Hoxha. Vepra, vëll. 37, f. 395.

Ë MARTË
22 DHJETOR 1970

SHËNIM

Diskutuam me Ramizin artikullin¹ për rënien e Gomulkës, që është shkruar për gazetën «Zëri i popullit» e që do të botohet nesër.

¹ «Rrëzimi i Gomulkës — një disfatë tjetër e rëndë për revizionistët hrushovianë». «Zëri i popullit», 23 dhjetor 1970.

Ë MARTË
22 DHJETOR 1970*

Ç'THA GËN BIAOJA KUR U LARGUA NGA TIRANA?

Ambasadori kinez Gën Biao, që po bën vizitat e lamtumirës, pse lë Tiranën dhe do të punojë si drejtor në Drejtorinë e Jashtme të KQ të PK të Kinës, në bisedë me shokët e Sektorit të Jashtëm të KQ të PPSH, u tha: Partia Komuniste e Kinës me revizionistët (ishte fjala për partinë revizioniste italiane) nuk do të mbajë më lidhje, por në rrugën e Shoqatës së Miqësisë Kinë-Itali po...

Vijë e bukur! Vijë e qartë marksiste-leniniste!! Revizionistët, sipas kinezëve, mund t'i kemi miq, mund të vemë e të vijmë, ata mund ta mburrin Kinën me artikuj, mund të mburrin Maon, dhe kjo, sipas tyre, është një gjë e mirë! Në një gjendje të tillë «miqësore» është e qartë se nuk mund të flitet as për luftë politike, as për luftë ideologjike me ta. Polemika shuhet. Natyrisht në këto rrugë dhe me këto forma gjenden edhe mënyrat e «krijimit të frontit të përbashkët antiimperialist edhe me revizionistët», vijë shumë e dashur dhe e ndjekur, siç po duket, me kohë dhe me konsekuencë nga shokët kinezë.

Hapja e portave në fushën e diplomacisë nga ana e Kinës, kështu si po bëhet në kundërshtim me politikën proletare, do të sjellë shumë gjëra të çuditshme, sepse parimet e politikës së jashtme do të jenë të lëkundshme dhe subjektivistë. Këto do të shkaktojnë zigzage, mundet dhe të rrezikshme.

MBI GJENDJEN SHPIRTËRORE NË KOSOVË

Dhimitër Shuteriqi që ishte në Kosovë në krye të një delegacioni të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, për të marrë pjesë në mbledhjen solemne kushtuar 70-vjetorit të vdekjes së Naim Frashërit, kishte folur për gjendjen atje. Rinia edhe pse ndjek modën perëndimore në veshje (shumë keq) shpirtërisht është e zjarrtë, me ndjenja patriotike, e etshme, ndjek me vëmendje dhe ka dashuri e besim të madh për Shqipërinë, ashtu si dhe i gjithë populli kosovar. Inteligjencia, në përgjithësi, mirë është e lidhur me popullin dhe, në veçanti, mësuesit janë të lidhur me të shumë mirë. Të tjerët, dhe veçanërisht zyrtarët, janë të shkëputur nga populli dhe nuk kanë influencë në masa.

TAKIM ME AMBASADORIN KINEZ

Sot pata një takim lamtumire me ambasadorin kinez Gën Biao i cili largohet nga Tirana për në Pekin. Këtu vjen një ambasador i ri, kandidat i Komitetit Qendror.

SHQETËSIM I MADH NË BASHKIMIN SOVJETIK DHE NË VENDET E TJERA REVIZIONISTE

Me rënien e Gomulkës ndihet një shqetësim i madh në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste. Kjo duket në shumë drejtime, veçanërisht në artikujt e shtypit, ku natyrisht janë shumë kurnacë për çështjen polake. Shtypi i tyre shkruan aq pak, sa të mos thuhet se nuk shkruan. Ai relatton në mënyrë shumë përmbledhëse disa thënie zyrtare polake, ku theksohet «besnikëria» ndaj aleancës me Bashkimin Sovjetik dhe me «bashkësinë» socialiste. **S'mund të flitet për litar në shtëpinë e të varurit.** Shtypi sovjetik, përkundrazi, bën be e rrufe se në Bashkimin Sovjetik çdo gjë bëhet «për popullin, për njeriun». Ai numëron me përqindje shtesat e radiove, të televizorëve, të këpucëve etj., kurse për sendet ushqimore, ku dyqanet janë bosh nuk vë përqindje, por mjaftohet vetëm të thotë se «janë shtuar», kurse «e ardhmja do të jetë e shkëlqyer, këtë do ta vendosë kongresi i partisë që do të bëhet në mars» shkruan shtypi sovjetik.

Bullgarët po të njëjtën këngë, s'mund të bëjnë përjashtim nga sovjetikët, vetëm se klika e Zhivkovit është e krimbur. Do të mjaftonin disa demonstrata në rrugë që ajo të hidhet në plehra.

Rumunët bëjnë zhurmë të madhe dhe të rreme se i kanë hambaret dhe dyqanet plot. Realiteti, siç e dimë dhe

siç na e tha edhe Rita që erdhi andej, është ndryshe.

Të mos flasim për Çekoslovakinë, ku kriza politike është e vazhdueshme dhe gjendja e krijuar në Poloni dhe në Bashkimin Sovjetik e gjetkë do të influencojë atje akoma më shumë.

Gjermanolindorët po hanë dhjamin që kanë vënë, ose që kanë marrë nga të tjerët për të mbajtur «vitrinën politike». Por shantazhi i tyre, natyrisht, do të vazhdojë, veçse nuk do t'u sjellë shumë gjalpë dhe sallame nga Polonia, nga Bullgaria e nga Çekoslovakia.

Në këto momente krize revizionistët hrushovianë janë shumë sensibël nga sulmet tona demaskuese. Artikujve tanë ua kanë frikën shumë, por veçanërisht atë që shkroi Kina tash së fundi për Poloninë, ku atakoi Gomulkën dhe sovjetikët tok me të. Ky u dogji sovjetikëve, pse menduan se tash që shkëmbyen ambasadorë me Pekinin do të ulej polemika, do të zbutej puna etj. Po ç't'i bësh, kalaja revizioniste është e kalbur dhe kolonat që mbajnë në këmbë çatinë e saj po rrëzohen njëra pas tjetrës. Bashkekzistenca paqësore hrushoviane nuk arrin të mëkëmbet nga tufanet revolucionare, të cilat medemos do të vazhdojnë. Ky është ligj. Në vetë Poloninë çështja s'ka mbaruar. Mund të themi se sa ka filluar. Lëvizja punëtore i provoi armët e saj dhe pati një gjysmësukces politik: rrëzimin e klikës së Gomulkës. Mirëpo klika tjetër revizioniste, me po ata vrasës dhe me të tjerë, erdhi në fuqi dhe do ta vazhdojë shtypjen politike, pa zgjidhur asnjë problem ekonomik. Përkundrazi, këto do të sjellin komplikacione të mëdha brenda, acarimin e klasës punëtore dhe të masave punonjëse me klikën udhëheqëse, e cila do të acarohet nga ana e vet me sovjetikët që do të kërkojnë me imponim të goditet revolucioni brenda, pse bëhet i rrezikshëm për ta dhe për të gjithë revizionistët. Sovjetikët do të hyjnë po ashtu në konflikt me klikën polake, pse kjo zem-

rën e ka nga perëndimorët, do t'u nderë edhe duart, edhe këmbët për t'u lidhur me ta.

Punë klikash, tradhtarësh, punë zinxhirësh për veten e tyre dhe për popujt mbi të cilët sundojnë. Këta zinxhirë të robërisë vetëm revolucioni që po ngrihet do t'i shkatërrojë dhe klikat tradhtarë revizioniste do t'i futë në varr.

Viti 1971 le të jetë viti i lavdishëm i një varg revolucionesh të udhëhequra nga partitë e vërteta marksiste-leniniste.

E MËRKURË
30 DHJETOR 1970

SUKSES I PROFESORËVE TANË NË KOSOVË

Ramizi më vuri në dijeni për punën e madhe që bënë në Universitetin e Prishtinës (Kosovë) grupi i parë i profesorëve tanë që shkuan dhe dhanë atje leksion. Sukses i madh te studentët, te profesorët dhe në publik. Profesorët tanë u treguan në lartësi të detyrës. Në krye të tyre ishte Androkli Kostallari për gjuhën shqipe.

Pas një jave do të shkojë një grup tjetër e kështu me radhë po zbatohet programi i vendosur. E tërë kjo është si të thuash një investim i madh ideologjik, politik, patriotik dhe kulturor nga ana jonë në shqiptarët e Kosovës, të Maqedonisë dhe të Malit të Zi.

SITUATA NË POLONI ËSHTË E ERRËT

Situata në Poloni është e turbullt, e errët dhe kë-shtu do të vazhdojë. Derisa çmimet nuk ulen dot, punë-torët dhe populli do të lëvizin. Bashkimi Sovjetik është në hall. Tash ka shkuar në Varshavë Patoliçevi për të dhënë disa lëmosha ushqimore nga halli i madh, pse sov-jetikët janë keq për vete, por lëvizjet në Poloni janë ngjitëse edhe për Bashkimin Sovjetik dhe për vendet e tjera revizioniste.

Udhëheqja aktuale polake mbështetet hapur te kisha katolike polake, e cila ka hapur dyert dhe gojën dhe, duke ftuar popullin «të ruajë qetësinë», kërkon konce-sione të mëdha, «liri», «demokraci». Udhëheqja revizio-niste polake po shkruan artikuj për kishën polake, për Vatikanin, për papët, Xhovanin dhe Pavlin VI etj.

E tillë është situata në vendet revizioniste në pra-gun e vitit të ri 1971, domethënë në shenjën e kishës, të kapitalit. Revolucioni do të ngrihet. Viti 1971 do të na sjellë fitore të reja neve, marksistë-leninistëve, kurse për revizionistët do të ketë disfata.

1971

E PREMTE
1 JANAR 1971*

NË KINË PO RIORGANIZOHET PARTIA

Lajmet që na vijnë nga Pekini janë të gëzueshme. Partia Komuniste e Kinës po riorganizohet sipas mësimëve të Mao Ce Dunit dhe direktivave të fundit të kongresit të saj që u mbajt në vitin 1969. Gjithashtu vjet, në muajt e fundit, u mbajt edhe kongresi i partisë i provincës ku ka lindur Maoja dhe thuhet se sivjet do të bëhen me radhë të gjitha kongreset e tjera të partisë të provincave. **Kjo, natyrisht, presupozon se në të gjithë Kinën është në vazhdim riorganizimi i partisë, krijimi i organizatave-bazë dhe i komiteteve të partisë.**

Sigurisht është bërë spastrimi i parë i elementit armik dhe ai është hedhur jashtë partisë. Zhvillimi i Revolucionit Kulturor ndihmoi në këtë çështje vendimtare, por kjo punë nuk ka mbaruar. Lufta për pastrimin e radhëve të Partisë dhe për kalitjen e komunistëve duhet të vazhdojë e të vazhdojë në kushte të reja e në rrugë të drejtë marksiste-leniniste.

Informatat që na vijnë, dhe kjo është logjike, tregojnë se pas formimit të partisë ata do të organizojnë bashkimet profesionale, organizatën e rinisë dhe atë të gruas. **Do të jetë interesante kjo eksperiencë e fituar nga shokët kinezë se si po riorganizohet partia dhe veprimtaria ekonomiko-shoqërore e shtetërore në kushtet e Kinës pas Revolucionit Kulturor.**

Vetë Revolucioni Kulturor përbën një problem të

madh politiko-teorik për t'u studiuar. Tash duket qartë se armiku kishte depërtuar thellë në parti, në pushtet, në ekonomi, në politikë dhe në kulturë. Autoriteti i Maos luajti rolin vendimtar në kushtet shumë të komplikuar dhe të rënda që ishin krijuar në Kinë. **Fakt është se Maoja u mbështet tek ushtria, e vetmja forcë e organizuar dhe ndoshta e pamolepsur nga fryma revizioniste.** U ngritën në revolucion edhe masat, sidomos rinia, se u bëri thirrje Mao Ce Duni, i cili i udhëhoqi ato në «rrëmujën e madhe».

Kam hedhur në letër disa mendime për Revolucionin Kulturor dhe për ngjarje të tjera që ndodhin në Kinë, sidomos që nga viti 1964. Këto mendime dhe gjykime i kam formuluar në bazë të ngjarjeve reale, të qëndrimeve zyrtare të kinezëve etj. Shumë herë informacioni, faktet, ishin të shkëputura, të pakonfirmuara dhe detyrohesh të bëja supozime, të bëja, si të thuash, *puzzle*¹. Këto shkrime i kam ruajtur dhe nuk u jam kthyer më, pra, i kam lënë ashtu siç i kam menduar në atë kohë që i kam shkruar. Mendimet që po hedh, në këtë ditar, janë, si të thuash, refleksione që bluaj në kokë në bazë të ngjarjeve që ndodhin në Kinë, të fakteve për të cilat shkruhet shumë, mbarë e prapë, si në Kinë ashtu edhe në botë, dhe mundohem të gjej, të shoh fillin në këtë proces situatash të komplikuar. Me siguri, ka gjëra që i kanë vërtetuar koha dhe evenimentet, ka të tjera të pagjykuara si duhet, ka edhe të tilla që nuk vërtetohen, sepse situatat ashtu kanë qenë, shumë të turbullta.

Ajo që ka rëndësi është se një kontinent i tërë siç është Kina, duket se shpëtoi nga katastrofa revizioniste, siç po thuhet, atje triumfoi revolucioni proletar, dhe kjo na gëzon.

¹ Anglisht — grumbullim faktesh nëpërmjet arsytimit logjik për të rindërtuar një realitet që s'e njohim.

SHËNIM

Bisedë me shokët për letrën që do t'i dërgohet Li Hsien Nienit për çështjen e ratave të vitit 1971, që pjesërisht të shtyhen dhe pjesërisht t'i paguajmë. Me atë pjesë, që propozojmë të shtyhen, të kërkojmë të blejmë një sërë prodhimesh bujqësore deficitare.

E PREMTE
8 JANAR 1971

MBI MARRËDHËNIET TONA ME GREQINË

Përfaqësuesi ynë në OKB, shoku Sami Baholli, pati një takim tjetër me përfaqësuesin e Greqisë në këtë organizatë, Bicios dhe, në vazhdim të propozimit të këtij të fundit, i komunikoi se Qeveria Shqiptare, si kurdoherë, është e gatshme të vendosë marrëdhënie diplomatike me Greqinë, të cilat, sipas mendimit tonë, të jenë në rang ambasadash dhe të shkëmbehen ambasadorë.

Greku Bicios iu përgjigj se do t'ia komunikonte menjëherë qeverisë së tij këtë propozim të Qeverisë Shqiptare. Ai shtoi se qeveria greke «ka konstatuar me kënaqësi se minoriteti grek në Shqipëri ruan dhe zhvillon gjuhën e tij amtare (greke) dhe e mëson atë edhe në shkolla. Po do të ishte mirë, dhe kjo do ta ndihmonte qeverinë greke në veprimet e saj, në rast se Qeveria Shqiptare bën një deklaratë me anë të së cilës të shpallë se i lejon minoritarët të ushtrojnë edhe fenë ortodokse». Greku kërkoi, gjithashtu, që komunikatës për vendosjen e marrëdhënieve t'i bëhej njëfarë shtojce *imprecise*¹, por që qeveria greke ta kishte si «gozhdë» për opinionin e brendshëm se «do t'i propozonte Qeverisë Shqiptare, pasi të vendoseshin marrëdhëniet, të firmosej edhe një traktat paqeje» etj.

Për çështjen që ka ngritur greku, Sami Baholli i ka

¹ Frëngjisht – e papërcaktuar.

folur si jurist dhe jo si diplomat, duke i thënë, në substancë, që këto janë çështje të brendshme tonat, që ne nuk i diskutojmë me kërrkënd dhe ca më pak me ju. Sidoqoftë, Samiu nuk u zgjat më tej dhe iu përgjigj se do ta vërë në korent Qeverinë e tij (Shqiptare).

Në do ta vëmë në korent Samiun që ai të veprojë edhe si politikan marksist-leninist, edhe si jurist i tillë, dhe do ta udhëzojmë si të veprojë në mënyrë që asnjë nga dëshirat e grekut të mos realizohet. Po të dëshirojnë, le të lidhin marrëdhënie diplomatike në kushtet tona dhe jo në ato reaksionare dhe shoviniste që kërkojnë ata. Të drejtat demokratike, si gjithë shtetasit e tjerë të republikës, minoriteti i vogël grek, që është pjesë integrale e popullit shqiptar dhe e Republikës Popullore të Shqipërisë, i fitoi me luftë dhe ia dha Partia e Punës e Shqipërisë, Partia e tij marksiste-leniniste dhe këtë nuk e bëri për t'u bërë qejfin ose jo qeveritarëve të Athinës, cilëtdo qofshin këta. Kjo ishte rruga e socializmit që ndoqën populli shqiptar dhe tok të bashkuar me të, edhe vëllezërit e minoritetit grek.

Qeveria fashiste e Athinës ka pasur kurdoherë të kisha ortodokse në minoritet bazën e saj agjenturore dhe të propagandës së megaloidesë vorioepirote. Po atë çerdhe, jo vetëm në minoritet por në të gjithë vendin, ua shkatërroi populli dhe Partia jonë reaksionit grekomadh dhe gjithë reaksionit tjetër.

E MARTË
12 JANAR 1971

DISA MENDIME PËR GJENDJEN NË VENDET REVIZIONISTE

Në të gjitha vendet revizioniste, pa përjashtim, situata e brendshme dhe e jashtme e tyre është shumë e sëmurë, e paqëndrueshme. Nga jashtë ajo është e padukshme, por brenda zien dhe u shkakton klikave në fuqi turbullira të shumëllojta nacionale, ndërkombëtare dhe në marrëdhëniet reciproke me njëra-tjetrën.

Vendet revizioniste kanë humbur çdo prestigj në arenën ndërkombëtare, s'kanë asnjë personalitet, nuk luajnë asnjë rol politik të dukshëm. Disa «probleme ndërkombëtare», si nënshkrimi i traktateve me Bonin ose «Sigurimi evropian», probleme këto të destinuara të pësojnë fiasko, janë kurdisur nga revizionistët sovjetikë dhe nga imperialistët amerikanë. Për këto revizionistët e tjerë, satelitë të Bashkimit revizionist Sovjetik, nuk bëjnë gjë tjetër veçse i bien «daulles pa të kremte». Roli i klikave revizioniste satelite në arenën ndërkombëtare është thjesht ai i një pioni. Ata nuk përbëhen veçse nga personalitete hipokrite e të frikshme që ndjekin, notojnë, gërthasin për «unitet» me Bashkimin Sovjetik e me njëri-tjetrin, por fshehurazi, në kulisa, i buzëqeshin imperializmit, marrin kredi, i hedhin vicka njëri-tjetrit, por vicka të matura, pse vetë këto klika qëndrojnë si mbi një vullkan, kanë edhe frikë. Që të qëndrojnë në fuqi ato kanë edhe nevojën e revizionistëve sovjetikë.

Problemi gjerman u djeg të gjithë revizionistëve, po, në thelb, zgjidhjen e tij nuk e shohin njësoj. Në përgjithësi, dhe në dukje, të gjithë aprovojnë Traktatin Moskë-Bon, por, në realitet, midis tyre ka kundërshtime. Kundërshtimi kryesor është ai që vjen nga revizionistët gjermanë. Ky kundërshtim bazohet në faktin që ky traktat u bë në kurriz e në dëm të Republikës Demokratike Gjermane. Partneri kryesor dhe «mbrojtësi» i Republikës Demokratike Gjermane nënshkroi këtë traktat me revanshistët e Bonit dhe këta i njohu përpara Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe aleatëve të tjerë të Bonit në NATO dhe jo në NATO, natyrisht, *de jure*, pa nënshkruar traktatin e paqes me të dy shtetet gjermane, kurse Republika Demokratike Gjermane mbeti vetëm në mëshirën e politikës hegjemoniste sovjetike. Në të tilla kushte Republika Demokratike Gjermane nuk ka, as në Traktatin e Varshavës dhe as si shtet sovran, atë gjendje juridike që kanë partnerët e tjerë të tij në Traktatin e Varshavës. Revizionistët gjermanë janë të pakënaqur, dhe kjo pakënaqësi buron jo nga pozita revolucionare, por revizioniste. Ata bënë lëshim në nënshkrimin e traktatit të paqes me të dy shtetet gjermane, ose po të mos donte Boni vetëm me Republikën Demokratike Gjermane dhe lëshimi i dytë dhe i tretë fatal është se revizionistët gjermanë pranuan Traktatin Moskë-Bon dhe Traktatin Varshavë-Bon.

Këto dy traktate ulin çdo autoritet të Republikës Demokratike Gjermane në arenën ndërkombëtare, e mbajnë atë në statukuonë e një guri shahu të politikës revizioniste sovjetike në Evropë, në tratativa me imperializmin amerikan dhe me fuqinë revanshiste të Bonit. Për revizionistët sovjetikë çështja gjermane vihet vetëm këshu: o një satelit i tij i bindur dhe në këtë rrugë bashkimi i të dy shteteve gjermane, sipas pikëpamjeve të Moskës, do të arrihet (kurse sipas nesh nuk mund të

ngjasë), ose Republika Demokratike Gjermane është për ta një shtet satelit tampon në një luftë të ardhshme imperialisto-revizioniste. Kurse klika e Gomulkës, duke nënshkruar traktatin me Bonin për kufirin Oder-Najse, që në realitet s'është kufiri i Polonisë me Bonin, por vetëm i Polonisë me Republikën Demokratike Gjermane, tha qartë se Republikën Demokratike Gjermane ajo e konsideron një shtet të përkohshëm pa asnjë të ardhme. Siguri për Poloninë është Boni. Revizionistët polakë nuk mund të besojnë në socializmin, por në forcën e traktateve që firmosin me kolegët e tyre revanshistë të Bonit. Brandi e Gomulka janë një. Një janë edhe Brezhnjev-Kosigini me dy të parët, pse këto dy traktate famëkeqe u bënë prej tyre.

Këto dy traktate duhet të ratifikohen nga Boni, i cili, natyrisht, kërkon lëshime të mëtejshme dhe këto kanë lidhje me sigurimin në mënyrë ligjore ndërkombëtare (pranimi zyrtarisht nga Republika Demokratike Gjermane), i rrugëve të hyrjes në Berlinin Perëndimor dhe lëshime të atilla në këtë pjesë të Berlinit, si dhe hapjen e murit në mënyrë që Republika Demokratike Gjermane të bëhet han me dy porta për Bonin, i cili të lëvizë lirisht, të veprojë lirisht dhe të realizojë planet e tij për gëlltitjen e Republikës Demokratike Gjermane.

Sa do t'i rezistojnë këtij plani revizionistët gjermanë, sa do të jenë solidarë revizionistët sovjetikë, padronët aktualë të Republikës Demokratike Gjermane dhe aleatët e Brandit me këto synime të Bonit? Sovjetikët do të gjejnë fjalën e lëshimeve tradhtarë të mëtejshme me klikën e Ulbrihtit, apo do t'ia ngrenë kësaj këmbët dhe do ta zëvendësojnë me një tjetër më të bindur?

Klika revizioniste e Ulbrihtit dhe diplomatët e saj u thonë diplomatëve tanë se «politika e Partisë së Punës të Shqipërisë ndaj Republikës Demokratike Gjermane është e vetmja politikë e drejtë, ne jemi dakord me të,

por s'veprojmë dot ashtu, se e kemi litarin në grykë».

Gazetat e Republikës Demokratike Gjermane i trajtojnë njerëzit e Bonit si revanshistë dhe si forca imperialiste më e rrezikshme në Evropë, si maja e shpatës e imperializmit amerikan. Këtë kemi thënë edhe ne kurdoherë, po revizionistët e tjerë thonë të kundërtën. Sovjetikët dhe polakët u puthën me Brandin. Ulbrihti, Çausheku, Zhivkovi, çekët e të tjerë, u ngopën së marri kredi nga revanshistët e Bonit.

Natyrisht këta revizionistë tradhtarë shohin te politika e Bashkimit Sovjetik ndaj Bonit një politikë «qetësie dhe sigurie» për të marrë ndihma e kredi nga Republika Federale e Gjermanisë. Parimet ata i kanë shkëlmuar, ata kanë tradhtuar popujt e tyre dhe jo të mos tradhtojnë interesat e Republikës Demokratike Gjermane.

Republika Demokratike Gjermane duhet t'u nënshtrohet interesave të tyre dhe interesat e çdo klike në veçanti predominojnë mbi interesin e përgjithshëm, sepse ky për ta s'përbën asgjë principiale, por është vetëm i çastit, koniunktural.

E shikuar nën këtë prizëm, situata në Bashkimin Sovjetik është shumë e turbullt, shumë kritike për klikën revizioniste në fuqi. Ajo është përballë shumë problemeve kapitale kyç, të pazgjidhshme për të, në këtë rrugë tradhtarë ku i ka futur vendin dhe partinë.

Pas vdekjes së Stalinit, tradhtia ndaj marksizëm-leninizmit, shkaktoi gjendjen aktuale katastrofike në të gjitha drejtimet e vendit.

Në radhë të parë, partia nuk ekziston më si parti udhëheqëse, ajo është një kufomë, një qenie formale, një rutinë, një slogan, pse të tjera ligje, të tjera parime, të tjera urdhëresa veprojnë. Nami i së kaluarës ka mbuluar, si me një cipë të zezë, një kërmë që po dekompozohet. Në këtë pasqyrë po zhvillohet atje edhe e gjithë

jeta ekonomike e kulturore. Jeta në Bashkimin Sovjetik ka degjeneruar, pse kanë degjeneruar ideologjia marksiste-leniniste dhe lufta revolucionare politike. Kapitalizmi atje është vendosur me gjithë tiparet e tij të shëmtuara morale, politike dhe ekonomike.

Nga një vend i demokracisë socialiste Bashkimi Sovjetik është kthyer në një vend të burokracisë së re represive, me ligjet, me normat, me burgjet, me kampet, me korrupsionin, me papunësinë, me prostitucionin, me mungesat e mëdha të prodhimeve, me luftëra në mes nacionaliteteve të tij etj. I gjithë ky llum korrupsioni e ka mbuluar shoqërinë në Bashkimin Sovjetik dhe çdo ditë gjendja po keqësohet. Qelbësira e madhe, që është krijuar, po mbulon çdo ditë e më shumë të kaluarën e lavdishme të Bashkimit Sovjetik.

Revizionistët sovjetikë janë futur në një rreth infernal. Brenda duan të japin përshtypjen se po ndjekin rrugën leniniste për çdo gjë, si në teori, edhe në praktikë, por gjendja zhvillohet në të kundërtën. Asgjë nuk e vërteton demagogjinë e tyre, përkundrazi kjo u krijon situata jashtëzakonisht të rënda, pse nuk mund të jetosh gjatë, me fjalë, në dy karrige: të jesh antimarksist i tërbuar dhe të thuash disa fjalë boshe për Leninin; të jesh antistalinist më i poshtër dhe të bësh një sy të mbyllur kur ndonjë flet për Stalinin; të flasësh me fjalë kundër imperializmit dhe të lidhesh e të bashkëpunosh aq ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës; të flasësh për politikën leniniste në ekonomi dhe të mos kesh të hash; të flasësh për parti leniniste dhe nga ana tjetër të ndërtosh një parti revizioniste të ashtuquajtur të të gjithë popullit; të flasësh për terrorin, burgjet dhe kampet gjoja të kohës së Stalinin dhe ta kthesh vendin në burg, në kamp, në çmendinë; të përpiqesh të zbutësh shpifjet, duke burgosur Solzhenicinët, dhe nga ana tjetër të lejosh të lulëzojë një literaturë e shturur dekadente. Një politikë e

tillë antimarksiste, plot me kontradikta e që vepron me gjysmë masa, pse revizionistët akoma nuk mund të veprojnë dot lirisht si një diktaturë fashiste, pse duan të ruajnë disa aparenca, e ka kallur vendin në një kaos kapitalist, nga më të këqijtë. Degjenerimi, natyrisht, nuk mund të krijojë veçse degjenerim, i cili po afirmohet, po fiton pozita në politikë, në ekonomi, në kulturë, por njëkohësisht krijon edhe të kundërtën e vet, kundërshtimin, të cilin udhëheqja revizioniste e ka frikë, do ta zbutë duke gënjer, por që gënjeshtër të zërë duhet t'u «shtrëngojë disi vidhat» njerëzve të vijës së tij revizioniste. Këtu haset kontradikta dhe anohet patjetër në shtypje, në shkelje të çdo parimi, në vendosje të dhunës fashiste.

Politika e qelbur revizioniste, degjenerimi moralopolitik dhe disfatat ekonomike brenda i kanë gërryer krejtësisht autoritetin dhe prestigjin e Bashkimit Sovjetik jashtë, në arenën ndërkombëtare. Bashkimi Sovjetik nuk ka më miq të singertë në botë, siç kishte më parë në kohën e Leninin dhe të Stalinin. Revizionistët ia larguan miqtë, revizionistët nuk mund të jenë miq as me njëri-tjetrin, ashtu siç nuk mund të jenë miq kapitalistët me njëri-tjetrin. Në mes tyre mbretëron ligji i xhunglës, në mes tyre dominojnë interesat e ndyrë të pasurimit borgjez dhe të dominimit kapitalist.

Satelitët revizionistë nuk kanë asnjë besim dhe asnjë dashuri për revizionistët dominues të Moskës. Qoftë ata, qoftë këta janë në pozita false me njëri-tjetrin, ia kanë njëri-tjetrit me lesh në bark, gjithsecili përpigjet të zhvatë sa më shumë nga tjetri, të tregohet servil kur shikon se i turret ndonjë rrezik nga ndonjë anë, gati të veprojë në të kundërtën nesër. Sot Novotni është i mirë, por, nesër ai i jep shkelmin për të vënë në vend të tij Dubčekun dhe më vonë këtij për Husakun. Dje Gomulka ishte fashist, për një kohë u bë hrushoviani dhe «pro-

sovjetiku» më i kulluar. Shkelmin edhe këtij për Gierkun dhe nesër këtij për një tjetër. E kështu me radhë për të gjithë.

Pra, politika sovjetike ndaj «miqve» s'ka asgjë miqësore, ajo është miqësi ujqish, është politikë imperialiste e veshur me parulla të rreme sociale, që nuk i beson kurrkush. Kur politika shoviniste imperialiste e revizionistëve sovjetikë është e tillë në drejtim të shteteve që quhen sovraane, mike dhe socialiste, merret me mend çfarë natyre ka politika e klikës revizioniste sovjetike ndaj popujve të botës që luftojnë për liri e ndaj shteteve të tjera. Kjo sidomos kur faktor vendimtar në politikën imperialisto-revizioniste, sot është pushtimi i tregjeve botërore, ndarja e zonave të influencës, politika e aleancës sovjetiko-amerikane, frika dhe tmerrri revizionist i një ballafaqimi me armë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe si konsekuencë lëshimet dhe koncesionet nga ana e tyre në favor të imperializmit amerikan dhe në dëm të interesave jetikë të popujve. E gjithë kjo politikë tradhtarë e revizionistëve sovjetikë nuk mund të mbulohet, nuk mund të mashtrrojë as borgjezët që e mbështetin këtë politikë, pse llogaritin fitimet dhe humbjet.

Të ashtuquajturat ndihma ekonomike sovjetike janë zinxhirë skllavërie dhe shfrytëzimi. Kriza ekonomike në Bashkimin Sovjetik po shtohet dhe po thellohet, klika imperialiste që është në fuqi është e detyruar të investojë në vende të tjera dhe të ndjellë kapitale të huaja brenda vendit. Me këtë mënyrë revizionistët sovjetikë mendojnë të zgjerojnë perandorinë, të lidhen ngushtë me trustet e mëdha amerikane e botërore dhe të bien në ujdi për shfrytëzimin e mëtejshëm të botës. Revizionistët sovjetikë mendojnë se osmoza e kapitaleve dhe monopoli i armëve atomike janë dy mjetet që do t'i shpëtojnë nga kriza dhe nga luftërat. Por ata me këtë janë luftënxitës,

po thellojnë krizën, po përgatitin luftën e përgjakshme botërore tok me imperializmin amerikan. Asgjë nuk i shpëton revizionistët nga kriza dhe nga disfata.

Varri në Çekosllovakia u hap dhe qëndron i hapur. U hap një varr i dytë më i madh e më i rrezikshëm për ta: varri polak. Klika e Gierkut është një klikë e përkohshme që edhe po të luajë në dy tablotë nuk do të qëndrojë dot në fron. Sovjetikët duan në Poloni një klikë të tyren, të fortë, fashiste, që zor ta gjejnë. Pra do të ketë turbullira në perspektivë. Përpara kongresit sovjetikët u detyruan të heqin nga goja e tyre për t'i dhënë disa krodha Gierkut, i cili mban fjalime e bën premtime që zor t'i mbajë. Në kongres Brezhnjevi duhet të thotë diçka për të gënjyer, pse në çdo anë, politika e tij dhe e shokëve të tij po bën fiasko. Jemi larg muajit të mjaltit revizionist të «unitetit të çeliktë». Figura «miqsh» revizionistë të vrenjtur do të dalin të përshëndetin në kongres.

E MËRKURË
13 JANAR 1971

TË DËNOJMË KRIMIN E REAKSIONIT JORDANEZ KUNDËR POPULLIT PALESTINEZ

Kërkova të përgatitet një projekttelegram përgjigjeje Shoqatës së Miqësisë Palestinë-Shqipëri, për krimet që bëri reaksioni jordanëz mbi fedainjtë palestinezë.

E PREMTE
22 JANAR 1971

TË SHFAQIM QËNDRIMIN TONË TË DREJTË PA U PRISHUR ME MIQTË EGJIPTIANË

Porosita shokët të lajmërojnë delegatin tonë në Kongresin e Bashkimit Sindikal Panafrikan që të mos grindet me miqtë egjiptianë, organizatorë të këtij kongresi, të cilët nuk duan që në përshëndetjen tonë të atakohen revizionistët sovjetikë. Na pëlqen ose nuk na pëlqen qëndrimi i tyre, ne duhet t'i kuptojmë egjiptianët në këtë rast, sovjetikët janë «aleatë» të tyre. Ai të mos përshëndesë fare dhe të mos prishë miqësinë me egjiptianët. Të gjithë e njohin vijën tonë, por ka edhe forma të tjera për ta shfaqur atë që edhe egjiptianët të mos kenë kundërshtim.

**PROPAGANDA JONË TË JETË MË AKTIVE NË
NDJEKJEN E ZHVILLIMEVE POLITIKE NË KOSOVË
E NË JUGOSLLAVI**

Përsëri i kujtova shokut Ramiz që punonjësit e propagandës të ndjekin me kujdes zhvillimet politike në Kosovë, pse atje dhe në Federatën Jugosllave ngjasin çështje që propaganda jonë, brenda kuadrit të marrëdhënieve tona shtetërore, mund t'i trajtojë dhe t'u vijë në ndihmë shqiptarëve të Kosovës për të konsoliduar të drejtat e fituara dhe për të fituar të tjera.

RRËZIMI I GOMULKËS

Vladislav Gomulka, udhëheqësi kryesor revizionist i Partisë Punëtore të Bashkuar Polake dhe një nga kaporionët fashisto-revizionistë më në zë të revizionizmit modern, u rrëzua nga fuqia, u dëbua nga Byroja Politike e u pezullua edhe nga qenia e tij si anëtar i Komitetit Qendror. Tok me të theu zverkun edhe grupi i afërt i tij, i quajtur «grupi i Gomulkës».

Kjo duhet të konsiderohet një ngjarje me rëndësi të madhe kombëtare për Poloninë dhe ndërkombëtare për revizionizmin modern, pse është një **disfatë e bujshme politike, ideologjike dhe ekonomike e rrymës tradhtarë revizioniste, në përgjithësi, dhe asaj polake në veçanti.**

Tipari kryesor i kësaj disfate është se rrëzimi i kësaj klike nuk erdhi si rezultat i një «grusht pallati» nga brenda korrenteve revizioniste në parti, por nga grushti i fortë i punëtorëve të porteve, të kantierëve detare dhe të fabrikave të qyteteve të bregdetit polak si Gdansk etj. Punëtorët polakë të bregdetit dolën në rrugë, në demonstrata, me parulla revolucionare, me Internacionalen dhe me këngë revolucionare polake.

Karakteristikë e demonstratave ishte se nuk kishte parulla reaksionare. Kjo do të thotë se reaksioni polak u gjend në befasi, s'mundi të ndërhynte dhe të ngatërronte ujërat, pse proletariati polak në këto demonstrata i kishte radhët të shtrënguara.

Karakteristika e dytë e tyre ishte se nuk kishin pa-
rulla antisovjetike. Kjo, mundet, për arsye që të mos
shkaktonin ndërhyrjen e ushtrisë sovjetike dhe, pra, go-
ditjen me armë me të dhe, si rrjedhim, pushtimin e
Polonisë, siç u bë me Çekoslovakinë, mundet dhe për
shkak të marrëdhënieve ekonomike të shumta me Bash-
kimin Sovjetik.

Grevat madhështore të punëtorëve të bregdetit polak
nuk ishin as spontane, as të rastit, as për arsyen e ngrit-
jes së çmimeve, që ndërmori ato ditë klika e Gomulkë-
-Ciriankieviçit, siç thuhet. Ato ishin shprehje politiko-
-ideologjike e urrejtjes së klasës punëtore polake kundër
klikës revizionisto-fashiste në fuqi, ato ishin me karakter
të theksuar revolucionar. Çështja e ngritjes së çmimeve
mund të themi se është vetëm një pretekst.

Fakt është se dalja në rrugë e proletariatis i tme-
rroi revizionistët polakë, me klikën e Gomulkë-Ciriankie-
viçit në krye, tmerroi reaksionin polak, tmerroi kishën
polake, tmerroi revizionistët sovjetikë, valetë e tyre dhe
reaksionin botëror.

Klika e Gomulkës nuk pati tjetër mundësi për të
shtypur grevat e proletariatis revolucionar polak veçse
t'i quajë këto «huligane, rrugaçe, të shtyra nga imperia-
listët» etj., të qëllojë me armë dhe të vrasë e të plagosë
me qindra punëtorë. Atëherë filloi përlëshja në mes pu-
nëtorëve dhe vrasësve gomulkianë. U krijuan komitetet e
grevave dhe u konstatua se partinë e Gomulkës dhe or-
ganizatata e saj i likuidoi vala e kryengritjes. Këto nuk
vepruan asgjëkundi, kudo sundonin komitetet e grevave,
bile edhe disa ditë pas goditjeve me armë vazhduan zin-
xhir edhe në qytete të tjera bregdetare, ku klasa punë-
tore në grevë arriti të marrë dhe të mbajë me ditë edhe
pushtetin politiko-administrativ.

Klasa punëtore polake u tregua e patrembur. Ajo
nuk u tremb nga vdekja, por marshoi përpara. Edhe pasi

i qëlluan, edhe pas vrasjeve, grevat zinxhir u zhvilluan
edhe në qytetet e tjera të bregdetit, pra, ishte rrezik
të merrte zjarr gjithë Polonia.

Përpara një situatë të tillë të frikshme revizionistët
polakë, për të evituar të keqen e madhe, rrëzuan Gomul-
kën dhe klikën e tij dhe sidomos morën masa të rrepta
që të izolonin bregdetin nga pjesa tjetër e Polonisë, si-
domos nga Varshava, ku, sipas njerëzve tanë, u morën
masa të rrepta me polici dhe me ushtri se mos u ngjiste
gjë. Por, megjithëkëtë, gjithë Polonia u drodh dhe revi-
zionizmi modern pësoi një nga disfatat e tij më të mëdha.

Kisha polake po dredhon. Me anë të Vishinskit bëri
thirrje për durim e qetësi, bile shkoi aq larg sa të thoshte
se «dhe ai vetë, edhe kisha, kanë bërë gabime dhe janë
fajtorë» për shkaqet që ndodhën. Lidhjet e ekipit të Gie-
rekut, që zëvendësoi Gomulkën, me kishën, po përmirë-
sohen haptazi. Qeveria polake po i kthen tokat kishës,
po ndërton monumentet fetare, po flet me simpati për
politikën ndërkombëtare të Vatikanit.

Revizionistët sovjetikë pësuan një disfatë të madhe,
jo lehtë të riparueshme, por ata u shqetësuan shumë se
mos detyroheshin të ndërhynin me armë dhe se, po të
ndërhynin si në Çekoslovakë, do të goditeshin. Prandaj,
jo vetëm që u vunë në gatishmëri ushtarake për çdo
eventualitet, por, duke parë se proletariati i bregdetit
polak e dogji kartën «Gomulka», revizionistët sovjetikë
shpejtuan dhe e hodhën poshtë «mikun» e tyre Gomulkë.
U kapën pas mikut të ri nga i cili kërkojnë besnikëri
ndaj aleatit, Bashkimit Sovjetik, pa të cilin Polonia, sipas
sovjetikëve, s'mund të rrojë dhe kërkojnë po ashtu që
partia revizioniste polake «të vazhdojë të jetë në fuqi dhe
të mos ngjasin ato që ngjanë në Çekoslovakë, përndryshe
preken interesat e Bashkimit Sovjetik e të kampit të
socializmit» etj., etj.

Të gjitha këto grupi i Gierekut i pranoi, i prokla-

moi; këto i pranoi *de facto* kisha, i pranoi *de facto* reaksioni botëror, i cili gati nuk flet fare për ngjarjet polake. Ç'të flasë, ato ishin në disfavor të tij dhe tash të gjithë po përpiqen të gënjejnë popullin polak dhe, në radhë të parë, klasën punëtore.

Po me se ta gënjejnë? Gierëku asgjë konkrete s'bën, veçse «premtion» në rast se «punohet». Ai s'ka asnjë program të ri, ai ecën me programin e vjetër të Gomulkës, ai eviton hëpërhë të ballafaqohet me punëtorët dhe veçanërisht me ata të porteve, të cilët vazhdojnë të jenë në lëvizje dhe në gjendje kurdoherë revolucionare. Situata në Poloni është e mbarsur me revolucion. Të shohim ç'rugë do të marrë. Punë e madhe e pret Partinë Komuniste të Polonisë dhe Partinë tonë për të demaskuar revizionistët modernë dhe për të ndihmuar me të gjitha forcat tona revolucionarët në këto vende dhe kudo.

E MËRKURE
3 SHKURT 1971

TË MBROJMË TEZAT E KOSOVARËVE RRETH NDRYSHIMIT TË KUSHTETUTËS

Bisedova me Ramizin për problemin jugosllav dhe, veçanërisht atë kosovar, konkretisht për diskutimin që po bëhet tash në lidhje me ndryshimet në kushtetutë dhe në format e drejtimit të vendit. Çështja qëndron që ne, me anë të shtypit dhe të radios, natyrisht, pa ndërhyrë në punët e brendshme të Jugosllavisë, të mbrojmë tezat e kosovarëve.

**E PREMTE
5 SHKURT 1971**

DY KOZMONAUTË AMERIKANË ZBRITËN PËRSËRI NË HËNË

Sot në orën 10.20, me orën tonë, kabina hënore e anijes kozmike amerikane «Apolo-14», me dy njerëz brenda, zbriti në Hënë. Kozmonauti i tretë qëndroi në «Apolo» dhe po vjen rrotull Hënës, duke pritur dy të tjerët, derisa të mbarojnë misionin e tyre në Hënë dhe të ngjiten përsëri në anijen kozmike, për t'u kthyer në Tokë. Edhe ky është një sukses i madh shkencor, megjithëse prej tij përfiton imperializmi amerikan, i cili dje dërgoi më se 40 mijë veta në Kamboxhia e në Laos, në mes tyre 10 mijë ushtarë amerikanë.

**E MËRKURË
10 SHKURT 1971**

TAKIM ME KAZHIMIEZH MIJALIN

Prita Kazhimiezh Mijalin, i cili më foli për ngjarjet e fundit në Poloni, për rolin e Partisë Komuniste të Polonisë në to dhe për punën e saj në perspektivë.

E falënderova, i thashë mendimin e Partisë sonë për ngjarjet, mendime që puqeshin me të tijat dhe e sigurova për solidaritetin tonë me lëvizjen e punëtorëve në luftë kundër revizionistëve polakë në fuqi.

**INVADIMI I LAOSIT NGA
AMERIKANO-SAJGONEZËT, REZULTAT I POLITIKËS
TRADHTARE TË REVIZIONISTËVE SOVJETIKË
E VIETNAMEZË**

Më tepër se 40 mijë forca të huaja ushtarake invaduan Laosin. Agjencitë e ndryshme të lajmeve thonë se 30 mijë janë ushtarë të kukullave të Sajgonit dhe 10 mijë ushtarë dhe oficerë amerikanë. Qëllimi i tyre është të zgjerojnë fushat e agresionit, të «vietnamizojnë» luftën, të godasin rrugën «Ho Shi Min», që kalon nga Laosi dhe shërben për furnizimin e luftës nacionalçlirimtare të Vietnamit të Jugut. Hyrja e forcave ushtarake amerikano-sajgoneze në Laos ka, gjithashtu, për qëllim kryesor të dobësojë luftën çlirimtare në Vietnamin e Jugut, luftën partizane në Kamboxhia dhe në Laos dhe të arrijë t'i lidhë e t'i konsolidojë disi «ballistët» e Indokinës nën drejtimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kundër popujve të të dyja pjesëve të Vietnamit, Kamboxhias, Laosit dhe Tajlandës.

Në këtë mënyrë imperializmi amerikan po futet më thellë në humnerën e luftës dhe, me siguri, do të pësojë disfata të mëdha. Për të nuk mund të ketë më asnjë shpresë. Sa më thellë ai shkallëzon e zgjeron agresionin, aq më e shpejtë dhe e pashmangshme bëhet disfata për të dhe për kukullat e tij. Goditjet që ai po bën nga zori, nga gjendja e vështirë ku ndodhet, nuk janë veçse disa

përpjekje sporadike e pa shpresë. Imperializmi gjakatar amerikan nuk mund t'u rezistojë luftërave popullore. Bombardimet e tij nuk patën sukses për tre vjet me radhë kundër Republikës Demokratike të Vietnamit, aq më pak ato do të kenë sukses kundër fshatrave dhe njësiteve partizane, që zhvillojnë luftime të ashpra e të pandërprera në pista aeroportesh e në xhungla.

Sidëcoftë operacionet në Laos dhe në Kamboxhia amerikanët po i shoqërojnë me rifillimin e bombardimeve në Vietnamin e Veriut. Ata njoftuan, gjithashtu, zbarkimin e forcave të reja amfibe në paralelin 17, gjoja për të përforcuar kufirin në mes të dy Vietnamëve dhe për të mos lejuar që forcat «ushtarake» verivietnameze ta kapërcejnë atë dhe t'u vijnë në ndihmë forcave në Jug.

Në dritën e zhvillimit të këtyre ngjarjeve duhet shikuar edhe ana tjetër e medaljes: tradhtia e madhe dhe e vazhdueshme e revizionistëve sovjetikë, bashkëpunimi i tyre i fshehtë dhe i hapët me imperializmin amerikan për çështjen vietnameze.

E gjithë politika dhe të gjitha përpjekjet e revizionistëve sovjetikë ishin vënë në lëvizje për ta shuar luftën çlirimtare vietnameze, për të bërë që vietnamezët të kapitullonin përpara amerikanëve dhe të hynin në kompromise e në bisedime me njëri-tjetrin. Është fakt se në Hanoi klika tradhtare proamerikane e Kremlinit kishte një mbështetje të fortë revizionistësh vietnamezë, të lodhur nga lufta dhe të prirë për të bërë lëshime serioze në dëm të luftës nacionalçlirimtare. Me keqardhje për popullin që luftonte, duhet thënë se revizionistët vietnamezë iu futën kësaj rruge me besim të madh se do t'ia arrinin «qëllimit shpëtimtar» që kishin kurdisur në ujdi me tradhtarët e Moskës.

Si rezultat i shumë tratativave të fshehta sovjetiko-amerikano-vietnameze (Hanoi), amerikanët, si me thënë morën njëfarë angazhimi dhe ndaluan bombardimet në

Vietnamin e Veriut. «Fitore e madhe u arrit», gërthitnin sovjetikët e revizionistët vietnamezë. Ata kujtuan se «zënë qiellin me dorë», se çdo gjë tash do të realizohej sipas dëshirës së tyre dhe plani i fshehtë do të fillonte të zbatohej me lehtësi, derisa amerikanët «me vullnet të mirë» të linin Vietnamin. Kështu veri dhe jugvietnamezët u futën me zell të madh në rrugën oportuniste të tratativave e të bisedimeve me amerikanët. Këto tratativa që filluan në Paris, ata i trumbetonin si një sukses të madh të «politikës tej pamëse marksiste-leniniste» të tyre, si një «taktikë dhe strategji lufte gjeniale», si «pjesë përbërëse të luftës së armatosur». «Ne do të vazhdojmë luftën në fushat e betejës, — thoshin ata, — se vetëm ajo do të na japë fitoren, por njëkohësisht ne zhvillojmë edhe bisedime në Paris, në të cilat nuk kemi asnjë besim, por i bëjmë me qëllim që duke biseduar (!) të dobësojmë e të demaskojmë imperializmin amerikan, të dobësojmë pozitat e Xhonsnit e të Niksonit».

Kjo ishte parada. Mendimet tona të kundërta që u shfaqnin për këto bisedime, ata jo vetëm që nuk i pëlqenin, por, linin të kuptohej se ne gjykonim me gjaknxehtësi dhe me *parti pris* për goditjet tona dhe për demaskimin e hapët që u bënim qëllimeve të revizionistëve sovjetikë dhe të amerikanëve.

E vërteta është se udhëheqësit veri dhe jugvietnamezë kishin më shumë besim në bisedimet e Parisit sesa në zhvillimin e vendosur e të rreptë të luftës në fushat e betejës. Ata bënë plane pas planesh dhe propozime me një mori të tërë pikash. Nga ana e tij Niksoni lëshonte, gjithashtu, deklarata e propozime por ky që më i kursyer në numrin e pikave. Mbi tryeza e në shkresa nxeheshin debatet akademike, kurse në terren shuhej e sabotohej lufta e popullit.

Fakt është se gjatë këtyre të famshmeve bisedime lufta partizane u ngadalësua, u pakësua presioni në Jug

kundër amerikanëve dhe ushtrisë së Sajgonit. Më pas revizionistët vietnamezë na thanë se «tash lufta do të marrë një karakter tjetër, do të godasim me njësitë e vogla dhe do të lakmojmë sidomos oficerët amerikanë». Me fjalë të tjera, udhëheqësit revizionistë filluan ta bëjnë fërtele e ta shpërndajnë në njësitë të vogla ushtrinë nacionalçlirimtare vietnameze. Niksoni ndërkohë bënte punën e vet duke deklaruar se gjoja do të tërhiqej nga Vietnam dhe se do t'i linte vietnamezët të luftonin kundër vietnamezëve. Për të gënjyer opinionin amerikan, ai hoqi nga Vietnam i Jugut edhe një kontingjent minimal forcash.

E gjithë kjo manovër ishte në favorin e amerikanëve dhe për ta çdo gjë vazhdonte e vazhdon si më parë. Përse? Imperialistët amerikanë kishin nevojë për një kohë qetësie dhe këtë e fituan. Gjatë kësaj kohe duke u fryrë llomotitjeve e pallavrave të kota, ata riorganizuan, stërvitën dhe shtuan ushtrinë e Sajgonit në një mënyrë të atillë që ajo, jo vetëm nuk rrezikohet aq shumë nga sulmet partizane brenda në Vietnam, po tashti është në gjendje të dalë me 60-70 mijë veta jashtë Vietnamit, të sulmojë Kamboxhian e Laosin dhe të godasë partizanët e të rrezikojë rrugët e tyre të furnizimit në Jug.

Ky është rezultati i politikës tradhtare të revizionistëve sovjetikë dhe i shërbëtorëve të tyre — revizionistëve vietnamezë.

ÇEN PO TAJA DËNOHET SI TRADHTAR

Shokët e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës na komunikuan zyrtarisht se «Çen Po Taja u deklarua tradhtar». Na numëruan për këtë çështje një varg arsyesish që fillojnë nga viti 1925, nga të cilat më kryesoret janë: «Ka qenë anëtar i Guomindanit; në atë kohë ka pasë shkruar artikuj kundër Partisë Komuniste të Kinës, në të cilët e ka quajtur partinë syleshe në politikë; ka ndjekur këmba-këmbës Van Minin, kur ky ka qenë sekretar i përgjithshëm; kur ka shoqëruar Maon në Moskë, në vitin 1950, për tri ditë rresht nuk e ka mbajtur në korent se ç'bënte; ka kundërshtuar tezën që Maoja e mbronte, se pushteti del nga gryka e pushkës; ka qenë trockist, ka qenë me Pin De Huanë e me Liu Shao Çinë, ka redaktuar librin «e famshëm» të këtij të fundit dhe e ka dërguar të shtypet në organin e Komitetit Qendror të Partisë, «Flamuri i kuq»; ka qenë për «grupet e punës», pastaj ia hodhi fajet Liut; ai është përpjekur të përçajë kuadrot e ushtrisë dhe t'i vërë njërin kundër tjetrit (në kohën e Revolucionit Kulturor); ka qenë në prapaskenë, në organizatën kundërrevolucionare të majit nr. 516, që kërkonte të rrëzonte një pjesë të udhëheqjes» etj., etj.

Dhe me të gjitha këto, ai konsiderohej «një udhëheqës i shquar», «teoricien i madh», «shok i ngushtë i Mao Ce Dunit e i Lin Biao», «shok vigjilent», «sekre-

tar i posaçëm i Maos» etj. Të gjitha këto epitete në drejtim të tij, nuk janë tonat, por janë fjalë të Maos, të Lin Biao, të Çu En Lait e të Kan Shenit që u janë thënë shokëve tanë, anëtarë të Byrosë Politike, kur kanë shkuar në Kinë dhe u kanë paraqitur Çen Po Tanë.

Nga ana tjetër, Çen Po Taja, që kur filloi Revolucionin Kulturor dhe deri sot, zyrtarisht ishte i njohur si një nga udhëheqësit kryesorë aktivë pas Maos, bile para Kan Shenit, pale përpara Çu En Lait, i cili nuk bënte fare pjesë në këtë komitet udhëheqës. Pra, menjëherë, pas gjithë këtyre lëvdatave dhe detyrave të mëdha, ai deklarohet tradhtar!

Bëjmë pyetjen: Ç'politikë kuadri është kjo? Ne nuk mund të bindemi se nuk dihej aktiviteti i Çen Po Tasë, nuk dihej që ky i përkrahte hapur Van Minin, Pin De Huanë, Liu Shao Çinë etj. Atëherë përse mbahej akoma si sekretar i Maos dhe ca më keq, si është e mundur që ky oportunist, trockist etj., etj., të vihej në krye të Revolucionit Kulturor që pikërisht ka për qëllim spastrimin nga rrënjët të të tillë njerëzve? Si është e mundur që tamam kur zien ky revolucion Çen Po Tasë i bëhen kaq shumë elozhe nga udhëheqësit kryesorë kinezë në sy të shokëve tanë?

Kjo situatë është e pakonceptueshme për ne. Një politikë e tillë, domethënë të marrësh armiqte, t'i vësh në krye, t'i mburrësh dhe pastaj t'i demaskosh, sikur edhe tepër makiaveliste të jetë, nuk mund të kuptohet.

A është Çen Po Taja armik e tradhtar? Kjo natyrisht është një çështje që s'e përcaktojmë dot ne. Partia Komuniste e Kinës e ka këtë kompetencë për të gjykuar në bazë të fakteve, të të dhënave dhe të interpretimit të drejtë dhe objektiv të tyre në rrugën dialektike marksiste-leniniste, por në bazë të atyre që thashë më lart te ne lindin dyshime të mëdha.

Të supozojmë se ky njeri kishte veprimtari armiqë-

sore të fshehtë dhe kjo nuk dihej e u zbulua tash së fundi, por e vërteta është se veprimtaria e tij dhe bashkëpunimi i ngushtë e trockist me armiqtë që njiheshin, që u demaskuan e u dënuan, si Van Mini, Pin De Huai, Liu Shao Çia, ishin publike, të hapëta e të njohura. Atëherë, pyesim përsëri, si u vu ky njeri të drejtonte Revolucionin e Madh Kulturor Proletar dhe të ishte udhëheqësi kryesor i tij pas Maos dhe Lin Biaos? Kjo është e errët, shumë e errët.

Më kujtohet ç'na raportoi Hakiu, kur u kthye nga Kina, në lidhje me Çen Po Tanë, që ishte caktuar ta shoqëronte në vizitat që bëri në provinca të ndryshme të Kinës. Çen Po Taja u soll jashtëzakonisht mirë, shumë i dashur, korrekt, dashamirës dhe admirues i madh i Shqipërisë, i Partisë sonë dhe i popullit shqiptar. Hakiu vuri re edhe kritikën e drejtë që Çen Po Taja u bënte, në sy të Hakiut, kuadrove kinezë për punën, vuri re, gjithashtu, një pakënaqësi të madhe të Çu En Lait ndaj Çen Po Tasë, të cilën ai e shprehu hapur, kur Çen Po Taja la mbledhjen kur fliste Çu En Lai, duke thënë: «Nuk e ndiej veten mirë».

Tash i shpjegojmë më mirë qëndrimet e poshtra të Li Hsien Nienit ndaj Hakiut dhe përgjithësisht shumë të ftohta ndaj të gjithëve, kur ai erdhi për festën tonë të Çlirimit. Ai, siç duket, donte të na thoshte neve se shokët kinezë «nuk janë dakord me qëndrimet e Hakiut dhe me miqësinë që u tregua ndaj Çen Po Tasë». Kjo është shumë e poshtër. I marrshin të keqen Hakiut, i cili u soll ashtu si duhej. I poshtër është veprimi i tyre, që, për të shoqëruar shokun e Byrosë Politike të Partisë motër, dërgojnë një udhëheqës që po e përpunojnë si armik, dhe pastaj kanë paturpësinë të vijnë në vendin tonë e të na mbajnë mëri për një çështje të panjohur fare nga ne, bile, siç duket, që do ta kenë përpunuar në kokën e tyre vetëm Çu En Lai dhe Li Hsien Nieni.

Kur do të mbarojë dhe si do të mbarojë kjo rrëmujë e madhe në Kinë, kjo natyrisht është shumë preokupante për ne, se rëndësia e Kinës është e madhe për revolucionin proletar botëror, për komunizmin. Do të fitojë oportunizmi i maskuar apo marksizëm-leninizmi?

Unë mendoj se, nën hijen e ideve të Mao Ce Dunit, ndeshen ashpër grupe të fuqishme, që herë konformohen, herë dalin mbi ujë, herë godasin, herë goditen; bëhet luftë për pushtet, për konsolidim të pozitive, kush e kush të ngrejë më shumë e më lart emrin e Maos, të reklamojë idetë e tij dhe të bëjë, nga ana tjetër, me mjeshtëri të madhe punën e vet, të vendosë njerëzit e tij, të zërë pozitën kyç, të bëhet absolutisht «i nevojshëm», «i paprekshëm», «i pakritikueshëm».

Çdo kritikë objektive kundër fraksionit kryesor përnjëherë hidhet në planin e punës armiqësore, të qëndrimit armiqësor «kundër kryetarit Mao»; çdo gjest, çdo fjalë analizohet nën këtë prizëm dhe hapen defterët e vjetër që janë plot, gati për të gjithë, se Partia Komuniste e Kinës gjatë gjithë jetës së saj 50-vjeçare ka kaluar përmes një lufte të pareshtur fraksioniste, në të cilën kuadrot janë përzier, janë përlyer, janë ndrequr ose janë dënuar.

Sidoqoftë, një gjendje e tillë është veçanërisht shqetësuese për Partinë tonë, se ne nuk jemi nga ata që u themi «amin» atyre që s'janë në rrugë të drejtë ose që nuk na japin fakte të plota bindëse për ato probleme mbi të cilat duan të na bindin, pa na vënë në korent plotësisht.

Ne kemi konstatuar, po ashtu, se udhëheqja kineze është tepër e ndjeshme ndaj reagimeve tona, të cilat kurdoherë kanë qenë dhe vazhdimisht do të jenë të matura, gjakftohta e të dreita. Interesat tanë të përbashkët janë të mëdhenj dhe ne do të përpigemi e kurrë nuk do të lejojmë që të mos zhvillohen në rrugë të drejtë marksiste-leniniste.

RIHAPJA E KANALIT TË SUEZIT

Kanali i Suezit, duke u bazuar në zhvillimin e situatës në Lindjen e Mesme, si duket do të hapet¹. Sigurisht do të bëhen akoma pazarllëqe, tratativa, diskutime në OKB dhe jashtë OKB-së, me Jaringun e pa Jaringun, me Titon dhe pa Titon etj. Hapja e kanalit të Suezit do të bëhet pa asnjë dyshim në dëm të Egjiptit dhe në favor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Izraelit. Egjipti do të kapitultojë në këtë veprim dhe do të shkojë duke i bërë lëshime të njëpasnjëshme Izraelit në kuadrin e përfitimeve të imperializmit amerikan në Lindjen e Mesme.

Borgjezia egjiptiane është e dobët politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht. Ajo nuk është në gjendje të sulmojë Izraelin dhe të çlirojë tokat e saj të pushtuara, për të mos thënë për t'i ardhur në ndihmë popullit palestinez që të fitojë të drejtat e tij të ligjshme. Propagandë dhe llafe bombastike do të lëshojë vazhdimisht El Sadati, po ai vazhdimisht do të lëshojë në dëm të sovranitetit të Egjiptit.

Sovjetikët i kanë hedhur Egjiptit thonjtë në grykë dhe nëpërmjet tij përpiqen të forcojnë ndikimin dhe sundimin e tyre në vendet arabe, veçanërisht në Siri, në Libi dhe në Sudan. Në të ashtuquajturën federatë me të katër këto vende, ku Egjipti përpiqet të sundojë, orvatet edhe sovjeti të sundojë nëpërmjet tij.

¹ Kanali i Suezit u rihap më 5 qershor 1975.

Çështja e «luftës me Izraelin» është një atë «e mrekullueshme» për sovjetikët, të cilët po e shfrytëzojnë fort këtë kartë. Armët që i japin Egjiptit dhe që i kontrollojnë mirë, janë vetëm armë mbrojtjeje dhe jo sulmi, kurse Izraeli, jo vetëm ka përgatitje të mirë për luftë, por armët e tij janë armë ofensive dhe mbrojtjeje dhe ai e luan bukur letrën e kërcënimit për luftë, e bën Egjiptin të kapitultojë dhe sovjetikët të kenë frikë nga një ballafaqim me armë me amerikanët, ose edhe me Izraelin se u sjell vështirësi të mëdha politike, ekonomike dhe ushtarake. Prandaj sovjetikët janë jo për ngatërresa luftarake në Lindjen e Mesme, po për ujdi, aq u bën atyre pse këto janë në kurriz të Egjiptit. Sovjetikët janë artizanët kryesorë të lëshimeve egjiptiane dhe të sakrifikimit të interesave jetikë të popujve arabë dhe, veçanërisht, të popullit palestinez. Ata duan paqe me çdo kusht në Lindjen e Mesme, që të konsolidojnë pozitën e fituara dhe, duke shpëtuar ndërlikimet me amerikanët, të ruajnë dhe të konsolidojnë më tej aleancën me ta.

Sa për luftën nacionalçlirimtare të palestinezëve, sovjetikët, si çdo luftë çlirimtare, duan absolutisht ta likuidojnë, të çarmatosin partizanët palestinezë dhe t'i dëbojnë këta nga tokat e tjera arabe, t'i futin në Izrael nën zgjedhën e Izraelit dhe atje gjoja të vazhdojnë luftën partizane, nga brenda.

E tillë është teoria e sovjetikëve dhe e egjiptianëve, që sundohen prej tyre. Flet El Sadati, po vullneti është i Brezhnjev. Sovjetikëve u intereson hapja e kanalit për çështje ekonomike, ushtarake dhe politike. Ai do të bëjë në kanal ligjin e shoqërisë së kanalit të Suezit. Por hapja e kanalit është zgjatja edhe për shumë kohë nga Izraeli i fitoreve të tij dhe i konsolidimit të mëtejshëm të këtyre, është zhvillimi dhe zbatimi i pafund i llogjeve e i bisedimeve.

Çelja e kanalit u intereson Francës, Italisë, Greqisë, me një fjalë të gjitha vendeve kapitaliste të Evropës; kjo u intereson ekonomikisht, por edhe ushtarakisht, pse kanë shpresë dhe mund të jetë një klauzolë e fshehtë e amerikano-sovjetikëve që Mesdheu të lehtësohet nga flota sovjetike. Prandaj këto shtete bëjnë presion te Shtetet e Bashkuara të Amerikës që të hapet kanali i Suezit, gjë që edhe ato e duan shumë. Sigurisht këtyre u intereson që flota sovjetike të shpërndahet në dete e në oqeanë dhe të mos përqendrohet një pjesë e mirë e Flotës së Detit të Zi në Mesdhe, rreth brigjeve të Afrikës. Shteteve të Bashkuara të Amerikës u intereson që kjo flotë të dalë në Oqeanin Indian dhe në Paqësor, larg bazave të furnizimit dhe të remontit dhe sa më afër Kinës, për ta shqetësuar këtë dhe për ta lehtësuar flotën amerikano-angleze ta godasë në rast konflikti. Por, në koniunkturat aktuale, qenia e flotës sovjetike në Mesdhe është një kërcënim për anëtarët e NATO-s, veçanërisht për të gjitha ato vende që lag Mesdheu. Pra, Shtetet e Bashkuara të Amerikës e përdorin këtë gjendje si një mjet shantazhi të fortë kundër tyre, për t'i mbajtur të lidhur dhe nën drejtimin e vet. Kështu që çelja e kanalit të Suezit, pronë e Egjiptit, është bërë një gur shahu, që ky nuk e lëviz në interesin e vet, por e lëvizin sovjetikët dhe amerikanët në interesin imediat dhe perspektiv të tyre.

Natyrisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përveç sa thashë më lart, synojnë, në radhë të parë, të forcojnë pozitat e tyre sunduese në Lindjen e Mesme, të sigurojnë naftën dhe ta kenë rrugën të hapët për t'u zgjeruar në Afrikë.

Objektivat e amerikanëve janë që t'i minojnë seriozisht, në mos t'i eliminojnë plotësisht pozitat e fituara nga sovjetikët në Afrikë dhe në Lindjen e Mesme. Prandaj, buzëqeshja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

ndaj RAB-it, tash, në zhvillimin e këtyre përpjekjeve dhe, akoma më shumë, më vonë, do të shtohen. Shtetet e Bashkuara e përdorin Izraelin si kobure, që e shkrepin kur të duan pa djegur drejtpërdrejt duart dhe Izraeli është ushtruar, është organizuar për luftë, është edukuar me një frymë agresive fashiste të atillë që nuk mund të rrojë jashtë rregullave të një jete banditeske. Izraeli ka gjetur edhe padronët, edhe partnerët e përshtatshëm. Natyrisht, në këto situata, kur në Lindjen e Mesme sundojnë këto dy superfuqi imperialiste, të cilat kanë hyrë thellë në jetën dhe në drejtimet e vendeve të ndryshme arabe, hëpërhë është zor që Shtetet e Bashkuara, Izraeli dhe sovjeti të ndodhen përballë një koalicioni popujsh arabë që t'u bëjnë ballë dhe t'u prishin planet.

Populli egjiptian dhe gjithë popujt arabë po tradhohen paturpësisht nga klikat udhëheqëse në fuqi, të cilat kanë fituar një shkathtësi të veçantë të tradhtojnë popujt e tyre, të ndërrojnë padronë sikur ndërrojnë këmbishë dhe të tregohen «nacionalistë të tërbuar», por, kur vjen puna ta tregojnë këtë «nacionalizëm», ky nuk është veçse një kamuflim i agjenturës borgjeze vendëse, që i ka shitur e i shet interesat e atdheut e të popullit në çdo moment.

Popujt arabë duhet të luftojnë me armë në dorë, për lirinë e tyre, që e kanë humbur, që në fakt nuk e kanë, pavarësisht nga aparenat e gënieshtërtë. Popujt arabë duhet të organizojnë luftën kundër pseudoaleatëve sovjetikë dhe atyre që i sollën këta në vendet e tyre dhe u shitën atdheun dhe shpirtin. E tërë kjo vitë e drejtë, që siguron të ardhmen me të vërtetë të lirë dhe sovranë për ta, nuk mund të arrihet veçse me armë, duke luftuar kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Izraelit dhe gjithë aleatëve të tyre, të hapët e të fshehtë. Fitorja nuk do të vijë pa sakrifica të mëdha dhe pa humbje e disfata të tjera. Po lufta e armatosur dhe disfatat do të sjellin

edhe fitoren e madhe e përfundimtare, fitoren e popullit dhe jo atë të klikave. Tash klikat duan të zgjatin jetën e tyre me kompromise me armiqtë e popujve. Këto klika të brendshme janë armiq të popujve, janë, pra, aleate të njërës o të tjetrit armik të jashtëm të popujve. Vetëm lufta e drejtë popullore nxjerr në shesh kalbëzimin e tyre, ajo sjell në fuqi e në drejtim popullin dhe njerëzit besnikë të tij, lufta krijon organizimin luftarak fitimtar, lufta krijon partinë e vërtetë të komunistëve, partinë marksiste-leniniste, pa të cilën nuk mund të shkohet në fitoren e plotë të revolucionit proletar, të socializmit dhe të popullit. Në këtë rrugë duhet të ecin dhe do të ecin popujt arabë.

E MARTË
23 SHKURT 1971

TAKIM ME AMBASADORIN E RI KINEZ

Prita ambasadorin e ri kinez Liu Xhen Hua. Pasi fola unë, ai më vuri në dijeni për çështjen e Çen Po Tasë. Në bazë të thëniesve të ambasadorit, ai del shumë i ngarkuar me «faje e krime të rënda».

Të gjitha kritikikat dhe demaskimet, sipas thënies së ambasadorit, ia ka bërë Maoja vetë dhe këto ia ka pasë bërë shumë herë, në kohën e duhur dhe në mbledhje. Këto gabime të rënda ky si duket i ka bërë dhe ka vazhduar punën armiqësore hapur dhe të maskuar. Por përsëri bëjmë pyetjen: Po të qe kështu pse e linin në këto funksione të larta? Kinezët i bëjnë këto gjëra me durim të çuditshëm.

MATIAS RAKOSHI — REVOLUCIONAR E KOMUNIST I SHQUAR

Dhashë udhëzime të botohet në «Zërin e popullit» një nekrologji e Matias Rakoshit, revolucionarit komunist të shquar hungarez, që vdiq në internim në Bashkimin Sovjetik dhe eshtrat iu varrosën fshehurazi, natën, në Budapest.

BUZËQESHJET POLITIKE TË JUGOSLLAVISË DHE TË BULLGARISË NDAJ NESH

Të dy këto shtete revizioniste (prapa bullgarëve fshihen padronët e tyre, revizionistët sovjetikë), me mënyrat e tyre diversioniste, përpiqen të na afrojnë kush e kush më shumë në anën e vet. Titistët luajnë kartën se revizionistët sovjetikë dhe këlyshët e tyre, bullgarët, kërcënojnë me invadim Jugosllavinë, pra edhe Shqipërinë, kurse revizionistët bullgarë luajnë kartën e «miqësisë së madhe me Shqipërinë», gjoja të njohjes, në parim nga ata, të gabimeve të Hrushovit, «të kthimit» të tyre në stalinizëm e demagogji të tjera të këtij lloji.

Fakt është se si Bashkimi Sovjetik, Jugosllavia titiste, ashtu edhe Bullgaria ndodhen në një krizë të rëndë politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake, në krizë të rëndë të brendshme dhe në arenën ndërkombëtare. Tradhtia ndaj marksizëm-leninizmit i çoi këto shtete në likuidimin, në vendet e tyre, e partive marksiste-leniniste, në likuidimin e rendit socialist, të diktaturës së proletariatit, në rivendosjen e regjimit kapitalist nëpërmjet reformave, të cilat nga ana e jashtme ishin gjoja të ndryshme, po në fakt kishin të njëjtën përmbajtje dhe të njëjtin qëllim me regjimin kapitalist. Kjo, natyrisht, çoi në krijimin, në këto vende, të një shtrese të re të borgjezisë burokratike, në organizimin e një superstrukture të përshtatshme për rendin e ri kapitalist, të kamu-

fluor me parulla demagogjike, të nevojshme e të domosdoshme për fazën e kalimit nga socializmi në kapitalizëm dhe për të gënjyer masat e punëtorëve dhe të popullit. Regjimet e reja kapitaliste, natyrisht, krijuan kriza të brendshme dhe ndryshime në politikën e tyre të jashtme. Krizat e brendshme dhe të jashtme, jo vetëm nuk mund të gjenin zgjidhje, por, do të thelloheshin, do të krijonin ndërlikime politike dhe ekonomike brendapërbrenda vendit, do të krijonin boshllëqe kolosale që do t'i detyronin t'u drejttoheshin, sikundër iu drejtuan, për ndihma politike dhe ekonomike, imperializmit botëror. Gjithashtu, do të krijonin vështirësi kushtetuese, probleme dhe konflikte nacionale brenda dhe, e ashtuquajtura aleancë e vendeve revizioniste, do të merrte plotësisht tiparet e një aleance të njëjtë me atë të vendeve kapitaliste. Kjo do të thoshte se Traktati i Varshavës nuk do të ishte më për realizimin e atyre qëllimeve, për të cilat edhe u krijua, por do të ishte një tjetër NATO, ku do të sundonte e do të bënte ligjin Bashkimi Sovjetik.

Pra, në të gjitha këto vende, në çdo gjë nuk ka stabilitet, nuk ekziston politikë parimore, as qëndrueshmëri politike, në çfarëdo fushë. Çdo gjë zgjidhet në bazë të interesave të klikave kapitaliste që sundojnë shtetin, çdo gjë kushtëzohet nga potenciali dhe sundimi i klikës e i klikave në udhëheqje mbi klikat e tjera brenda, në opozitë të hapët e të fshehtë, çdo gjë varet nga aleancat dhe nga interesat imediatë, ose të një kohe relativisht më të gjatë, që klikat në udhëheqje lidhin ose zgjidhin me fuqitë e tjera imperialiste. Kuptohet fare lehtë ç'lëkundje të tmerrshme ngjasin në ujërat imperialisto-revizioniste (të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik), ku noton barka jugosllave me të famshmin renegat të marksizëm-leninizmit, Titon.

Jugosllavinë titiste e ka marrë lumi. Ajo ndodhet në një kaos të madh, është një shtet tipik kapitalist, krej-

tësisht i falimentuar nga çdo pikëpamje, por që qëndron në këmbë, si shtet e si Federatë, për arsye të inercisë, të njëfarë tradite historike dhe veçanërisht për arsye të kontradiktave kapitaliste në mes NATO-s dhe Traktatit të Varshavës, për arsye të pozitave strategjike të saj, si rajon i rrezikshëm për t'u shkelur nga të dyja palët dhe për asnjë arsye tjetër.

Titoja dhe klika e tij ua kanë shitur Jugosllavinë imperializmit amerikan dhe kapitalistëve të tjerë. Natyrisht ata llogaritin se kjo gjë është një atë përforcuese e pozitave strategjike të Jugosllavisë në mes NATO-s dhe Traktatit të Varshavës.

Mirëpo, në një shtet të degjeneruar kapitalist si Jugosllavia, asgjë nuk është stabël, asnjë politikë nuk është parimore dhe asgjë s'mund të jetë e qëndrueshme. Politika dhe strategjia e Titos hasin në kundërshtimin e një opozite të fortë, legale dhe ilegale, të kryesuar nga kapitalizmi serbomadh, i cili në këto koniunktura gjen frymëzimin dhe mbështetjen e hapët dhe të fshehtë të revizionistëve sovjetikë.

Pra, klika titiste, duke qenë aktualisht në fuqi, përpiqet të forcojë pozitën e saj brenda mbi kundërshtarët dhe jashtë, karta kryesore vendimtare e saj, karta efektive, është aleanca me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo aleancë nuk afishohet në mënyrë të shthurur. Titoja, nën këtë maskë, luan rolin e një fuqie, bile të një fuqie kryesore «të forcës së tretë». Titoja, natyrisht, luan rolin e një udhëheqësi të pavarur nga Kremli, dhe, në fakt kështu është, por kjo gjë nuk i pëlqen Kremlini. Ky, brenda mundësive dhe koniunkturave, i bën Titos nga ana e vet presione dhe shantazhe. Titoja i përgjigjet sipas tonit të tyre, por asnjëherë nuk u është nënshtruar dëshirave ose kërcënimeve të revizionistëve sovjetikë, ai ka shfaqur dëshirat e tij dhe kërcënimeve të tyre u është përgjigjur me organizim mbrojtjeje ushtarake.

Pra, në këtë politikë të këtyre dy shteteve, ne vëmë re që marrëdhëniet herë acarohen, herë zbuten, herë keqësohen, herë përmirësohen. Të dy janë me thika në duar, të dy punojnë hapur dhe fshehtazi kundër njëri-tjetrit.

Opozita antititiste brenda punon edhe ajo, organizohet dhe përfiton nga këto koniunktura. Përkrahjen dhe shpresën kryesore ajo i ka në mbështetjen sovjetike, po nuk i pret urat me Perëndimin dhe sidomos me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo pret sidomos vdekjen e Titos për të vepruar më hapur. Klikat serbomëdha janë dhe kanë qenë kurdoherë armiq të betuar të pavarësisë së Shqipërisë, kanë qenë për aneksimin e saj dhe kanë praktikuar në të kaluarën dhe në kohën tonë shfarosjen e popullatës së shumtë shqiptare, që traktatet e vjetra imperialiste i lanë nën robërinë serbe.

Titoja ndoqi deri në fund me egërsi këtë politikë, por, kur hyri në konflikt me klikën serbomadhe të Rankoviçit, atëherë filloi të devijojë disi nga këto qëndrime. Ai e pa se me shqiptarët, qoftë me Republikën Popullore të Shqipërisë, me Partinë e Punës të Shqipërisë, qoftë me shqiptarët në Jugosllavi nuk mund të kishte fitore, përkundrazi konstatoi se Republika Popullore e Shqipërisë dhe Partia e Punës e Shqipërisë rezistuan heroikisht kundër tij, kundër imperialistëve të çdo ngjyre, kundër revizionistëve sovjetikë. Pra, politika e koniunkturave dhe forca e pamposhtur e Republikës Popullore të Shqipërisë, e bënë Titon që të ndërronte qëndrim ndaj nesh.

Ai filloi buzëqeshjet, arsyen e të cilave, qëllimet e, çfarëdo gjë tjetër, ne i kuptonim mirë. Ai kërkonte të miqësohej me ne në rrugën e tij revizioniste, kërkonte që në mos një shtet mik, të kishte te ne, të paktën, një shtet neutral. Në këto koniunktura, kur ishte prishur edhe me Rankoviçin, edhe me revizionistët sovjetikë, qëndrimet tona të forta atij i interesonin. Titoja shikonte se ne ishim të përgatitur dhe të vendosur të luftonim

deri në fitore kundër kujtdo qoftë që do të na sulmonte. Kjo, qëndresa jonë, nuk kishte si të mos ishte edhe në interesin e Jugosllavisë, në rast se kjo nuk bënte pjesë në grupet agresore eventuale kundër Shqipërisë. Pra, Titoja, që nuk është një injorant në politikë, në rast se Jugosllavia kishte në mend të luftonte dhe të mbrohej kundër agresorëve të saj, e kuptonte se Shqipëria socialiste nuk do të ishte kurrë në anën e agresorëve të Jugosllavisë, por do të ishte një shtet i fortë dhe mik, pavarësisht nga ndryshimet e regjimeve dhe të pikëpamjeve politike. Erdhi koha që këtë pikëpamje të drejtë tonën ne e bëmë të njohur zyrtarisht dhe popujve të Jugosllavisë e Titos kjo u erdhi mirë dhe për hosh. Ata panë edhe një herë se ne ishim të vendosur e parimorë dhe asgjë s'na trembte për të mbrojtur të drejtat dhe parimet.

Titoja, pra, shikonte se komunistët dhe populli shqiptar ishin dhe mbeteshin armiqtë e tij të betuar, politikë dhe ideologjikë, por ishin miq besnikë të popujve të Jugosllavisë dhe do t'i ndihmonin këta, në rast se do të sulmoheshin nga jashtë, në rast se do të rrezikoheshin liria dhe pavarësia e tyre.

Udhëheqja jugosllave pa se ne qëndronim të vendosur në parime, se luftonim dhe do të luftojmë me tërbim e pa pushim kundër imperializmit amerikan dhe social-imperializmit sovjetik.

Ne, duke e ndjekur me vëmendje politikën jugosllave, të brendshme dhe të jashtme, ecim me kujdes. Jugosllavët synojnë që të fshihet çdo gjë nga e kaluara e turpshme dhe armiqësore e tyre ndaj nesh dhe t'u përgjigjemi të gjitha «avancave» të tyre, që kanë për qëllim ngritjen e «prestigjit të tyre» gjoja si komunistë, që t'i thonë botës se «ja, edhe Shqipëria socialiste u dorëzua, erdhi në rrugën e Titos». Këtë ne nuk e hamë, nuk na gënjejnë buzëqeshjet e jugosllavëve. Ne zhvillojmë me ta

tregtinë, e përmirësojmë këtë në leverdi reciproke, bëjmë disa aktivitete të vogla me Federatën dhe i kemi zgjeruar shumë e do t'i zgjerojmë marrëdhëniet tregtare dhe sidomos arsimore e kulturore me Kosovën.

Kjo çështje për ne bëhet në rrugën e drejtë marksiste-leniniste dhe aspak shoviniste, por njëkohësisht fakt është se për Republikën Popullore të Shqipërisë, elementi shqiptar vëlla në Jugosllavi është elementi dhe populli më i vendosur e më besnik ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë, në kuadrin e popujve të Jugosllavisë. Këtë ne nuk e fshehim, këtë e dinë jugosllavët dhe nuk kanë si të mos e njohin dhe ta mbajnë parasysht.

Kush dëshiron të jetë mik me Republikën Popullore të Shqipërisë duhet të respektojë të drejtat e plota nacionale të shqiptarëve në Jugosllavi.

Pra, ambasadorët jugosllavë kudo u buzëqeshin tanëve, u japin «informata», «kritikojnë» revizionistët sovjetikë e bullgarë etj. Ministria e Jashtme e Jugosllavisë po atë punë bën, «na vë në korent» gjoja për çdo situatë, për qëndrimet e tyre në problemet e ndryshme dhe «fjalë të ëmbla» për qëndrimet e ndryshme tonat, asnjë reagim për çka botojmë ne kundër tyre, thonë vetëm sikur «të mos na sulmoni kaq fort, se përfitojnë armiqtë tanë të përbashkët», domethënë sovjetikët. Te këta vihet theksi më i madh nga ana e tyre dhe, që të na afrojnë më shumë, të gjithë i bien kësaj kambane, me të kremte dhe pa të kremte: «Jugosllavia kërcënohet seriozisht nga Bashkimi Sovjetik, Bashkimi Sovjetik do të sulmojë Jugosllavinë, Bashkimi Sovjetik kërkon me kërcënim portet jugosllave për të strehuar flotën e Mesdheut, po ne nuk ua dhamë» etj., etj.

Në këto, natyrisht, ka të vërteta dhe revizionistët e Moskës i bëjnë të tilla kërcënime, kur shohin se Titoja gjendet në vështirësi të mëdha brenda. Por është fakt se politika e tyre është e paqëndrueshme, aty kërcënohen,

aty pajtohen, aty marrin kredi e shkëmbejnë delegacione të panumërta e të çfarëdollojta, atje anije lufte sovjetike venë bëjnë vizita «miqësore» në portet jugosllave.

Revizionistët sovjetikë, përveç kërcënimeve të drejtpërdrejta, që me siguri u bëjnë revizionistëve jugosllavë, veprojnë edhe me anën e shërbëtorëve të tyre, revizionistëve bullgarë. Këta kërkojnë haptazi bashkimin e Maqedonisë me Bullgarinë. Kjo natyrisht i sjell vështirësi të mëdha të brendshme regjimit titist. Këtij shantazhi i shtohen edhe rivendikimet dhe demonstratat e fashistëve italianë në Trieste, të cilët kërkojnë korigjimin e kufijve të pasluftës së Dytë Botërore në mes Jugosllavisë dhe Italisë.

Kufijtë jugosllavë me Shqipërinë janë, pra, të qetë dhe të sigurt, pse Republika Popullore e Shqipërisë udhëhiqet nga një Parti marksiste-leniniste, se është një vend socialist, dhe, me gjithë padrejtësitë historike që i janë bërë në lidhje me Kosovën dhe me tokat e tjera shqiptare në Jugosllavi, ajo nuk kërkon t'i zgjidhë këto jashtë rrugës marksiste-leniniste, po në kohën e vet dhe në marrëveshje me vetë popullin shqiptar të Kosovës dhe me popujt e Jugosllavisë. Metodrat shoviniste, imperialiste e fashiste të revizionistëve bullgarë, sovjetikë dhe të fashistëve italianë nuk janë tonat, ne ato i urrejmë dhe i luftojmë.

Por në gjithë këtë situatë dhe në këto koniunktura, në gjendjen ku ndodhet Bashkimi Sovjetik, ne gjucojmë se nuk mund të sulmojë dot as Jugosllavinë, as ne. Edhe situatat aktuale të brendshme dhe të jashtme nuk ia lejojnë një aventurë të tillë, e cila, po të ndiqet, do të thotë të ndizet një luftë e tretë botërore. Imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik përgatiten për një eventualitet të tillë, por revizionistët sovjetikë, aktualisht, bëjnë çmos t'i evitojnë, për vete të tyre edhe këtë, edhe luftërat agresive lokale, siç po zhvillojnë amerikanët, pse edhe ajo «fletë fiku», që i mbulon, u bie.

Megjithatë agjuntura jugosllave përpigjet të na bindë ne se Jugosllavia është «në rrezik të sulmohet jo nga njëra anë, por nga të dyja anët».

Jugosllavët «miq» u thonë njerëzve tanë në konfidencë se këta muajt e fundit KQ i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë u ka dërguar organizatave një letër, gjoja shumë sekrete, prej 15 faqesh, për të cilën ka udhëzuar të mos mbahet asnjë shënim dhe në të, në substancë, thuhet se Jugosllavia do të sulmohet nga Bashkimi Sovjetik. Forcat bullgare do të sulmojnë Maqedoninë në drejtim të Serbisë Jugore. Njëkohësisht me këtë sulm dhe, për t'u mbrojtur, NATO-ja me forcat italiane dhe me Flotën e 6-të Amerikane do të sulmojë bregdetin jugosllav, bregdetin kroat e dalmat etj. Jugosllavët do të luftojnë nga të dy krahët dhe i vetmi aleat i fortë dhe besnik i saj është Shqipëria socialiste etj.

Kaq flitet në këtë «dokument», gjoja me kaq rëndësi strategjike, dhe nuk flitet për qëllimet e sovjetobullgarëve dhe të NATO-s kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Duket qartë që ky dokument, ku flitet se «shqiptarët janë trima, janë besnikë», është përgatitur apostafat që të na e sjellin neve në vesh. Kjo është një «krehje bishti», që përpigjet të na bëjnë nga ana e tyre titistët. Gjithashtu, këta dinë se ne nuk do të luftojmë kurrë krah për krah me imperialistët amerikanë kundër një imperializmi tjetër, në rast se të parët, gjoja u vijnë në ndihmë jugosllavëve për t'i «shpëtuar». Prandaj titistët nuk harrojnë që edhe tentativën e NATO-s ta quajnë agresion. Ne mbajmë shënime për çdo gjë, po nuk shkelim në dhogë të kalbur. Me kujdes dhe të matur bëjmë punën tonë në rrugën e drejtë marksiste-leniniste.

Kurse revizionistët bullgarë nga ana e tyre këndojnë tjetër këngë dhe lozin tjetër muzikë me ne, po shumë më të trashë. Kënga e tyre është si të pëlliturit e gomarit që dikush e nxit me hosten, në këtë rast sovjetiku.

Diplomatët, tërthorazi agjuntura bullgare, po na japin «mësim» se «jugosllavët janë të poshtër, ju i kishit njohur mirë, ne kishim gabuar në mendimet ndaj tyre, në Jugosllavi nuk ndërtohet socializmi, por kapitalizmi» etj., etj. Prandaj me fjalë të tjera «mbani qëndrimet e para, mos i përmirësoni marrëdhëniet me jugosllavët», por «i përmirësoni me ne», pse «ne bullgarët ju duam shumë, ju admirojmë, kemi bërë shumë gabime ndaj jush, por do t'i ndreqim. Hrushovi ka qenë i poshtër, ai na futi në qorrsohak. Udhëheqja jonë, me Zhivkovin në krye, është e poshtër, do ta rrëzojmë së shpejti, ne jemi stalinistë, me Dimitrovin. Të gjithë në Bullgari janë me Stalinin, me Dimitrovin, me Enverin e të tjerë. Po edhe në Bashkimin Sovjetik punët kanë ndryshuar dhe pas kongresit do të ndryshojnë më shumë. Siç e shihni kanë filluar të rehabilitojnë Stalinin, në kongres do të flasin më shumë, do të kritikojnë Hrushovin, do të flasin edhe për të përmirësuar marrëdhëniet me ju. Prandaj kini dhe pak durim dhe pranoni të bisedoni me përfaqësuesit sovjetikë» etj., etj.

Të tilla janë muzikat e bullgaro-sovjetikëve për të na zbutur, për të na afruar. Buzëqeshje revizioniste prej gomarësh.

Po ne nuk gënjehemi. Revizionistët sovjetikë përpigjen të mos i sulmojmë përpara kongresit të tyre, përpigjen të fillojnë një cikë bisedim, pastaj me kohë, me dredhi, me lajka mendojnë se do të pushojmë. Ata gabojnë si kurdoherë. Ne do t'i sulmojmë deri në shkatërrimin e tyre të plotë.

MBI LIBRIN «FUNDI I MISTERIT ETRUSK»

Lexova librin e ri të Majanit «Fundi i misterit etrusk». Majani deshifron gjuhën etruske me anën e gjuhës sonë. Kjo është shumë e bukur dhe do të na pëlqente që gjuha jonë të ishte kyçi i zgjidhjes së këtij problemi misterioz.

SHËNIM

Ramizi më dha përsëri një lajm të hidhur në lidhje me shokun polak Mijal, për të cilin mjekët dyshojnë se mund të ketë kancer në stomak. Këtë duhet ta vërtetojmë sa më parë, prandaj vendosëm, dhe Mijali është dakord (pa e ditur këtë dyshim), që të hënen që vjen të niset për në Kinë dhe atje, në klinikë të specializuar, të shikohet dhe t'i bëhen kurat. Por le të shpresojmë se nuk do të dalë ashtu,

SHËNIM

I ritheksova Ramizit se duhet përmirësuar metoda e përpunimit të artikujve kryesorë, duke u bazuar në fakte, dokumente dhe studime dhe jo në lajmet e kronikës së përditshme e sidomos në kronikën e zezë. Prandaj të ripunohen sa më parë artikujt kundër revizionistëve sovjetikë me rastin e Kongresit të 24-t të tyre.

SHËNIM

Vizitova shokun polak Mijal që do të niset të mërkurën për në Kinë për t'u kuruar. Jemi të shqetësuar për të se çfarë sëmundje do t'i dalë në tëmbël apo në stomak.

KONGRES REVIZIONIST

Po i dërgojmë gazetës «Zëri i popullit» artikullin me titull: «Një kongres revizionist për qëllime revizioniste» që ta botojë nesër. Me të «përshëndetim» Kongresin e 24-t të revizionistëve sovjetikë që do të mbledhet më 30 mars.

FORMULA GREKE PËR LIDHJEN E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME VENDIN TONË

Qeveria greke, nëpërmjet përfaqësuesit të saj të përshërshëm në OKB, Bicios, i komunikoi Sami Bahollit formulën e vet për lidhjet diplomatike me Republikën Popullore të Shqipërisë. Ja teksti:

«Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe qeveria mbretërore e Greqisë, duke dëshiruar të normalizojnë gjendjen që ekziston tani midis dy vendeve dhe të përgatitin terrenin për zhvillimin e marrëdhënieve të tyre, ranë dakord që të vendosin marrëdhënie diplomatike midis dy vendeve dhe të këmbëjnë përfaqësues diplomatikë në rang ambasadorësh».

Po e studiojmë.

E PREMTE
2 PRILL 1971

TË MOS BËJMË ASNJË LËSHIM

Porosita shokët që Sami Baholli të mos i bëjë asnjë lëshim përfaqësuesit grek në OKB, Bicios¹. Grekët do ta pranojnë propozimin dhe formulimin tonë për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike.

¹ Shih në këtë vëllim, f. 284.

E SHTUNË
3 PRILL 1971

TË ZGJEROJMË SHKËMBIMET KULTURORE, SIDOMOS ME KOSOVËN

Lexova projekt marrëveshjen njëvjeçare për shkëmbimet kulturore me Jugosllavinë që ka përgatitur Ministria e Punëve të Jashtme. Për ne rëndësi të madhe ka, sidomos, zgjerimi i këtyre shkëmbimeve me Kosovën. Bëra disa vërejtje.

E HËNE
12 PRILL 1971

SHËNIME

Bisedova me shokët për mënyrën diplomatike me të cilën duhet t'i përgjigjet Sami Baholli përfaqësuesit grek në OKB, Bicios, në lidhje me refuzimin tonë për çka kërkonte ai.

Dhashë pëlqimin që shkrimtari rumun me origjinë shqiptare Viktor Eftimiu, personalitet i madh i kulturës, lindur në Boboshticë të Korçës, të dekorohet me urdhrin «Naim Frashëri» të shkallës së parë.

E ENJTE
15 PRILL 1971*

«POLITIKA E PINGPONGUT»

Kina, siç tha Çu En Lai, para dy ditësh «hapi një faqe të re» në marrëdhëniet e saj me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo e filloi këtë politikë me ftesën që i bëri ekipit të pingpongistëve amerikanë, të cilët zhvilluan ndeshje me pingpongistët kinezë në Japoni.

Pingpongistët amerikanë, tok me katër a pesë gazetarë e kineastë, u ftuan në Pekin. Këta shkuan, u pritën «mirë e në mënyrë të ngrohtë», bile agjencia franceze e lajmeve AFP bënte edhe një krahasim duke thënë se pritja ishte më e nxehtë nga sa mund t'i bëhej një ekipi shqiptar, të cilët kanë qenë dhe janë miqtë më besnikë të Kinës. Natyrisht agjencitë borgjeze të lajmeve e bëjnë mizën buall dhe me këto duan të vërtetojnë se «në Kinë diçka e madhe po ngjet». Këtë taktikë reaksioni do të vazhdojë ta përhapë dhe ta propagandojë, pse i duhet për të çoroditur opinionin. **Por fakt është se ngjarja nuk ka rëndësinë e një evenimenti të zakonshëm sportiv, por të një evenimenti të ri politik.**

Çështja e pingpongistëve është një pretekst për veprime të tjera të reja drejt avancave që kanë bërë herë pas here presidentët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në drejtim të Kinës.

Pingpongistët amerikanë i priti edhe Çu En Lai, gjë që duhet konsideruar si një gjest i rëndësishëm politik

ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës. **Çu En Lai** jo vetëm që i priti me «përzemërsinë» tradicionale, pa bërë as polemikë, por u tha se Kina dëshiron të zhvillojë marrëdhënie miqësore me popullin amerikan.

Niksoni, nga ana e vet, iu përgjigj, si të thuash, zjarr për zjarr **Çusë**. Ai deklaroi se heq embargon mbi shumë mallra jostrategjike për Kinën, se është gati të zhvillojë tregti etj. Në të njëjtën kohë, sipas agjencive të lajmeve, Shtetet e Bashkuara të Amerikës i tërhoqën kërkesit e naftës nga Deti i Kinës.

Siç shihet, pra, po thyhet akulli. Dardha, thotë populli, e ka bishtin prapa. **Ministria e Jashtme Kineze**, në përmjet ambasadorit tonë në Pekin, na vuri në korent për këtë ngjarje, duke na siguruar se asgjë nuk ka ndryshuar dhe nuk do të ndryshojë në politikën e Kinës kundër imperializmit amerikan, revizionizmit sovjetik dhe reaksionit botëror.

Kina duhet të dalë e fuqishme si një shtet kolos socialist në arenën ndërkombëtare dhe të luftojë për revolucionin, për lirinë dhe të drejtat e popujve, të luftojë për socializmin dhe për komunizmin. Kina e madhe duhet të luftojë me të gjitha forcat kundër dy superfuqive të mëdha imperialiste, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, t'u prishë atyre planet djallëzore, të shkatërrojë aleancat e tyre luftënxitëse, t'u prishë «qetësinë» dhe planet për hegjemoninë që përpiqen të vendosin në botë, duke skllavëruar popujt, duke shuar revolucionet etj.

Daljen e Kinës në arenën ndërkombëtare ne e kemi dashur, e kemi përkrahur, ua kemi sugjeruar shumë herë direkt shokëve kryesorë të udhëheqjes kineze. Por ajo që ka rëndësi në këtë veprim, është që Kina të qëndrojë kurdoherë e kuqe, të zbatohen me përpikëri idetë marksiste-leniniste, të mos devijohet nga parimet dhe nga strategjia jonë proletare. Taktikat në këtë rast janë të

kuptueshme, por, për mendimin tonë, edhe ato duhet të jenë kurdoherë parimore dhe t'i shërbejnë strategjisë.

Shokët kinezë e kanë në natyrë të punës së tyre që disa herë i kapërcejnë caqet që kërkojnë situatat dhe momentet, disa herë shpejtohen, ekzagjerojnë, pastaj tërhiqen. Këto taktika i kemi vënë re në qëndrimet e kinezëve me revizionistët sovjetikë. Kemi shpresa se taktika të tilla nuk do të praktikohen edhe në qëndrimin me amerikanët, me anglezët e të tjerë. Ja, për shembull, sipas meje, nuk ishte me vend që pingpongistët amerikanë t'i priste përnjëherë **Çu En Lai**, ata mund t'i priste edhe dikush tjetër, dhe kjo punë të bëhej vetëm nëse duhej të arrihej ndonjë objektiv i shpejtë dhe i rëndësishëm. Nuk e dimë nëse ishte ky qëllimi. Të presim e të shohim.

Mirë, ne e kuptojmë këtë hap të Kinës, po shumë njerëz në botë nuk do ta kuptojnë aq shpejt dhe armiqtë do të përpiqen që pikërisht ta kuptojnë shtrembër, në rast se Kina, në zhvillimin e taktikave, nuk tregohet e matur, por e nxituar, dhe nuk kujdeset që çdo gjë t'u shërbejë strategjisë dhe interesave të revolucionit. Humbja dhe fitimi janë motër e vëlla; të dyja palët luftojnë për të pasur secili më shumë fitime dhe asnjë humbje.

Amerikanët dhe sovjetikët përpiqen edhe ata në këto drejtime, prandaj lufta do të bëhet e ashpër, në kushte dhe në koniunktura disi të reja, të cilat duhet t'i kthejmë kurdoherë në favorin tonë dhe në disfatën e tyre.

SHËNIM

I bëra disa rregullime artikullit kundër Kongresit të 24-t të revizionistëve sovjetikë¹. Po ia dërgojmë gazetës «Zëri i popullit» për ta botuar.

¹ «Kongresi i restaurimit të kapitalizmit dhe i socialimperializmit». «Zëri i popullit», 17 prill 1971.

TAKIM ME AMBASADORIN E RD TË VIETNAMIT

Prita ambasadorin e RD të Vietnamit¹, i cili largohet nga Shqipëria. Më foli për gjendjen, po nuk më tha asgjë të re, përveç çështjeve të njohura dhe formulave të zakonshme.

I bëra një pasqyrë të shkurtër të vijave kryesore të politikës së jashtme të Partisë sonë, veçanërisht për qëndrimin ndaj luftës së tyre.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 42.

PO VENDOSËN MARRËDHËNIET DIPLOMATIKE ME GREQINË

Qeveria greke pranoi të vendosë marrëdhënie diplomatike me Republikën Popullore të Shqipërisë. Njoftimi për këtë do të bëhet respektivisht në Tiranë dhe në Athinë në datën 6 maj, ora 16⁰⁰. Këtë e komunikoi përfaqësuesi grek në OKB, Bicios. Kështu mbaron një situatë absurde, shoviniste dhe luftënxitëse nga ana e qeverive greke kundër vendit tonë. Vetë kurdisën dhe mbajtën «gjendjen e luftës» me Shqipërinë, vetë bërtitnin si çakej për rivendikimin e tokave të atdheut tonë, por morën në çdo çast përgjigjen e merituar nga ne. Situata tash do të normalizohet, por ne e dimë kush janë ata dhe vigjilenca jonë do të qëndrojë kurdoherë lart.

TAKIM ME DELEGACIONIN E PUNËTORËVE KINEZË

Prita delegacionin e punëtorëve kinezë¹, që ka ardhur në vendin tonë për festën e 1 Majit, i ftuar nga Bashkimet Profesionale të Shqipërisë. Tre pjesëtarë të delegacionit janë anëtarë të plenumit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës.

¹ Delegacioni kryesohej nga anëtari i KQ të PK të Kinës dhe zëvendëskryetar i komitetit revolucionar të provincës Kiansi, Pan Shi Gao.

E PREMTE
30 PRILL 1971

SHËNIM

Dhashë disa udhëzime që të përgatitet një artikull¹ për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Greqinë, i shkurtër, konciz, politik, pa hyrë as në hollësitë e mosmarrëveshjeve, autori i të cilave ka qenë vetë pala greke dhe as të procedurave që çuan në përfundimin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike në mes Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Greqisë.

¹ «Një ngjarje e shënuar në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë», «Zëri i popullit», 14 maj 1971.

E PREMTE
30 PRILL 1971

QËNDRIM KONIUNKTURAL I KOREANËVE

Shokët më raportuan sot se, ambasadori i Republikës Demokratike Popullore të Koresë, në një bisedë në Ministrinë e Jashtme kishte lavdëruar vijën e Partisë sonë kundër revizionizmit sovjetik dhe kishte thënë se edhe partia e tij, Partia e Punës e Koresë, është kundër revizionistëve sovjetikë. «Ne, — kishte thënë ai, — nuk flasim hapur si ju, por brenda në parti dhe në popull flasim hapur». Po të jetë kështu, çka, por kjo është koniunkturale dhe jo me bindje ideologjike, besoj unë.

KRIZA E BRENDSHME JUGOSLLAVE

Kjo krizë po thellohet dita-ditës dhe nxjerr në shesh kalbëzimin e regjimit titist, falimentimin e tij ideologjik, politik dhe ekonomik. Tradhtia e Titos dhe e grupit të tij antimarksist do t'i sillte Jugosllavisë, siç i solli, katastrofën. Titoja përpiqet, si dashi te kasapi, ta evitojë këtë katastrofë buzë greminës, por është e pamundur, për arsye se tashmë Jugosllavia ka hyrë plotësisht dhe përfundimisht në rrugën kapitaliste, të një kapitalizmi anarkik, ku forcat reaksionare të brendshme përleshën midis tyre për epërsi dhe pushtet, ndërsa forcat kapitaliste të jashtme, që kanë investuar aty kapitale të shumta, kanë shtënë në dorë pozita të forta ekonomike dhe politike. Të gjitha këto forca reaksionare po ndeshen në arenën jugosllave. Titoja vazhdon të luajë kartën e vetadministrimit dhe, nën këtë maskë, përpiqet të hiqet si «mbrojtës marksist i rrugës socialiste jugosllave, i socializmit specifik». Kjo kartë false marksiste është e demaskuar tash përfundimisht nga jeta, nga faktet. Ajo ishte një «perde mëndafshi» për të vendosur kapitalizmin, për të maskuar procesin e transformimit kapitalist.

Ngjau ajo që duhej të ngjiste dhe që e kishim parashikuar dhe thënë më parë. Maskimi që u përdor ishte aq i dobët, në dukje dhe në brendi, sa që nuk mund të mbante, në kornizat e tij prej karte dhe fjalësh të Tito-Kardelit, marshimin galopant të degjenerimit moralo-

-politik që sillte me vete sistemi kapitalist. Dualizmi i maskimit dhe i veprimit bëri që edhe kapitalizmi që po restaurohej në Jugosllavi të merrte një zhvillim anarkik, që krijonte turbullira të mëdha në investime, në ndërtime, krijonte inflacione e kriza në prodhim, anarki në treg, ku çmimet ngriheshin pareshtur. Ai krijonte rivalitete në mes republikave të ndryshme, nxiste frymën shoviniste nacionaliste dhe bënte të shtoheshin grindjet në mes republikave më të forta dhe atyre më të dobëta, të republikave të fuqishme ekonomikisht e që përfitonin pjesën e luanit nga investimet dhe nga kapitalet e huaja dhe të republikave të varfra që rronin me thërrimet e sofrës. Asnjë autoritet, që mund t'u vinte fre këtyre lakmive, që mund të vinte rregull, nuk ekzistonte. E ashtuquajtura Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë jo vetëm që ishte krejt e degjeneruar, por asaj i ishin hequr të gjitha fuqitë edhe si parti revizioniste. I vetmi «autoritet» si me thënë, që kishte mbetur në Jugosllavi, ishte tradhtari Tito, i mbështetur nga grupime nacionalshoviniste të brendshme dhe kryesisht nga kapitali amerikan, si dhe nga kapitalistë të tjerë të huaj. Në këtë gjendje Titoja bën përpjekje të ristabilizojë situatën.

Në radhë të parë, i shtrënguar nga gjendja brenda dhe nga kapitalet e huaja që e financojnë dhe që kanë në dorë pozitat kyç të vendit dhe vetë personin e Titos, ky po sakrifikon ca nga demagogjia për të përsosur dhe për të konsoliduar sistemin kapitalist në Jugosllavi. Prandaj këshilltarë të shumtë të koncerneve të huaja kanë ardhur në Jugosllavi dhe po riorganizojnë ndërmarrjet në format më të përshtatshme kapitaliste. Kapitalistët kolonizatorë s'mund të lejojnë më sfumatura, ata nuk duan të rrezikojnë kapitalet e tyre të investuara, as pozitat kyç dominuese që kanë zënë.

Le që vetadministrimi u ka vërtetuar punëtorëve në jetë shfrytëzimin e egër që u solli, jo vetëm sepse ky

farë vetadministrimi nuk u dha as më të voglën mundësi punëtorëve të administronin, por krijoi dhe pasuroi një shtresë grabitësish aq të madhe e të fuqishme, sa që u hodhi zinxhirët e skllavërisë, i hodhi në rrugë, i la pa punë. Jugosllavia titiste u bë vendi që eksporton më shumë fuqi punëtoresh në Evropë. Jugosllavia titiste është një shtet që, përveç kredive që i japin bankat kapitaliste perëndimore, rron me të ardhurat nga emigracioni dhe nga turizmi. Të dyja këto rrugë katastrofike për ekonominë e vendit, për moralin, për politikën, ekzaltohen vazhdimisht nga i falimentuari Tito.

Çështja tash për Tito tradhtarin qëndron në përpjekjet për ta forcuar disi këtë situatë. Ai nuk mund të bëjë asnjë hap prapa nga rruga e tradhtisë së tij, nuk mund ta mohojë në bllok vetadministrimin se gjoja këtë tezë e përdorin kundërshtarët e tij, antimarksistët, revizionistët e tjerë, shovinistët serbomëdhenj me Rankoviçin etj. Këta janë për «centralizmin kapitalist», domethënë për sundimin serb mbi të gjitha e mbi çdo gjë.

I ndodhur në këto kushte Titoja e mbron vetadministrimin, duke i bërë disa kritika të rastit, por qëllimi i tij është dhe mbetet shpartallimi i kundërshtarëve. Ai mbështetet në ato republika dhe përkëdhel ato kombe të Jugosllavisë dhe ato klika revizioniste që janë kundër fuqisë sunduese të Republikës Federative të Serbisë. Kjo është taktika e tij. Këtë ai përpiqet ta realizojë nëpërmjet reformave të kushtetutës, e cila gjoja do të shpërndajë fuqitë aktuale të presidentit të republikës, te presidiumi, që do të formohet nga të zgjedhurit e republikave dhe të krahinave autonome, në mes të cilave edhe Kosova.

Me këtë reformë Titoja do të tregojë se efektivisht u njehtëzoi të gjitha të drejtat dhe pas vdekjes së tij do të ruhet dhe do të forcohet uniteti i Federatës.

Kjo është një ëndërr me sy hapur dhe ka për që-

llim t'u hedhë hi syve njerëzve. Kjo është një manovër, për të dalë nga kriza e rëndë dhe për të mposhtur grupimet kundërshtarë që kërcënojnë Titon dhe grupin e tij. Vetë Titoja i kërcënoi hapur këta në një fjalim që mbajti nga fundi i prillit në Kosovë.

Në këtë fjalim Titoja, që ruan nostalgjinë e periudhës Tito-Rankoviç, kur Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë ishte vënë nën drejtimin e drejtpërdrejtë të ministrit të Brendshëm, Rankoviç dhe kur ishin shkelur dhe bastarduar të gjitha normat marksiste-leniniste të një partie marksiste, tha se «në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë ka fraksione të rrezikshme, unë jam mësuar në luftë kundër këtyre fraksioneve dhe s'kam frikë të luftoj. Unë do të flas hapur kundër tyre» etj., etj. Por këto kërcënime nuk i frikësojnë kundërshtarët e Titos, pse Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë aktualisht s'ka asnjë autoritet dhe nuk luan asnjë rol të rëndësishëm. Të jesh ose të mos jesh në Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë nuk ka rëndësi për kërkënd. Ata që janë brenda në parti, s'kanë gjë në dorë, në qoftë se përjashtohen asnjë punë nuk u priset këtyre. Çështja është kush ka efektivisht në dorë dhe nën drejtimin politik dhe ideologjik ushtrinë, UDB-në, pushtetin civil dhe atë ekonomik, kush është më i zoti dhe më në gjendje të përpunojë opinionin.

Punët kanë degjeneruar në atë shkallë në Jugosllavi që përpunimi i opinionit, në përgjithësi, bëhet nga shumë grupime rivale, të cilat, pavarësisht se janë ose nuk janë formalisht në radhët e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, kanë lidhjet e tyre brenda dhe jashtë Lidhjes, brenda dhe jashtë pushtetit qendror federativ, brenda dhe jashtë republikave, prandaj është e zorshme për Titon dhe për grupin e tij të marrë aktualisht masa administrative kundër kundërshtarëve, siç bënte në kohën Tito-Rankoviç. Dhe në fakt, pas fjalimit në Kosovë,

në fund të prillit, ku kërcënoi kundërshtarët, ai bëri mbledhjen e udhëheqjes së gjerë në Brioni, mbledhje që vazhdoi tri ditë.

Premtimet dhe kërcënimet e Titos nuk u vërtetuan. Doli një komunikatë e gjatë dhe e zezë, ku vihet në dukje gjendja e krizës së madhe dhe të përgjithshme në të cilën përpëlitet Jugosllavia. Cilët janë fraksionistët, ç'masa u morën kundër tyre, asgjë nga të gjitha këto nuk ka dhe natyrisht nuk mund të ketë. Titoja dhe grupi i tij, sido që duhet të jetë më i fuqishëm nga grupet e tjera rivale, u tremben masave, pse lufta e tyre do ta shtojë më tepër kaosin, në mos edhe më shumë se kaq. Titoja dëshiron dhe shpreson të arnojë situatat dhe të ruajë prestigjin e tij personal derisa të vdesë. Këtu nuk luhet aspak. Kujdesi i tij është gjoja për të shpëtuar Jugosllavinë nga humnera, ku ai vetë e çoi, po këtu luhet një lodër e hapët dhe e fshehtë për pushtet. Një pjesë, sa rron Titoja, përpiket të përfitojë nga koha për të forcuar pozitat e saj, të tjerët po ashtu përpiqen edhe ata të forcojnë pozitat, të evitojnë grushtet dhe të presin vdekjen e Titos për të vepruar më energjikisht për sundim dhe epërsi.

Shqiptarët e Kosovës përpiqen të konsolidojnë pozitat e fituara dhe të luftojnë për të fituar të drejtat e tjera që u mohohen. Në këto koniunktura Titoja duket sikur i mbron disi për interesat e tij kundër klanit aktual serb, kundërshtar të tij, por kuptohet se, si antimarksist, ai bën politikën e balancimit, as shumë kundër serbëve, as shumë afër me shqiptarët. Klani kroat, natyrisht antiserb, e luan më hapur kartën pro të drejtave të shqiptarëve të Kosovës. Reaksioni serb në fuqi, për të mos folur për atë që vepron nga jashtë, është i egër dhe i hapët kundër shqiptarëve. Serbët përpiqen që kushtetuta të mos ua japë të gjitha të drejtat shqiptarëve (krahinës së Kosovës), në mënyrë që kjo krahinë

në letër të quhet «autonome», po të vazhdojë si më parë, bile edhe ca më keq, pas vdekjes së Titos të lëngojë nën terrorin serbomadh.

Shqiptarët e Kosovës po luftojnë dhe duhet të luftojnë të bashkuar dhe në unitet, ndryshe i merr lumi. Serbi përpiket dhe do të përpiket t'i përçajë, pse e shikon se ata janë një forcë e madhe. Nga regjistrimet e muajit prill të këtij viti rezultoi se vetëm në Kosovë jetojnë 920 000 shqiptarë, domethënë 73 për qind e popullsisë së Kosovës. (Në realitet janë më shumë.) Në Maqedoni dhe në Mal të Zi mund të jenë ndonja 400 000 të tjerë. Kështu që gjithë shqiptarët nën robërinë titiste jugosllave mund të arrijnë afërsisht 1 500 000 veta, domethënë tri herë më shumë se malazeztë, më shumë se sllovenët edhe më shumë se maqedonasit.

Punët në Jugosllavi po zhvillohen në rrugë shumë interesante, me të papritura, me rreziqe të mundshme. Prandaj po e ndjekim atë me vigjilencë të madhe.

E MARTË
4 MAJ 1971

RRËZIMI I VALTER ULBRIHTIT

Berlini shpalli mbrëmë se Valter Ulbrihti «dha dorë-heqjen» nga Sekretar i Parë i Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane, duke mbetur kryetar i partisë, anëtar i Byrosë Politike dhe Kryetar i Këshillit të Shtetit. Arsyeja që u dha, ishte mosha e tij e kaluar 77-vjeçare (?). Vendin e tij si sekretar i parë e zuri Honekeri.

Mund të jetë edhe arsyeja e moshës, flitej me kohë se ai ishte edhe i «sëmurë nga kanceri», por këto mund të ishin fjalë, që hapeshin për të përgatitur këtë terren.

Që revizionisti i vendosur Ulbrihti, me një të kaluar të gjatë prej «militanti», ishte një personalitet «revolucionar», që tradhtoi më vonë marksizëm-leninizmin si shumë shokë të tij në Bashkimin Sovjetik, në Gjermani e gjetkë, kjo është e vërtetë. Pas vdekjes së Stalinit dhe të Vilhelm Pikut, ai u imponua në RD Gjermane dhe në Partinë Socialiste të Bashkuar Gjermane me të kaluarën dhe me personalitetin e tij. Ai ishte dakord me Hrushovin kundër Stalinit, kundër marksizëm-leninizmit, për Kongresin e 20-të të PK të BS; ai shikonte forcën e Bashkimit Sovjetik dhe «interesin» që Republika Demokratike Gjermane të qëndronte e lidhur ngushtë me sovjetikët, por, me sa e njoh unë Ulbrihtin, karakterin e tij, pikëpamjet e tij, pse kam biseduar shumë herë me të, kemi shkëmbyer mendime me të etj., për shumë probleme, mendoj se ai nuk ishte qojle e Hrushovit ose e

Brezhnjev-Kosiginit, siç u treguan shumë të tjerë, ai kishte personalitetin e tij. Revizionistët sovjetikë e dinin se Republika Demokratike Gjermane s'mund të ecte dot pa Bashkimin Sovjetik, por edhe Ulbrihti e dinte se Bashkimi Sovjetik kishte shumë nevojë për Republikën Demokratike Gjermane dhe pa të nuk mund t'i ecte asgjë e mirë në Evropë, pas Luftës së Dytë Botërore.

Prandaj Ulbrihti, me dashje ose pa dashje nga revizionistët sovjetikë, duhej të pyetej, të dëgjohej, të bihej dakord me të dhe, shumë herë, sovjetikët t'i bënin lëshime në shumë gjëra kokëfortësisë gjermane të Ulbrihtit.

Shumë herë në praninë time Ulbrihti ka akuzuar Hrushovin dhe Mikojanin si burokratë dhe ka kërkuar me këmbëngulje që RD Gjermane t'i jepeshin kredi pa kufi dhe t'i bëheshin favore kolosale. Dhe këto ajo i merrte. Sigurisht, edhe unë jam i bindur që Hrushovi e më vonë Brezhnjevi dhe Kosigini dëshironin dhe fshehtazi punonin që t'ia ngrinin këmbët Ulbrihtit, që të kishin të bënin me një gjerman të tipit Zhivkov, po ishte e zorshme.

Përveç të tjerave, çështja vendimtare për Ulbrihtin ishte nënshkrimi i Traktatit të Paqes me të dyja shtetet gjermane dhe fundi vetëm me Republikën Demokratike Gjermane. Hrushovi e tradhtoi këtë vijë. Natyrisht Ulbrihti s'ishte dakord dhe duhet ta ketë pëlqyer rënien e Hrushovit dhe ardhjen e Brezhnjev-Kosiginit, të cilët me siguri, me veten e tij ai i ka çmuar si «fenda», në rast se Hrushovi ishte «një pordhë me zhurmë».

Mirëpo me këta kontradiktat u shtuan. Revizionistët sovjetikë po futeshin më thellë në aleancë me amerikanët, si ata, edhe polakët, erdhën në ujdin me Bonin, nënshkruan dhe traktate, të cilat kanë mbetur pezull dhe nuk ratifikohen nga Boni, pse ky i fundit kërkon lë-

shime, natyrisht në kurriz të Republikës Demokratike Gjermane.

E gjithë kjo situatë nuk ishte e favorshme për Republikën Demokratike Gjermane dhe për liderin e saj, Valter Ulbrihtin. Ky ishte i zemëruar, i pakënaqur dhe me siguri ka «vënë veton në shumë veprime sovjetopolako-gjermanoperëndimore». Unë mendoj se Ulbrihti nuk ka hequr dorë nga pikëpamjet e tij për të drejtat e Republikës Demokratike Gjermane. Mundet që presionet e mëdha dhe të shumëllojshme të sovjetikëve dhe të shokëve të tij më oportunistë ta kenë detyruar që ai të tërhiqej, duke rënë në disa kompromise për t'u zhbllokuar situata aktuale.

Ky variant ka rëndësi dhe do të duket shpejt në qëndrimet politike të sovjetikëve, të Bonit dhe të Republikës Demokratike Gjermane. Do të shohim sa u pagua dhe si u pagua koka dhe mjekra e «cjapit përç», pse ideologjikisht Valter Ulbrihti ishte vetë revizionist i bindur dhe jo pse i fliste në vesh Hrushovi. Ai ishte një revizionist prusian, që nuk i kishte thonjtë të gjatë, se po t'i kishte ua hidhte në grykë Hrushovit dhe gjithë të tjerëve. Ulbrihti ishte i pari në luftën kundër Stalinit, kundër nesh. Ai luajti rol të rëndësishëm në pushtimin e Çekosllovakisë, vendin e tij e mbajti dhe e mban nën roberinë e rëndë të ushtrisë pushtuese hrushoviane. E gjithë kjo mund të jetë rezultat i një perspektive kombinacionesh të ardhshme.

Revizionistët sovjetikë, duke u frikësuar nga një zhvillim i «kontakteve Kinë-SHBA», duke parë rrezikun e likuidimit të influencës së tyre në Lindjen e Mesme, kërkojnë të konsolidojnë aleancën ruso-gjermane, duke arritur deri edhe në bashkimin e dy shteteve gjermane si kundërpeshë për amerikanët dhe për dobësimin e pozitave të këtyre në Evropë dhe në NATO. Po të ndjekim

zhvillimin e ngjarjeve, do të shohim ku e ka bishtin «mjekra e Ulbrihtit», pse mund të ngjasë edhe ndryshe, që të vazhdojë rezistenca kundër përpjekjeve sovjetike për të marrë koncesione nga gjermanolindorët për përmirësimin e marrëdhënieve me Bonin. Atëherë në këtë rast ne do të asistojmë në qëndrime më të ashpra e më të prera nga ana e Honekerit kundër Bonit, që do të thotë kundër tendencës së lëshimeve. Në këtë rast është me vend të thuhet se Ulbrihti u tërhoq dhe la Honekerin, si më të ri, të luftojë, për arsye të moshës dhe jo për arsye presioni.

Të shohim pra ç'do të bëjë Honekeri, ç'qëndrim do të mbajë. Në qoftë se mban qëndrim intransigjent, atëherë do të kemi gjëra me rusët, do të kemi gjëra në Evropë.

U SHPALL VENDOSJA E MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE ME GREQINË

Sot, në Tiranë dhe në Athinë u shpall njëkohësisht vendosja e marrëdhënieve diplomatike në mes dy vendeve tona.

TAKIM ME DELEGACIONE TË HUAJA SINDIKALE

Sot paradite në selinë e Komitetit Qendror të Partisë prita delegacione të ndryshme të bashkimeve profesionale të huaja¹ që kanë ardhur në vendin tonë, me ftesë të BPSH, me rastin e 1 Majit.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 50.

SHËNIM

Revizionistët e ndyrë rumunë na kërkuan aprovim që nga telegrami im i urimit, që u dërgova për 50-vjetorin e partisë së tyre, të hiqnin frazën «revizionizmin modern me atë sovjetik në krye». Ne nuk pranuan. Megjithatë, ata e hoqën. Do të protestojmë.

RRETH NJË TAKIMI TË TË NGARKUARIT TONË ME PUNË NË BEOGRAD ME FADIL HOXHËN

Meqenëse Fadil Hoxha u shpreh për ta bërë «zyrtar» takimin që i kërkoi i ngarkuari ynë me punë, Lik Seiti, edhe ne ia përshtatëm përmbajtjen e mesazhit që do t'i thoshte «rrethanave zyrtare».

Meqenëse Fadil Hoxha u shpreh për ta bërë «zyrtar» takimin që i kërkoi i ngarkuari ynë me punë, Lik Seiti, edhe ne ia përshtatëm përmbajtjen e mesazhit që do t'i thoshte «rrethanave zyrtare».

KRIZË NË EGJIPT

Anvar el Sadati eliminoi Ali Sabrinë, personalitet i rëndësishëm pas tij, me pretekstin e pjesëmarrjes në një komplot për të marrë fuqinë dhe «për ta vënë popullin egjiptian nën zgjedhë».

Kjo ngjau kur Roxhersi, sekretari amerikan i shtetit ishte në udhëtim e sipër për vizitë në shumë shtete të Lindjes së Mesme dhe sidomos në Egjipt e në Izrael. Ishte e qartë se Roxhersi vinte në Egjipt të gjente fjalën me Izraelin dhe me Sadatin për një kompromis për zgjidhjen e divergjencave. Ishte, pra, diçka e re. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, miqtë e Izraelit, po bëheshin drejtpërdrejt ndërmjetësit e kompromisit pranë egjiptianëve, duke eliminuar zyrtarisht, nga këto traktativa, Bashkimin Sovjetik.

Për Bashkimin Sovjetik kjo ishte një disfatë politike, ai nuk ishte më partneri kryesor që do të manovronte me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në emër të Egjiptit dhe të dy tok me Shtetet e Bashkuara të Amerikës të manovronin në Lindjen e Mesme për Egjiptin, për palestinezët dhe për popujt e tjerë arabë. El Sadati e theksoi këtë shuplakë politike kundër «aleatit të tij», Bashkimit Sovjetik, duke eliminuar në mënyrë të bujshme Ali Sabrinë, njeriun e sovjetikëve. Anvar el Sadati veproi si Hrushovi që eliminoi Molotovin, pikërisht kur Titoja ishte në udhë e sipër për në Moskë.

Hrushovi i tha me këtë veprim Titos se «unë po të hap rrugën e miqësisë dhe të aleancës, duke eliminuar stalinistin Molotov; më vonë do t'i pastroj të gjithë, duke i cilësuar edhe si antiparti». Edhe Sadati i tha Roxhersit «po të spastroj rrugën e miqësisë dhe të aleancës, duke e qëruar prosovjetikun Ali Sabri; më vonë do të spastroj edhe të tjerët».

Në fakt, sonte u lajmërua nga Kajroja se gjashtë ministra, në mes të të cilëve ministri i Brendshëm, ai i Mbrojtjes etj., dhanë dorëheqjen dhe, tok me ta, dolën nga kryesia e partisë, që është në fuqi, edhe tri personalitete të tjera. Të gjithë këta, s'ka asnjë dyshim, janë prosovjetikë dhe shokë të Ali Sabriut. Pra këtu qëndron kriza. El Sadati do të flasë në datën 14, në mbrëmje. Të shohim çfarë do të thotë, por edhe ato që do të thotë, s'do të jenë të vërteta. Çështja zien, brenda dhe jashtë.

As grupi i Sadatit nuk është për luftë dhe as Ali Sabriu. Por Sadati, siç po duket, po ua kthen fletën sovjetikëve, të cilët përpiqen t'ia ngrënë këmbët. Deri tash ka fituar Sadati. Të shohim ç'forcë minuese dhe komplotuese kanë sovjetikët brenda dhe ç'ndihmë e përkrahje do t'i japin Uashingtoni dhe Izraeli El Sadatit. Sovjetikët janë në pozita të vështira, se po humbasin njerëzit e tyre në Egjipt, të cilët është e zorshme t'i marrin hapur në mbrojtje dhe të hyjnë në konflikt me udhëheqjen zyrtare të Egjiptit, që edhe kjo, duke manovruar që të mos i akuzojë hapur, do t'i qërojë të gjithë përkrahësit e tyre.

Që Bashkimi Sovjetik të ndërhyjë në traktivat e hapëta dhe të fshehta, që po zhvillon Sadati me Uashingtonin dhe me Tel-Avivin, nuk e bën dot dhe as i pengon dot marrëveshjet e kompromisit që mund të arrihen pa të. Revizionistët sovjetikë janë duke luajtur letrën e fundit, të dëshpëruar, për të mos humbur pozitën e grabitura politike, ekonomike dhe ushtarake në Lindjen e

Mesme dhe në Egjipt, që po ua grabitin Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Do të shohim se si do të zhvillohen situatat, por është e qartë se imperializmi amerikan do të bëjë të gjitha përpjekjet, sa nuk është vonë, që ta eliminojë Bashkimin Sovjetik nga Lindja e Mesme dhe nga Afrika, të mos e lërë të vazhdojë që, nën maskën e «mbrojtësit» të popujve arabë të forcojë pozitën politike, ekonomike, kolonialiste dhe ushtarake, sidomos në Egjipt, në Siri, në Mesdhe në përgjithësi.

Popujt arabë nuk kanë ndonjë simpati të veçantë si për revizionistët sovjetikë, ashtu edhe për imperialistët amerikanë, bile i urrejnë. Kurse klikat arabe që janë në fuqi shiten tek ai që u jep më shumë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sigurisht, për t'ia arritur qëllimit, llogaritin t'i japin kredi të majme Egjiptit. Prite kur të hyjë në lëvizje dhe Titoja për këtë, në mos ka hyrë më parë. Izraelit po ashtu i intereson, sa nuk bëhet vonë, që të sigurojë në mënyrë ndërkombëtare kufijtë e tij, të bëjë disa lëshime të vogla hëpërhë, «të premtojë» lëshime të tjera krahas shkëputjes së Egjiptit nga sovjetikët, likuidimit në favorin e vet të problemit palestinez etj.

Amerikanët do të përpiqen që flotën sovjetike në Mesdhe ta lënë si peshku pa ujë, duke e dëbuar nga bazat aktuale ku ankorohet sot në Egjipt dhe në Siri. Çështja e NATO-s dhe pellgu i Mesdheut janë me rëndësi për strategjinë amerikane. Këtu ka ndeshje me sovjetikët.

Çdo veprim politik dhe i çfarëdo natyre qoftë është shumë i ndjeshëm për të dyja superfuqitë imperialiste dhe socialimperialiste, qoftë për Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe për Bashkimin Sovjetik, veçanërisht këto javët e fundit në Evropë.

Dorëheqja e Ulbrihtit dhe ardhja e Honekerit si sekretar i parë u la shteg spekulimeve politike, natyrisht në favor të sovjetikëve, duke thënë se Honekeri është njeri i sovjetikëve, se do të lëvizë çështja e kompromi-

seve për Berlinin Perëndimor në favor të Bonit, të Traktatit Moskë-Bon dhe të atij Bon-Varshavë etj.

Sovjetikët nga ana e tyre filluan riaktivizimin e agjunkturës për çështjen e mbledhjes së «Sigurimit evropian», kurse Brandi dhe qeveria e tij lançuan, nga ana e tyre, çështjen e krizës së rëndë monetare, që kishte për qëllim zhvlerësimin e dollarit dhe forcimin e markës.

Boni arriti të veprojë, për një periudhë kohe të caktuar, në unitet me Belgjikën, Holandën, Luksemburgun dhe Zvicrën dhe kësajsoj dollari pësoi një ulje në bursë. Megjithatë qeveria amerikane nuk pranoi të zhvlerësonte dollarin. Filluan, natyrisht, presionet politike, ekonomike, por edhe ushtarake të senatorëve amerikanë kundër Brandit, duke kërkuar nga Niksoni që të tërheqë forcat e okupimit amerikan nga Republika Federale e Gjermanisë, për ta dëmtuar këtë ekonomikisht dhe ushtarakisht. Ky ishte, kuptohet, një shantazh, me të cilin donin t'i thoshin Bonit të mos bëjë hapa më tej me sovjetikët dhe të pushojë luftën kundër forcës dhe pushtetit të dollarit. Niksoni hëpërhë zgjodhi rrugën e mesme, dhe iu përgjigj senatorëve kundërshtarë se ai nuk mund t'i heqë trupat nga Evropa dhe të dobësojë NATO-n dhe, në rast se ata e çojnë çështjen në Senat, ai do të vërë veton. Gjatë kësaj kohe Roxhersi kurdisi ardhjen në Egjipt dhe bisedimet me Sadatin. Kurse «kapiten» Leonid Brezhnjevi u kthye më shpejt në Moskë nga Gjeorgjia, në vendin e Stalinit, ku kishte vajtur të bënte «politikën e madhe», me rastin e 50-vjetorit të RSS të Gjeorgjisë.

**SI TI NDIHMOJMË KOSOVARËT PËR TË LUFTUAR
HAKMARRJEN, KRIMINALITETIN DHE
DEGJENERIMIN E RINISË**

Bisedova me shokët që nga dokumentet e Partisë e fjalimet që kemi mbajtur kundër kriminalitetit të përpilohet diçka e përshtatshme për Kosovën, ku ekziston hakmarrja, kriminaliteti dhe rreziku i degjenerimit të rinisë shqiptare nga ana e titizmit dhe kjo të jepet nga Radio Kukësi. Në këtë përmbledhje të vihen ato çështje që interesojnë popullin shqiptar, rininë, inteligjencien. Qëllimi është t'i bëjmë të ndërgjegjshme masat popullore në Kosovë për të luftuar kundër degjenerimit titist të rinisë e kundër hakmarrjes, zakon i egër nga e kaluara, që titistët e nxitin ta mbajnë gjallë, për të përçarë popullin shqiptar.

ÇAUSHESKU DO TË VIZITOJË KINËN

Çausheku i Rumanisë ka filluar me radhë pritjet e takimet pa bërë përjashtim dhe pa bërë dallim. Ai pret e përcjell krerët e imperializmit, përfaqësuesit e bankave botërore të vendeve kapitaliste, pret e përcjell krerët e vendeve revizioniste, pret e përcjell delegacione zyrtare të larta kineze etj. Nga të gjithë merr kredi të shumta: nga amerikanët, nga Republika Federale e Gjermanisë, nga Franca, nga Kina, e nga kush nuk merr! **Rumania e Çaushekut po shitet në ankand me kredi. Kësaj i thonë «vdekje me kredi».**

Dhe për këtë politikë antimarksiste, revizioniste, pa kurrfarë skrupulli dhe ndërgjegjeje mburret Nikolae Çausheku, hiqet si komunist i vërtetë, si njeri i madh i kohës, si diplomat i shquar! Ai shkon kudo, që nga Uashingtoni dhe deri në Teheran, për të celebruar mijëvjeçarët e perandorisë persiane, për të dekoruar shahinshahun, vrasësin e luftëtarëve e të komunistëve dhe për të marrë dekoratë nga ai.

Çaushi ndjek rrugën e tradhtisë dhe të aventurave të Titos. Ai po përgatitet që në arenën ndërkombëtare të zëvendësojë Titon në qerren amerikane. Çaushekut i është rritur aq shumë mendja, saqë Titoja «s'i duket gjë» përpara vetes. Titon vërtet e kemi armik, por Çaushi mbetet çaus para bashçaushtit.

Por, megjithëkëtë evidencë, shokët kinezë i buzëqe-

shin këtij antimarksisti dhe bëjnë lodrën e tij duke e ndihmuar me qëndrimet e tyre, që Çaushi të hiqet si marksist, për çka nuk ka qenë, nuk është dhe nuk do të jetë kurrë.

Për Çaushin, padronët e tij, kapitali botëror, kanë interes të madh, ashtu siç kishin edhe për Titon, që ai të luajë rolin e «komunistit», që vendi i tij, Rumania, të quhet sikur ndërton socializmin dhe sikur ka kontradikta me revizionistët sovjetikë. Këtë kartë të fundit luajnë kinezët për të arsyetuar kontaktet shumë miqësore me rumunët. Kinezët na thonë neve në vesh: «I njohim, ata (rumunët) janë revizionistë, ne e dimë që në Rumani nuk ndërtohet socializmi, ne jemi të skandalizuar nga pritjet madhështore që iu bënë në Rumani Dë Golit, Niksonit, kancelarit të Bonit etj., etj., por...».

Ky «por» fsheh dhe lejon, sipas mendimit tim, që shokët kinezë të bëjnë shumë gabime politike në qëndrimet e tyre ndaj Rumanisë.

Në radhë të parë, «diploma» që kërkon Çaushesku nga Kina, për të vërtetuar se ai është «komunist», nuk duhet t'i jepet. Por shokët kinezë ia kanë dhënë dhe po ia forcojnë pozitat. Kinezët mbajnë lidhje partie, flasin për Partinë Komuniste të Rumanisë me terma aq lavdërues, sa që s'ka ku vete më tej. Tash Çaushi do të shkojë në Kinë edhe si përfaqësues i partisë, si sekretar i parë i saj, dhe, me siguri, atje do t'i bëhet pritje madhështore, me popull, me valle, me gonge e me miliona njerëz nëpër rrugë. Pale fjalimet si do të jenë! Çaushi do t'ua kthejë monedhën, do t'u bëjë elozhe e mburrje, sa që do t'i mahnitë kinezët, të cilët do të arrijnë të thonë: «Ku kemi qenë që kemi dyshuar diçka te ky burrë?!».

Sigurisht Çaushesku do të shesë shumë mend në Kinë. Atij nuk i mungojnë as fjalët, as dredhitë. Ai mund të jetë ngarkuar edhe me misione të veçanta...

Sidoqoftë, vetëm vajtja e tij në Kinë do t'ia ngrejë

«ajarin» komunist këtij pseudokomunisti në sytë e atyre që duan ta shohin Kinën nën këmbë. Çausi revizionisti merr fuqi të gënjejë, të intrigojë, të luftojë marksizëm-leninizmin.

Që kur Çausi kërkoj të shkonte në Kinë, ne s'ishim kundër, nuk ishim për atë që të refuzohej vajtja e tij, por ama vetëm si përfaqësues i shtetit rumun dhe jo i partisë. Pastaj me këtë rast atij nuk duhet t'i bëhet pritje e jashtëzakonshme, por një pritje e zakonshme zyrtare.

Të vijnë tash te çështja e kredive që Kina po i jep Rumanisë. Ne nuk e dimë sa i jep, por tërthorazi marrim vesh se kreditë që i akordohen janë shumë të mëdha, bile edhe në devizë të huaj. Nuk është e drejtë, t'i jepet kredi nga një shtet socialist një shteti revizionist të lidhur me kapitalistët dhe imperialistët, një shteti që shkatërron bazat e socializmit dhe ndërton një ekonomi kapitaliste-titiste, t'i jepet kredi një udhëheqjeje revizioniste që mëkëmb dhe forcon borgjezinë e re rumune. Për mendimin tonë ky është gabim i rëndë politik, ideologjik dhe ekonomik i udhëheqjes kineze.

Kinezët mund të thonë se «kemi një politikë tonën të gjerë, me perspektivë dhe, për ta kristalizuar këtë, do të bëjmë edhe disa lëshime, do të bëjmë edhe disa sakrificë, por fundi i fundit paret tona japim, juve, shqiptarëve ju kemi dhënë po ashtu kredi» etj., etj. Kjo është e drejta e tyre, por politikisht dhe ideologjikisht është gabim që antimarksisti të kalojë për marksist. Nuk është e drejtë t'i jepet kredi Rumanisë që borgjezia e re parazitare rumune të rrojë në bollëk të madh, kur populli kinez lufton dhe bën sakrificë të mëdha, dhe me gjithë sukseset që ka arritur dhe punën e madhe që po bën, disa herë i ka mangut në sasi yndyrën, mishin, bile dhe kryesoren — bukën, orizin.

Këto mund të mos bëjnë efekt në Kinë po ato bëjnë

efekt në Shqipëri, në Shqipërinë socialiste të rrethuar nga armiq të egër, disa prej të cilëve janë revizionistë, që hiqen si komunistë, i bëjnë reklamë vetes me kreditë e imperialistëve dhe të Kinës, siç është rasti i rumunëve, dhe luftojnë republikën tonë, e cila, në fakt, nuk mund ta ketë nivelin e jetesës të shtresës së re borgjezo-revizioniste.

Sidoqoftë, ne do ta ndjekim udhëtimin e Çausheskut në Kinë, do të shohim edhe dozën e pritjeve dhe të fjalimeve të shokëve kinezë. Por qëndrimi i shtypit tonë do të jetë i ftohtë dhe njoftimi do të bëhet në formë kronike shumë të thjeshtë. Le ta kuptojnë edhe kinezët qëndrimin tonë ndaj revizionistëve rumunë, të cilëve nuk kemi ndër mend aspak t'u «lyejmë me ar» bakrin.

E MËRKURE
26 MAJ 1971

SHËNIM

Dhashë disa mendime e teza për një artikull kundër revizionistëve çekoslovakë, të cilët këto ditë janë mbledhur në kongres partie, dhe kundër revizionistëve sovjetikë.

SHËNIM

Porosita Ministrinë e Jashtme të shpejtojë kthimin e Lik Seitit nga Beogradi, se duhet të përgatitet për në Athinë, ku e kemi caktuar ambasador.

SHËNIME

Ramizi më raportoi për bisedat «pozitive» të rektorit të Universitetit të Beogradit dhe të qëndrimit e të bisedimeve të shkrimtarëve nga Kosova, që kishin ardhur për 125-vjetorin e lindjes së Naimit.

U lajmërua ambasadori ynë në Pekin që, në ceremonitë që do të zhvillohen me rastin e vajtjes atje të Çausheskut, të qëndrojë korrekt, por asnjë shenjë e veçantë afërsie.

Rumunëve u bë më protestën për heqjen nga telegrami im të fjalëve «revizionizmit modern, me atë sovjetik në krye»¹.

¹ Shih në këtë vëllim, f. 358.

KINEZËT DHE ÇAUSHESKU

Çaushesku shkoi në Kinë në krye të një delegacioni prej... 80 vetash. Nuk mungonte as kuzhinieri!

Pritje e madhe iu bë në aerodrom dhe nëpër rrugë, ku kishin dalë mbi gjysmë milioni njerëz, që brohoritnin për të. Përveç Çu En Lait dhe kuadrove të tjerë të rëndësishëm të partisë e të shtetit kinez, Lin Biaoja kishte dërguar në aerodrom gruan e tij, kurse gruaja e Maos i priste «mysafirët e shquar» në «rezidencën e pritjes». Siç shihet, pritja qe complete: edhe dy më të mëdhenjtë ishin përfaqësuar nga bashkëshortet në pritjen e «të madhit të Rumanisë».

Fjalimi i Çu En Lait ishte pompoz e jashtëzakonisht i ngrohtë, i mbushur me shprehje të tilla si «populli rumun ka luftuar heroikisht», «ai u çlirua vetë», «Partia Komuniste e Rumanisë, parti heroike revolucionare», «Rumania socialiste lufton me heroizëm kundër imperializmit», «Partia Komuniste e Rumanisë dhe Çaushesku luftojnë për madhësinë e Rumanisë socialiste», «populli kinez frymëzohet nga ata», «populli kinez do t'i ndihmojë deri në fund» etj., etj. shprehje si këto.

Kujt ia bëjnë këto elozhe? Një revizionisti të afirmuar, një titisti, një proamerikani, që priti me aq brohoritje Niksonin, që gjoja sot është në kontradikta me sovjetikët, por që nesër prapë do të puqet me ta, pse ai është reaksionar, pa parime.

Zaten, në përgjigje të fjalimit të Çu En Lait, Çaushesku me sigurinë dhe me gjakftohtësinë më të madhe shtroi vijën e tij revizioniste. **Ai nuk tha asnjë fjalë për Revolucionin Kulturor, sikur të mos kishte ngjarë gjë, asnjë fjalë nuk përmendi kundër imperializmit amerikan, por u shpreh «për unitetin e vendeve socialiste dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare».**

Zëvendësministri i Jashtëm i Kinës, që ishte në një tryezë me ambasadorin tonë, i cili qëndronte i ftohtë e as duartrokiste, gjendet ngushtë dhe i thotë ambasadorit tonë: «Vazhdimisht e kemi këshilluar shokun Çaushesku se këto gjëra i shtron gabim dhe nuk duhet t'i shtrojë kështu». Ambasadori ynë i përgjigjet: «Kot e keni që e këshilloni, ai nuk mund t'i shtrojë ndryshe çështjet, se është revizionist i vendosur». — Ashtu është, — i tha kinezi.

Çausheskun e priti Maoja, HSINHUA-ja njoftoi vetëm se ai u tha: «Shokë rumunë, të bashkohemi për të rrëzuar imperializmin». Si zor që Çaushesku me shokët e tij të rrëzojnë imperializmin!! Në prittë bota një gjë të tillë nga Çausheskët, imperializmi do të rrojë me dhjetëra mijë vjet. Kundër imperializmit luftojnë proletariati dhe popujt.

Sidoqoftë, Çaushesku bën punën e tij, ndjek dhe mbron vijën e vet revizioniste, vazhdon turneun në Kinë në mes brohoritjesh e do të marrë me siguri kredi të majme «për të ndërtuar socializmin». Nga Kina ai do të hidhet te miku i tij, Kim Ir Seni. Nga Koreja do të shkojë në Vietnam, pastaj në Mongoli, ku e pret Cedenbali «i montuar» si ato kukullat mongole nga Brezhnjevi, dhe prej andej pastaj s'është çudi të vejë në Moskë, gjoja meqë i bie rruga, por duke lëshuar dhe duke marrë nga sovjetikët, me të cilët «është në kontradikta», sikurse pohon vetë aq me të madhe. Me siguri Çaushesku do ta vërë në dijeni Brezhnjevin për rezultatet e arritura në

Kinë, pa munguar të mburrë veten, do t'u flasë atyre për përshtypjet mbi Kinën dhe «shpresat» e mëdha që ushqen ai.

Toni i fjalimit zyrtar të Çaushekut dhe veçanërisht kur ai thotë: «Të bashkohemi në luftë kundër imperializmit, të forcohet uniteti i vendeve socialiste», të lë të dyshosh se ai ka vajtur në Pekin i ngarkuar me mision të veçantë nga sovjetikët. Ky mision duhet të konsistojë në shuarjen e polemikës me sovjetikët dhe në pajtimin ideologjik me ta.

Do të jetë shkarje në revizionizëm të hapët, po ta pranojnë një gjë të tillë shokët kinezë, por unë kam shpresë se Maoja këtë nuk e pranon. Po të jetë për disa të tjerë, ata i gjejnë mënyrat dhe e pranojnë.

Kjo është vija që predikonin Liu Shao Çia dhe Ten Hsiao Pini në kohën kur sulmi i revizionistëve sovjetikë kundër Partisë sonë dhe yni kundër tyre kishte arritur kulmin dhe zhvillohej me furi. Ne që në atë kohë u thamë kinezëve se «nuk ecim në këtë rrugë, po të doni shkoni, por do të jetë rrugë fatale për ju». Ata bënë si bënë, u tërhoqën dhe nuk u zu më në gojë kjo rrugë, por u shtua zjarri i luftës kundër revizionistëve sovjetikë. Tash na doli «politikani» rumun të na propozojë të futemi në vallen e tradhtisë, ku është zhytur vetë si në një gjiriz. Që të mos i hapë punë vetes, të mos kërkojë të përzihet me ne, le të qëndrojë atje ku është tok me shokët e tij, revizionistët e Moskës, të Beogradit e të tjerët ngado që janë.

Duke ditur disa dobësi të shokëve kinezë në vijë, strategjia e Çaushekut, e Titos dhe e padronëve të tyre synon që me taktika të ndryshme të krijojë përshtypjen në botë se rreth Kinës, me disa parime të caktuara, po krijohet një bllok (pa qenë një bllok) dhe lënë të supozohet se, meqë është Kina, është edhe Shqipëria me Rumaninë, me Jugosllavinë, me Korenë e Veriut e me Viet-

namin e Veriut. Këtij të ashtuquajturit grupim që tentojnë të krijojnë ata javash-javash, i japin edhe ngjyrën e një grupimi komunist marksist-leninist, me marrëdhënie partie me njëri-tjetrin, që zhvillohen me disa kontradiktat të brendshme, por të parëndësishme.

Këtë strategji dhe këto taktika antimarksiste dhe proimperialiste duhet t'i demaskojmë dhe t'i shkatërrojmë. Shokët kinezë nuk duhet të gënjejnë e të bien në këto kurthe dhe ne nuk duhet të pranojmë që të duket sikur në manovrat, të cilat i luajnë revizionistët me kinezët, jemi edhe ne brenda dhe i pranojmë ato. Në çdo çështje që paraqit rrezikshmëri, ne duhet të mbajmë qëndrimin tonë të pavarur, që opinioni ta kuptojë se ne nuk hyjmë në kombinacione me revizionistët, por kemi politikën dhe qëndrimet tona të pavarura marksiste-leniniste.

Me kinezët ne duhet të diskutojmë hapur, si shokë, për shumë nga këto gjëra që ne mendojmë se janë çështje të rëndësishme vije. Si kurdoherë, me ta ne do të jemi të hapët dhe të sqartë, sepse dëshirojmë që në unitetin tonë marksist-leninist të mos ketë asnjë hije. U pëlqejnë ose nuk u pëlqejnë shokëve kinezë vërejtjet tona shoqërore, atëherë kur duhet ne do t'ua themi. Ne mendojmë se kur gjërat thuhën haptazi, nga cilado palë, në interes të marksizëm-leninizmit dhe të vijës së përbashkët, ato janë pozitive dhe marksistë-leninistët s'ka se si të mos reflektojnë mbi to; edhe kur pikëpamjet janë të ndryshme, koha dhe zhvillimi dialektik e revolucionar i ngjarjeve vërtetojnë drejtësinë e çdo teze, të çdo qëndrimi, i drejtë ose i gabuar qoftë.

SHËNIM

Bisedova me shokët që delegacioni ynë bujqësor që vete në Kinë të shtrojë çështjen e avancimit të kërkesave tona për mekanizimin e bujqësisë.

KINEZËT PAS ÇAUSHESKUT PRESIN EDHE JUGOSLLAVIN TEPAVAC

Çaushesku është duke e mbaruar udhëtimin e tij në Kinë. Ministri i Punëve të Jashtme të Jugosllavisë, Tepavaci, do ta fillojë nesër ose pasnesër. Udhëtime të sinkronizuara. Njëri s'e lë vezën e tjetrit të ftohet. Të dy janë shokë, miq, aleatë revizionistë. Të dy, si rumuni ashtu edhe jugosllavi, hiqen si komunistë, marksistë-leninistë, antisovjetikë «të tërbuar», po aq «të tërbuar» edhe si antiimperialistë.

I pari, Çaushesku hiqet sikur e ka «diplomën» e marksistit dhe do ta përforcojë, duke kërkuar vulën e Maos. Tjetri, jugosllavi, «diplomën» e ka të grisur e të njollosur, por do ta ngjitë dhe ta lajë e ta shpëlajë prapë me vulën e Maos. Pra, kërkohet vula dhe, natyrisht, të dy këta «myteberë» që vrasin lart, kanë bashkërenduar veprimet, taktikat dhe strategjinë.

Kina po i pret, të paktën rumunin, që e dimë tash, me lule, me epitete, me mburrje, me gonge e me popull. Kjo është fasada. Do të shohim mënyrën e pritjes që do t'i bëhet jugosllavit. Besoj (por asgjë nuk dihet) se me popull Tepavaci nuk do të pritët, por nga Çu En Lai, shefi i diplomacisë dhe i çdo gjëje kineze, do të pritët patjetër, bilë pa humbur kohë. Jugosllavi Tepavac do të manovrojë aq bukur, do t'u thurë gjëra «aq të besueshme, aq interesante, aq në rregull politikisht», sa që

unë besoj se do t'i hapet edhe porta e Maos, të cilit ai mund t'i japë ndonjë mesazh përshëndetje shoqërore dhe miqësore nga ana e Titos.

Akulli u ça nën pretekstin e antisovjetizmit. Më vonë Titoja me Jovankën ose Çu En Lai mund të bëjnë nga një udhëtim nëpër vendet e njëri-tjetrit, «kuptohet» duke ruajtur gjithsecili mendimet që i ndajnë, por duke bashkëpunuar në ato që i bashkojnë.

Zanatçiu Tito dhe çiraku i tij i vogël, por me aspirata të mëdha, Çaushesku, nën maskën e antisovjetizmit, do të manovrojnë për afrimin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku kanë kokën dhe grazhdin. Mjerë ata që bien në kurthin e tyre!

Të uriturve u pëlqen edhe era e bukës. Titistët e kanë torbën plot me informata të servirura në një shkallë të lartë dhe të përgatitura në kuzhina speciale të spionazhit perëndimor. Ata kalojnë lehtë në vrimë të gjilpërës, si diplomatë të rafinuar, bile si «marksistë», në rast se nuk mprehet vigjilenca ndaj tyre. Ata janë mashtrues të stërvitur për të hedhur të tjerët në kllapa, duke lavdëruar një shtet të madh ose një shtet të vogël. Pak punë u prish, ata janë gati «të njohin» gabimet e bëra ndaj të tjerëve, pa njohur asgjë, derisa të të futin thonjtë në grykë.

Çaushesku propagandoi se, për të shkuar në Kinë, nuk do të kalonte nga Moska. Tash që siguroi vajtjen në Pekin, deklaroi se do të vizitojë edhe Mongolinë, koloninë sovjetike. Ambasadorët rumunë në Evropë po përgatitin terrenin e kalimit të Çausheskut nga Moska për të afirmuar këtë herë «neutralitetin» dhe për atë që ai punoi në Kinë për «unitetin e vendeve socialiste».

Ç'do të shpjerë tjetër Çaushesku në Moskë, ne nuk e dimë, por sigurisht ai do të çojë sigurime të tilla si «shokët kinezë po spastrojnë vijën nga teprimet» etj., etj.

Pra, atë që na e thonë edhe neve, shokët kinezë ia thonë më me hollësi mikut dhe shokut të tyre, Çausheskut.

Sigurisht, Çaushesku do t'u këshillojë sovjetikëve të kenë ca durim, të mos i «bruskojnë» punët, pse ata dhe titistët janë duke punuar. Revizionistët do të vazhdojnë të bëjnë zanatin e tyre dhe të fitojnë pare nga klientët të cilëve u bëjnë shërbime të posaçme.

S'mund të bëjë përjashtim nga Titoja, të cilit Nikolae Çaushesku aspiron t'i zërë vendin dhe ta luajë ky rolin e tij, të marrë kurdoherë, pas një veprimi tradhtie e pazarllëku, çekun me dollarë ose me rubla. Çdo gjë nga këto që them është vërtetuar dhe përsëri në të ardhmen do t'i vërtetojë koha.

E MARTE
8 QERSHOR 1971*

ÇEN PO TAJA AKUZOHEP PËR TË GJITHA GJYNAHET

Gën Biao, ish-ambasador i Kinës në vendin tonë e që tash është drejtor i Drejtorisë së Jashtme të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, i tha ambasadorit tonë në Kinë afërsisht këto gjëra: Jemi shumë të zënë me punë, se po spastrojmë vijën nga shtrembërimet dhe gabimet e rënda që ka bërë Çen Po Taja.

Cilat janë këto gabime që ka bërë Çen Po Taja? Zhvillimi i kultit të Maos, thurja e himneve për Maon; mbushja e mureve me citate e me portrete; propaganda e fryrë dhe pa përmbajtje; studimi i teorisë jo me baza të thella; fshehja e të metave; tendenca për të nxjerrë për cdo gjë të parë Kinën etj., etj.

Shumë mirë, po korrigjojnë të metat dhe gabimet në vijë. Kjo është pozitive. Por përsëri shtrohet pyetja: Vetëm «i poshtri Çen Po Ta» i paska bërë këto? Nëse ishte apo jo Çen Po Taja i poshtër, ata e dinë më mirë. Po të tjerët ku kanë qenë? Përse i lejuan këto «gabime në vijë»? Dhe në ç'kohë i lejuan? Pikërisht kur po luftohej grupi i Liu Shao Çisë dhe kur vigjilenca për pastërtinë e vijës duhej të ishte shumë e mprehtë!

Mbushjen e mureve me citate e portrete, studimin jo të thellë të mendimit e të ideve të Mao Ce Dunit në format, në metodat që u përdorën për të, dhe thurjen e himneve (që e orkestronte dhe e drejtonte vetë Çu En

Lai), vetëm Çen Po Taja i paska krijuar dhe vënë në zbatim? Kështu ky po na del një «diktator i çuditshëm», që s'peshon njeri, që s'pyet njeri, që bën si di dhe si do vetë. Po të tjerët ç'bënin? Flinin? Të paktën vetëm për këtë a nuk e meritojnë të kritikohen? Fli një herë, fli dy herë, kush siguron se nuk do t'i zërë gjumi për herë të tretë?!

Po vërtetohen të gjitha ato që kemi thënë ne mbi këto çështje dhe për të cilat kemi dhënë gjykime nga faktet e jashtme. Mirëpo, megjithatë, disa çështje, edhe pse kanë qenë jashtë normave të një partie marksiste-leniniste, gjatë zhvillimit të Revolucionit Kulturor kemi thënë se *a la rigueur*¹ mund të bëheshin, si për shembull, autoriteti i Maos ishte i nevojshëm të ngrihej në ato rrethana për të triumfuar mbi bandën e Liu Shao Çisë etj.

Mirëpo shokët kinezë na thonë tash se ky spastrim i vijës po bëhet «në funksion të daljes së Kinës në arenën ndërkombëtare», «për të qenë në rregull me miqtë e huaj e të tjerë». Në qoftë se bëhet për këto arsye, prapë nuk është parimore, është koniunkturale, bie erë oportunistem.

A do të ruhen parimet marksiste-leniniste në vijën, në strategjinë dhe në taktikën aktuale që adoptojnë Partia Komuniste e Kinës dhe qeveria kineze? Këto zbutje dhe zgjerimi progresiv ala Çu En Lai a do t'i ruajnë caqet e një vije të fortë në parime dhe elastike në veprim, apo elasticiteti të dominojë mbi parimet, derisa t'i shtrembërojë dhe më në fund të gjendet prapë një Çen Po Ta tjetër për t'ia hedhur të gjithë fajin, ose ndonjë Çen Po Ta tjetër të triumfojë dhe Çen Po Ta të bëhen ata që mbronin vijën e kundërt dhe parimet?

Në qoftë se ndiqet rruga që t'u pëlqejë të huajve, ne e dimë se çfarë duan këta; dimë, gjithashtu, se kjo rrugë

1 Frëngjisht — në fund të fundit.

nuk hapet përnjëherë, por përgatitet, zbatohet progresivisht, propagandohet «duke e ilustruar» me teorinë marksiste-leniniste, me idetë e Mao Ce Dunit, vihen «mirë» në dukje nga propaganda e brendshme dhe nga «miqtë e jashtëm» «të mirat, sukseset, fama ndërkombëtare» që solli «kjo vijë marksiste-leniniste kaq e zgjuar dhe e zhdërvjellët».

Kështu që Çaushesku e filloi punën duke vajtur zyrtarisht në Kinë, e megjithëse s'foli fare për Revolucionin e Madh Kulturor, atij iu bënë nderime shumë të mëdha, iu dhanë shumë ndihma, u quajt «marksist-leninist». Jugosllavi Tepavac ndjek Çausheskun. Titistët jugosllavë janë mjeshtër për intriga. E shohin që hekuri kinez është i nxehtë dhe shpejtojnë ta rrahin, që të mos e lënë të ftohet.

Kinezët na thanë se kanë vendosur të lejojnë të hyjnë në Kinë senatorë amerikanë, afaristë, gazetarë, sociologë etj. Kështu filluan edhe sovjetikët.

Larg qoftë se mos ngjasë ndonjë gjë!

E SHTUNE
12 QERSHOR 1971

ÇU EN LAI PRITI NGROHTËSISHT TEPAVACIN

Edhe Çu En Lai e priti ngrohtësisht titistin Tepavac, i cili iu lut t'i transmetojë Mao Ce Dunit të falat e përzemërta nga ana e Titos. Kaq dimë deri tash.

NË KINË PRITET MINISTRI I JASHTËM TITIST

Vajtja e Tepavacit në Kinë bëhet me ftesën e qeverisë kineze. Ai u prit në aerodromin e Shangait me popull, me flamuj dhe nga autoritetet kryesore të qytetit. Në aerodromin e Pekinit pritja qe më e ngrohtë. Kishin dalë me lule, me flamuj e me gonge më se 5 000 veta. Atë e priti Li Hsien Nieni me suitën e tij të zakonshme.

Jugosllavi mbeti i kënaqur nga pritja. Këtë e shpreh edhe shtypi titist. Kinezët, gjithashtu, kanë mbetur shumë të kënaqur. Këtë e shprehu Li Hsien Nieni në fjalimin e tij në banketin që shtroi. Këtë e thonë artikujt e «Zhenminzhibaos», të cilët ka ditë që zënë edhe nga një faqe të tërë për këtë problem.

Ambasadorit tonë në Pekin deri tash nuk i kanë zënë në gojë asnjë fjalë. Gjykojmë vetëm nga fjalimet e Li Hsien Nienit dhe të Tepavacit.

Li Hsien Nieni i foli jugosllavit me një ton shumë të ngrohtë, shumë miqësor, ai nuk zuri në gojë çështje partie, ideologjike, ose çështje për të cilat s'janë «dakord»; me sa vërejta unë, ai nuk tha se në Jugosllavi ndërtohet socializmi, por e la të kuptohej një gjë të tillë, kurse për të gjitha të tjerat foli dhe e mbylli fjalën e tij duke ngritur dolli për shëndetin e Titos. Li Hsien Nieni i mburri revizionistët jugosllavë në mënyrë të bujshme, por njëkohësisht edhe me servilizëm (me qëllim të dukshëm afrimi dhe pajtimi).

Përveç vlerësimit të lartë të heroizmave të popujve të Jugosllavisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjë që është reale dhe me vend të thuhet, Li Hsien Nieni (pa adresë) ekzaltoi edhe luftën aktuale që na bëkan jugosllavët kundër imperializmit!!, luftën dhe rezistencën e tyre kundër një fuqie të madhe, që këto kohët e fundit (!!) po ndër-hyn në punët e Jugosllavisë. (Me «fuqi të madhe» kuptohet Bashkimi Sovjetik, po këtë mund ta kuptosh edhe për kohën e Stalinit.)

Li Hsien Nieni lavdëroi politikën e Titos «në botën e tretë» dhe rolin e madh të jugosllavëve titistë në këtë drejtim. Ai falënderoi për ndihmën e vazhdueshme që Jugosllavia i ka dhënë Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, vuri në dukje qëndrimet «e drejta» të titistëve ndaj Vietnamit, ndaj Kamboxhias, ndaj vendeve arabe etj., etj. si këto, dhe përfundoi se do të bashkëpunojnë, do të bashkekzistojnë, do të ndihmohen etj., etj. fjalë të bukura e të mira, sikur të mos kishte ndodhur gjë fare në mes të marksistë-leninistëve dhe titistëve.

Kurse fjalimi i Tepavacit ishte plot nuanca, i sigurt për ato që thoshte, fjalim diplomati, i ngrohtë dhe njëkohësisht i ftohtë si gjaku i gjarprit. Titisti parashtrroi vijën e tij, duke vënë mirë pikat mbi i. Ai bëri disa mburrje normale për kinezët (marshimi i gjatë, durimi kinez), por s'mungoi të thoshte se «nuk e njohim mirë njëri-tjetrin», se «ne, jugosllavët, nuk jemi kundër fuqive të mëdha, por kundër diktatit të tyre», se «gjendjen në botë ne e shohim të shqetësuar», se «ne në Jugosllavi ndërtojmë socializmin»; se «ne jemi për Sigurimin evropian», gjë që ia aprovoi Li Hsien Nieni në fjalimin e tij etj., etj. Nuk munguan propozimet për bashkëpunim miqësor në të gjitha fushat dhe titisti e mbylli «buketën» e tij me dolli, në mes të të cilave katër ishin dolli të veçanta: një për Maon, një për Lin Biao, një për Çu En Lain dhe më në fund një për Li Hsien Nienin (katër veta që

drejtojnë Kinën). Me siguri, kinezëve u është bërë shumë qejfi.

Më vonë Tepavaci bëri disa vizita andej-këtej në ndonjë fabrikë, në murin kinez, në varret e perandorëve dhe hëngri, sipas zakonisht tradicional kinez, me shkopinj. Të gjitha këto kinezët i vunë në dukje. Më në fund atë e priti në audiencë të ngrohtë Çu En Lai. Ç'u tha, ç'u bisedua, nuk thuhet asgjë. Ambasadorit tonë nuk i thonë gjë, as për përfundimin e bisedimeve me Çaushekun, as me Tepavacin. Mirë, presim, kemi durim.

Por një tendencë është e qartë. Rumunët, nga njëra anë, nën maskën e komunistëve dhe me marrëdhënie partie, jugosllavët, nga ana tjetër, nën maskën e komunistëve, por që kinezët akoma «nuk i njohin si të tillë dhe nuk kanë marrëdhënie partie», bëjnë përpjekje dhe po ia arrijnë qëllimit të afrohen me Kinën, të tregohen dhe të bëhen miqtë e saj më të mirë në botë. (Me përjashtim, hëpërhë të Shqipërisë, mendojnë këta, e cila, sipas tyre e mundet edhe sipas kinezëve, të kapërcehet, ose duke hyrë në kombinacionet e tyre, ose duke mbetur si diçka e parëndësishme dhe anakronike.) Kësaj tendence, këtij fyelli po i fryn edhe Kina.

Aktualisht Kina konsideron «mik dhe shok të parë» Shqipërinë dhe Partinë e Punës të Shqipërisë, në radhë të dytë Vietnamin dhe Korenë, në radhë të tretë, — këtu ylli i saj ngjitet në Evropë, — Rumaninë dhe Jugosllavinë. Në miqësinë me këta pseudokomunistë të Evropës revizioniste dhe proamerikanë dominon tendenca antisovjetike. Pikërisht në antisovjetizmin mbështeten kinezët për zhvillimin e miqësisë me këto dy vende, gjoja në platforma shtetërore, por me një platformë shumë të zbutur ideologjike. Rumania me Jugosllavinë, po ashtu, përfitojnë nga kontradiktat sovjeto-kineze për të dobësuar kontradiktat e tyre me sovjetikët.

Të dyja palët duan të përfitojnë nga situatat që kri-

juan dhe që pompojnë. Dy kalanderët evropianë fuqizojnë pozitën e tyre përpara amerikanëve dhe shteteve të tjera kapitaliste, si edhe në «botën e tretë», duke u treguar atyre se ata janë miqtë e një fuqie kolosale që po ngrihet dhe pa të cilën s'mund të vazhdohet të ecet. Nënkupto- het se revizionistët jugosllavë e rumunë janë bashkautorë të një diçkaje të madhe që po përgatitet.

Kurse Kina nga ana tjetër, dhe unë mendoj se ajo gabon dhe llogaritë nuk janë në favorin e saj, kërkon të mbështetet mbi dy forbans¹ politikë ndërkombëtarë, që nuk të ndreqin punë, por afrimi me ta të ndot. Ne do të jemi spektatorë të një zhvillimi të tillë jonormal për Kinën. Format nuk mund të fshehin për shumë kohë përmbajtjen.

Mund të flitet shumë për bashkekzistencën, bile kjo të quhet edhe me germa të mëdha «leniniste», por çështja varet nga përmbajtja. Ajo duhet të jetë me të vërtetë leniniste, ndryshe e mori dreqi atë bashkekzistencë. Do të shohim! Do të shohim! Qofshim të gabuar ne! Ne jemi gati të bëjmë autokritikë, në rast se asnjë nga këto që parashikojmë, nuk realizohet. **Por populli thotë: «Fshati që duket, s'do kallauz».**

1 Frëngjisht — keqbërës pa skrupuj.

ÇAUSHESKU NË KORE

Çaushesku i Rumanisë vazhdon udhëtimin e tij triumfues te miku i tij, Kim Ir Seni. Ai vazhdon të grijë për «unitetin e vendeve socialiste dhe të lëvizjes komuniste botërore», «të luftës kundër imperializmit» (pa adresë).

TITOJA KA LËSHUAR SOS-IN

Falimentimi i titizmit nuk mund të mbulohet më. Titoja me gojën e tij po e pohon kath e çdo dy-tri ditë me fjalimet e veta¹. Ai në këto fjalime nuk lë gjë pa prekur, asgjë nuk mund ta mbajë fshehtë, pse gjendja ka ardhur në buzën e greminës dhe pikërisht këtë gjendje ai e vë në dukje pa dorashka, për t'i bërë thirrje popullit të përballojë katastrofën e afërme dhe kërkon ndihmën e tij për ta shmangur. Një kambanë bie disi pa ndryshuar, ajo që gjoja **vetadministrimi është në rregull, është e vetmja rrugë që duhet të mbështetet**. Ky është «parimi» që sorollat Titoja në të gjitha fjalimet e tij, po tërë përmbajtja e çdo fjalimi vë në dukje se vetadministrimi titist Jugosllavisë i solli katastrofën.

Natyrisht, deri këtu Titoja nuk shkon dhe nuk mund të shkojë, pse atëherë s'ka ku mbahet fare, po përpiqet «të vërtetojë» se të gjitha të këqijat që i kanë pllakosur vijnë për arsye se «vetadministrimi nuk është kuptuar

¹ Gjatë muajve maj-qershor 1971, Titoja ka mbajtur disa fjalime publike në vende të ndryshme të Jugosllavisë. Dy herë ka folur në kongresin e vetadministruesve jugosllavë në Sarajevë, më 5 dhe më 8 maj. Këto fjalime karakterizohen nga demagogjia dhe përpjekjet e tij të mëdha për të justifikuar e për të mbuluar të çarat dhe dështimet e vetadministrimit e të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë dhe nga sulmet e kërcënimit e ashpra ndaj kundërshtarëve të tij për pushtet në Jugosllavi.

mirë», «nuk është zbatuar mirë», «është shtrembëruar» dhe po «luftohet nga armiqtë e jashtëm e të brendshëm», të cilët, tash së fundi Titoja ka filluar t'i quajë «agjentë të fuqive të huaja».

Titoja pohon me gojën e tij se «janë bërë gabime në investimet», se «kemi qenë shumë liberalë në ndërtimin e të ashtuquajturave fabrika politike», se «janë ndërtuar kudo fabrika të njëjta dhe pavarësisht nëse ka apo jo lëndë të parë» etj. Ankohet se në Jugosllavi ka vjedhje të mëdha, se çmimet ngrihen çdo ditë. Ç'duhet të bëjmë? — pyet Titoja dhe vetë thotë — duhet të bëjmë diçka, të përqendrohen ndërmarrjet, pra, të krijohen koncertet, gjë që do të thotë «adio vetadministrimi punëtor», të unifikohen bankat etj. E ç'nuk thotë Titoja gati çdo ditë, përmend një sërë problemesh kaotike, që duan zgjidhje, po që kjo nuk u jepet dot.

Pas gjithë këtyre, Titoja, çirret i zemëruar «do t'i godasim» këto shfaqje dhe bartësit e tyre, «s'kam frikë» etj., etj., por në fakt nuk bën gjë. Tash kundërshtarët e tij në Beograd, siç thotë vetë Titoja, thonë: «Shoku Tito shumë herë është kërcënuar. Edhe tani po kërcënon, por edhe kjo është një pushkë boshe».

Titoja ka folur edhe herë të tjera dhe po flet përsëri për Lidhjen e Komunistëve, po këto ditë në një aktiv në Beograd e hapi fare kapakun e qelbësirave. Kësaj radhe ai u detyrua të pranonte se **Lidhja e tij ka degjeneruar, është mbushur me aventurierë, karrieristë, armiq, janë thyer parimet, nuk ekziston centralizmi, kërkohet që të vendoset edhe në parti decentralizmi etj.** «Në organizatat e Lidhjes së Komunistëve, thotë tekstualisht ai, vihen re shumë shfaqje negative e shpërdorime. Ka mjaft njerëz që vazhdojnë të jetojnë në njëfarë mase në llogari të të tjerëve. Ndryshe si ka mundësi ndonjëri të blejë edhe një anije me vleftë prej disa dhjetëra milionë dinarësh. Kjo nuk mund të arrihet vetëm me anën e pagës».

Përsëri kërcënon se këtë gjendje nuk do ta lejojë kurrë(!) «Lidhjen, — çirret ai, — duhet ta riorganizojmë»; kërkon që nga radhët e saj të largohen ata që nuk i binden Titos dhe të mos e detyrojnë «të bëjmë spastrime» etj., etj.

Për të treguar në ç'gjendje të keqe ndodhet sot Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë, Titoja evokon periudhën para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur, sipas tij, në parti ka pasur disiplinë, zbatoheshin direktivat etj. dhe thotë: «Kur punoja në Komintern, më është dashur të zhvilloja një luftë, si të thuash, për ekzistencën e partisë sonë. Veçanërisht vështirë e kam pasur me disa përfaqësues të Partisë Komuniste Bullgare në Komintern» (aluzion për G. G. Dimitrovin) etj., etj.

Të tilla gjëra grin Titoja sot, kur detyrohet të thotë se njerëzit e Lidhjes së Komunistëve as binden, as marksistë janë. Çdo filozofi tjetër kanë përqaftuar ata, po jo marksizmin. Prandaj bën thirrje të futet «marksizëm-leninizmi në shkolla»(!), (tash u kujtua ai për këtë), të kemi një parti kuadrosh etj. Më në fund, për ta shkarkuar veten nga çdo përgjegjësi, nuk i vjen zor të thotë se ai nuk ka thënë se partia duhet të jetë kështu e ashtu etj., etj.

Çfarë trockist i poshtër e rrenacak! Asgjë s'merr përsipër, ndërsa vetë ky është krimineli numër një. Kur thuhet se partia «ka qenë në rrugë të mirë» hiqet si autori i saj, pastaj se si u bë, për këtë çuditet, sikur nuk ishte po ky në krye gjatë katastrofës, kurse tash në fund na zgjohet nga gjumi, me «duar të lara», sikur s'ka bërë gjë dhe, duke kritikuar andej e kënde, po jep receta për «shërimin e situatës». Mjerë e sëmura e rëndë Jugosllavi, në çfarë doktor kasap ka rënë!

E MARTË
22 QERSHOR 1971*

SHOKËT KINEZË NA «INFORMOJNË» MBI BISEDIMET ME ÇAUSHESKUN

Informacion i thënçin! Ky u bë nga një person i kartërt apo i pestë i Drejtorisë së Jashtme të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës dhe jo nga Gën Biaoja, siç i kishte thënë ky vetë ambasadorit tonë, por që s'e bëri se gjoja ishte i zënë me punë!

Informacioni ishte plot gjëra të përgjithshme, jo vajtje, jo ardhje, ato që ka dhënë HSINHUA-ja dhe janë botuar në gazeta, citate nga fjalimet publike të Li Hsien Nienit dhe të Çausheskut.

Pastaj u tha se Çaushesku kishte vajtur në Kinë që të forconte pozitat e tij dhe të Rumanisë në botë, t'u kërkonte kinezëve ndihmë ekonomike «pse ishte në vështirësi» dhe kinezët i dhanë 60 milionë dollarë në devizë e në mallra.

Çaushesku u propozoi kinezëve që të pushonin polemikën kundër «Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe partive të tjera të vendeve socialiste», të futeshin në KNER dhe të merrnin pjesë në organizatat ndërkombëtare, si në Federatën Sindikale Botërore etj., dhe të përmirësonin marrëdhëniet me partitë e tjera revizioniste të botës për hir të unitetit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare.

Më në fund, si konkluzion, kinezët i thanë ambasadorit tonë se bisedimet përfunduan me sukses, u forcua

«lufta kundër imperializmit amerikan dhe socialimperializmit sovjetik». Çaushesku foli mirë në këtë drejtim për Kinën, për ndërtimin e industrisë dhe, siç u shprehën kinezët, ai tha: «Për këto shkruhet në shtypin rumun dhe kemi filluar të edukojmë popullin rumun».

«Çdo gjë shkoi mirë me Çausheskun, — i thanë ambasadorit tonë kinezët, — por patëm edhe kontradikta me të. Ne nuk ishim dakord ta shuanim polemikën me sovjetikët as për 8 000 vjet; ne nuk bashkohemi me ta në luftën kundër imperializmit; ne nuk futemi në organizatat ndërkombëtare dhe revizionistët do t'i luftojmë jashtë këtyre organizatave dhe jo duke marrë pjesë në to».

Këto ishin kundërshtimet. Për të gjitha të tjerat bisedimet shkuan si në gjalpë. Çaushesku i siguroi kinezët se sovjetikët nuk do t'i sulmojnë dhe s'ka më rrezik për një Çekoslovaki të dytë. Siç shihet «të gjitha të mirat» u sollli kinezëve Çausi i Rumanisë.

E ç'hyjnë në punë ato që na thonë kinezët neve në vesh? Çausi në shumë çështje u imponoi atyre hapin e tij. Ai nuk i la kinezët që t'i sulmonin revizionistët sovjetikë, tregoi kujdes që në komunikata e në fjalime as të mos lihej të kuptohej se Bashkimi Sovjetik u bie në qafë rumunëve, por propozoi dhe ishte gati të ndihmonte që Kina t'u hapte krahët revizionistëve sovjetikë. Çausi nuk donte të ndryshonte asgjë nga formulimet e tij revizioniste. Qëllimi i tij, për të sjellë sa më afër kinezët me pikëpamjet e tij, ishte i qartë.

Çausi u përpoq të vuloste se sa vende janë socialiste, po në këtë kurth kinezët nuk ranë.

Por, vallë, a e kuptuan kinezët kush është Çaushesku? Në qoftë se e kuptuan, atëherë përse ia bënë gjithë atë pritje, gjithë atë salltanet, gjithë ato mburrje?

Çaushesku donte të eliminonte deri edhe termin «partitë marksiste-leniniste», kur flitej në komunikatë për të dyja partitë, por të thuhej «partitë motra». Është i qartë

aluzioni dhe objektivi. Kinezët, natyrisht, «i hodhën ujë dhe e lanë Çaushin», duke ngulur këmbë që të përdorej termi «parti marksiste-leniniste». Kështu që Partia Komuniste e Rumanisë e mori vulën nga kinezët që është një «parti marksiste-leniniste», kur ajo është fund e krye një parti revizioniste.

Ç'del nga e gjithë kjo? Është e qartë se marrëdhëniet shtetërore sunduan mbi vijën ideologjike të Partisë Komuniste të Kinës. Kjo e fundit, vija ideologjike, iu nënshtrua së parës. Shumë parime bazë ideologjike dhe vije u shkelën, u shtrembëruan, ose u zbehën. Të tria këto ngjanë jo rastësisht, por me bindje të plotë ideologjike. Nuk kanë rëndësi frazat me shumë kuptime që na thonë neve «në vesh» se «duke kaluar nëpërmjet bisedimeve dhe vizitës ne i njohim kush janë ata» (!). Shumë vonë i njohën!! Nuk kanë pasur, vallë, kohë t'i njihnin më parë?! Kanë pasur sa të duash kohë dhe vepra plot që vërtetonin ç'janë Çaushesku me shokë. Po sa rëndësi ka një fjalë në vesh, kur qëndrimet zyrtare flasin të kundërtën, kur vendimet dhe veprimet e bashkëpunimit politik, ideologjik, ekonomik, deri edhe ushtarak flasin ndryshe? Ne jemi të bindur se ngjarjet e mëvonshme do të na japin të drejtë. Çdo gjë ne e shohim në prizmin politik dhe ideologjik, nuk i konfundojmë marrëdhëniet shtetërore me ato partie, por edhe marrëdhëniet shtetërore nuk qëndrojnë jashtë sferës së politikës dhe të ideologjisë së partisë, prandaj edhe në drejtim të tyre ne bëjmë kujdes të madh që të mos kapërcehen caqet. Armiqtë bëjnë shumë përpjekje e përdorin një mijë dredhi për të të futur në rrugën e bastardimit të vijës marksiste-leniniste. Që të mos shkasësh në rrugën e armikut, duhen formimi, pjekuria, bindja dhe vendosmëria ideologjike në marksizëm-leninizmin. Po i ke këto, ecën përpara, pa qenë as sektar, as oportunist, as nuk shkon drejt izolimit dhe as rrëshqet në revizionizëm e në prehrin e kapitalizmit.

E MËRKURË
23 QERSHOR 1971

SHËNIM

Shokët Hysni dhe Ramiz më raportuan për bisedën që patën me anëtarin e Byrosë Politike të KQ të PK të Brazilit që ndodhet në vendin tonë. Ai u tha, në mes të tjerash, që momentet në vend janë pjekur për luftën e armatosur.

E PREMTE
2 KORRIK 1971

TAKIM ME VIKTOR EFTIMIUN

Prita, në selinë e Komitetit Qendror të Partisë, shkrimtarin e shquar rumun me origjinë shqiptare, Viktor Eftimiu¹. Pata me të një bisedë të përzemërt e të gjatë. I fola për respektin që kemi për talentin e tij të madh, për përparimet e vendit tonë, për fshatin e tij të lindjes, Boboshticën etj. Eftimiu foli për mallin e madh që kishte për atdheun e tij dhe me simpati foli edhe për arritjet tona.

¹ Procesverbali i takimit gjendet në Arkivin Qendror të Partisë.

E PREMTE
16 KORRIK 1971

NIKSONI FTOHET TË VIZITOJË KINËN

Sot, nëpërmjet agjencisë së lajmeve HSINHUA, Kina shpalli publikisht se ka ftuar presidentin amerikan Nikson të shkojë në Pekin, para majit të vitit 1972. Po kjo ç'do të thotë?! E çuditshme!

PRITJA E NIKSONIT NË KINË ËSHTË NJË GABIM I MADH OPORTUNIST

Niksoni do të vejë në Pekin. Ne s'jemi dakord, pra-ndaj mendoj t'u bëjmë një letër kinezëve. Ja cilat do të ishin tezat kryesore:

Falënderim për informacionin që shoku Çu En Lai i bëri ambasadorit tonë në Pekin, i cili erdhi apostafat në Tiranë dhe na raportoi se çfarë i qe komunikuar. (Mundësisht, në hyrje, të bëhet një përmbledhje shumë koncize, duke përdorur shprehjet autentike të Çusë, për ato probleme që ne do t'i ngremë ose do t'i kontestojmë, por që e gjitha të ketë një rrjedhim logjik. Me këtë ne u themi shokëve kinezë se përgjigjja jonë mbështetet në informacionin e Çusë.)

Do të bëjmë një tiradë ku të tregohet se të dyja partitë, të dyja qeveritë dhe të dy popujt tanë kanë luftuar në një vijë në ballë të frontit kundër imperializmit amerikan, imperializmit revizionist sovjetik e reaksionit botëror dhe kanë korrur suksese etj., etj. Këta armiq kanë sulmuar vendet tona, partitë tona, marksizëm-leninizmin, por kanë dështuar, janë demaskuar dhe uniteti ynë është kalitur.

Do të flasim për rolin e madh të Kinës në arenën ndërkombëtare, si e kanë luftuar të tjerët dhe si e kemi mbrojtur ne.

Do të flasim për Revolucionin Kulturor, për shpresat e armiqve dhe fitoren e këtij revolucioni në Kinë.

Me ecjen përpara të Revolucionit Kulturor dhe ndryshimin në balancën e forcave, armiqtë fillojnë t'i buzëqeshin Kinës, miqtë e rremë hiqen si miqtë e saj të singertë, tradhtarët revizionistë, me kohë në shërbim të imperializmit amerikan dhe në divergjencë koniunkturale me revizionistët sovjetikë, hiqen si miq të Kinës, armiq të sovjetikëve, armiq të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe miq të vendosur të «botës së tretë». Të tërë flasin për bashkekzistencë paqësore; shumë shtete njohin Kinën dhe Shqipërinë. Kësaj koniunkturë të favorshme, të krijuar jo nga dëshira e armiqve tanë, por nga lufta jonë e vendosur, ne duhej t'i përgjigjeshim në mënyrë të favorshme, kurdoherë që paraqitej rasti dhe kurdoherë duke ruajtur parimet dhe dinjtetin e shteteve tona socialiste.

Ne kemi qenë dhe jemi për atë që Kina të dalë në arenën ndërkombëtare si një shtet i madh e i fuqishëm socialist dhe, tok me të, të gjithë ne, të gjithë popujt e botës të thonë fjalën e tyre, të imponojnë vullnetin e tyre dhe të shkatërrojnë planet djallëzore, luftënxitëse, kolonialiste, skllavëruese të fuqive të mëdha imperialiste, sovjetike, amerikane e të tjera.

Mendojmë se duhet bashkërendim i luftës sonë të përbashkët, sidomos kur është çështja për një «strategji të madhe». Ne, pra, duhet të kuptohemi drejt nga ju, nuk kemi qenë, as jemi dhe as do të jemi kurrë që Kina e madhe të mos bisedojë me kë të dojë e të mos lidhë marrëdhënie diplomatike me kë të dojë, qoftë edhe me imperializmin amerikan. Por, kur vjen çështja e ndryshimit të një taktike, pa lëre të strategjisë, ndaj imperializmit amerikan, ne mendojmë se duhen konsultime në mes miqve të ngushtë për të peshuar edhe minuset, edhe pluset e hapit që do të bëhet, kur ky hap ka efekt dhe jehonë të madhe ndërkombëtare.

Pa pasur marrëdhënie diplomatike me Shtetet e Bash-

kuara të Amerikës, por, përkundrazi, duke pasur një gjendje armiqësore në mes të dy shteteve dhe, mbi të gjitha, duke ditur se kemi të bëjmë me armikun numër një të popujve, të presësh presidentin Nikson dhe të bisedosh me të nuk është e drejtë dhe as që do të pranohet nga popujt, nga revolucionarët, nga komunistët e vërtetë. Ne jemi nga ata që nuk e pranojmë këtë vendim dhe nuk do ta mbështetim.

Ne do të shprehim bindjen se shokët kinezë nuk do të bëjnë lëshime në parimet, se ata do të luftojnë si duhet kundër imperializmit amerikan dhe se **ky qëndrim, i lojgjikshmi, marksist-leninisti, do të bjerë përnjëherë në kundërshtim flagrant me vendimin që kanë marrë, të cilin ne do ta quajmë të shpejtuar.**

Duhet t'u theksojmë se armiqtë, — imperializmi amerikan, revizionizmi sovjetik, titizmi, revizionistët rumanë dhe i gjithë reaksioni botëror, — i kanë akorduar telat për diskreditimin e politikës së Kinës. **Të mos harrojmë se guri i provës dhe ajo që na ndan nga armiqtë, është lufta e ashpër pa kompromis, dhëmb për dhëmb në radhë të parë me imperializmin amerikan dhe me social-imperializmin sovjetik.**

Neve na duket se vazhdimi i bisedimeve me amerikanët për probleme që paraqitin rëndësi për Republikën Popullore të Kinës dhe për çështjet botërore, **ka rëndësi në disa kushte të caktuara dhe pikërisht: kur janë në interes të Kinës dhe të çështjes së revolucionit në përgjithësi; kur shkohet në këto bisedime në kushte të paktën të barabarta, posaçërisht për Kinën; kur Shtetet e Bashkuara të Amerikës të kenë njohur Qeverinë e Republikës Popullore të Kinës si të vetmen qeveri të ligjshme të popullit kinez, kur të kenë hequr trupat nga Tajvani etj., dhe kur nga këto bisedime nuk cenohen interesat e popujve, të revolucionit dhe të marksizëm-leninizmit.** Në këto kushte ne nuk jemi kundër bisedimeve dhe e kuptojmë

se, për të arritur aty, bisedimet mund edhe të shkallëzohen, natyrisht me shumë kujdes, **por ne nuk jemi dakord që këto shkallëzime të shkojnë nga «kontakte pa asnjë vlerë» përnjëherë në takimin e personaliteteve më të larta të të dy shteteve, të Kinës dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pse paska shfaqur dëshirën shumë herë Niksoni! Ky nuk mund të quhet më një «shkallëzim i thjeshtë bisedimesh», por një shkallëzim shumë i komplikuar dhe me pasoja, mendojmë ne.**

Ne nuk kemi dëgjuar gjë për «dëshirën e zjarrtë të Niksonit për tre vjet rresht për të ardhur në Kinë», por po ju besojmë juve. **Dëshirat e këtij presidenti fashist për të ardhur në Kinë janë të kuptueshme, ato janë dëshira të një agresori, vrasësi të popujve, armiku të komunizmit, të socializmit, veçanërisht të Kinës, së cilës i ka pushtuar Tajvanin dhe i ka kurdisur komplete tok me revizionistët sovjetikë. Ai është veçanërisht armik i Shqipërisë, të cilën Shtetet e Bashkuara të Amerikës as që kanë dashur kurrë ta njohin si Qeveri Demokratike Popullore dhe kanë kurdisur një mijë komplete kundër saj, me titistët, me monarko-fashistët grekë, me neofashistët italianë dhe me socialimperialistët revizionistë sovjetikë.** Prandaj ne, nga ana jonë, as e kemi pasur ndër mend t'i vëzhgonim «këto dëshira» të këtij xhelati, që kishin për qëllim diskreditimin e Republikës Popullore të Kinës, përçarjen e saj nga miqtë dhe daljen e tij gjoja me degën e ullirit, në një kohë kur mbi Vietnam e gjetkë lëshoheshin sasi të tmerrshme bombash. Por ne jemi nisur nga mendimi që, ashtu si Shqipëria, edhe Republika Popullore e Kinës qëndronte si shkëmb graniti dhe demaskonte e luftonte këtë xhelat.

Mosplotësimin e dëshirave të Niksonit për të vajtur në Kinë, në këto kushte (që na zbulohen tash në relacion),

nga ana e diplomatëve kinezë, ju (kinezët) e quani një «veprim ultra të majtë» të Ministrisë suaj të Punëve të Jashtme. Kjo është e drejta juaj, por, derisa për këtë fakt na vini edhe ne në dijeni, ne po ju shprehim mendimin tonë se nuk duheshin plotësuar dëshirat e Niksonit.

Thuhet se «bisedimet e Varshavës ishin të hapëta dhe diheshin nga e gjithë bota». Mund të jetë kështu për gjithë botën, po jo për ne, për Shqipërinë, aleaten besnike të Kinës, e cila nuk është vënë asnjëherë në korent për këto bisedime veçse tash.

Gjithashtu, tash për herë të parë ne po marrim vesh se Kina në Varshavë kishte pranuar që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të dërgonin funksionarë të lartë të posaçëm në Kinë për të përgatitur ardhjen e presidentit, në një kohë kur lufta dhe sulmet amerikane vazhdonin të furishme, njëra pas tjetrës, mbi popujt e Indokinës. Këtë e konsiderojmë shumë të gabuar si parim, si strategji dhe si taktikë.

Ne mendojmë se ardhja e pingpongistëve nuk është një gjë e rastit. Ardhja e pingpongistëve nuk ka pasur për qëllim «lidhjet me popullin amerikan», por përkundrazi, ka qenë një pretekst për të rivendosur lidhjet e shkëputura dhe për të vënë në jetë ujdite e arritura.

Konsideratat dhe konkluzionet mbi gjendjen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë absolutizuar dhe janë trajtuar jo realisht, me qëllim që t'i shërbejnë shpjegimit të hapit politik që po bëjnë: «Populli amerikan nuk e

do luftën», «populli bën demonstrata», «bëhet luftë në rrugë dhe vriten katër studentë», «hidhen dekoratat në parkun e Shtëpisë së Bardhë», «populli amerikan nuk është kundër regjimit, por drejtohet kundër Niksonit». Dhe ky Nikson, që e «urren» populli amerikan, thërritet në Pekin!

Ajzenhauerin në Japoni, Khonsonin dhe Niksonin, kudo që kanë vajtur (me përjashtim të Jugosllavisë dhe të Rumanisë, ku i presin me lule) i kanë pritur me domate, me vezë të prishura dhe me demonstrata.

Ne vlerësojmë se **revolucioni është në ngritje, se popujt po luftojnë për liri, se imperializmi amerikan po dobësohet dhe po kalon një krizë të rëndë e jo vetëm ai, por i gjithë sistemi kapitalist botëror, dhe kjo bëhet jashtë vullnetit të tyre, pavarësisht nga luftërat e tyre grabitqare dhe gjakatare. Por tabloja që na bën shoku Çu En Lai, duke na cituar një varg faktesh plotësisht të vërteta, nuk mund të vërtetojë konkluzionin se «imperializmi amerikan është krejt i rraskapitur dhe mjafton një e fryrë që të rrëzohet», edhe pse na sillen citate të vetë Niksonit.**

Armikun nuk duhet as ta mbivlerësojmë, as ta nënvlehtësojmë. Është e vërtetë se në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka protesta dhe demonstrata kundër luftës në Vietnam, por këto janë akoma sporadike dhe as nuk mund të themi se «Shtetet e Bashkuara të Amerikës ndodhen në një stuhi të madhe revolucionari». Këtë gjë ne nuk e çmojmë kështu. Populli amerikan nga gjendja ekonomike, nga ideologjia që e frymëzon, nga mënyra e jetesës, nga zakonet, traditat, lidhjet etj., është larg që të jetë në pozita revolucionare. Shumë ujë do të kalojë nën urat e lumenjve amerikanë që të arrijë kjo kohë. Ne kemi bindjen se kjo kohë do të vijë me siguri, por për këtë duhet

një punë e madhe, një luftë e madhe. Iluzione nuk duhet të krijojmë.

Teoria e kontakteve me popullin.

«Ne zhvillojmë diplomacinë e popullit», thonë ata, por në fakt zbatojnë diplomacinë e krerëve. Të zhvillojmë këtu shembullin tonë me jugosllavët.

Për analogji kinezët duhet të veprojnë si me amerikanët edhe me sovjetikët. Pra të vejë Brezhnjevi në Pekin.

Të zhvillojmë qëndrimin tonë ndaj revizionistëve sovjetikë.

Nuk u duhet zënë besë fjalëve të imperializmit amerikan. «Ushtria amerikane do të krimbet», «Niksoni vjen se nuk do të vazhdojë luftën» (domethënë imperializmi amerikan nuk do më luftëra!!), «Niksoni do të zbutë Kinën» (po, për ta dobësuar dhe për ta nxitur kundër revizionistëve sovjetikë, me të cilët Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të kenë edhe kontradikta).

Teoria e luftës dhe e paqes.

Ne nuk besojmë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës do t'i tërheqin trupat dhe bazat që kanë në botë, pa

i detyruar ata me luftë. Shembulli i Libisë nuk vërteton shumë gjëra. Në qoftë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës mendojnë që kukullat e tyre të luftojnë vetë kundër popujve që ngrihen dhe Amerika t'i ndihmojë me para, kjo do të thotë që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të firmosin vdekjen e tyre dhe të kukullave. Të mos kemi iluzione se një gjë e tillë do të ngjasë me dëshirën e Amerikës. Tërheqja nga një vend pas një disfate nuk do të thotë mosdërhyrje në një vend tjetër.

Bisedimet për luftën në Vietnam vetëm në qoftë se janë bërë pas një konsultimi me vietnamezët dhe mbi baza të drejta e parimore, janë në rregull. Ne e kemi përcaktuar vijën tonë për luftën e Vietnamit dhe prapë ua përcaktojmë.

Për Tajvanin politika jonë të konfirmohet përsëri.

Problemi i Japonisë.

Problemi i Koresë.

Çështja e Indisë.

Heshtje për Bashkimin Sovjetik.

Ç'tha Kisingeri?

Për këtë «plan të madh strategjik» do të ishte më drejt që të kishim pasur bisedime më parë, se në fakt këtu kemi të bëjmë me një plan të ri strategjik, bisedime direkte dhe të nivelit të lartë midis Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës në kushte të veçanta.

Vija e Partisë sonë do të mbetet e pandryshuar.

Si konkluzion, kinezët kanë bërë një gabim të madh

oportunist, janë treguar të djathtë dhe veprimi i tyre është revizionist e i dënueshëm. Ata në asnjë mënyrë nuk duhej të pranonin që Niksoni të vinte në Pekin. Me këtë akt politik ata çoroditin lëvizjen revolucionare botërore dhe i hedhin ujë hovit revolucionar, e shuajnë këtë hov dhe ndihmojnë nxitjen e ndjenjave më të këqija pacifiste. Ata i dëmtojnë rëndë partitë e reja marksiste-leniniste, të cilat te Kina dhe te Mao Ce Duni shihnin shtyllën e revolucionit dhe mbrojtësit e marksizëm-leninizmit.

Revizionistët modernë janë shumë të kënaqur nga kjo që bëri Kina, se ky veprim çon ujë në mullirin e tyre. Ata do ta shfrytëzojnë shumë këtë gjë dhe me demagogji të madhe do ta gërryejnë atë kapital pozitiv që kishte vënë Kina. Ata do të manovrojnë në një mënyrë që Kina të futet sa më thellë në pellgun revizionist dhe në miqësi me amerikanët do të ngrenë në teori antisovjetizmin e shtetit të madh kinez.

Imperializmi dhe kapitalizmi botëror përfitojnë nga ky veprim i Kinës. Kjo, me këtë që bëri, ndihmoi fashistin Nikson, i dha atij mundësi të mëdha të fitojë përsëri në zgjedhjet presidenciale, bëri që ai të hiqet si një «president i paqes, si një president i madh». Niksoni me këtë fitoi rolin e «arbitrit» në mes Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Popullore të Kinës. Të dy kërkojnë gjoja miqësinë e popullit amerikan, por kompozojnë dhe merrren vesh me presidentët. Duke u marrë vesh me presidentët, që të dyja palët pretendojnë se marrin kontakt me popullin amerikan dhe «kështu ia tronditin fronin imperializmit amerikan». Të gjitha këto do të thonë t'i hedhësh hi syve opinionit, pse nuk është nevoja të vijë Niksoni ose ndonjë president tjetër në Pekin, që populli amerikan të influencohet nga Kina. Lufta dhe idetë nuk njohin kufi.

Është e vërtetë se imperializmit amerikan duhet «t'i

tronditet fronti brenda», por është po aq e vërtetë, dhe në mos më shumë, se duhet t'i tronditet e t'i rrëzohet fronti edhe jashtë. Fuqia e imperializmit amerikan nuk qëndron vetëm brenda Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe jashtë tyre, dhe jashtë është pika e dobët e tyre. Imperializmi amerikan po shfrytëzon popujt e botës dhe këtë shfrytëzim e mbron me forcë, me ushtri, me baza, me komplete, të cilat nuk i pakëson, siç thotë Çuja, përkundrazi do t'i shtojë. Këtu duhet goditur më fort. Këtë front në asnjë mënyrë nuk duhet ta dobësojmë. Po humbën këtu Shtetet e Bashkuara të Amerikës, mbaroi perandoria e tyre, ashtu si ajo e Anglisë, dhe vetëm atëherë mund të parashikojmë kriza të rënda brenda në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

T'U DËRGOHET LETËR KINEZËVE LIDHUR ME FTESËN QË I BËNË NIKSONIT TË SHKOJË NË KINË

Biseduam sot me Hysniun dhe me Ramizin dhe u dhashë tezat për letrën që duhet t'u dërgohet kinezëve për vizitën e Niksonit në Pekin.

REVIZIONIZËM ME BRIRË

Muaji i mjalitit kino-amerikan filloi. Shkesët, më në fund, bënë takimet e parafundit për të përgatitur dasmën e madhe, takimin Mao-Nikson.

Bisedimet «e gjata dhe të përzemërta në mes miqve të vjetër» Mao Ce Dun, Çu En Lai dhe Edgar Snou mbaruan me sukses, si ariet e fillimit të «Madamë Bateriait». Përmbajtjen e tyre e mori vesh Niksoni (pse ky ishte qëllimi për të cilin u bënë), e mori vesh reaksioni amerikan, e mori vesh Uoll Striti, e kanë marrë vesh me siguri aleatët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e në radhë të parë sovjetikët, veçse për shqiptarët, «aleatët besnikë» të Kinës, kinezët e kanë mbajtur dhe e mbajnë të fshehtë.

Vëmë pyetjen e thjeshtë: Pse? Ç'të fshehtë ka në këto bisedime që ne të mos njihemi me përmbajtjen e tyre? Edhe përgjigjja është e thjeshtë: Bisedimet nuk janë zhvilluar në vijën marksiste-leniniste, prandaj shokët kinezë kanë frikë të na i bëjnë të njohura neve.

Sigurisht, me Edgar Snoun ata kanë biseduar mbarë e prapë për strategjinë dhe taktikën e tyre. Edgar Snou me siguri ka blerë shumë dhe s'ka shitur asgjë. Ai e ka gjykuar situatën shumë të favorshme për imperializmin amerikan dhe realizoi «mblesërinë» që, për fat të keq të Çu En Lait, ua kishin ngatërruar për tre vjet me radhë

sulmet e armatosura në Vietnam dhe në gjithë Indokinën (siç e thotë vetë Çuja).

Të bisedosh me një të dërguar të imperializmit amerikan, që hiqet gjoja si mik i Kinës, të jesh i sigurt se ato që i thua, ai do t'ua çojë «të ngrohta» krerëve të imperializmit, zaten për këtë arsye u bënë bisedime dhe, nga ana tjetër, të mos vësh në dijeni, në radhë të parë, mikun dhe aleatin tënd, Shqipërinë, pastaj edhe gjithë opinionin botëror, **kjo është një poshtërsi, kjo është revizionizëm me brirë, kjo nuk është një «diplomaci popullore», siç pretendojnë kinezët, po është një diplomaci sekrete me krerët e imperializmit amerikan.**

Hrushovi ka bërë shumë poshtërsi, mbi ujë dhe nën ujë, por takimet ai i botonte. Takimi i Çu En Lait me Kisingerin do të ndiqte këtë rrugë që ndoqi, sepse kështu filloi, në mënyrë shumë sekrete, por, meqë përfundoi «me sukses» dhe iu dha botës «sihariqi i madh», kinezët këtë nuk kishin se si të na e fshihnin.

Pavarësisht nga turpi i madh që nuk e ndienë kurrë, pse kishin kaq kohë që bënëin tratativa të fshehta, pavarësisht se kur u bë *fait accompli*, na vunë në korent, informacioni i Çu En Lait që na u dha, tregon vijën e tyre oportuniste-revizioniste, tregon mungesë logjike dhe argumentimi, tregon dëshirën e tyre për t'u afruar me amerikanët dhe tentativat e çala për ta fshehur këtë dëshirë. Ky informacion sjell argumente të dobëta për t'u dalë përpara kritikave të drejta e parimore që do t'u bëhen dhe, më në fund, të gjitha këto janë të bazuara në një analizë politike shumë të dobët, të gabuar, të ujdishur me kleçka, që nuk qëndrojnë për të arsyetuar këtë mutësi që bënë.

Le të marrim çështjen e së famshmes «analizë të situatës ndërkombëtare» që na bën Çuja. Në të duket qartë besimi i tij te Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai beson

në arsye që nuk qëndrojnë në këmbë, që janë pacifiste, revizioniste dhe antirevolucionare e antimarksiste, beson se ushtritë dhe bazat amerikane do të tërhiqen nga Indokina, nga Lindja e Largme në përgjithësi, nga Tajvani. Sipas ekspozesë së Çusë del se militarizmi japonez po bëhet kërcënues dhe do të kërkojë ekspansion, prandaj Çuja kërkon nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës që të mos e lejojnë një gjë të tillë dhe këtë ata «ia pranuan». Nga bisedimi del se në mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës kërkohet një «aleancë ose miqësi» për të frenuar Japoninë, që po bëhet e rrezikshme. Por është edhe çështja e Bashkimit Sovjetik. Çfarë u tha për të? Kinezët, sipas Çusë, s'folën fare, kurse Kisingeri, sipas tij, foli gjatë. Po çfarë tha? Për ne shqiptarët është mister.

Si është e mundur të na thonë neve kinezët mendimet e armiqve tanë për armiqtë tanë!!! Kjo është poshtërsi e madhe. Po kjo duhet të ketë arsyet e saj të mëdha. Të dyja këto shtete, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës ashtu dhe Kina, puqen në ndjenjat antisovjetike dhe në kontradiktat që kanë të dyja me Bashkimin Sovjetik. Në këto llogaritë të përfitojnë të dyja palët.

E gjithë politika e Kinës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës u kufizua në Indokinë, në Tajvan, në Japoni dhe në Pakistan. Bashkimi Sovjetik, sipas ekspozesë kineze, sikur nuk ekziston fare, sikur nuk ekzistojnë fare Evropa, Amerika Latine, Afrika, Azia dhe të gjitha problemet e mëdha e të koklavitura botërore. Kësaj i thonë të hysht në arenën ndërkombëtare nga dera e kuzhinës, mundësisht pa bërë zhurmë, se mos u prishësh oreksin e drekës zotërinjve të mëdhenj, që janë shtruar dhe ushqehen me gjakun dhe me mishin e popujve. Me fjalë të tjera, Kina u thotë Shteteve të Bashkuara të Amerikës: «Të jemi miq në këtë zonë, të frenojmë Bashkimin Sovjetik, unë kënde, ju në anët e tjera të botës dhe veçanërisht në Evropë dhe në Afrikë. Unë nuk kam pretendime të mëdha për

zona influence në ato vende, unë edhe në Indi nuk po bëj as më të voglën tentativë» etj.

Çështja, pra, nuk mendoj se është aq e thjeshtë, siç kërkon të na e shpjegojë Çu En Lai me «diplomacinë e krerëve», që bëjnë revizionistët sovjetikë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe me «diplomacinë e popullit», që bëjnë kinezët, gjoja për t'u lidhur me popullin nëpërmjet krerëve. Këtë nuk e ha njeri! Kësaj i thonë: «Jo shi, po boboshi».

Përse nuk lidhet Çuja me qeverinë indiane për t'u lidhur me popullin indian? Vallë interesi i Kinës dhe i revolucionit është të lidhesh më parë me popullin amerikan apo me atë indian? **Vihen pyetjet: Kush është më afër revolucionit, populli indian apo ai amerikan? Kush është më i egër e më i rrezikshëm, reaksioni indian apo imperializmi amerikan? Ç'e bëri Çuja teorinë që e mbron aq shumë «fshati të rrethojë qytetin»? Përse nuk punohet duke shkatërruar influencën e imperializmit amerikan në Indi e në botë, që të dobësohet metropoli dhe imperializmi? Përse kjo mbrojtje këmbëngulëse që i bëhet Pakistanit (për të cilën ne nuk jemi kundër) në dëm të afrimit me Indinë? Kani i Pakistanit është aq i pabesë sa edhe Gandhi e Indisë. Përveç Indisë, po me Japoninë pse nuk bën Kina orvatje të zbatojë po të njëjtën «politikë të ndritur» që filloi të bëjë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës?**

Jo! Kjo politikë është e përpriçtë dhe në bazë të saj është një vijë antimarksiste, antirevolucionare. Kërkohet pajtim me imperializmin amerikan, kërkohen kompromise me të, duke sakrifikuar parimet. Fjalët se «duam të lidhemi me popullin amerikan për t'i tronditur fronin imperializmit në metropol», janë demagogji. Me vajtjen e Li Hsien Nienëve, Go Mo Zhove e të tjerëve si këta në SHBA për vizita e takime me krerët e qeverisë, as nuk merret kontakt me popullin amerikan dhe as nuk i tron-

ditet fronin imperializmit. Vetëm lufta e drejtë parimore, pa kompromis, vetëm revolucioni do t'ia bëjë varrin imperializmit.

Kjo e famshme diplomaci, gjoja e re, që na predikojnë Mao Ce Duni dhe Çu En Lai nuk është e re, po e vjetër, është diplomaci e osmozës. Kësaj i thonë dërgo njerëz nga Kina «t'i edukojë» Amerika, dërgo edhe nga Amerika njerëz në Kinë që «të edukojnë». Këta njerëz që do të vijnë në Kinë do të jenë 99 për qind agjentë të imperializmit dhe ata që do të venë nga Kina do të jenë revizionistë të zgjedhur nga Çu En Lai dhe njerëzit e tij. Perspektivë e bukur për Kinën!!

Në qoftë se nuk i vihet fre menjëherë këtij kursi revizionist, Kina e Mao Ce Dunit do të marrë po atë rrugë që mori Bashkimi Sovjetik revizionist, dhe këtu është rrezik të rrokullisen çështjet dhe të krijohet një konfuzion i madh.

Kjo që ngjet në Kinë u intereson edhe imperialistëve, edhe revizionistëve. Faza e parë është ajo e futjes së Kinës në rrugën e ujdisë me tradhtinë revizioniste, në rrugën e diskreditimit në arenën ndërkombëtare në sytë e popujve dhe të komunistëve. Faza e dytë është loja e të tri superfuqive, e kombinacioneve të reja, e balancimit të forcave, e grindjeve më të ashpra në arenën ndërkombëtare.

Popujt dhe marksistë-leninistët duhet të luftojnë me vetëmohim për ta ndaluar këtë kurs regresiv botëror. Partisë sonë të vogël, po heroike, marksiste-leniniste, i takon roli historik dhe i rëndë të qëndrojë në ballë të kësaj lufte dhe ta udhëheqë atë. Ne do të luftojmë dhe do të fitojmë, pse jemi në rrugën e Leninit dhe të Stalinit.

DURRËS, E MARTË

27 KORRIK 1971*

RADHITJE ANTIMARKSISTE

Qëndrimet kineze kundër revizionistëve sovjetikë në thelb shprehin pikëpamje të theksuara shoviniste të shtetit të madh, megjithëse kinezët përpiqen t'i maskojnë me kujdes. Ata ritheksojnë vazhdimisht se «ne nuk jemi një shtet i madh», «ne nuk do të bëhemi një superfuqi», «ne luftojmë te kuadrot dhe në popull ndjenjën e shtetit të madh», por realiteti nuk tregon kurdoherë këtë dhe, kur vjen puna për qëndrime për të cilat duhet, të paktën, të merret edhe mendimi i të tjerëve «më të vegjël», — pse ky mendim është i domosdoshëm, — këtë nuk e bëjnë dhe zemërohen kur ua vënë në dukje këtë «neglizhencë». Shokët kinezë mendojnë se të tjerët duhet të aprovojnë çdo gjë që thonë ose bëjnë ata, mendojnë se çdo thënie dhe veprim i tyre duhet të konsiderohet si thesar për marksizëm-leninizmin dhe të zbatohet kudo. Tipike është çështja e Revolucionit Kulturor që po zhvillohet sot në Kinë, i cili konsiderohet prej tyre, pa pikë modestie, si rrugë e detyrueshme për të gjithë dhe nuk mendohet nëse ky do të afirmohet apo jo nga lëvizja komuniste botërore.

Shokët kinezë në praktikë kanë një përcëimim për partitë e reja marksiste-leniniste që janë krijuar. Ata nuk i përkrahin dhe nuk i ndihmojnë këto parti, por mbajnë lidhje me lloj-lloj grupesh, e sidomos me ata që mburrin Mao Ce Dunin dhe Revolucionin Kulturor, pavarësisht se çfarë tendencash kanë këto grupe.

«Antirevizionizmi» i tyre ndaj hrushovianëve nuk bazohet, pra, në ideologjinë marksiste-leniniste. Revizionizmin sovjetik ata nuk e luftojnë nga pozita parimore. Përkundrazi, kush është antisovjetik, ai është i mirë për kinezët, ai radhitet me ta, pavarësisht se cilët janë këta antisovjetikë: janë titistë-revizionistë, tradhtarë të marksizëm-leninizmit, agjentë të amerikanëve, janë revizionistë rumunë, të lidhur me amerikanët dhe me reaksionin evropian, apo janë borgjezë reaksionarë. Mjafton të jesh antisovjetik dhe ke simpatinë e kinezëve.

Ky qëndrim antimarksist e futi aktualisht Kinën në një rrugë pa krye, në një rrugë që, po nuk u ndal, e çon atë në tradhti. Këto pikëpamje antimarksiste të Kinës në politikën që ndjek kundër Bashkimit Sovjetik, i njohin imperializmi dhe revizionizmi modern dhe si njëri, ashtu edhe tjetri veprojnë për t'i shfrytëzuar në maksimum.

Midis revizionistëve sovjetikë dhe atyre jugosllavë e rumunë ka kontradikta koniunkturale dhe të natyrshme, por që të tre këta së bashku punojnë për të minuar bazat e socializmit në Kinë. Në mes të të tre këtyre komplotistëve revizionistë po kurdisen me mjeshtëri, kundër njëri-tjetrit, intriga, bëhen kërcënime, presione, tërheqje etj. për t'i krijuar përshtypjen Kinës së verbuar nga antisovjetizmi se në mes Jugosllavisë dhe Rumanisë nga njëra anë, dhe Bashkimit Sovjetik nga ana tjetër, ka një luftë për vdekje dhe se Kina «duhet të mbrojë të dobëtit, sepse kështu mbron popujt».

Kina radhitet me Jugosllavinë dhe me Rumaninë, pa shikuar se kush janë këta, për të nxitur kontradiktat e tyre me Bashkimin Sovjetik. Këto kontradikta, me siguri, i nxitin edhe vetë Rumania e Jugosllavia, bile edhe më shumë se ç'duhet, për ta futur mirë Kinën në kllapa. Në fakt Kinën dhe Rumaninë nuk i ndan asgjë. Ato janë plotësisht dakord me njëra-tjetrën në politikë dhe në ideologji, ato deklaruan se partitë e tyre janë motra. Kjo

do të thotë se për Kinën, partia revizioniste rumune dhe grupi revizionist i Çausheikut janë marksistë-leninistë. Kjo ka marrë fund. Mbështetja e Kinës për Rumaninë në përçapjet politike, në ndihmën ekonomike dhe ushtarake është e siguruar.

Është shumë skandaloze dhe antimarksiste që Kina komuniste ta deklarojë veten motër dhe shoqe me Rumaninë revizioniste, që është kokë e këmbë në Traktatin e Varshavës dhe në KNER, që merr ndihma nga këta, nga amerikanët, nga revanshistët e Bonit etj. Pale, por revizionistët rumunë njihen edhe për «trimërinë» e tyre. Duhet të kesh humbur krejtësisht busullën, që të zhytësh në këtë batak. Këto veprime kanë një logjikë të tërë antimarksiste.

Gjithashtu, lidhjet e Kinës me Jugosllavinë titiste janë në baza antimarksiste. Kinezët s'kanë qenë kurrë të bindur se Titoja është një renegat i marksizëm-leninizmit. Partia Komuniste e Kinës u gjend përkrah nesh në luftën kundër titizmit për oportunitet, se nuk mund të bënte ndryshe, ashtu sikundër edhe sot po për oportunitet nuk mund të deklarohet dot solidare me Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë. **Hëpërhë është e rrezikshme për të që të deklarojë se në Jugosllavi ndërtohet socializmi dhe se Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë është një parti marksiste.** Por kjo mund të vijë nesër. «Sot për sot, mendojnë kinezët, zhvillojmë dhe intensifikojmë marrëdhëniet shtetërore, ekonomike, kulturore dhe mjaftohemi me atë që «Partia motër e Rumanisë» është «motër me Lidhjen e Komunistëve të Jugosllavisë». Pra, motra e motrës sime është motra ime. Marrëdhëniet e Kinës me Titon, përveç qëllimit të përbashkët antisovjetik, kanë edhe një qëllim tjetër. **Kinezët kanë një stimë të veçantë, të papohueshme për politikën universale të Titos në «botën e tretë», për «prestigjin» e këtij politikani të paguar nga amerikanët, për «zotësinë» e tij, që u shërben ameri-**

kanëve me zjarr dhe i shan nga ana tjetër për t'u maskuar. Nga të gjitha këto anë «pozitive» të Titos, kinezët duan të përfitojnë sa më shumë dhe sa më parë, pse shumë kohë kanë humbur. Dhe Kina, për të vënë në vend kohën e saj të humbur, me afrimin drejt politikës së Titos, Çausheikut, Niksonit, Brezhnjevitet dhe gjithë reaksionit botëror, bëri që këta të korrin një sukses të madh.

Politika «tejpamëse» antimarksiste e Kinës e radhiti Republikën Popullore të Kinës në një vijë me Republikën Federative të Jugosllavisë dhe me Republikën Popullore të Rumanisë. Niksoni do të vizitojë Pekinin, pasi vizitoi Bukureshtin dhe Beogradin. Tri vende «socialiste» nxjerrin popullin të presë me lule xhelatin e popujve. Bukureshti dhe Beogradi kishin, të paktën, marrëdhënie diplomatike dhe ishin vënë me kohë në shërbim të imperializmit amerikan, por Kina *qu'allait-elle faire dans cette galère*¹, siç thoshte dikur Moliere. Sigurisht, Kinën e futën në këtë rrugë të gjitha ato që thashë më lart.

E gjithë politika e jashtme e Republikës Popullore të Kinës është e papërcaktuar, kaotike, është një politikë e rastit dhe e lëkundshme, ku e izoluar dhe ku e gabuar, ku e hapur si tash, por prapë e gabuar. Politikën e jashtme të Kinës e bën Çu En Lai, me pikëpamjet e tij oportuniste të djathta. Ai nuk pyet njeri, ai vendos vetë, duke marrë ngandonjëherë një aprovim në parim të përgjithshëm të Maos.

Evropa për Kinën nuk vlen më për revolucionin. Për Çunë nuk kanë vlerë grevat e demonstratat madhështore të klasës punëtore evropiane. Për të kanë vlerë vetëm disa demonstrata në Uashington. Partitë marksiste-leniniste që janë krijuar, gjithashtu, nuk kanë vlerë për Çunë.

¹ Frëngjisht — Ç'iu desh atij të hyjë, të ngatërrohet në këtë punë. (Nga «Les Fourberies de Scapin» (1671), akti i 2-të, skena e 7-të.)

Në Evropë politikën e Kinës e bën Rumania. Meqenëse Rumania dhe Jugosllavia janë dakord për konferencën e «Sigurimit evropian», edhe Kina deklaroi se është dakord. Kina lavdëron dhe miraton politikën titiste në Lusakë dhe në «botën e tretë» me shpresë mos shpëputë ndonjë kockë. Por të jesh dakord me Rumaninë dhe Jugosllavinë në politikën evropiane, do të thotë të jesh dakord me politikën amerikane.

Çu En Lai, në informacionin që na jep për vajtjen e Niksonit në Kinë, thotë disa absurditete. Ai pretendon se futjen e Anglisë në Tregun e Përbashkët Evropian e lejon edhe Franca, për të forcuar pozitën antiamerikane të këtyre vendeve. Të mendosh kështu, do të thotë të mos kuptosh gjë nga politika. Pompiduja nuk është Dë Goli. Për borgjezinë franceze, aleatët e saj tradicionalë kanë qenë dhe mbeten vendet anglosaksone: Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Anglia. Gjermania ka qenë armiku tradicional i Francës, po edhe i Anglisë. Anglia në çdo situatë do të mbështetet te Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pavarësisht se Çu En Lai i ka dhënë urdhër «Zhenminzhibaos» të shkruajë për luftën e vjetër civile amerikane, për të sheqerosur për popullin kinez lajmin e bukur të vajtjes së Niksonit në Pekin. Futja e Anglisë në Tregun e Përbashkët, pavarësisht nga kontradiktat që ka ajo me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është në favor të politikës amerikane në Evropë. Lejimi nga ana e Francës i hyrjes së Anglisë në këtë organizatë bëhet më shumë jo kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por për të balancuar Gjermaninë e Bonit dhe nga frika e një aleance eventuale Bon-Moskë.

Të gjitha këto do t'i vërtetojë koha, por gjatë kësaj kohe Kina po bën gabime të rënda parimore, që do t'u kushtojnë rëndë asaj dhe botës. Ne duhet të përpiqemi, po të kemi mundësi, ta ndalojmë këtë kurs aventuresk të Kinës. Letra që po i përgatitim Komitetit Qendror të

Partisë Komuniste të Kinës, është një nga këto tentativa. Kjo letër neve mund të na kushtojë shtrenjtë, por asnjë lëshim nuk duhet të bëjmë në parimet. Ne duhet t'i mbrojmë deri në fund parimet marksiste-leniniste të Partisë sonë.

KINA, VIETNAMI, KOREJA DHE VAJTJA E NIKSONIT NË PEKIN

Vietnami i Veriut, për vite me radhë, po bën një luftë heroike kundër imperializmit amerikan. Ai u dogj dhe u bë hi nga bombardimet, por nuk u dorëzua, përkundrazi vazhdoi rezistencën heroike dhe luftën në Jug. Vietnami i Jugut luftoi dhe lufton heroikisht kundër imperializmit amerikan dhe kukullave të Sajgonit.

Amerikanët vazhdojnë të bëjnë një nga luftërat më barbare që ka parë bota. Barbarët amerikanë përdorën të gjitha taktikat, të gjitha dredhitë, të gjitha llojet e armëve të shpikura deri tash, veç armës atomike, por nuk fituan dot. Ata u thyen, u mundën dhe kanë ardhur në pragun e disfatës.

Lufta e vietnamezëve është e admirueshme. Revizionistët sovjetikë bënë të gjitha përpjekjet që vietnamezët ta pushonin luftën, të binin në kompromis dhe në bisedime me amerikanët. Revizionistët sovjetikë ishin grevëthyesit e luftës së Vietnamit. Ata kërkonin të shpëtonin «me nder» tërheqjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke mbrojtur më vonë interesat e tyre në Vietnam, që të bëheshin «pjesëtarë në fitoren e arritur». Presionet e mëdha dhe skandaloze të sovjetikëve mbi vietnamezët arritën në një rezultat: Vietnamezët filluan bisedimet me amerikanët në Paris, sipas parullës: «Edhe luftë, edhe politikë e bisedime».

Kina i ndihmoi dhe i ndihmon vietnamezët në luftë. Ajo ka qenë gati të dërgonte edhe vullnetarë në çdo moment. Kinezët ishin kundër bisedimeve të vietnamezëve me amerikanët. Këtë ua kishin thënë shumë herë atyre, zyrtarisht na e kanë thënë edhe neve. Kinezët i konsideronin bisedimet e vietnamezëve me amerikanët jo të drejta, jo të frytshme, bile të dëmshme e të rrezikshme, por kjo ishte çështje e vetë vietnamezëve, kurse qëndrimi i Kinës ndaj luftës së popullit vietnamez dhe ndihma e saj nuk ndryshonin.

Partia jonë, pa u konsultuar me Kinën, kur duhej mbajtur qëndrim, ndaj luftës së Vietnamit (pse kinezët nuk e marrin mundimin të konsultohen me Partinë tonë as për këto probleme kapitale), mbajti qëndrimin që dihet botërisht dhe nuk kurseu kurrë çdo ndihmë për këtë luftë. Ne nuk ishim dakord me bisedimet që vietnamezët filluan me amerikanët. Mendimin tonë ne ua kemi thënë disa herë shokëve vietnamezë. Kështu kanë qenë çështjet deri tash në fund.

Pavarësisht se Kina dhe Shqipëria nuk ishin dakord me bisedimet e Parisit, kjo çështje në fund të fundit ishte një punë e vietnamezëve. Ne nuk mund t'i ndalonim ata. Nga ana tjetër, duhej të vazhdonim dhe vazhduam të ndihmonim edhe më shumë luftën e tyre çlirimtare, të demaskonim barbarizmat e amerikanëve dhe të ishim konsekuentë në qëndrimet tona. Ne qëndruam konsekuentë në përkrahjen e luftës së Vietnamit, Kina jo. **Kur lufta vazhdonte, kur amerikanët vritnin e bombardonin Vietnamin dhe gjithë Indokinën, Kina bënte bisedime sekrete dhe ujdisej me amerikanët që të vinte Niksoni në Pekin ku, siç doli, të bënin bisedime edhe për Vietnamin.**

Këto tratativa të turpshme antimarksiste, antishoqërore, bëheshin pa dijeninë e vietnamezëve, pa lëre tonën. Kjo ishte skandaloze. Kjo ishte një tradhti e kinezëve ndaj vietnamezëve, ndaj luftës së tyre, ndaj nesh, aleatë-

ve të tyre, dhe ndaj gjithë popujve të tjerë përparimtarë. Kjo është revoltuese.

Konkluzionet e bisedimeve të Çu En Lait me Kisingerin na ranë si bombë neve shqiptarëve, vietnamezëve dhe koreanëve, për të mos folur për të tjerët. Kani i Pakistanit meritoi të ishte në korent më parë «me të fshehtat e perëndive». Ç'paturpësi nga ana e kinezëve! Këtë e bazojmë në faktet. Kur Çu En Lai thirri në orën tre të natës ambasadorin tonë për ta vënë në mënyrë lakonike në dijeni «për sihariqin» që do të botohej një ditë më vonë, i tha atij se do ta thërriste prapë për ta vënë gjerësisht në korent për çështjen që të vinte në dijeni shokët në Tiranë, sepse i tha: «Tash sapo u ktheva nga Hanoi, ku vura në korent shokët. Tani do të shkoj në Kore të vë në dijeni Kim Ir Senin dhe, kur të kthehem, do të vë në korent Sihanukun e do t'ju thërres edhe ju». Ne, natyrisht, do të na vinte në dijeni pas princit të Kamboxhias! Ç'tregon kjo? Kjo tregon se vietnamezët, koreanët, si edhe ne u gjendëm përpara faktit të kryer.

Ç'qëndrim duhet të kenë mbajtur vietnamezët? Këtë nuk e dimë. Çuja nuk pipëtin asnjë fjalë dhe psenë e marrim me mend. Vietnamezët kanë qenë kundër vajtjes së Niksonit në Pekin në një kohë që amerikanët luftojnë kundër tyre. Sigurisht vietnamezët e konsiderojnë qëndrimin e Kinës, si edhe ne, si një ndihmë për Nikson fashistin, vrasësin numër një të vietnamezëve, që ai të hiqet si pacifist dhe të rizgjidhet president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo do të thotë të bisedosh me një armik për fatin e një populli që po lufton dhe që e ka marrë vetë në duar fatin e tij, do të thotë të bisedosh me kryexhelatin e një populli, pa e pyetur dhe pa u këshilluar me popullin, kur ti, Kinë, ke qenë kundërshtarja më e rreptë e bisedimeve me amerikanët për çështjen e luftës së Vietnamit. **Kina nga njëra anë kritikon sovjetikët dhe vietnamezët që bisedojnë me amerikanët, nga**

ana tjetër, fshehtazi, bie në ujdi vetë dhe bisedon me ta! Kjo është një punë hileqare, nuk është e ndershme, as marksiste. Vietnamezët publikuan menjëherë një artikull ku shfaqën pakënaqësinë e tyre, duke sulmuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Niksonin, dhe thoshin se nuk do t'i lejojnë fuqitë e mëdha të luajnë me fatin e tyre.

Kjo kthesë e Kinës në qëndrimin ndaj Vietnamit është e turpshme dhe shpjegohet me ndryshimin e vijës për afrim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kinezët bëjnë edhe një gabim tjetër të madh për të arsyetuar mutësinë e tyre. Çu En Lai në informacionin që i dha ambasadorit tonë, i tha: «Ne parashikojmë se lufta në Vietnam do të vazhdojë; prandaj, siç u thamë edhe shokëve në Hanoi, ata duhet të luftojnë dhe njëkohësisht ne të bisedojmë».

Sigurisht që kjo i ka revoltuar me të drejtë vietnamezët, pse këta që ishin kundër bisedimeve, tani venë dhe u thonë: «Ju luftoni, derdhni gjak dhe ne këtu në Pekin e në Uashington bisedojmë». Kjo do të thotë, me fjalë të tjera, në qoftë se vjen fitorja në Vietnam, këtë e sollën bisedimet Mao-Nikson, domethënë fitorja u përket kinezëve dhe jo atyre që u vranë e u dogjën. Jo! Këto nuk pranohen, në asnjë mënyrë nuk pranohen.

Koreanëve të Veriut, me Kim Ir Senin në krye, si centristë që janë, në shumë drejtime u kanë pëlqyer këto akrobaci politike të kinezëve, por në disa drejtime të tjera ata s'janë dakord. Edhe ata, pas informacionit që u dha Çuja, botuan një artikull në të cilin e vinin theksin kundër imperializmit amerikan dhe militarizmit japonez etj. Po çfarë u ka pëlqyer koreanëve? Atyre u ka pëlqyer kthesa nga e djathta e kinezëve, e cila do t'i sjellë këta në pozitë centriste të koreanëve. Por, Kim Ir Senit nuk i pëlqen pozita e shtetit të madh shovinist kinez. Ai e gjykon këtë nga pozitë e tij nacionaliste dhe me largësi të barabartë në mes Bashkimit Sovjetik dhe Kinës. Kim

Ir Senit i pëlqen mbështetja e Kinës përpara rrezikut japonez dhe indirekt gëzohet nga miqësia që zhvillohet në mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por ka frikë acarimin midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik. Prandaj ai do të manovrojë dhe do të punojë që të shërbejë si urë në mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik për afrimin e këtyre dy shteteve revizioniste. Kim Ir Seni është në pozita më të mira nga Çausheku për të luajtur kartën e sovjetikëve pranë kinezëve, kurse Çausheku është karta e amerikanëve pranë kinezëve. Nuk ishin të rastit dashuria dhe uniteti «i shëndoshë» i pikëpamjeve që u manifestuan në mes Koresë dhe Rumanisë me rastin e vajtjes së Çaushekut në Kore.

Kinezët kanë filluar ta mburrin shumë Korenë. Kim Ir Senin kanë filluar ta quajnë udhëheqës të madh, kurse dje neve zyrtarisht na thoshin se «ai s'ka asnjë vlerë, se ai ka qenë një tetar i ushtrisë kineze» etj. *O tempora! O mores!*¹ Ç'do të na dëgjojnë veshët e ç'do të na shohin sytë!! Ky është fillimi, por një fillim shumë i keq.

Mao Ce Duni duhet ta braktisë sa më parë këtë rrugë. Kjo rrugë nuk mbrohet, siç bëjnë propagandistët kinezë, duke thënë se «edhe Lenini bënte bisedime me menshevikët», «edhe Lenini bisedoi me gjermanët në Brest». Nesër këta propagandistë do të thonë me siguri se «edhe Stalini nënshkroi traktatin e mossulmimit me Hitlerin». Këto «argumentime» i ka përdorur vazhdimisht borgjezia, po ka thyer kokën në to, pse as Lenini, as Stalini nuk binin kurrë në gabime parimore, nuk i shkelnin kurrë parimet. Veprimet e tyre kanë qenë të qarta, ato i ka qartësuar katërcipërisht koha dhe teoria e pagabueshme, marksizëm-leninizmi.

¹ Latinisht — O kohë! O zakone!

MBLEDHJE E BYROSË POLITIKE LIDHUR ME ÇËSHTJEN E VIZITËS SË NIKSONIT NË PEKIN

Sot u bë mbledhja e Byrosë Politike për të dëgjuar informacionin e Partisë Komuniste të Kinës dhënë, nëpërmjet Kryetarit të Këshillit të Shtetit Çu En Lait, ambasadorit tonë në Pekin, Xhoxhi Robos për Partinë tonë, lidhur me çështjen e ftesës drejtuar Niksonit për të vizituar Pekinin, si dhe për të vendosur për letërpërgjigjen që do t'u japë kinezëve Partia jonë¹.

Në mbledhje u diskutua gjerësisht dhe u aprovua projektletërpërgjigjja.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 62.

Ir Senit i pëlqen mbështetja e Kinës përpara rrezikut japonez dhe indirekt gëzohet nga miqësia që zhvillohet në mes Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por ka frikë acarimin midis Kinës dhe Bashkimit Sovjetik. Prandaj ai do të manovrojë dhe do të punojë që të shërbejë si urë në mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik për afrimin e këtyre dy shteteve revizionistë. Kim Ir Seni është në pozita më të mira nga Çaushesku për të luajtur kartën e sovjetikëve pranë kinezëve, kurse Çaushesku është karta e amerikanëve pranë kinezëve. Nuk ishin të rastit dashuria dhe uniteti «i shëndoshë» i pikëpamjeve që u manifestuan në mes Koresë dhe Rumanisë me rastin e vajtjes së Çausheskut në Kore.

Kinezët kanë filluar ta mburrin shumë Korenë. Kim Ir Senin kanë filluar ta quajnë udhëheqës të madh, kurse dje neve zyrtarisht na thoshin se «ai s'ka asnjë vlerë, se ai ka qenë një tetar i ushtrisë kineze» etj. *O tempora! O mores!*¹ Ç'do të na dëgjojnë veshët e ç'do të na shohin sytë!! Ky është fillimi, por një fillim shumë i keq.

Mao Ce Duni duhet ta braktisë sa më parë këtë rrugë. Kjo rrugë nuk mbrohet, siç bëjnë propagandistët kinezë, duke thënë se «edhe Lenini bënte bisedime me menshevikët», «edhe Lenini bisedoi me gjermanët në Brest». Nesër këta propagandistë do të thonë me siguri se «edhe Stalini nënshkroi traktatin e mossulmimit me Hitlerin». Këto «argumentime» i ka përdorur vazhdimisht borgjezia, po ka thyer kokën në to, pse as Lenini, as Stalini nuk binin kurrë në gabime parimore, nuk i shkelnin kurrë parimet. Veprimet e tyre kanë qenë të qarta, ato i ka qartësuar katërcipërisht koha dhe teoria e pagabueshme, marksizëm-leninizmi.

¹ Latinisht — O kohë! O zakone!

MBLEDHJE E BYROSË POLITIKE LIDHUR ME ÇËSHTJEN E VIZITËS SË NIKSONIT NË PEKIN

Sot u bë mbledhja e Byrosë Politike për të dëgjuar informacionin e Partisë Komuniste të Kinës dhënë, nëpërmjet Kryetarit të Këshillit të Shtetit Çu En Lait, ambasadorit tonë në Pekin, Xhoxhi Robos për Partinë tonë, lidhur me çështjen e ftesës drejtuar Niksonit për të vizituar Pekinin, si dhe për të vendosur për letërpërgjigjen që do t'u japë kinezëve Partia jonë¹.

Në mbledhje u diskutua gjerësisht dhe u aprovua projektletërpërgjigjja.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 62.

KINEZËVE UA DORËZUAM LETRËN TONË LIDHUR ME VIZITËN E NIKSONIT NË PEKIN

Xhoxhi Robon e priti Çu En Lai. Ia dorëzoi letrën tonë. Pritja ishte neutrale, vetëm me një ndërhyrje, sa për të thënë: «Sikur nuk kam thënë se në Amerikë revolucioni është në ngjitje».

TRAKTATI SOVJETO-INDIAN DHE KINA

Javën e kaluar Gromikoja nënkroi në Delhi traktatin e «miqësisë dhe të bashkëpunimit» në mes Bashkimit Sovjetik dhe Indisë, ose, me fjalë të tjera, nënkroi traktatin sovjeto-indian kundër Kinës Popullore.

Midis revizionistëve sovjetikë dhe reaksionit indian ekzistojnë lidhje të ngushta e miqësore, të krijuara dhe të forcuara që në kohën e Hrushovit. India e Nehrusë, sido që për sy e faqe kishte një pozicion neutral në mes Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe në armiqësi me Kinën, mbante një pozitë të «forcës së tretë», bile Nehruja ishte një nga udhëheqësit kryesorë të saj. Ajo hante në të dy grazhdet, merrte edhe nga Bashkimi Sovjetik, edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bënte pjesë në Komonuelth, por, në dukje, anonte më shumë nga sovjetikët. Këta bënin bujë të madhe për këtë miqësi, jepnin ndihma të mëdha, ushqenin armiqësinë e Nehrusë kundër Kinës dhe nxitnin lakmitë e tij ndaj Pakistanit. Të mbështetur në këtë politikë, natyrisht, hrushovianët përfitonin për të depërtuar dhe për të influencuar në të ashtuquajturën botë e tretë.

Sigurisht, nënkontinenti indian kishte një rëndësi të madhe strategjike për socialimperialistët sovjetikë, të cilët e donin për ta shfrytëzuar atë në format e kolonializmit të ri, për ta pasur si një mbështetje të madhe për rrethimin e Kinës, për të neutralizuar imperializmin ame-

rikan në Oqeanin Indian, në atë Paqësor dhe për të mos lejuar që në Indi të zhvillohej dhe të shpërthente revolucioni.

Në Indi e ashtuquajtura partia komuniste e Danges u bë me revizionistët sovjetikë dhe punonte për qëllimet e tyre. Zëvendësit e Hrushovit dhe ata të Nehrusë vazhduan rrugën e caktuar nga paraardhësit e tyre. Kosigini e Bahaduri sa rroi, jo vetëm punuan dorë për dorë për të mposhtur Pakistanin, por dhe çështjen e Kashmirit e zgjidhën, natyrisht, në favorin e Indisë. Edhe më vonë Indira Gandhi ndoqi po këtë rrugë të tyre. Bile ajo shkoi edhe më tej, hodhi poshtë maskën e të mosangazhuarit dhe u lidh me traktat me revizionistët sovjetikë.

Mund të vihet pyetja: Ç'gjë anormale ka këtu në mes socialimperialistëve dhe reaksionit indian? Asgjë. Përkundrazi, mund të shihet një shkathtësi në politikën ekspansioniste të revizionistëve sovjetikë, një «konkurrencë» në ndjekjen e vijës së tyre të rrethimit të Kinës dhe një mbështetje e vazhdueshme e agresivitetit të reaksionit indian kundër Pakistanit dhe «miqve të tij». Reaksioni indian ushqen pretendime edhe mbi Tibetin dhe kufijtë me Kinën vazhdimisht po kontestohen. Reaksioni indian edhe i sulmoi këta kufij, po pësoi një disfatë të turpshme. Hrushovianët në këtë çështje mbajtën hapur dhe me konsekuencë anën e miqve të tyre, reaksionarëve indianë.

Kina filloi t'i afrohej Pakistanit, kuptohet, si kundërpeshë e Indisë. Kjo ishte një politikë e drejtë shtetërore e Kinës dhe kjo politikë vazhdon, por mendoj se nuk duhet të kalojë caqet dhe të konsiderohen të gjitha veprimet e Kanit të Pakistanit të drejta e të mbështetshme. Ajub Kani, Jahja Kani, Aga Kani me djallin e me të birin nuk janë veçse reaksionarë sa edhe Nehruja me të bijën. Që të dyja palët shtypin në mënyrë barbare popujt e tyre, që rrojnë në një mizerje të papërshkrueshme.

Nuk është rruga e një shteti socialist, ajo që në politikën me shtetet, të humbasësh nocionin kryesor për të ndihmuar popujt që të çlirohen nga zgjedha e brendshme dhe e jashtme. Pakistani Lindor u ngrit kundër Kanit. Atje populli është i shtypur dhe, nën udhëheqjen e Rahmanit, u revoltua për Bangladeshin. U qëlluan me armë. Ka gisht reaksioni indian këtu? Sigurisht që ka. Por të deklarohesh përnjëherë pro Kanit dhe të angazhohesh se, po të sulmohet Pakistani nga India, Kina do t'i vijë Pakistanit në ndihmë, do të thotë të bësh kauzë të përbashkët me Kanin, pavarësisht se nga ana shtetërore Kani do të mbrojë kufijtë e shtetit të tij. Por çështja e bengalezëve dhe e gjithë popullit indian është një çështje shumë e madhe. Kina këtë problem kaq të madh, sipas mendimit tonë, e ka injoruar në mënyrë magjistrale.

Me gjithë qëndrimet e njohura të Nehrusë, të Bahadur Shastrit, të Indira Gandit, me sa dimë ne, Kina nuk bëri asnjë përpjekje për t'i përmirësuar marrëdhëniet me Indinë, me qëllimin e madh që të neutralizonte atje influencën sovjeta-amerikane. Kinezët, që duan të hiqen si të durueshëm, këtu nuk treguan këtë veti, po të kundërtën. Të mbash anën e një Kani (që është i lidhur edhe me traktat me Shtetet e Bashkuara të Amerikës) kundër një Kani tjetër dhe ta konsiderosh këtë qëndrim «diplomacia e popullit», kjo nuk shkon. Miku Kan të lë në llucë kur të duash, por populli s'të lë kurrë, në rast se bën me të vërtetë një politikë për popullin.

A i lejohej Kinës të bënte një politikë të tillë mosafrimi ndaj Indisë? Unë mendoj se jo. Kur Kina po i bën tërë këto lëshime Niksonit, kreut të imperializmit amerikan, të çudit mbajtja e një qëndrimi të tillë ndaj Indisë. Kurse sovjetikët vepruan me shkathtësi. Ata nënshkruan Traktatin sovjeta-indian dhe forcuan pozitat e tyre në Indi, u thanë reaksionit indian dhe «popullit indian»: «Mos kini frikë as nga Kina, as nga Shtetet e Bashkuara

të Amerikës, se, po t'ju sulmojë kush, do të hyjmë edhe në luftë tok me ju». Traktati në fjalë, i bërë në këtë kohë, i thotë botës se ai «u nënshkrua kundër aleancës kino-amerikane që është në erë». Nga ana tjetër, Kina zyrtarisht u gjend e rrethuar nga traktate zjarri: nga traktatet e vjetra të SEATO-s, SENTO-s etj. dhe tash nga ky sovjeto-indiani. Këtë e precipitoi «politika e zgjuar» e Maos dhe e Çu En Lait drejt hapjes me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e precipitoi «diplomacia e popullit».

Rrethimi i Kinës do të zgjerohet. Ministri i Jashtëm i Indisë, Sing, pasi u largua Gromikoja nga Delhi, u nis që të nesërmen për në Xhakarta për t'u marrë vesh me fashistët indonezianë. Si kundërpeshë, flitet se Kina dërgoi një person në Malajzi. Ç'politikë mizerje, inkohente, e koniunkturave, politikë oportuniste dhe subjektivistet e njerëzve, të cilët evenimentet i kanë bërë të humbasin toruan!

Siç po duket, nga kjo politikë «Japonia është bërë kërcënimi kryesor për Kinën», pastaj vjen Bashkimi Sovjetik, dhe kinezët do t'i frenojnë me «miqësinë e re me Niksonin, me Jugosllavinë e Titos dhe me Rumaninë e Çausheekut»!

Tri janë pikat kardinale të politikës «pozitive» të Kinës: bisedimet me Niksonin, miqësia me Çausheekun dhe lidhjet e vendosura me Titon. Këta dy të fundit, për kinezët, «do të minojnë sovjetët në Evropë!». Dhe lidhjet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të frenojnë edhe sovjetët, edhe japonezët në Azi! Por kinezëve nuk po u shkon fare në mend se janë në pozita oportuniste, se po izolohen, po rrethohen dhe po diskreditohen në sy të popujve, po dobësohen dhe, në rast se nuk reagojnë, do të bëhen preja e armiqve.

Me një politikë të tillë Kina nuk mund të çajë në favor të çështjes së socializmit unazën e zjarrtë sovjeto-japono-amerikane. Interesat e këtyre janë shumë të më-

dhenj e të koklavitur. Lidhjet me Kanin e Pakistanit nuk mund ta çajnë këtë front. Vetëm lufta revolucionare dhe diplomacia revolucionare, vetëm lidhjet me popujt u vijnë hakut armiqve.

Sovjetikët do të fillojnë me siguri edhe konkretizimet e miqësive me Japoninë, kurse gjatë kësaj kohe kinezët interesohen të dinë nga ne, nëse dimë gjë se çfarë u bisedua në Krime dhe mos u vendos gjëkafshë të sulmohet Rumania, siç u sulmua Çekosllovakia?!?! Është me të vërtetë e zorshme të kuptohet një politikë e tillë, politikë që nuk ka një bosht të qëndrueshëm e që lëviz sa andej-këtej.

Do të shohim si do të zhvillohet kjo politikë më vonë. Le të shpresojmë kurdoherë se Mao Ce Duni do ta rishikojë këtë strategji ku ka hyrë politika kineze.

DURRËS, E DIEL

15 GUSHT 1971*

MANOVRAT E KINEZËVE NË BALLKAN

Sot vjen në Tiranë një delegacion i ushtrisë së RP të Kinës i të gjitha armëve, i kryesuar nga drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Politike, Li Te Shen. Ai vjen si delegacion miqësor, por jo apostafat për këtu. Ky delegacion ishte destinuar posaçërisht për në Rumani, e cila më 23 të këtij muaji ka përvjetorin e çlirimit. Shokët kinezë kërkuan që delegacioni i tyre, pasi të vinte në Bukuresht, të vinte edhe te ne. Ne, natyrisht, e pranuan, por ishim të mendimit që ky delegacion të vinte më parë në Shqipëri dhe pastaj të shkonte në Rumani. Prandaj i njoftuam shokët kinezë se pranohej plotësisht propozimi i tyre, por, në rast se e gjenin të arsyeshme, ne delegacionin e pritnim më parë në Tiranë dhe prej këndeje ai të shkonte në Bukuresht.

Kinezët e pranuan propozimin tonë, por ne nuk fituam gjë nga ky ndryshim që kërkuam. Nuk ndryshuam asgjë nga qëllimet e kinezëve. Në fakt, ndoshta, do të ishte më mirë për ne të vinte delegacioni kinez pas Bukureshtit, që opinioni të shikonte se ai ishte nisur apostafat për në Rumani dhe, «kur mbaroi punë «te miku i shquar» në kontinentin evropian, u kthye edhe në Shqipëri». Tjetër kuptim ka kur vjen nga Rumania e tjetër kuptim ka kur vjen më parë te ne.

Pastaj, përse duhet të kalojë nga ne çdo veprim që do të bëjë Kina në Evropë? Ky pretendim nuk është i

drejtë, pse ne jemi modestë dhe kurrë nuk e konsiderojmë veten si «kërthiza e botës». Kur miqtë nuk të konsultojnë për veprimet e tyre politike eventuale, përse ne duhet të implikohemi, qoftë edhe formalisht, nga ana e jashtme, në ato momente dhe për ato çështje për të cilat nuk jemi të një mendimi me ta? Nuk duhet, pra, të hapim precedente të rrezikshme, të cilat më vonë mund të na kushtojnë.

Të marrim çështjen e dërgimit të delegacionit kinez në Rumani. Qëllimi kryesor i kinezëve është të mbështetin antisovjetizmin e rumunëve dhe të nxitin kontradiktat armiqësore rumuno-sovjetike. **Kontradiktat e rumunëve me sovjetikët nuk janë në baza marksiste, po në baza nacionaliste.** Udhëheqësit rumunë, si edhe sovjetikë, janë revizionistë. Rumunët janë anëtarë të KNER-it dhe të Traktatit të Varshavës. Ata marrin kredi dhe bëjnë tregti të madhe me Bashkimin Sovjetik, por nuk duan t'u nënshtrohen shumë gjërave të sovjetikëve, të cilët i kërcënojnë, u bëjnë shantazhe dhe i frikësojnë.

Politika e udhëheqësve revizionistë rumunë është e njëjtë me politikën e Titos: miqësi e ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bonin, me Italinë dhe me të gjitha shtetet kapitaliste. Tash Rumania na doli mikja e ngushtë e Kinës, e cila e ndihmon, e mbron dhe e mbështet Rumaninë pikërisht për këtë vijë politike të saj. Natyrisht ne nuk mund të jemi dakord me Kinën për këtë çështje. **Ne kundërshtojmë ndërhyrjen e revizionistëve sovjetikë në Rumani ose në Jugosllavi, ne jemi dhe do të ndihmojmë për ruajtjen e pavarësisë dhe të sovranitetit të këtyre dy vendeve nga kërcënimet e revizionistëve sovjetikë dhe të imperialistëve. Por ne kurrsesi nuk mund ta lidhim politikën tonë të drejtë me politikën aventureske të titistëve dhe të revizionistëve rumunë.** Të bëhemi ne solidarë me ta në këtë politikë të qelbët të tyre? Në asnjë mënyrë jo! Jo vetëm që nuk do ta bëjmë

kurrë këtë, por as nuk do të lejojmë që këto dy shtete revizioniste, por edhe Kina, të krijojnë përshtypjen në opinion se bëjmë kauzë të përbashkët. Do të qëndrojmë përkrah Rumanisë dhe Jugosllavisë, në rast se këto dy shtete do të sulmohen nga jashtë dhe vetëm në atë rast kur do të luftojnë me armë kundër invazorëve të tyre dhe kur nuk u vjen në ndihmë NATO-ja ose ndonjë anëtar i saj, sepse në këtë rast të fundit lufta e humbet karakterin çlirimtar dhe futet në binarët e një lufte imperialiste.

Kinezët, siç po shohim, në Ballkan dhe në Evropë, janë futur në një politikë që ne nuk mund ta ndjekim plotësisht, siç e mendojnë ata. Politika e tyre në Ballkan dhe në Evropë është «miqësi me të gjithë ata që janë në kundërshtim me sovjetikët», pa pyetur se kush janë këta, janë pro amerikanë, titistë etj. Kjo gjë për ta nuk ka rëndësi. Kjo politikë është pa perspektivë, nuk është në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Të nxiten kontradiktat, të mbrohen popujt, të ndihmohet revolucioni, të vëzhgohet rrjedhimi i politikës dhe i ngjarjeve, mua më duket se janë probleme të mëdha dhe jo kaq të thjeshta, siç i mendojnë kinezët.

Revizionistët rumunë janë mbështetur te revizionistët jugosllavë. Nuk është çudi që midis tyre të kenë edhe marrëveshje të fshehta, që ua dinë sovjetikët, po që nuk ndihen, sepse u leverdis ose kanë edhe ata planet e tyre në këtë lojë. Titoja mbështetet tek amerikanët, te NATO-ja. Ekziston aleanca Jugosllavi-Greqi-Turqi, e cila tash për tash është në gjumë, por që mund të aktivizohet në rast rreziku. Jugosllavët dhe rumunët bëjnë çmos që në rrethin e tyre të na futin edhe ne. Kështu, mendojnë ata, «bëhen tri vende socialiste» kundër Bashkimit Sovjetik, plus Greqia me Turqinë dhe Ballkani hyn i tëri në komplotin titisto-amerikan. Të mos harrojmë se ka disa vjet që Çu En Lai i tha Beqir Ballukut që ne të ecim në këtë drejtim.

Ëndrra e vjetër e Titos dhe e anglo-amerikanëve, tentativat e tyre në kohën e Stalinit dhe tentativat aktuale janë një vazhde!! Kinezët kanë rënë në këto ujëra të qelbëta, por jo ne. Ne nuk do të shkelim në dhogë të kalbur, qoftë edhe sikur kjo gjë të dojë sakrifikimin e miqësisë me Kinën. Ne do të luftojmë edhe vetëm, po ta dojë nevoja; por do të ecim drejt dhe nuk do të futemi në intrigat e fuqive të mëdha.

Vajtja e delegacionit kinez në Rumani dhe ardhja e tij te ne ka si synim që të japë përshtypjen në opinionin botëror se Jugosllavia, Rumania dhe Shqipëria janë «solidare», bile edhe ushtarakisht, kundër Bashkimit Sovjetik. Kinezët, pa aprovimin tonë, por duke përfituar nga miqësia shqiptaro-kineze, u vijnë në ndihmë rumunëve dhe jugosllavëve në këtë drejtim, për të krijuar këtë përshtypje.

Një gazetë hungareze, para tri ditësh, njoftonte se nga vjeshta Çu En Lai do të vizitojë Tiranën, Beogradin dhe Bukureshtin. Sa është e vërtetë kjo, nuk e dimë, por kinezët kanë mundësi ta bëjnë një gjë të tillë skandaloze. Çu En Lai i tha Tepavacit, ministrit të Jashtëm jugosllav, se «po të vij në Evropë, do të vij edhe në Jugosllavi». Natyrisht, në qoftë se e bëjnë këtë, kjo është shumë e rrezikshme për ne. Ne nuk mund të jemi dakord as me brendinë dhe as me format e këtij turneu; nuk mund të jemi dakord as me propagandën e tyre, se kinezëve, titistëve dhe rumunëve u mjafton, qoftë dhe formalisht, që në këtë turne të futet edhe Shqipëria. Do të detyrohemi t'ua themi hapur, si kurdoherë, kinezëve pikëpamjet tonë. Ne në çdo kohë e presim Çu En Lain të vijë, por jo në këto rrethana. Ne, gjithashtu, nuk e ndalojmë atë të vejë në Beograd, në Bukuresht, në Moskë dhe në Uashington, po të dojë. Por këto probleme, kështu si i kuptojnë dhe si i zbatojnë kinezët, do të na nxjerrin telashe, prandaj ne duhet t'i gjykojmë me gjakftohtësi dhe t'i

zgjdhim, gjithashtu, me gjakftohtësi, në rrugën marksiste-leniniste dhe në interesin e atdheut tonë socialist.

Propagandë e madhe po bëhet dhe po fryhet nga jugosllavët, nga rumunët, nga shtypi borgjez se Bashkimi Sovjetik do të sulmojë Jugosllavinë dhe Rumaninë. Natyrisht përmendin edhe Shqipërinë. Kinezët, nga ana e tyre, në kontakte të ngushta me rumunët dhe me jugosllavët, kanë rënë në këto kurthe dhe po shqetësohen seriozisht për fatin e Jugosllavisë dhe të Rumanisë. Ambasadorët kinezë në mënyrë naive kërkojnë të na mbushin mendjen që t'u besojmë këtyre gjërave, bile na raportojnë gjoja «të dhënat» që u japin gjeneralët jugosllavë mbi domethënien e manovrave sovjetike në Hungari dhe në Bullgari. E gjithë kjo punë e kinezëve i ngjet punës së neofitëve që ekzaltojnë dhe kanë besim në miqësitë e reja. Po kjo është puna e tyre.

Që sovjetikët bëjnë presion kundër Rumanisë, kjo nuk ka asnjë diskutim. Ata mbjellin frikë te rumunët dhe u krijojnë e do t'u krijojnë vështirësi të brendshme. Sovjetikët do ta marrin kalanë nga brenda në Rumani, në mos sot, nesër. Rumania është e rrethuar. Do ta sulmojnë me armë? Çdo gjë mund të bëjnë, po situatat nuk janë për një gjë të tillë. Sovjetikët e pushtojnë kollaj Rumaninë me sulm, por, po ta bëjnë një veprim të tillë, do të humbasin shumë politikisht.

Po ashtu sovjetikët bëjnë shantazhe kundër Jugosllavisë, megjithëse janë të sigurt se jugosllavët nuk i trembin dot. Në Jugosllavi ata e dinë se derdhet gjak. Por mendoj se është e vështirë që Bashkimi Sovjetik të sulmojë Jugosllavinë. Këtë gjë as carët nuk e kanë bërë, përkundrazi, ata kanë qenë mbrojtësit më besnikë të serbëve, të malazezve e të tjerëve. As revizionistët sovjetikë nuk do të guxojnë ta sulmojnë Jugosllavinë, se kjo gjë do të ishte një marrëzi. Titoja e di fare mirë këtë. Vetëm kinezët nuk e dinë, por hanë çfarë u thotë Titoja. Sovje-

tikët i bëjnë presion e shantazh Titos që ai të zbutë politikën me ta, të desolidarizohet me rumunët dhe të punojë politikisht për ta në arenën ndërkombëtare. Titoja manovron si ngjalë, kurse sovjetikët përfitojnë nga situata e turbullt brenda në Jugosllavi. Ata dhe miqtë e tyre, serbomëdhenjtë, Titoja nuk i lë të bëjnë si të duan. Këtu qëndron kontradikta dhe fërkimet, por kjo është larg sulmit të armatosur. Titos edhe i leverdis kjo situatë, edhe jo. Brenda nuk i leverdis, por, sidoqoftë, dominon, kurse jashtë e përdor dhe u gri duke marrë ndihma e kredi kolosale nga amerikanët dhe nga të tjerët.

Të gjitha këto ne i kemi parasysh. Ne e njohim mirë Titon, njohim dinakëritë e tij dhe të sovjetikëve. Këta çdo gjë mund të bëjnë, po ta shohin keq (por ujërat nuk tregojnë atë). Zhurma e madhe që po bëhet nëpër botë nga fuqitë e mëdha për rivalitet e hegjemoni, do të nxjerrë diçka në shesh dhe mendoj se kjo tregon pikërisht atë diçka të rrezikshme që po përgatitet. Prandaj duhet të ruajmë gjakftohtësinë, kthjelltësinë në mendime dhe vigjilencën revolucionare.

BISEDË ME DELEGACIONIN USHTARAK KINEZ

Prita sot delegacionin ushtarak të RP të Kinës, që ka ardhur për vizitë në vendin tonë¹.

Biseda kaloi shumë ngrohtë. Pasi i foli për lidhjet e ngushta të miqësisë marksiste-leniniste dhe për disa probleme ndërkombëtare, veçanërisht të luftës sonë kundër imperializmit amerikan dhe revizionizmit sovjetik, i përcaktova që ta kenë të qartë politikën tonë dhe natyrën e lidhjeve me Jugosllavinë dhe me Rumaninë.

Edhe kryetari i delegacionit² foli ngrohtë për marrëdhëniet me ne dhe ekzaltoi rolin e Partisë sonë. Ai foli shumë mirë edhe për ushtrinë tonë.

1 Shih: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 78.

2 Li Te Shen, në atë kohë kandidat i Byrosë Politike të KQ të PKK dhe drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Politike të Ushtrisë Popullore Çlirimtare Kineze.

SHËNIM

Në bazë të kompetencave që na kishte lënë Byroja Politike, sot morëm disa vendime definitive për ftesat që do të bëjmë për pjesëmarrjen e delegacioneve të huaja në Kongresin e Partisë sonë. Për sa i përket Partisë Komuniste të Rumanisë ne jemi të mendimit që të mos ftojme delegacion, por për këtë definitivisht do të pyetet Byroja Politike. Arsyet janë të qarta, ajo ka një vijë revizioniste, të gjitha partitë revizioniste i konsideron «parti komuniste» dhe partitë e reja (m-l) as i njuh, as i peshon, përkundrazi i lufton. Ndaj Partisë sonë ajo nuk ka bërë autokritikë etj.

DELEGACIONI YNË I BUJQËSISË ËSHTË PRITUR MIRË NË KINË

Haki Toska më raportoi se delegacionin tonë të bujqësisë, që u kthye dje nga Kina, e kishin pritur shumë mirë. Shokët e delegacionit kishin parë dhe përfituar mjaft. Kërkesat tona, për mekanizma bujqësorë i kishin pranuar, do të na i japin, prandaj qëndruan atje pesë nga anëtarët e delegacionit për t'i specifikuar.

KINEZËT NA PRESIN MIRË POR LETRËS SONË PËR NIKSONIN ENDE NUK I PËRGJIGJEN

Delegacioni i Ministrisë së Bujqësisë u kthye nga Kina. Shokët tanë panë atje shumë gjëra të mira dhe të përparuara në bujqësi, veçanërisht në rendimente të larta të drithërave, të zorzavateve, të pambukut dhe të rritjes së derrit etj. Pritja që shumë e ngrohtë dhe entuziaste nga masat dhe nga udhëheqësit. Delegacioni ynë kërkoi një ndihmë suplementare në mekanikën bujqësore. Shokët kinezë na e akorduan.

Për çështjen e letrës sonë në lidhje me Niksonin asnjë përgjigje, por me siguri ajo ka bërë efekt.

BREZHNEVI TE TITOJA

Shënime

Moska ka lajmëruar për vizitën që Brezhnjevi do të bëjë këtë muaj në Beograd. Sigurisht do të zbutet situata në mes «shokëve», ata do të përqafohen me njëri-tjetrin. Ka mundësi që Bashkimi Sovjetik t'u akordojë edhe kredi ekonomike «vëllezërve sllavë të Jugut». Këtu nuk ka asgjë për t'u çuditur. Kanë, sigurisht, dhe do të kenë akoma kontradikta sovjetikët me Titon, por këto kontradikta nuk mund të shkojnë më tej «presioneve dhe shantazheve» të zakonshme. Të sulmohej Jugosllavia nga Bashkimi Sovjetik, siç bëhej zhurmë (bile edhe nga Titoja vetë, i cili as që e besonte një gjë të tillë, po e trumbetonte për të alarmuar opinionin, për të treguar vendosmërinë e tij në «neutralitet» dhe sidomos për të marrë kredi nga miqtë dhe nga aleatët e tij perëndimorë), këtë psikozë e frynin edhe rumunët, pse ata ishin dhe janë më në rrezik real nga ndonjë ndërhyrje e sovjetikëve dhe kishin natyrisht interes që ta lidhnin fatin e tyre me atë të Jugosllavisë.

Kontradiktat me Titon, revizionistët sovjetikë nuk i kanë sot. Ata duan ta kenë Titon «të bindur» e tyre, po këtë gjë as e kanë arritur dhe as do ta arrijnë edhe pas vdekjes së Titos, me çfarëdo tipi udhëheqësish që do të vijnë në Beograd. Titoja i ka mprehur mirë njerëzit e

vet; por edhe kundërshtarët e tij të brendshëm, që të mos bien nën tutelën e revizionistëve sovjetikë, ai i ka mprehur dhe i ka edukuar të hanë në çfarëdo grazhdi dhe të anojnë e të ndihmojnë atë grazhd, ku ka ushqime më shumë. Në këto situata nuk fryn erë e favorshme për Kremlinin në Jugosllavinë titiste.

Moska e sheh se Titoja dhe titizmi luajnë një rol që i sjell favore imperializmit amerikan dhe si këtij, ashtu edhe Titos u vjen në ujdi ky rol. Janë të tilla koniunkturat: Kartën e «socializmit», që luan Titoja për amerikanët nuk mund ta luajë kurrkush tjetër. Këtë e dinë edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, edhe Titoja, i cili, gjithashtu, e ka të qartë se, në rast se i largohet këtij roli dhe futet në radhën e Zhivkovëve atëherë mbaron «personaliteti» i tij dhe merr fund gjithashtu roli i tij.

Revizionistët sovjetikë janë megalomanë dhe të mërzitur që nuk po ia arrijnë dot këtij qëllimi. Ata, pra, duke përfituar nga kaosi dhe nga rrëmuja që ka shkaktuar titizmi në Jugosllavi, forcuan presionet mbi të. Por shantazhi nuk u shkoi, atëherë ndërruan pllakën, e zbutën, prandaj do të shkojë atje Brezhnjevi. Kjo është rruga më «e natyrshme». Titoja nuk do t'u bëjë lëshime «parimore», duke shkelur vijën e tij, por do t'u bëjë disa sfumatura. Sovjetikët e kuptojnë mirë që këto janë sfumatura, por do të mbyllin sytë dhe «shokut» Tito do t'i japin kredi, se mbase me anën e tyre depërtojnë më mirë.

Rumunët kanë frikë se mos Titoja i lë në baltë, po e kanë gabim, se Titoja do t'i mbrojë, io për sytë e bukur të tyre, por për interesat e Jugosllavisë dhe për dobësimin e influencës sovjetike. Sovietikët aktualisht kanë tendencë të ulin tensionin në Evropë, të bëjnë presione mbi Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pse frikësohen se mos këto afrohen me Kinën, prandaj dhe bëjnë përgatitje të ethshme për të kundërshtuar më fort Kinën. Pra, politika aktuale sovjetike nuk është të acarojë punët me

Jugosllavinë dhe me Rumaninë, po t'i zbutë, për të punuar në konsolidimin e aleancës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe të mos i lënë këto që të afrohen me Kinën. Në qoftë se nuk ia arrijnë kësaj, sovjetikët punojnë të dobësojnë pozitën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës me Francën, me Bonin etj., dhe të përgatiten kundër Kinës. Nën dritën e kësaj lëvizjeje duhet ta shikojmë ne edhe vajtjen e Brezhnjev-it në Beograd, pastaj në Francë, vajtjen e Podgornit në Hanoi dhe të Kosigin-it në Kanada.

E SHTUNË
11 SHTATOR 1971

VDIQ RENEGATI HRUSHOV

Agjencitë e huaja të lajmeve njoftuan sot nga Moska për vdekjen e N. Hrushovit, renegat e armik i egër i marksizëm-leninizmit dhe i Bashkimit Sovjetik¹.

¹ Hrushovin e rrëzuan nga pushteti pjesëtarët e klikës së tij, më 14 tetor 1964.

PËR FJALIMIN TONË NË OKB

Lexova fjalimin që kishte përgatitur Ministria e Jashtme për mbledhjen e sivjetme të Asamblesë plenare të OKB-së. Ai nuk vlente, ngjante me një artikull propagandistik ordiner dhe, natyrisht, nuk na nderonte. Nuk thellohen shokët sa duhet në problemet dhe zgjedhin mënyrën stereotipe të shtruarjes së tyre.

Thirra Nesti Nasen¹ dhe bisedova me të se çfarë problemesh të rëndësishme, në ç'formë dhe në ç'proporcione duhet të shtrohen në fjalimin që do të mbajë.

¹ Ish-ministër i Punëve të Jashtme, tani dhënë organeve të diktaturës së proletariatit si armik i popullit dhe i Partisë.

RENEGATI HRUSHOV

Shënime

Renegati Nikita Hrushov vdiq më 11 shtator të këtij viti. Ai ishte armiku më i egër i socializmit shkencor, ishte një antimarksist dhe antistalinist i dorës së parë. Me punën e tij tradhtare ai u bë udhëheqësi i revizionizmit modern dhe i shkaktoi një dëm të madh socializmit dhe komunizmit në Bashkimin Sovjetik e në botë. N. Hrushovi i vuri kazmën drejtimit të socializmit në Bashkimin Sovjetik dhe e futi këtë në rrugën e kapitalizmit. Bashkimi Sovjetik vazhdon të ecë në këtë rrugë pa Hrushovin. Shokët e tij renegatë, për të gënjyer masat brenda dhe jashtë vendit të tyre, mezi, pas dy ditësh, dhe me dy radhë lajmëruan vdekjen e tij, kurse gjithë shtypi botëror borgjez, me të drejtë, i bëri shumë elozhe për shërbimet e mëdha që i kishte bërë kapitalizmit.

Partia jonë ka meritën historike që e demaskoi fund e krye e pa mëshirë këtë tradhtar të ndyrë të marksizëm-leninizmit dhe të Bashkimit Sovjetik.

TË DEMASKOJMË QËLLIMET E AFRIMIT MIDIS BASHKIMIT SOVJETIK E GJERMANISË FEDERALE

Dhashë disa mendime e teza që gazeta «Zëri i popullit» të shkruajë një artikull për vajtjen e Vili Brandit në Bashkimin Sovjetik dhe për vijat kryesore të qëllimeve të fshehta që kanë bisedimet Brezhnjev-Brand, veçanërisht për forcimin e miqësisë midis Bashkimit Sovjetik dhe Republikës Federale të Gjermanisë. Kjo miqësi synon t'i shërbejë konsolidimit të pozitave të Republikës Federale të Gjermanisë kundrejt aleatëve të saj në Evropën Perëndimore dhe dobësimit brendapërbrenda të aleancave midis vendeve perëndimore në favor të revanshistëve të Bonit dhe të revizionistëve sovjetikë. Ajo sjell kontradikta në mes Francës dhe Gjermanisë Perëndimore në lëmin ekonomik-financiar dhe në atë ushtarak.

VILI BRANDI NË BASHKIMIN SOVJETIK

Vili Brandi ndodhet prej disa ditësh në Krime, për bisedime me kreun e udhëheqjes revizioniste sovjetike, pas suksesit që korri në çështjen e Berlinit Perëndimor.

Sigurisht, ai vete në këto bisedime si kancelar i Bonit dhe, në sipërfaqe, do të trajtohen probleme të ngriatura ose të zgjidhura me kohë, siç është Traktati Moskë-Bon dhe ai Bon-Varshavë, gjithashtu dhe konferenca që po përgatitet për «Sigurimin evropian» etj. Por ai vete, gjithashtu, si udhëheqës i socialdemokracisë gjermane, që është aktualisht në fuqi. Këtë çështje, pa e thënë në shtyp, e vë në dukje vetë Vili Brandi, i cili nuk ka marrë me vete personalitete të rëndësishme të qeverisë së tij dhe sidomos ministrin e Jashtëm. Por nga ana sovjetike përbërja e delegacionit dhe format kamerateske dhe intime të takimeve e të diskutimeve theksohen me të madhe. Nga ana sovjetike, vetëm Brezhnjevi, sekretari i parë i partisë, pret e përcjell. Në delegacion nuk duket as Kosigini, as Podgorni, as Gromikoja, por as edhe ndonjë zëvendës i tyre kryesor. Kokë më kokë, shefi i partisë revizioniste sovjetike dhe shefi i socialdemokracisë gjermane, pra, revizionizmi modern dhe socialdemokracia, në biseda intime, kanë arritur, në parim, në një unitet mendimesh ideologjike dhe politike, për problemet e mëdha botërore, se kontradikta ka dhe do të ketë në mes tyre dhe pikërisht për t'i sheshuar këto janë takuar dhe, në-

përmjet pazarllëqesh të turpshme, përpiqen të arrijnë në një gjuhë të përbashkët. Këto takime bëhen në Krime, në një vend pushimesh balneare, pa kravata, pa xhaketa, bile edhe pa brekë, po me rrobe banjoje, në pishinat e Hrushovit dhe mbi jahte të ndërhuara nga punëtorët sovjetikë, të cilët nuk e dinin se në to do të prehen dhe do të kurdisin komplete shtypësit dhe vrasësit e tyre, barbarët e djeshëm, revanshistët e Bonit.

Unë mendoj se ky takim udhëheqësish partie, që opinionin botëror nuk e vë në dukje, ka rëndësinë më të madhe, jo për format, por për përmbajtjen, sidomos për zhvillimin e ardhshëm të problemit të rëndësishëm gjerman, evropian dhe botëror.

Sigurisht nga këto takime do të dalë përcaktimi i datës së ratifikimit të traktateve Moskë-Bon dhe Bon-Varshavë, të cilat do të ritrumbetohen si një sukses i të tre këtyre shteteve, po pa përmendur, natyrisht, se kjo u arrit në kurriz të të drejtave të ligjshme të Republikës Demokratike Gjermane, e cila jo vetëm nuk u njoh si shtet sovran, por u afirmua si satelit i Bashkimit Sovjetik revizionist, i cili i manipuloi si deshi të drejtat e Republikës Demokratike Gjermane, i imponoi kësaj një udhëheqje të re, shërbëtore të bindur të tij, likuidoi udhëheqjen revizioniste të Ulbrihtit që rezistonte përpara diktatit dhe hapi rrugën për manipulime të reja skanda-loze.

Pikërisht etapa, që do të zhvillohet pas ratifikimit, është një etapë e rëndësishme dhe kjo, mendoj unë, përbën thelbin e bisedimeve Brand-Brezhnjev, ose bisedimet B-B.

Pse mendoj unë që kjo etapë ka rëndësi? Përpara është çështja e «Sigurimit evropian». Është dëshira e madhe e sovjetikëve që kjo konferencë të ketë sukses, në radhë të parë, për interesat e tyre. Dhe që të arrijë sukses, duhet të ketë partnerë të fuqishëm në Evropën Pe-

rëndimore, domethënë të çajë unitetin politik dhe ekonomik, të paktën, në NATO. Dy janë shtetet më të fuqishme, ku sovjetikët mund të përpjekin kokën: Gjermania e Bonit dhe Franca. Në këto dy drejtime synon aktualisht diplomacia sovjetike. Ajo synon të afrohet mirë me Bonin dhe të qetësojë Francën. Kështu dëmton aleancën e NATO-s, izolon Anglinë, dobëson ndikimin amerikan në Evropë dhe bën që të lëkunden gjithë aleatët e saj në kontinentin tonë. Revizionizmi sovjetik nuk ka ç'i premtton Francës, pa lëre që t'i japë asaj, kurse copës më të rëndësishme dhe më të fuqishme, Republikës Federale të Gjermanisë, ka ç't'i japë dhe ç'të marrë prej saj.

Këto llogari bën edhe Boni, i ndërgjegjshëm për fuqinë e vet, për rolin që duhet të luajë dhe për objektivat që ka caktuar dhe duhet t'i arrijë një nga një.

Qëllimet e Bonit janë: Bashkimi i të dy shteteve gjermane dhe depërtimi i influencës gjermane politikisht, ekonomikisht dhe më vonë kontraktive dhe aleanca ushtarake me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera ku sundojnë revizionistët. Me fjalë të tjera përsosjen e fuqisë së plotë gjermane në Evropë dhe në botë.

Në këto drejtime do të vërtiten bisedimet e Krimësë në mes dy B-ve. Këtu është çështje perspektive, çështje strategjike, për të dyja palët. Problemet nuk do të zgjidhen me lehtësi nga të dyja palët, se edhe po të bien dakord ata, do të lëvizin faktorë të tjerë të shumtë. Do të përdoren taktika dhe zigzage të shumta e të paparashikuara, do të ketë fitore e disfata për të dyja palët e për të tretët; koniunktura të reja do të krijohen, që do të lehtësojnë, do të pengojnë ose do të shkatërrojnë komplotet imperialisto-revizioniste.

Por unë mendoj se revizionizmi sovjetik po afrohet me socialdemokracinë gjermane. Boni e ka më lehtë punën me Brandin në krye, sesa me Kisingerin ose me një shokun e tij.

Revizionistët sovjetikë zor e kishin për të bërë lëshime në kurriz të Republikës Demokratike Gjermane, kur gjenin pengesë nga udhëheqja e kësaj. Tash këtë e eliminuan e do të bëjnë çmos që udhëheqja e Republikës Demokratike Gjermane, dhe pas kësaj, të ecë me çapin që do t'i diktojë Moskë. Në një regjim të tillë, në Republikën Demokratike Gjermane, nuk ka rrezik që populli i këtij vendi të mos dojë bashkimin. Ndjenja e shovinizmit të shtetit të madh është e zhvilluar edhe në Bashkimin Sovjetik, ku më parë ndërtohej socializmi, e jo më në Republikën Demokratike Gjermane, ku socializmi që si një cipë e hollë. Prandaj Boni në këtë drejtim do të ketë sukses më shumë me rrugën «paqësore» sesa me rrugën e luftës, por sigurisht, Bashkimi Sovjetik do t'i bëjë lëshime, por edhe ky do të kërkojë «sigurime», do të kërkojë ndihmë e kredi, mundësisht edhe aleanca. Republika Demokratike Gjermane, sot ose nesër, në një mënyrë ose në një tjetër, do të sakrifkohet nga Bashkimi Sovjetik dhe Gjermania do të unifikohet ashtu siç e do Boni.

Revizionistët sovjetikë dhe satelitët e tyre në Evropë kanë filluar dhe do ta intensifikojnë propagandën e tyre për Republikën Federale të Gjermanisë, që ta paraqitin këtë se nuk është më një vend revanshist, do të propagandojnë për mirëkuptime politike dhe ideologjike me Vili Brandin dhe me partinë e tij. Do t'i vijë radha prishjes së murit të Berlinit, si rezultat më substancial i forcimit të miqësisë Bon-Moskë dhe ky akt do të jetë prelude që të lajmërojë bashkimin e të dy shteteve gjermane. Për të arritur këto qëllime të mëdha të reaksionit gjerman, ka mundësi që reaksioni gjermanoperëndimor ta mbështetë këtë strategji të Brandit dhe të partisë së tij, derisa t'i arrihet natyrisht qëllimit.

Mirëpo e gjithë kjo nuk mund të ecë si në gjalpë, pa kundërshtime, bile të forta, nga shtete të tjera kapitalis-

te të Evropës. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me siguri, nuk do të rrinë me duar lidhur përpara ngjarjeve dhe do të krijohen medoemos kontradikta dhe acarime të ashpra. Këto kontradikta do të ngrenë akoma më shumë rezistencën e popujve kundër fuqive imperialisto-revizioniste që i shtypin dhe luajnë me fatin e tyre.

Sovjetikët dhe gjermanët e Bonit përpiqen të përfitojnë nga koniunkturat aktuale të krizës që ka shpërthyer dhe që me siguri do të zgjerohet dhe do të thellohet më tej në botën kapitaliste, sidomos dhe veçanërisht në ekonominë amerikane. Na bie detyrë t'i ndjekim me kujdes këto zhvillime të situatave, të vërtetojmë nga faktet e jetës konkluzionet tona, të jemi vigjilentë, t'i demaskojmë të gjitha këto makinacione që bëhen në kurriz të popujve, të paqes, të socializmit dhe të revolucionit dhe të jemi kurdoherë të përgatitur për çdo të papritur.

Ç'THONË AGJENCITË E LAJMEVE PËR KINËN

Këto ditë agjencitë e ndryshme të lajmeve po bëjnë shumë zhurmë për «diçka» që po ngjet në Kinë. Ato thonë se dita e shpalljes së republikës, 1 Tetori, nuk do të festohet dhe nuk do të ketë paradë (këtë na e konfirmuan shokët kinezë me arsye jo të shëndosha); se fluturimi i avionëve në Kinë është pezulluar (edhe këtë na e konfirmuan shokët kinezë, si edhe aviatorët tanë që ishin në Kinë); se gjoja është arratisur Lin Biaoja, i ndihmuar nga shefi i shtabit të ushtrisë kineze (arsyeja që na thonë neve: duhet të jemi vigjilentë nga sovjetikët?!); se gjoja Mao Ce Duni është i sëmurë nga zemra ose ka vdekur (këto shpifje i bëjnë çdo vit), ose po bëhet mbledhja e Komitetit Qendror dhe brenda tij ka luftë në mes fraksionit liberal dhe atij «të fortit». Kujt t'i besosh? Ka mundësi që të gjitha këto të jenë dokrra. Të shohim!

SHËNIM

Bisedova përfundimisht me Nesti Nasen, që shkon të martën për në Nju-Jork, për qëndrimet dhe taktikat që duhet të përdoren nga ana jonë në OKB, në lidhje me çështjen e pranimi të Kinës në këtë organizatë.

Rezoluta jonë nuk do të pranohet, pse për dëbimin e Tajvanit amerikanët do të kërkojnë rregullin e dy të tretës së votave dhe kështu ka rrezik që të fitojë rezoluta amerikane, për të cilën ne do të votojmë, si kurdoherë, kundër dhe do ta demaskojmë fort.

NË PRITJEN E AMBASADËS KINEZE

Sonte do të marrim pjesë në pritjen që jep ambasadori kinez me rastin e 22-vjetorit të themelimit të Republikës Popullore të Kinës. Të shohim a do të thotë gjë ambasadori kinez për letrën tonë kundër vizitës së Niksonit në Pekin. Por, me siguri, ai do të heshtë, si zakonisht, se ç'të thotë?! Udhëheqja kineze është në hall, të pranojë bie brenda, të kundërshtojë bie po brenda. Prandaj mund të ketë zgjedhur rrugën e strucit: të futë kokën në rërë që të mos dëgjojë e të mos shikojë çfarë u themi ne kundër kthesës politike që po bëjnë në kundërshtim me interesat e vetë Kinës Popullore, të revolucionit e të socializmit.

TAKIM ME TRUPËN E BALETIT TË RP TË KINËS

Sot paradite në Pallatin e Brigadave prita trupën e baletit të RP të Kinës që po jep shfaqje në vendin tonë.

E DIEL
3 TETOR 1971

ZBULOHEK NJË DOKUMENT ME VLERË TË MADHE SHKENCORE

Shoku Ramiz më vuri në dijeni për «Kodin purpuris Beratinus», dokument i shekullit të 6-të të erës sonë, i cili u gjet në dhe, i fshehur që më 1930, në një kishë në kalanë e Beratit. Ky kod njihet në gjithë botën shkencore si një dokument me vlerë të madhe dhe është kërkuar më kot. Francezi P. Batifol më 1886 ka regjistruar tekstin nga pergameni (100 faqe), po, thuhet, me gabime. Këtë dokument e dërguam në Kinë për t'u restauruar prej specialistëve, pse ishte dëmtuar. Kinezët e ringjallën «të vdekurin» me një punë të lartë e të hollë.

E DIEL
3 TETOR 1971

KISINGERI DO TË SHKOJË NË KINË

Shokët kinezë na njoftuan zyrtarisht se në datën 5 të këtij muaji do të shpallet vajtja e Kisingerit (këshilltarit të Niksonit) në Pekin në 10-ditorin e dytë të këtij muaji, «për rregullimin e vizitës së Niksonit».

Të shohim ç'do të dalë. Koha është e përshtatshme që kinezët t'i vënë kushte.

SHËNIM

Shoku Ramiz më raportoi dhe më kërkoi mendimin tim për marrëveshjen vjetore në mes Universitetit Shtetëror të Tiranës dhe atij të Prishtinës.

KISINGERI PËRGATIT UDHËTIMIN E NIKSONIT NË KINË

Nga të gjitha të dhënat e agjencive të huaja, si dhe nga bisedimet e ndryshme të Çu En Lait me «miqtë» që e vizitojnë, për të cilat na njofton ambasadori ynë në Pekin, vajtja e Kisingerit në Pekin ndjek «rrugën normale» për të përgatitur vizitën e Niksonit, e cila paraqitet «e siguruar».

E PREMTE
8 TETOR 1971

BREZHNJEVI NË BEOGRAD

Shënime

Shumë spekulime u bënë jashtë mbi këtë vizitë. Disa parashikonin presione nga ana e sovjetikëve kundër Jugosllavisë, disa rezistencë «të ashpër» nga ana e Titos etj.

Vetëm ne as që shqetësoheshim për këtë vajtje, pse e parashikonim që ishte pjekje e dy krerëve revizionistë, që kanë kontradikta, por që e gjejnë megjithatë fjalën në mes tyre. Pavarësisht nga kontradiktat, Titoja dhe Brezhnjevi janë dy miq revizionistë, që ia kanë nevojën njëri-tjetrit në këto koniunktura, prandaj nuk do ta çojnë punën në thikë e në pikë. Kollaj nuk sulmohet Jugosllavia nga sovjetikët si Çekoslovakia dhe as Titoja nuk bëhet lepitkë përpara tyre si udhëheqja bullgare. Prandaj parashikonin se bisedat do të zhvilloheshin ashtu siç u zhvilluan.

Në sipërfaqe të puthurat ala sllavçe nuk munguan as në ardhje, as në ikje, pavarësisht se ishin të puthura si të Judës nga të dy kalanderët revizionistë. S'munguan as bisedimet kokë më kokë.

Brezhnjevi zyrtarisht lëshoi nga goja «mjaltë», e quajti «absurde e të pathemeltë» doktrinën me emrin e tij, dënoi «shpifjet» rreth sulmeve nga ana e sovjetikëve në Ballkan, «premtoi» miqësi dhe ndihma për Jugosllavinë. Titoja «u kënaq» që Brezhnjevi përsëriti çka ishte

vendosur për Jugosllavinë në kohën e Hrushovit, ai paktjetër foli edhe për «miqësinë» në mes dy popujve dhe për «politikën e mirënjohur» të ushqimit në shumë grazhde.

Në këtë drejtim Brezhnjevi i doli Titos përpara me kredi të reja, për ta lejuar sovjetin të ruajë praninë e «vëllait të madh sllav» në Jugosllavi. Kjo është puna me ozure e revizionistëve sovjetikë, pa i thënë Titos, i cili e di si buka që ha, «s'të ngasim sa të rrosh, por s'e ke jetën të gjatë. Pas vdekjes sate, «dallëndyshe ktheje ndryshe»».

Sidoqoftë të dy luftuan për të fituar kohë dhe Titoja, pasi siguroi kreditë nga Bashkimi Sovjetik, do të shkojë së shpejti me dhisk në Kanada, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e gjetkë, për silazh të ri.

Vetëm rumunëve u ka hipur frika dhe dyshojnë nga «miku i tyre i ngushtë», Titoja. Ata dyshojnë se Titoja i la në llucë dhe Çaushtit i janë ftohur p... Revizionisti Çausheku e di se revizionistët e tjerë mendojnë si ai, njëri-tjetrit ia kanë me lesh në bark. «Sllavët puqen», thotë «ideologu i madh» Çausheku, «në kurriz të latinëve». Prandaj i preokupon shumë të dinë bisedat kokë më kokë të Tito-Brezhnjevit, që nuk do t'i mësojnë kurrë. Pale, por rumunët kishin edhe pretendimin që Brezhnjevi, i cili shkoi në Hungari dhe në Bullgari, të shkonte edhe në Bukuresht, domethënë të shkonte të piquej me «dashnoren rumune».

Brezhnjevi jo që nuk shkoi, por as Titoja nuk e thirrri deri tash lakeun Çausheku që t'i thoshte disa fjalë, se ç'u bë në Beograd.

Titoja vazhdon politikën e madhe të tradhtisë. Ai tradhtoi marksizëm-leninizmin, ai shet popullin e tij dhe jo të mos shesë lëkurën e Çaushekut.

E PREMTE
8 TETOR 1971

PSE NUK DUHET FTUAR NË KONGRESIN TONË PARTIA KOMUNISTE E RUMANISË

Shënime

Nuk duhet ta thërresim pse ajo komuniste ka vetëm tabelën, kurse në fakt nuk është veçse një parti revizioniste. Kontradiktat që ka ajo me Bashkimin Sovjetik dhe me revizionistët e tjerë, janë kontradikta jo në baza parimore marksiste-leniniste, por në baza revizioniste, nacionaliste, borgjezo-kapitaliste. Ideologjia dhe politika e Partisë Komuniste të Rumanisë janë të një-llojta me atë të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, por me ndryshimin se ajo dhe shteti që drejton janë të inkuadruar në organizmat që ka krijuar shteti sovjetik dhe partia revizioniste e Bashkimit Sovjetik. Partia Komuniste e Rumanisë lufton t'u shpëtojë këtyre hallkave brenda kësaj rrjete, kurse titizmi lufton jashtë rrjetës.

Organizimi i brendshëm i partisë rumune dhe ai i shtetit rumun nuk kanë marrë plotësisht ato tipare që kanë këto në Jugosllavi, ato ruajnë disa tipare afërsisht të njëjta me partinë dhe me shtetin revizionist hrushovian, por degjenerimi i tyre ka ndjekur dhe po ndjek të njëjtën rrugë. Mund të ruash disa tabela, të varura jashtë, për demagogji, por politika dhe ideologjia janë tjetër, janë revizioniste.

Partia Komuniste e Rumanisë mbështeti plotësisht

vijën e Kongresit të 20-të dhe jo vetëm nuk formuloi asnjëherë qoftë një kritikë të vogël kundër kësaj tradhtie të madhe, por e mbështeti me zjarr këtë dhe vazhdon ta mbrojë dhe të ketë në parimet orientuese të saj strategjike po ato parime që formuloi Hrushovi: pacifizmin, «bashkekzistencën paqësore», miqësinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me shtetet e tjera kapitaliste, shuarjen e polemikës në mes marksistë-leninistëve dhe revizionistëve, unitetin e marksistë-leninistëve dhe të revizionistëve, «të lëmë mënjanë ç'na ndan dhe të shohim ç'na bashkon», bashkimin e marksistë-leninistëve me revizionistët në një «front të vetëm kundër imperializmit» etj., etj.

Pra asgjë nuk ka ndryshuar ideologjikisht dhe politikisht në Partinë Komuniste të Rumanisë për sa i përket kursit të saj revizionist, përkundrazi revizionizmi është konsoliduar, gjë që do të thotë se partia dhe shteti i tyre janë degjeneruar.

Partinë tonë rumunët e kanë sharë, e kanë sulmuar dhe atakuar poshtërsisht. Asnjëherë ata nuk kanë njohur gabimet e tyre të rënda në këtë drejtim dhe vazhdojnë të mos bëjnë autokritikë. Në Kongresin tonë të mëparshëm ne i thirrëm për t'u dhënë mundësinë të shikonin dhe të ndreqnin pozitat e tyre veçanërisht ndaj Partisë sonë. Ata bënë të tyren, bile në korridore, në Kongresin tonë nuk munguan të tregonin habinë, duke thënë: «Ç'janë këta përfaqësues partie marksiste-leniniste që kanë ardhur». Ne i vumë në vend këta revizionistë që në atë kohë.

Po ne konstatojmë se që atëherë dhe deri tash ata kanë bërë përparime në këtë drejtim. Jo vetëm që janë aktivizuar për partitë revizioniste jashtë bllokut të Traktatit të Varshavës, por bëjnë çmos për t'u hequr si lidërsi i tyre. Bile, krahas kësaj, rumunët bëjnë një luftë të hapët dhe denigruese kundër partive të reja

marksiste-leniniste. Këtë politikë denigruese përpiqen t'ua futin edhe kinezëve dhe t'i shtyjnë këta të marrin lidhje dhe kontakte me partitë revizioniste.

Në këto kushte Partia Komuniste e Rumanisë nuk ka vend në Kongresin tonë të 6-të, s'mund të kemi lidhje me një parti revizioniste. Marrëdhëniet shtetërore janë tjetër gjë, të tilla ne kemi dhe do të vazhdojmë të kemi.

E DIEL
10 TETOR 1971

SHËNIM

Ramë dakord me shokët e Byrosë Politike që t'u paraqitet shokëve kinezë varianti për ndërtimin e Hidrocentralit të Bushatit dhe shtesat në termocentralet ekzistuese, për të plotësuar nevojën me energji elektrike, në rast se Hidrocentrali i Fierzës nuk mbaron më 1976.

SHËNIM

U rekomandova shokëve të Qeverisë të studiojnë kuotën që duhet të paguajnë jugosllavët, në rast se ne fillojmë ndërtimin e Hidrocentralit të Bushatit. Nga këto punime në zonën e Shkodrës, Mali i Zi do të përfitojë sasi të mëdha toke, që do të bonifikohen. Jugosllavët kanë shumë mundësi që të bëjnë naze dhe të mos na paguajnë gjë, po ne duhet të insistojmë.

PARTIA KOMUNISTE E KINËS NUK DËRGON DELEGACION NË KONGRESIN E 6-TË TË PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

Këtë lajm na e komunikuan ambasadori kinez në Tiranë dhe Gën Biaoja ambasadorit tonë në Pekin. Një gjë të tillë nuk e pritnim, as na shkonte ndër mend që Partia Komuniste e Kinës t'i bënte Partisë sonë një «sfidë» të tillë publike.

Cilat janë arsyet që dhanë?

1) Se në kongresin e tyre të fundit kanë vendosur që as të mos thërresin delegacione të partive motra në kongreset e tyre, as të dërgojnë delegacione të Partisë Komuniste të Kinës në kongreset e partive motra.

2) Se lëvizja komuniste ndërkombëtare aktuale nuk është si më parë, janë krijuar shumë parti marksiste-leniniste dhe grupe, që akoma nuk janë konfirmuar, që paraqiten të përçara, bile në vende të ndryshme ka dy e tri parti të tilla etj., etj.

3) Se shokët e udhëheqjes aktualisht janë shumë të zënë me punë shtetërore dhe partie brenda dhe nuk mund të dalin dot jashtë vendit të tyre etj.

Por, shtoi ambasadori kinez, «Partia Komuniste e Kinës do t'i dërgojë Kongresit të 6-të të PPSH një mesazh urimi edhe për 30-vjetorin e themelimit të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe do të shkruhet në gazetatat tona e do të bëhen mitingje në qendra pune» etj.

Këto janë të famshmet arsye që japin për mosardhjen në Kongresin e 6-të të Partisë sonë. Të gjitha këto arsye janë pa baza, jo të drejta, disa edhe të gënjeshtërt. Le t'i analizojmë një e nga një.

Kongresi i Partisë Komuniste të Kinës nuk ka marrë një vendim të tillë, siç thonë ata, këtë vendim është e logjikshme ta marrë Komiteti Qendror ose Byroja Politike. Një vendim i tillë mund të merret, por në momente e në raste të caktuara, e jo të bëhet parim, siç na u tha nga shokët kinezë. Ata vendosën që të mos thërritnin delegacione në Kongresin e 9-të të partisë së tyre. Kjo është normale dhe nuk mund të kundërshtonte njeri. Ata mund të merrnin edhe një vendim, sikurse e morën, që të mos vijnë në Kongresin e 6-të të Partisë sonë. Nga ana formale kjo është një e drejtë e tyre, po nuk u lejohet të gënjejnë. Vendimin për të mos dërguar delegacion në Kongresin e Partisë sonë e ka marrë Komiteti Qendror, Byroja Politike, ose disa udhëheqës, po jo Kongresi i 9-të i Partisë Komuniste të Kinës. Me këtë manovër pa kripë ata duan të mbulojnë veprimin e udhëheqjes, duke e quajtur atë si zbatim të vendimit të Kongresit të 9-të të partisë së tyre, domethënë «në vend që të vënë vetulla, nxjerrin sytë». Ky vendim është marrë tash vonë, nga mesi i shtatorit. Këtë gjë e vërtetojnë dy ndodhi:

a) Një shoku të Partisë Komuniste të Polonisë, që ishte në Kinë dhe donte të vinte në Shqipëri, që në qershor i thanë: «Rri deri nga tetori dhe shko tok me delegacionin e partisë sonë që do të vejë në Kongresin e Partisë së Punës të Shqipërisë».

b) Një shok indonezian na tha tash, para dy-tri ditëve: **Me ç'linjë avionësh mund të vij në Tiranë për të marrë pjesë në Kongresin e 6-të të PPSH, se shokët kinezë më kishin thënë që do të vija tok me delegacionin kinez, i cili do të kryesohej nga Li Hsien Nieni, por ata më lajmëruan se nuk do të dërgojnë delegacion.**

Këto fakte vërtetojnë, pra, se ky nuk është vendim kongresi, se vendimi për të dërguar delegacion në Kongresin e 6-të të Partisë sonë ishte marrë dhe u tërhoq pas letrës që ne i dërguam Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, ku i shfaqnim mendimin tonë lidhur me vajtjen e Niksonit në Pekin. Gjithashtu del se ky vendim është marrë pas 1 shtatorit, kur u penguan dhe u hoqën manifestimet e paradat në Tien An Men, kur një avion u rrëzua thellë në territorin mongol, kur u ndaluan fluturimet ushtarake dhe civile në Kinë, u mbyllën aerodromet etj.

Këto janë të vërteta, kurse emri i Lin Biaos, në fakt, nuk përmendet fare që në atë kohë as në pritjet që jepen brenda në Kinë, po as jashtë saj, kur flasin kinezët. Ambasadori kinez te ne, i cili orë e çast e përmendte emrin e Lin Biaos bashkë me atë të Maos, tani nuk përmend as këtë të fundit, që të mos duket boshllëku.

Në këtë çështje bota e jashtme bën shumë spekulime dhe kryesorja është kjo kampanë: **Lin Biaoja dhe shokët e tij janë eliminuar, se kanë qenë kundër vajtjes së Niksonit në Pekin. Atëherë, po të jetë e vërtetë kjo ngjarje (dhe ne mendojmë se duhet të jetë e vërtetë), mosdërgimi i delegacionit në Kongresin e 6-të të Partisë sonë është kundërshtim për çështje parimore me Partinë tonë. Ne jemi të bindur për këtë, se i njohim mirë lëkundjet në vijë të kinezëve, pozitat revizioniste të grupit të Çu En Lait, i cili, në fakt, ka fituar mbi të tjerët dhe vepron, i ndihmuar nga Maoja dhe nën hijen e këtij.**

Pra, pikëpamjet e shfaqura në letrën tonë kanë koiciduar me pikëpamjet e grupit të Lin Biaos. Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës jo vetëm nuk iu përgjigj letrës sonë, dhe nuk tregoi asnjë reagim, por, me vajtjen e delegacionit tonë të bujqësisë në RP të Kinës, ata i pranuan me dashamirësi kërkesat tona për bujqësinë.

Ne dolëm me konkluzionin se ata do të na jepnin përgjigje për letrën gojarisht nëpërmjet kryetarit të delegacionit të tyre që do të vinte në Kongresin e Partisë sonë, për të cilin ishte vendosur. Mirëpo, siç duket, punët brenda tyre u komplikuan «me kundërshtimin e grupit të Lin Biaos». Po të pranojmë këtë version, atëherë mund të thuhet se çështja u komplikua për ta për arsye se «Lin Biaon e dënuan për problemin e Niksonit», gjë që do të thotë se ata janë në kundërshtim parimor me vijën tonë për këtë çështje dhe, në rast se do të vinin në Kongresin e Partisë sonë, atëherë duhej të na jepnin përgjigjen e letrës që ne u kishim dërguar lidhur me vizitën e Niksonit në Kinë, por njëkohësisht do të na thoshin edhe arsyet e «dënimit të Lin Biaos». Kjo nuk ecte për ta, prandaj supozohet që të kenë gjetur si rrugëzgjdhje mosdërgimin e delegacionit, për të mos i acaruar më tej punët me Partinë tonë.

(Në mbledhjen e Byrosë Politike kam parashtruar edhe një varg argumentesh të tjera që vërtetojnë vijën e drejtë të Partisë sonë dhe pikëpamjet revizioniste të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës, prandaj nuk dëshiroj të zgjatem më tej për këtë pikë.)

Arsyeja e dytë që japin shokët kinezë për mosdërgimin e delegacionit të Partisë Komuniste të Kinës në Kongresin e Partisë sonë nuk qëndron aspak në këmbë. **Ne bëjmë Kongresin e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe jo mbledhje të komunizmit ndërkombëtar. Pra, ti vjen në Kongresin e 6-të të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe jo në ndonjë mbledhje të partive marksiste-leniniste të botës.** Ti, Partia Komuniste e Kinës, ke marrë një vendim që të mos thërresësh në kongresin tënd partitë motra dhe kjo është një çështje që të përket ty, kurse Partia e Punës e Shqipërisë ka vendosur të thërresë delegacione dhe kjo është një çështje që i përket asaj.

Por problemi themelor nuk qëndron në këtë të drejtë,

ai qëndron gjetkë: **Partia Komuniste e Kinës nuk ka besim te partitë e reja marksiste-leniniste dhe te grupet që po krijohen, që po luftojnë e po konsolidohen, po spastrohen e po kaliten. Ky është një proces dialektik revolucionar. Partia Komuniste e Kinës nuk do që të afishohet tok me to, ajo ka frikë për këtë dhe kjo i përshtatet vijës revizioniste të lëkundshme të saj. Ajo tregon solidaritet të plotë me partinë revizioniste të Rumanisë, por syrin e ka edhe te partitë e tjera revizioniste.** Duke mos dëshiruar të afishohet, ajo do që ta lavdërojë të tërë, të bëjë nga një bisedë dypalëshe, por të mos i japë asnjë ndihmë në bllok lëvizjes së komunizmit ndërkombëtar. Partia Komuniste e Kinës, me dy ose më shumë vija në gjirin e saj, mban lidhje me çfarëdo parti ose grup që quhet gjoja marksist-leninist dhe që e lavdëron atë. Kurse Partia e Punës e Shqipërisë mban qëndrim marksist-leninist revolucionar ndaj lëvizjes komuniste botërore dhe partive e grupeve marksiste-leniniste, të cilat i ndihmon e i përkrah dhe dënon ato që devijojnë nga parimet marksiste-leniniste.

Për sa i përket arsyes së tretë që japin kinezët, në rast se pranojmë versionin që në udhëheqjen e Partisë Komuniste të Kinës kanë ngjarë turbullira, për të cilat unë kam shkruar, atëherë shpjegohet arsyeja e mosardhjes së delegacionit të kësaj partie. Por, në rast se s'ka ndonjë gjë serioze, të thuash se «s'dërgojmë dot delegacion se shokët janë të zënë me punë», kjo jo vetëm është absurde, por edhe armiqësore ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë. (Këtë situatë e shpjegova më hollësisht në mbledhjen e Byrosë Politike dhe nuk është nevoja të zgjatem.)

Çdo e keqe ka edhe të mirën e vet. Reaksioni dhe revizionistët do ta shfrytëzojnë këtë veprim antimarksist të udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës, por lëvizja komuniste ndërkombëtare do të gjykojë sa drejt e ka

vijën Partia jonë dhe sa të gabuar e ka Partia Komuniste e Kinës në këtë çështje.

Bota do të shohë, gjithashtu, e do të gjykojë se Shqipëria është e pamposhtur, se Partia e Punës e Shqipërisë është e pamposhtur. Mosdërgimi i delegacionit të Partisë Komuniste të Kinës në Kongresin e Partisë sonë, brenda vendit tonë nuk do të bëjë asnjë efekt negativ, përkundrazi **Partia dhe populli ynë, që kanë kaluar kaq dallgë, do të bëhen më të fortë e më të çeliktë. Uniteti te ne do të arrijë kulmin, entuziazmi i popullit për Partinë do të jetë i papërshkrueshëm.**

Për lëvizjen komuniste ndërkombëtare natyrisht kjo vijë oportuniste, revizioniste e Partisë Komuniste të Kinës nuk është e mirë, sepse e dobëson dhe e çorodit. Por çdo gjë do të kapërcehet.

Le të luftojmë dhe le të shpresojmë se shokët kinezë do të frenohen. (Për sa u përket qëndrimeve tona fola, gjithashtu, gjatë në mbledhjen e Byrosë Politike, prandaj nuk është nevoja të zgjatëm këtu.)

E ENJTE
14 TETOR 1971

SHËNIM

Lajmëruam që Nesti Nase të qëndrojë në Nju-Jork derisa të hapet debati për pranimin e Kinës në OKB, pastaj të nisët menjëherë.

E MARTË
19 TETOR 1971

ÇFARË QËNDRON PAS KËTIJ VENDIMI TË KINEZEVE

U konfirmua nga shokët tanë se në ditët e para të shtatorit ishte marrë vendimi që Partia Komuniste e Kinës të dërgonte delegacion në Kongresin e 6-të të Partisë sonë. Këtë ua komunikuan tanëve shokët e Drejtorisë së Jashtme të KQ të PKK. Ky vendim duhet të jetë ndryshuar më vonë. Pra nuk është e vërtetë, siç na u komunikua zyrtarisht, se mosdërgimi i delegacionit ishte vendim, në parim, i Kongresit të 9-të të Partisë Komuniste të Kinës.

E MËRKURË
20 TETOR 1971

SHËNIME

U dhashë dorën e fundit fjalimeve që do të mbaj në mbylljen e Kongresit të 6-të, në mitingun që do të mbahet me popullin e Tiranës dhe në darkën që do të jepet nga Komiteti Qendror i Partisë për delegatët e huaj.

Partia e Tajlandës, ajo e Birmanisë dhe ajo e Malezisë lajmëruan se «s'kanë mundësi» të dërgojnë delegacion, por do të dërgojnë mesazhe. Është e qartë, ndjekin shembullin e Kinës. Vietnami i Jugut do të vijë, i Veriut nuk ka lajmëruar.

E ENJTE
21 TETOR 1971

SHËNIM

Republika Demokratike e Vietnamit do të dërgojë delegacion në Kongresin tonë të 6-të.

E PREMTE
22 TETOR 1971

KINEZËT NUK DUAN TË BISEDONJË PËR HIDROCENTRALIN E BUSHATIT

Kinezët refuzuan të bisedonin me shokun Rahman Hanku, në lidhje me propozimin tonë për Hidrocentralin e Bushatit. I thanë se janë të zënë me punë (Li Hsien Nieni), e dinë propozimin dhe nuk janë dakord. Ata qëndrojnë vetëm te Hidrocentrali i Fierzës dhe ky të mbarojë më 1977. E lajmëruam Rahmanin të përfundojë për Fierzën.

E HËNE
25 TETOR 1971

KAZHIMIEZH MIJALI SHFAQ PAKËNAQËSI NDAJ KINEZËVE

Shoku Ramiz më vuri në dijeni për bisedën që i ka bërë shoku polak Mijal, i cili u kthye nga Kina. Për shërbimet mjekësore që i kanë bërë, ai ishte i kënaqur, por kishte mbetur i pakënaqur për qëndrimet e tjera, për punë partie, për punë politike. Ai kishte rënë në kundërshtim për mjaft çështje dhe shokëve kinezë, sipas tij, u kishte mbetur «qejfi». Këtë e kishin treguar me pritjet e ftohta ose krejt «të shkurtra dhe pa brendi të thellë».

E MARTE
26 TETOR 1971*

PRANIMI I KINËS NË ORGANIZATËN E KOMBEVE TË BASHKUARA

Votimi u bë dje në mesnatë dhe rezoluta jonë, që kërkonte pranimin e Republikës Popullore të Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara me të gjitha të drejtat dhe dëbimin nga kjo organizatë të kufomës së Çan Kai Shisë, fitoi me 76 vota pro. Rezoluta amerikane nuk mori veçse 35 vota. Imperializmi amerikan pësoi një disfatë të madhe politike. Lufta e guximshme, konsekuente dhe e ashpër kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës u udhëhoq nga Republika Popullore e Shqipërisë.

Një vend i vogël socialist, por i pamposhtur, fitoi mbishtetin më të fuqishëm imperialist. Ne luftuam për një çështje të madhe e të drejtë, prandaj fituam. Kundërshtarët tanë ishin të plotfuqishëm në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe në krye të tyre qëndronin Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sovjetikët, në fakt, ishin në ujdi me SHBA-në dhe votimi i revizionistëve sovjetikë, gjoja pro Kinës, ishte vetëm formalizëm, për të mos u demaskuar ujdia e tyre me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në përpjekjet për ta mbajtur jashtë Kinën nga Organizata e Kombeve të Bashkuara. Çdo qëndrim tjetër atyre do t'u prishte punë, do t'u krijonte telashe të mëdha dhe do t'i bënte të humbisnin influencën dhe statusin që kishin krijuar.

Në Organizatën e Kombeve të Bashkuara sundonin

këto dy superfuqi, kurse të tjerët i ndiqnin, kush më shumë e kush më pak. Vetëm Shqipëria socialiste u binte kokës me guxim që të dyve dhe satelitëve të tyre në çdo seancë e për çdo problem, kundër çdo intrige e plani djallëzor. Ky ishte realiteti dhe ky realitet u kurorëzua me sukses me pranimin e Republikës Popullore të Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara.

Është Kina socialiste ajo që me prestigjin e saj në arenën ndërkombëtare, bëri që të shpartallohej politika obstruksioniste e armiqve të saj, që për dekada e mbante Kinën jashtë Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Pësha e Kinës në botë është e madhe.

Partia jonë e mbrojti Kinën me të gjitha forcat e saj. Ne e mbrojtëm Kinën vetëm, kundër të gjithëve në Bukuresht, dhe këta të gjithë kishin në krye revizionistët sovjetikë dhe mbështetjen e imperializmit amerikan dhe të reaksionit botëror. Ne i mbrojtëm Kinën, Mao Ce Dunin dhe Revolucionin Kulturor, sepse mbronim marksizëm-leninizmin. Mbetëm vetëm, por as u tundëm, as u frikësua, përballuam furtuna të tmerrshme që iu turrën Kinës dhe neve.

Qëndrimet tona ndaj Kinës kanë qenë kurdoherë parimore, të hapëta, të sigjerta, pavarësisht se shumë qëndrime e veprime të tyre, në situata të ndryshme, kanë qenë të paqarta, oportuniste, revizioniste. Ne nuk e humbëm besimin te Partia Komuniste e Kinës, por parimet marksiste-leniniste i ruanim e i ruajmë si sytë e ballit dhe vërejtjet tona shoqërore kurdoherë nuk kanë munguar kur duheshin dhe pavarësisht se si do të priteshin.

Pra, për pranimin e Republikës Popullore të Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara kontribuoi fuqimisht edhe vija e drejtë, revolucionare, marksiste-leniniste e Partisë dhe e Qeverisë sonë në fushën diplomatike botërore.

Është e natyrshme dhe e ligjshme që autoriteti i Re-

publikës Popullore të Shqipërisë të ngrihet akoma më lart në botë. Shtypi i huaj thotë: **Vite me radhë luftoi Davidi me Goliathin dhe fitoi Shqipëria e vogël, u mund Amerika e madhe.** Ne ishim të bindur për këtë fitore, sikurse jemi të bindur se për Shtetet e Bashkuara të Amerikës kjo disfatë nuk është as e para, por nuk do të jetë as e fundit.

Kjo ngjarje e madhe ndërkombëtare do të ketë rrjedhime të mëdha në çështjet botërore. Varet shumë nga politika që do të ndjekë Republika Popullore e Kinës. Në rast se ajo do të bëjë një politikë të zgjuar, të shkathtë dhe sidomos parimore, marksiste-leniniste, atëherë revolucioni dhe lufta çlirimtare e popujve do të kenë shumë dobi.

Për sa na përket neve, do të vazhdojmë rrugën tonë, vijën tonë, luftën tonë për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të socializmit, të komunizmit. Ne do të vazhdojmë t'u japim pareshtur ndihmën tonë popujve që luftojnë, do të vazhdojmë luftën e paepur kundër imperializmit amerikan, socialimperializmit sovjetik dhe satelitëve të tyre. Ne do të jemi në unitet të plotë me të gjithë ata që do të zbatojnë drejt dhe me konsekuencë parimet e marksizëm-leninizmit.

Me letrën që Komiteti Qendror i Partisë sonë i dërgoi Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, ku i shfaqte mendimin që Niksoni s'duhej prituri në Pekin (dhe për këtë mendim, megjithëse ata deri tash nuk na kanë thënë asgjë, ne e kuptojmë që shokët kinezë nuk kanë mbetur të kënaqur), ne treguam konsekuencën e luftës sonë, si rezultat i së cilës u hoq njëra pengesë që kishin vendosur Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat s'ishin dakord që RP e Kinës të pranohet në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Por, me pranimin e Kinës në këtë Organizatë, kjo pengesë u zhduk. Kështu u hap rruga që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të detyrohen të njo-

hin Qeverinë e RP të Kinës dhe të sqaronin çështjen e Tajvanit para vajtjes së Niksonit në Kinë. Pra, ne luftuam që padrejtësitë, të cilat i bëheshin Kinës, të viheshin në vend, jo me pazarllëqe, por me luftë dhe jo pse donin Shtetet e Bashkuara të Amerikës, po kundër dëshirës së tyre.

Shokët kinezë nuk duhet as ta harrojnë, as ta nënvleftësojnë këtë dhe kjo duhet t'i bëjë ata të njohin gabimin e tyre të madh dhe të turpërohen që nuk dërgojnë delegacion në Kongresin e 6-të të Partisë sonë, të kësaj partie që iu ndodh kurdoherë në krah në momentet më të vështira të jetës së tyre. Por s'ka gjë, ne bëjmë detyrën tonë si parti marksiste-leniniste dhe si shtet socialist.

E EMLIT
E TETOR 1971

E MARTË
26 TETOR 1971*

URIMET TONA PËR PRANIMIN E KINËS NË ORGANIZATËN E KOMBEVE TË BASHKUARA

Ne duhet t'i bëjmë urimet tona Kinës për pranimin e saj në OKB. Me këtë rast i thashë Nesti Nases të shkonte për të uruar ambasadorin e Kinës dhe për t'i marrë mendimin (se gjoja mos bëjmë ndonjë gabim) në lidhje me atë që telegramin t'ua drejtojmë Maos, Dun Bi Usë dhe Çu En Lait, në vend të Maos, Lin Biaos dhe Çu En Lait, si zakonisht, dhe këtë gjë «e bëjmë», t'i thotë, «për t'i dhënë rëndësi edhe nga ana shtetërore». Ambasadori kinez, i lehtësuar, qe përgjigjur: «Shumë mirë keni menduar». Ai u pyet përsëri: «A është nevoja që ju të konsultoheni me Pekinin për këtë çështje?». Ambasadori i tha: «Jo, jo, ju e keni menduar shumë mirë këtë çështje». Pra, pa na thënë gjë, vërtetohet tërthorazi se diçka ka ngjarë me Lin Biaon. Fjalët që janë hapur nuk duhet të jenë pa baza. Po do të presim kur kinezët të na e thonë vetë. Kjo çështje do të dalë një ditë.

U rekomanduam shokëve të organizohen vizita nga punonjësit e Tiranës në ambasadën kineze dhe t'i dërgojmë urime Pekinit.

Me të gjitha qëndrimet tona konsekuente marksiste-leniniste në mbrojtje të Kinës dhe të Partisë Komuniste të Kinës, le t'i themi Pekinit se ata bënë një gabim të madh që nuk dërguan delegacion në Kongresin tonë të 6-të.

BISEDIMET E ÇU EN LAIT ME HENRI KISINGERIN

Bisedimet e dyta mbaruan. Në vend të katër ditëve ato vazhduan gjashtë ditë, në fshehtësinë më të madhe. Komunikata është lakonike, sidomos nga ana e kinezëve, një komunikatë që nuk thotë gjë tjetër përveçse «bisedimet kishin të bënin me udhëtimin e presidentit amerikan për në Pekin». Këtë e di e gjithë bota.

Kurse Kisingeri, i cili u kthye në Uashington, pati bisedimet e para me presidentin e tij dhe, sipas agjencive të huaja, deklaroi se çdo gjë shkoj mirë, bisedimet mbi udhëtimin e presidentit në Kinë janë në vijë. Ky udhëtim do të bëhet nga fillimi i vitit 1972 dhe për këtë Kisingeri do të shkojë prapë në Pekin, ku do të ketë bisedime me Çunë, këtë herë për të bërë përgatitjet e udhëtimit nga ana teknike.

Kisingeri, kurdoherë sipas agjencive të shtypit, ka deklaruar se Niksoni do të bisedojë me Maon dhe me Çunë për shumë probleme, po jo për Bashkimin Sovjetik dhe për çështjen e Vietnamit, që duhet «të bisedohet me vietnamezët». Kisingeri kishte thënë, gjithashtu, se gjoja nuk dinte gjë mbi mosmarrëveshjet në gjirin e udhëheqjes kineze dhe kjo sikur, siç u shpreh ai, nuk u interesonte.

Mundet, pra, të konkludojmë se vajtja e Niksonit në Pekin nuk has në asnjë pengesë. Edhe në qoftë se ka pasur pengesa për këtë në gjirin e udhëheqjes kineze, ato tashmë janë eliminuar, duke u dënuar si «pikëpamje maj-

tiste». Për problemet që do të bisedohen kanë rënë me siguri dakord jo vetëm si nomenklaturë, por është gjen-dur edhe zgjidhja e përafërt dhe e përbashkët. Pretendi-mi i Kisingerit se nuk është folur për Bashkimin Sovjetik dhe për Vietnamin, është vetëm për galerinë.

Problemi i pranimit të Kinës në Organizatën e Kom-beve të Bashkuara, ku ne luajtëm një rol të rëndësishëm, u zgjidh me luftë, dhe një vit më përpara nga sa e prit-nin si Niksoni ashtu edhe Çu En Lai dhe nga sa e kishin deklaruar ata vetë zyrtarisht disa ditë më parë se të bë-hej votimi definitiv në OKB. Domethënë pengesa numër një e jashtme u eliminua. Sikurse rekomandova të shëno-hej në fjalimin e delegacionit tonë në Organizatën e Kom-beve të Bashkuara, «Pons Pilati» i lau duart për dëbimin e Çangut nga kjo organizatë. Kjo i hapi rrugën kapërcimit të pengesës së dytë, lidhjes së marrëdhënieve diplomatike në mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republi-kës Popullore të Kinës. Për këtë duhet gjetur formula e pranueshme nga të dyja palët që «edhe mishi të piqet, edhe helli të mos digjet», edhe Çangu të rrojë në Tajvan, edhe Çuja të shpëtojë aparenecat, pse, te «bisedimet» (ku-pto miqësia) me Shtetet e Bashkuara të Amerikës qëndron strumbullari i strategjisë «së re e të madhe» të Kinës.

Ujdia mbi këtë pikë mund të jetë arritur që tash në bisedimet e dyta Çu-Kisinger dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës u duhen një apo dy muaj që ta bindin Çan-gun për të rënë në këtë ujdi.

Vizita e tretë e Kisingerit ka mundësi që të sjellë edhe vendosjen e marrëdhënieve diplomatike midis Shte-teve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës Popullore të Kinës. Atëherë për Çunë çdo gjë do të shkasë si në gjalpë. Presidenti Nikson do të pritët me lule, me gonge e me portrete në Pekin, «do të hapet një erë e re», do të hapen defterë të rinj, «dallëndyshe ktheje ndryshe» dhe Çuja do të thotë: «Shqiptarëve ua mbyllëm gojën për

vërejtjet e tyre lidhur me vizitën e Niksonit në Pekin, pasi Kina u pranua në Kombet e Bashkuara, pasi ajo u njoh nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe pasi u rregullua edhe çështja e Tajvanit». — Tash, do të thotë Çuja, të bisedojmë, o miq të singertë amerikanë. Po ç'të bisedojmë? Për punët tona dhe për ato të të tjerëve, të zhvillojmë miqësinë, tregtinë, artin dhe kulturën, të vijmë e të na vini pa teklif, të bisedojmë për Japoninë, për Indinë, për Indonezinë, për Evropën, për Australinë, me një fjalë për të gjitha, «me përjashtim të Bashkimit Sovjetik dhe të Vietnamit».

Por Çuja e di fare mirë se shqiptarët nuk i hanë kollaj këto gjëra. Fakt është se brenda kinezët duhet të kenë pasur kundërshtime. Neve na i mbajnë fshehur, nga ne ata ruhen «si djalli nga thimjami». Por, sado që të ruhen, ajo që fshehin nga ne do të vijë dita që të dalë sheshit. Ambasadori kinez në Hanoi i kishte thënë ambasadorit tonë: «Ne (kinezët) kemi bërë gabime të rënda ndaj vietnamezëve, si ambasada, ashtu edhe ushtria jonë që ka punuar këtu. Ne i kishim dënuar bisedimet vietnamezo-amerikane në Paris. Kjo ishte majtiste». Sigurisht që kjo «është majtiste», kur ti je vetë i djathtë, e kur je i djathtë dhe oportunist e revizionist, fillon e i godet marksistë-leninistët si majtistë...

Tash fajin për Maon dhe për Çunë e kanë majtistët. Ata puqen dhe janë dakord me grupin revizionist në udhëheqjen e Vietnamit, që Çuja vetë na e ka cilësuar si të tillë. Me këta tash Çuja është në një vijë, por nuk është «dakord» me miqtë e tyre, sovjetikë. Kjo është e përkohshme, retë e zeza do të sqarohen.

Titistët dhe rumunët janë në hare. Kina është me ta, në mos krejt hapur sot, nesër po, me vijë do të jetë me ta. Kina do të zërë pozitën «e tretë», «të botës së tretë», botës që Titoja e quan me një emër tjetër «bota e paangazhuar», dhe do të jetë udhëheqës i saj. Kina do

të përpiqet të balancojë fuqinë amerikane dhe sovjetike në sfera të reja të influencës, që duhet t'ua shkëputë këtyre të dyve, por mjerisht jo në favor të revolucionit. Titoja me Çaushekun do të përpiqen që era, e cila fryn në Kinë pro Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të forcohet në kurriz të sovjetikëve. Le të vazhdojë kjo të quhet «era e Lindjes», por kjo erë e Lindjes është me llohë, me noti, me revizionizëm. Kjo do të bëjë që Kina të fillojë të shtojë kreditë e saj për vendet e «botës së tretë», do të fillojë bisedimet, kontaktet me partitë revizioniste, nga janë e nga s'janë; Kina do t'i braktisë njëren pas tjetrës partitë e reja marksiste-leniniste, duke pretenduar se mjafton nga «një takim dypalësh» dhe nga një bisedë dhe kaq.

Zaten këtë braktisje ajo e filloi botërisht me mosardhjen në Kongresin e 6-të të Partisë sonë, ku do të marrin pjesë përfaqësues të partive marksiste-leniniste dhe të grupeve revolucionare. Sigurisht kthesa do të bëhet e nuancuar, «e argumentuar», që të mos i ngjasë as asaj të revizionistëve sovjetikë, as asaj të titistëve e as asaj të rumunëve. Kjo do të ketë nuancat e veta kineze edhe të një shteti të madh, edhe të një partie të pakonsoliduar e me shumë korrente.

Natyrisht lufta për Partinë tonë dhe për lëvizjen komuniste ndërkombëtare bëhet më e rëndë, më e vështirë. Por për ne çdo gjë është e qartë, asgjë nuk mund të na gënjejë. Partia jonë është rrahur me vaj e me uthull, ajo ka kaluar shumë vështirësi e pengesa, ka luftuar dhe ka një eksperiencë të madhe. Do të qëndrojmë ballëllart duke luftuar për mbrojtjen e parimeve marksiste-leniniste kundër cilitdo qoftë, edhe kundër të gjithëve, po të jetë nevoja. Marksizëm-leninizmi na e ndrit rrugën, ai nuk na fut kurrë në qorrrokak, në rast se i qëndrojmë besnikë. Dhe Partia jonë do t'u qëndrojë besnike marksizëm-leninizmit, popullit të vet, socializmit dhe komunizmit.

TAKIM ME PËRFAQËSUESIT E DELEGACIONEVE TË HUAJA

Sot në orën 17³⁰ pasdreke në selinë e Komitetit Qendror, bashkë me shokët e Byrosë Politike, prita shokët dhe miqtë e huaj, përfaqësues të partive komuniste e punëtore dhe të grupeve revolucionare marksiste-leniniste që kanë ardhur nga të gjitha anët për të marrë pjesë në Kongresin e 6-të të Partisë sonë¹.

U urova mirëseardhjen, me një fjalim të shkurtër, mbasandaj bisedova gati një për një me të gjithë. Ishin shumë të gëzuar dhe entuziastë që do të asistonin në Kongresin tonë. U habitën, u hidhëruan dhe disa nuk u përmbajtën, por shprehën indinjatën për mosdërgimin e një delegacioni nga Partia Komuniste e Kinës.

Pritja shkoi shumë mirë.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 93.

SHËNIME NGA SALLA E KONGRESIT TË 6-TË TË PARTISË

Mbi delegacionet e huaja

Kongresi i 6-të i Partisë po i vazhdon punimet.

Shokët më thanë se në bisedat që kishin pasur me shokët danezë dhe skandinavë këta ishin treguar shumë entuziastë për Kongresin tonë, kurse polaku Mijal nuk e zuri në gojë fare Kongresin dhe problemet politike që u ngritën në raport, por gjeti vetëm kohë të shfaqte skepticizmin e tij për planifikimin e bujqësisë gjatë planit tonë pesëvjeçar. Po hiqet shumë «specialist». Më duket se nuk ishte vendi për të tilla vërejtje. Ai mund t'i bënte këto edhe më vonë, po për atë çështjet politike dhe ideologjike duhet të qëndronin në radhë të parë.

Para se të diskutonte Adili, shoku Pirro Kondi lexoi përshëndetjen e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës drejtuar Kongresit të 6-të.

Delegatët reagan drejt, duartrokitën nxehetësisht kur u lexua përshëndetja sido që ishin të indinjuar për mosdërgimin e delegacionit.

Edhe populli është i indinjuar për këtë gjë, por ne

TAKIM ME PËRFAQËSUESIT E DELEGACIONEVE TË HUAJA

Sot në orën 17³⁰ pasdreke në selinë e Komitetit Qendror, bashkë me shokët e Byrosë Politike, prita shokët dhe miqtë e huaj, përfaqësues të partive komuniste e punëtore dhe të grupeve revolucionare marksiste-leniniste që kanë ardhur nga të gjitha anët për të marrë pjesë në Kongresin e 6-të të Partisë sonë¹.

U urova mirëseardhjen, me një fjalim të shkurtër, mbasandaj bisedova gati një për një me të gjithë. Ishin shumë të gëzuar dhe entuziastë që do të asistonin në Kongresin tonë. U habitën, u hidhëruan dhe disa nuk u përmbajtën, por shprehën indinjatën për mosdërgimin e një delegacioni nga Partia Komuniste e Kinës.

Pritja shkoi shumë mirë.

¹ Shih: Enver Hoxha. «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 93.

SHËNIME NGA SALLA E KONGRESIT TË 6-TË TË PARTISË

Mbi delegacionet e huaja

Kongresi i 6-të i Partisë po i vazhdon punimet.

Shokët më thanë se në bisedat që kishin pasur me shokët danezë dhe skandinavë këta ishin treguar shumë entuziastë për Kongresin tonë, kurse polaku Mijal nuk e zuri në gojë fare Kongresin dhe problemet politike që u ngritën në raport, por gjeti vetëm kohë të shfaqte skepticizmin e tij për planifikimin e bujqësisë gjatë planit tonë pesëvjeçar. Po hiqet shumë «specialist». Më duket se nuk ishte vendi për të tilla vërejtje. Ai mund t'i bënte këto edhe më vonë, po për atë çështjet politike dhe ideologjike duhet të qëndronin në radhë të parë.

Para se të diskutonte Adili, shoku Pirro Kondi lexoi përshëndetjen e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës drejtuar Kongresit të 6-të.

Delegatët reagues drejt, duartrokitën nxehtësisht kur u lexua përshëndetja sido që ishin të indinjuar për mosdërgimin e delegacionit.

Edhe populli është i indinjuar për këtë gjë, por ne

dhe Partinë tonë nuk i tund asgjë, jemi mësuar të luftojmë dhe të fitojmë kundër revizionistëve. Kësaj i thonë ngritje e lartë politike dhe ideologjike.

Përsëritet Kongresin dhe na dorëzoi mesazhin e KQ përfaqësuesi i partisë së Vietnamit të Veriut.

Shokët skandinavë kërkuar leje që ta përkthejnë nga anglishtja raportin tim në Kongres, sidomos kapitullin për marksizëm-leninizmin dhe pjesën ku flas për Kushtetutën e vjetër dhe të ardhshmen. Ne u thamë: Keni leje të plotë, bile edhe mund t'ju ndihmojmë për këtë gjë.

Dinuçi, i Partisë Komuniste të Italisë (m-l), më falënderoi për fjalët e mira që thashë për lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe veçanërisht për komunistët italianë. Ai lavdëroi raportin për përmbajtjen e tij të lartë marksiste-leniniste.

Përshtypja e shokëve të huaj për raportin është shumë e mirë, janë shumë entuziastë dhe veçanërisht për kapitullin e 6-të, mbi problemet që flasin për punën e Partisë.

Vetëm përfaqësuesit e delegacionit të Indonezisë dhe të Malajës nuk para japin mendim, janë të druajtur, thonë vetëm se shoku Enver është shumë mirë nga shëndeti.

Siç më thonë, pse po i përkthejnë fjalimet e tyre,

delegacionet nuk po flasin për Kinën! S'u ka ardhur mirë që Kina nuk erdhi në Kongresin tonë.

Përsëritet delegacioni i Vietnamit të Jugut. Në diskutime ata nuk do të qëndrojnë, do të shëtitin dhe do të vijnë kur të mbahet raporti për pikën e dytë dhe në mbyllje.

E MËRKURË

3 NENTOR 1971

NË KONGRES VAZHDOJNË TË PËRSHËNETIN DELEGATËT E HUAJ

Seanca e mëngjesit e Kongresit u çel nga shoku Adil Çarçani.

Në fund të seancës përshëndeti kryetari i delegacionit të Partisë Komuniste të Indonezisë, shoku Axhitorop, pastaj u lexua telegrami i përshëndetjes që dërgon Partia e Punës e Koresë.

Përshëndeti kryetari i delegacionit të Partisë Komuniste të Polonisë, Sekretar i Përgjithshëm, Kazhimiezh Mijal. Përshëndetja ishte shumë e mirë.

Përshëndeti Kongresin kryetari i Partisë Komuniste të Australisë, Hill. Shumë mirë.

Përshëndetin braziliani dhe Dinuçi i PK të Italisë (m-l).

Përshëndetën edhe shoku i Perusë dhe shoqja e Malajës.

U takova me Zhill-er Myrinë, profesor filozof marksist francez, mik i Shqipërisë dhe i Partisë sonë. Është thirrur nga «Zëri i popullit» për të asistuar në Kongres. E falënderova për librin që ka shkruar për Shqipërinë socialiste, si dhe për ndihmën që jep për botimin në Paris të disa fjalimeve të mia. Ai kërkoi nga ne ndihmë dhe orientim për përgatitjen e një materiali problematik të veçantë që ne ta gjejmë të nevojshme. I thashë se do të mendojmë dhe do të bisedojmë me të. Mbeti shumë i kënaqur. I dhurova me autograf një «Histori të PPSH» dhe një ekzemplar të raportit tim në Kongresin e 6-të. Mbeti shumë i kënaqur dhe tha: «Jam i prekur nga kujdesi që po tregohet, sidomos tani që jeni të zënë me kaq punë të mëdha».

Delegatët e partive komuniste dhe punëtores (m-l) që kanë ardhur në Kongresin tonë janë shumë entuziastë. Ata ndjekin me admirim punimet e Kongresit dhe flasin me zjarr dhe me sinqeritet revolucionar për punën e Partisë sonë, për vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste, për guximin revolucionar të saj. Ata po u japin një ndihmë shumë të madhe Partisë dhe popullit tonë.

E ENJTE

4 NËNTOR 1971

KONGRESI APROVON REZOLUTËN NË PËRKRAHJE TË LUFTËS ÇLIRIMTARE TË POPULLIT VIETNAMEZ

Në seancën e mëngjesit përshëndeti Uillkoksi, përfaqësues i Partisë Komuniste të Zelandës së Re, u lexuan mesazhe nga Birmania, Tajlanda, Franca.

Foto Çami propozoi rezolutën e Kongresit në përkrahje të luftës çlirimtare të popullit vietnamez.

Shkova në sallën ku pushojnë shokët e huaj dhe bisedova veç e veç dhe bashkërisht me ta. Shkëmbyem mendime me njëri-tjetrin, sidomos për çështjet e unitetit, unitet ky që ndaj armiqve duhet të manifestohet. Shokët thanë fjalë shumë të mira për Kongresin, për raportin, për diskutimet. Edhe unë u fola mbi të gjitha këto çështje dhe ata i aprovuan mendimet e mia.

I rekomandova Ramizit që, në mënyrë «diplomatike», t'i thotë ndonjë delegati të huaj, siç është Kazhimiezh Mijali, sigurisht në qoftë se do të lindë nevoja, që në përshëndetjen që do të bëjë në Kongres, të mos ngrejë çështjen e mbajtjes së një konference ndërkombëtare të

partive marksiste-leniniste për luftën që duhet të bëjnë kundër imperializmit dhe revizionizmit. Në parim, ne kemi folur me kohë për këtë ide, por kjo nuk mund të bëhet në këto momente, kur shumë parti komuniste e punëtore janë të pakonsoliduara, s'kanë unitet brenda tyre dhe në mes tyre, por sidomos kur Partia Komuniste e Kinës nuk do bisedime të përbashkëta, ajo do kontakte bilaterale, derisa nuk vjen as në Kongresin tonë. Po të bëhet një gjë e tillë pa Kinën, kjo do të jetë një gabim dhe do të thotë që të krijosh një përçarje të re. Shokët këtë gjë duhet ta kuptojnë, po duhet punuar në këtë rrugë, të përgatiten situata më të favorshme, pse ne në asnjë mënyrë nuk mund të fshehim as luftën revolucionare të popujve dhe as përpjekjet e zjarra të partive marksiste-leniniste punëtore motra që e udhëheqin këtë revolucion. Kina bën një gabim kolosal në këtë drejtim. Ne duhet të udhëhiqemi nga lufta e Marksit dhe e Leninit në këtë çështje.

Si është e mundur të mos koordinojmë ne luftën me njëri-tjetrin? Si është e mundur të mos vemi dhe të mos vijmë shokët në kongrese të njëri-tjetrit? Si është e mundur të mos punojmë intensivisht që kur të pihen kushtet të mblidhemi në një konferencë të partive tona marksiste-leniniste? Ne duhet të punojmë që edhe Partia Komuniste e Kinës të vijë, por edhe në qoftë se s'vjen, bota nuk rrënohet dhe marksizëm-leninizmi do të triumfojë!

E PREMTE
5 NËNTOR 1971

KINEZËT HESHTIN PËR KONGRESIN TONË

Kongresi ynë vazhdon punimet me sukses.

Në Kinë pothuaj asgjë nuk është shkruar mbi Kongresin tonë, veçse është njoftuar për hapjen e tij, është botuar mesazhi i tyre dhe është ribotuar një artikull i «Zërit të popullit» për Kongresin. Të shohim ç'do të bëjnë më vonë! Është turp dhe qesharake, kur, në këto ditë të rëndësishme për Partinë tonë, ata flasin për «ullinjtë» e Hanxhout, shenjë e miqësisë!

Përhëndetin delegacioni i Anglisë, ai i Japonisë dhe ai i Spanjës.

Agjencitë e huaja borgjeze-reaksionare-revizioniste të lajmeve, me përjashtim të radios dhe të shtypit titist, gati heshtin për Kongresin dhe për raportin tim. Patjetër nuk u leverdis të flasin për të, pse është kundër tyre. Tymi të shkojë lart. As duam të na propagandojnë ata, me ta ne jemi në luftë, në thikë e në pikë.

Përhëndetin përfaqësuesi i Kilit dhe i Cejlonit.

Përhëndetin shokët e delegacioneve të partive të Ekuadorit, të Sudanit dhe të Austrisë.

Përhëndetin shokët e partive komuniste (m-l) të Gjermanisë dhe të Holandës.

Kinezët vazhdojnë të mos flasin për Kongresin tonë, ato që shkruajnë janë gjepura, janë anësore, për të fshehur mosqenien dakord me vijën e Partisë sonë. Ata kanë frikë të prononcohen, pse po marrin një rrugë tjetër; ata nuk duan të zemërojnë miqtë e tyre, rumunët, kubanët, pse jo edhe titistët, polakët, partinë e Karriljo-Ibarrurit etj. Të gjitha arsyet që japin janë bajate, ata në këtë rrugë ku po ecin, jo vetëm s'kanë nevojë për marksizëm-leninizmin, por këtë e komprometojnë. Kjo duket qartë nga këto qëndrime.

Çdo gjë në Kongres ecën si sahat, një organizim i përsosur, si brenda ku zhvillohen punimet, ashtu edhe jashtë ku hanë, flenë dhe bëjnë jetën kulturore gjithë delegatët, të ftuarit e huaj dhe të ftuarit nga rrethet që ndjekin në televizor Kongresin, në sallat e tjera të Pallatit të Kulturës.

As gjëja më e vogël nuk na u sinjalizua, asnjë diskutant nuk kaloi kohën e caktuar, aparatet, sekretaria, çdo gjë e të gjithë ishin në këmbë dhe bënë një punë të një cilësie shumë të lartë. Shokët e huaj shprehën habinë dhe na përgëzuan edhe për këtë.

**E SHTUNË
6 NËNTOR 1971**

**KONGRESIN E 6-TË E PËRSHËNDETËN GATI
TË GJITHA DELEGACIONET E HUAJA**

Seancën e hap shoku Pilo Peristeri.

Lexohen në Kongres mesazhi i Belgjikës dhe i Ligës së Suedisë.

Gati përshëndetën gjithë shokët e huaj. Fjalët e tyre ishin shumë të nxehta, shumë entuziaste dhe shumë inkurajuese për Partinë dhe për popullin tonë. Ndihma që na dhanë ata me ardhjen dhe me pjesëmarrjen e tyre në Kongres është e paçmueshme për ne, për lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe për unitetin e saj marksist-leninist internacionalist.

Përshëndetin shokët e Argjentinës, të Danimarkës, të Norvegjisë.

Shoku Kazhimiezh Mijal (polaku) na tha se e kishte ftuar dje, më 5 nëntor, për drekë ambasadori kinez dhe i kishte thënë arsyet pse nuk erdhën në Kongres. Mijali i qe përgjigjur mirë dhe hapur: Ju keni bërë keq dhe një gabim të madh që nuk erdhët në këtë Kongres. Ca më keq keni bërë që keni marrë vendim në kongres, vendim që mund ta shkelni. Shqiptarët i keni ofenduar, por

ata mbajnë një qëndrim të lartë, marksist-leninist e të pandryshuar ndaj Kinës.

Si është e mundur ta quani pjesëmarrjen dhe vajtjen në kongres të partive motra një praktikë hrushoviane? Kjo ka qenë praktika e Leninit dhe e Stalinit, praktikë e nevojshme.

Lenini ka ndihmuar në mënyrë të fuqishme dhe hap-tazi partitë e reja që u shkëputën nga Internacionalja e Dytë. Vallë a do ta bëjë këtë Maoja për partitë e reja marksiste-leniniste që po krijohen dhe po mëkëmben? Me një fjalë ia rrëzoi të gjitha arsyet e dobëta dhe revizioniste të tij dhe ambasadori mbeti kështu me gisht në gojë.

Uruam shokun Uillkoks, Sekretarin e Përgjithshëm të PK të Zelandës së Re, i cili sot, më 6 nëntor 1971, mbushi pesëdhjetenëntë vjeç.

KONGRESI I 6-TË U DHA FUND PUNIMEVE

E hapa unë seancën e fundit të Kongresit.

Pasi mbajta një fjalë të shkurtër, rreth orës 13⁰⁰ deklarova Kongresin e 6-të të Partisë të mbyllur.

U dhashë dorën dhe falënderova delegatët e partive komuniste dhe punëtore (m-l) motra, pastaj zbritëm nga tribuna në plate dhe u përqaftuam me delegatët në mes të një gëzimi që s'mund të përshkruhet dot.

Në mbrëmjen e po kësaj dite, në Pallatin e Brigadave kishte darkë për delegatët e Kongresit dhe për të huajt. Përshëndeta unë. Darka ishte shumë e ngrohtë dhe shoqërore.

MITING I MADH I POPULLIT TË TIRANËS

Në orën 16⁰⁰ në sheshin «Skënderbej» u bë një miting i madh i popullit të Tiranës me rastin e përfundimit të punimeve të Kongresit të 6-të të Partisë dhe me rastin e 30-vjetorit të themelimit të Partisë sonë heroike.

Në miting foli unë e përshëndetën edhe përfaqësuesit e partive komuniste dhe punëtore (m-l) motra.

E MARTË
9 NËNTOR 1971*

SHOKËT KINEZË DHE KONGRESI I 6-TË I PARTISË SONË

Kongresi i 6-të i Partisë mbaroi me një sukses të jashtëzakonshëm. Në këtë Kongres shkëlqeu uniteti brenda në Parti dhe uniteti Parti-popull, shkëlqyen mençuria dhe pjekuria e Partisë, guximi dhe internacionalizmi i pathyeshëm i saj.

Cili ishte qëndrimi i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës ndaj kësaj ngjarjeje të madhe për Partinë dhe popullin tonë? I ftohtë dhe mund të them ofendues. Por ne nuk e bëmë veten, pavarësisht se i kuptuam të gjitha kinezëritë e tyre. Ne nuk u vumë në pozitë e tyre të gabuara, por qëndruam të patundur në vijën tonë marksiste-leniniste revolucionare ndaj Partisë Komuniste të Kinës dhe ndaj popullit vëlla e mik kinez.

Komunistët në botë le të gjykojnë kush bëri mirë dhe kush bëri keq, kush u tregua i patundur në vijën marksiste-leniniste dhe kush është lëkundur. Mosdërgimi nga ana e udhëheqjes së Partisë Komuniste të Kinës të delegacionit të saj në Kongresin e 6-të të Partisë sonë nuk është «për arsye të vendimit që kanë marrë në Kongresin e tyre të 9-të». Kjo nuk është e vërtetë, është një gënjeshtër e qepur me pe të bardhë. Një vendim të tillë nuk mund ta marrë një kongres që respekton mësimet e Marksit dhe të Leninit. Një vendim i tillë do të ishte antimarksist. Ne e dimë që këtë vendim Kongresi i 9-të i

Partisë Komuniste të Kinës nuk e ka marrë dhe udhëheqja kineze që gënjen, tregohet dyfish antimarksiste ndaj kongresit të vet dhe ndaj nesh. Mund të ndodhë sipas rasteve e rrethanave që komiteti qendror i një partie të marrë një vendim të tillë dhe ky veprim nuk është i gabuar, por ky vendim kurrë nuk mund të jetë i përhershëm dhe kurrë i aprovuar nga kongresi.

Pra, vendimi për mosdërgimin e delegacionit të PK të Kinës në Kongresin e 6-të të Partisë së Punës të Shqipërisë është marrë nga Mao-Çu En Lai për arsye kundërshtimi në vijë me Partinë tonë. Ku qëndron kundërshtimi? Këtë ne ua kemi thënë çiltas si bolshevikë. Ata nuk flasin për këtë, por i grumbullojnë dhe i shtrembërojnë thëniet tona, pastaj dalin me qëndrime publike dhe me arsyetime jomarksiste.

Fakt është se ata radhiten në vijën revizioniste, në kursin drejt pajtimit dhe drejt kontakteve me partitë revizioniste të botës. Pra, ata, për oportunitet «politik», kanë filluar të rrinë në dy karrige, zemrën e kanë andej, kurse formulat stereotipe, tabelat për galerinë, — sepse u duhen akoma, — i kanë këtej. Është e kuptueshme se marksizëm-leninizmi ua nxjerr shpejt lakrat oportunistëve që përdorin maska e gënjeshtër.

Qëndrimet e udhëheqësve kinezë, përveçqë nuk dërguan delegacion në Kongresin tonë të 6-të, reflektohen edhe në shtyp e në radio, e këtu kanë qenë si «tabela me bojë të shpëlarë» për të kaluar kohën dhe «për të hedhur lumin».

Përshëndetja e tyre dërguar Kongresit të 6-të të Partisë sonë ka qenë diçka e zakonshme, që mund t'i bëhet çfarëdolloj partie, dhe plot me formula stereotipe, që kinezët bëjnë vazhdimisht. Ajo nuk firmohej nga Maoja si herët e tjera, «pse i binte nderi». Gjatë punimeve të Kongresit të 6-të nuk u shkrua asgjë prej tyre, por u rishtyp në «Zhenminzhibao» një artikull i «Zërit të popullit», u

botua një korrespondencë nga gazetarë kinezë që ishin në Kongres, korrespondencë që mund të quhet kronikë pa kurrfarë vlere. Dhe, që të tregonin se interesoheshin, filluan kinezëritë në gazetatat e tyre për «ullinjtë e miqësisë», për «grurin shqiptar» e të tjera të tilla që nuk hahen.

Përshëndetja për 30-vjetorin e themelimit të Partisë sonë nuk ishte veçse përshëndetja që dërguan për Kongresin e 6-të, duke i shtuar ose duke i hequr disa formula stereotipe. Edhe kjo ishte pa shpirt, si përshëndetja anonime që na bënë me rastin e zgjedhjes së Komitetit të ri Qendror të Partisë sonë. Thonë se me këtë rast, kanë bërë një mbledhje solemne në Pekin; ne nuk kemi lajm për të, por e marrim me mend se si do të jetë zhvilluar.

Kjo është «e tërë zhurma» që shokët udhëheqës kinezë bënë për Kongresin e 6-të të Partisë sonë heroike, e cila, kur Partia Komuniste e Kinës dhe Kina po sulmoheshin me tërbim nga të gjitha anët e nga të gjithë, i ka mbrojtur me vendosmëri marksiste-leniniste. Vetëm Partia e Punës e Shqipërisë, vetëm Shqipëria socialiste u qëndroi pranë dhe, me luftë të rreptë, të vazhdueshme, konsekuente, parimore, marksiste-leniniste, mbrojti Partinë Komuniste të Kinës dhe fitoret e Kinës Popullore. **Ne bëmë detyrën tonë internacionaliste dhe si miq të tyre të vendosur. Historia na gjykon dhe do të na gjykojë edhe në të ardhmen, ajo do t'u japë kurdoherë të drejtë Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë.**

Udhëheqja kineze mendon se «tash që kalova lumin, s'kam nevojë më për kalin». Por ne shqiptarët, në historinë tonë shekullore jo vetëm që s'kemi mbajtur dhe as kemi duruar kurrë kurrkënd në kurriz, por ata që kanë pasur mendime të tilla, kanë ngrënë nga shqiptarët të atillë dru që s'e harrojnë kurrë, sado shekuj e rrethana të ndryshme që të kalojnë. Për ne shqiptarët, si popull e si

marksistë, miqësia në baza internacionaliste marksiste-leniniste është e shenjtë dhe ne kemi luftuar e do të luftojmë me guxim e me këmbëngulje për këtë. Për miqësinë e vërtetë marksiste-leniniste me Partinë Komuniste të Kinës dhe me popullin kinez, miqësi që është e shenjtë për ne, do të luftojmë, do të jemi të matur, të pjekur, të durueshëm, **por parimet marksiste-leniniste të Partisë sonë do t'i mbrojmë si jetën e do të luftojmë kundër atyre, cilëtdo qofshin, që do të kërkojnë t'i shtrembërojnë dhe t'i godasin.**

NJË «DIÇKA» SENSACIONALE

Një radiogram që na vjen nga Pekini na njofton se një kinez i tha një shokut tonë: «Pas 10 ditësh do të dëgjoni diçka shumë sensacionale». Kaluan 10 ditë dhe po ai person tha: «Në udhëheqjen kryesore të Kinës ka ngjarë një përçarje e madhe dhe janë marrë masa kundër atyre që ndryshe thoshin në Revolucionin Kulturor dhe ndryshe vepronin. Në krye të këtyre është Lin Biaoja».

ÇU EN LAI DREJTON EDHE USHTRINË

Udhëheqja kineze nuk po pipëtin për çfarë ngjet, por njerëzit fillojnë «të flasin vetë».

Shoferët kinezë të Ambasadës së Republikës Popullore të Shqipërisë në Pekin u thonë shokëve tanë: «Çu En Lai, megjithëse ka qenë shumë i lodhur, tash duket më i çlodhur **e drejton edhe ushtrinë**».

Kuptojeni, pra, ju, që Lin Biaoja është skartuar!

SHËNIM

Shokët më raportojnë se delegacionet e partive mot-
ra, kudo që kanë shkuar, kanë mbetur shumë të kënaqu-
ra dhe po largohen me përshtypje nga më të mirat.

NË OKB TË BASHKËPUNOJMË ME KINEZËT, POR TË RUAJMË PAVARËSINË DHE PERSONALITETIN E VENDIT TONË

Kinezët shkuan në Nju-Jork me në krye ministrin
e Jashtëm Çao Kua Huan. Ne u dhamë udhëzime shokëve
tanë në OKB që të bashkëpunojnë ngushtë me ta, por
të ruajnë pavarësinë, personalitetin e vendit dhe autori-
tetin e madh që ka fituar Shqipëria në arenën ndërkom-
bëtare. U thashë shokëve se ne duhet të dërgojmë, si
kryetar të misionit, një diplomat të karrierës e të shka-
thët.

**E SHTUNË
13 NËNTOR 1971**

QËNDRIMI YNË I MATUR I DETYRON KINEZËT TË NDRYSHOJNË QËNDRIMIN E TYRE

Qëndrimi i matur dhe i drejtë yni ndaj shokëve kinezë, që nuk dërguan delegacion në Kongres dhe ndaj shtypit të tyre, që në fillim u tregua i ftohtë, i theu të gjitha barrikatadat dhe bëri që të ndryshojnë qëndrimet e tyre. Shtypi kinez botoi dje tekstin e plotë të raportit tim në Kongres. Kjo është një fitore për marksizëm-leninizmin.

**E SHTUNË
13 NËNTOR 1971**

**E SHTUNË
13 NËNTOR 1971**

SHËNIM

Bisedova me Çeno Nushin se si të punojë në Romë për të bërë të njohur në publikun italian realitetin socialist të vendit tonë dhe veçanërisht punimet e Kongresit të 6-të të Partisë.

...

...

PËR NJË TAKIM TË SHOKUT HYSNI ME AMBASADORIN KINEZ

Shënime

I thashë Hysniut të thërresë ambasadorin kinez dhe, në emër të Komitetit tonë Qendror, t'i japë për Komitetin e tyre Qendror materialet zyrtare të Kongresit të 6-të të Partisë sonë: raportet, diskutimet kryesore të shokëve të Byrosë Politike, projektdirektivat e planit të ardhshëm pesëvjeçar etj., e t'i thotë: «Kjo bëhet në shenjë solidariteti marksist-leninist në mes partive tona, meqenëse ju nuk mundët të dërgonit delegacion në Kongres, gjë për të cilën na ka ardhur keq». Kaq për këtë dhe të mos ia zgjatë.

Nga ana tjetër i thashë ta falënderojë Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Kinës për mesazhin dërguar Kongresit dhe për përshëndetjen e dërguar me rastin e 30-vjetorit të themelimit të Partisë së Punës të Shqipërisë si dhe për mbledhjen solemne të organizuar në Pekin, ku asistuan anëtarët e Byrosë Politike të Komitetit Qendror, me shokun Çu En Lai në krye. T'i theksojë se kjo na gëzoi shumë se shërben për çelikosjen e mëtejshme të unitetit marksist-leninist në mes dy partive tona dhe forcon miqësinë që lidh të dy popujt tanë.

T'i thotë, po ashtu, se Komiteti ynë Qendror i falë-

nderon shumë dhe është shumë i prekur për vlerësimin e lartë që Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës u bëri punimeve të Kongresit të Partisë sonë, për botimin e plotë të raportit të shokut Enver në gazetat kryesore të Pekinit.

E HËNË

15 NËNTOR 1971*

SHËNIME PËR KINËN

Botimin e raportit të Kongresit tonë të 6-të dhe punimin e tij në masat e partisë dhe të popullit në Kinë duhet ta konsiderojmë si një sukses shumë të madh për Partinë tonë dhe për vijën e saj marksiste-leniniste.

Kina tani kalon me siguri një moment krize të brendshme të rëndë dhe veçanërisht krizë në udhëheqjen kryesore të partisë. Për «luftën kundër majtizmit», «për rrëzimin e Lin Biaos» etj. zyrtarisht asgjë nuk dimë, asgjë nuk na thonë. Që diçka e rëndë po ndodh atje, kjo s'ka asnjë dyshim.

Ç'janë këta «majtistë»? Përse akuzohen këta dhe nga kush akuzohen? Të gjitha këto nuk mund të mbahen vazhdimisht fshehur. Fakt është se në këto situata të rënda, raporti i mbajtur në Kongresin e 6-të të Partisë sonë iu dha partisë dhe popullit kinez «për ta studiuar dhe për të nxjerrë mësim». Kjo na gëzon.

Revizionistët dhe oportunistët mund të bëjnë dhe të thonë çdo gjë, por mbresat për Partinë dhe për popullin tonë në komunistët kinezë dhe në popullin kinez janë të thella dhe nuk mund të shlyhen me shpifje. Politika e Partisë sonë duhet të bëjë çmos që Kinën dhe Partinë Komuniste të Kinës t'i influencojë me vijën e saj të drejtë, në rrugën marksiste-leniniste.

Ne nuk duhet të harrojmë kurrë se kjo është detyra jonë më e madhe në lëmin ndërkombëtar. Ne jemi në

luftë të rreptë e të pamëshirshme me imperializmin, me revizionizmin dhe me reaksionin. **Kush do ta fitojë Kinën? Reaksioni apo socializmi, revizionizmi apo marksizëm-leninizmi?** Ne do të luftojmë që ta fitojë marksizëm-leninizmi.

Shqipëria socialiste le të duket e vogël si shtet, po marksizëm-leninizmi, nën flamurin e të cilit ajo lufton, është kolosal. Prandaj, për çdo çështje që ka të bëjë me Kinën, u them vazhdimisht shokëve: të mos e harrojmë kurrë këtë qëllim të madh, këtë detyrë të madhe kolosale në shkallë ndërkombëtare, në dobi të revolucionit botëror.

ÇFARË PROBLEMESH TË DISKUTOHEN ME DELEGACIONIN QEVERTAR EKONOMIK KINEZ

Bisedova me shokët për problemet e ndryshme ekonomike që duhet të trajtojnë shokët tanë me delegacionin qeveritar ekonomik kinez, të kryesuar nga Fan Jiri i cili vjen nesër.

Çështja e Hidrocentralit të Bushatit dhe e termocentraleve të reja, çështja e kredisë së re për bujqësinë dhe disa probleme të perspektivës, zgjerimi i metalurgjisë së zezë dhe Hidrocentrali i Komanit. Këto duhet të shtrohen si probleme të pastuduara përfundimisht nga ne, po të nevojshme për pesëvjeçarin e ardhshëm.

SHËNIM

Porosita shokët e Qeverisë që ta shpejtojnë dërgimin e Reiz Maliles në OKB, për të pasur atje një shok kompetent, pse tashti, me vajtjen e delegacionit kinez, punët do të marrin një rrugë tjetër. Politika jonë duhet të afirmohet më mirë dhe për delegacionin kinez Reizi do të jetë një bashkëpunëtor më i zoti që mund t'i japë një ndihmë më të kualifikuar, sidomos tash në fillim.

E PREMTE
19 NËNTOR 1971*

KARRILJOJA NË KINË

Agjencia HSINHUA bëri të ditur se një delegacion i partisë revizioniste spanjolle të Pasionares, me Karriljon në krye, sekretar i përgjithshëm, arriti në Kinë dhe bëri vizita në shumë qytete të saj. Ajo njoftonte se për nder të delegacionit u dha një banket i përzemërt dhe Gën Biaoja, drejtor i Drejtorisë së Jashtme të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, pati me të biseda, ku u shtruan mendimet e të dyja palëve.

Është e qartë tash, Partia Komuniste e Kinës filloi kontaktet, bisedimet dhe, pse jo, edhe marrëveshjet. Hëpërhë mundet këto të jenë për disa probleme, derisa të vijnë në ujdi për të gjitha. Pas këtij takimi u vjen radha takimeve me partitë e tjera revizioniste, me atë italiane, franceze, angleze, holandeze etj. Është një proces i tërë në zhvillim.

Nga një anë Partia Komuniste e Kinës ndjek rrugën oportuniste më të hapët, gjoja mban lidhje bilaterale me partitë komuniste e punëtore (marksiste-leniniste) «sa për t'i dëgjuar, për t'u informuar», por pa i ndihmuar, veçanërisht pa i përkrahur ideologjikisht në luftën kundër partive revizioniste dhe kundër grupeve të tjera anarkiste, trockiste, kurse nga ana tjetër, Partia Komuniste e Kinës filloi dhe do të vazhdojë të zhvillojë kontaktet e të bjerë në ujdi me partitë revizioniste. Kjo vijë, natyrisht, do ta kredhë thellë atë në llumin e ideologjisë revizionis-

te, do ta çojë ideologjikisht në «botën e tretë», domethënë në rrugën revizioniste të Titos, Çausheikut, Kastros etj.

Rruga tjetër që ndjek Partia Komuniste e Kinës, është ajo e gjoja lidhjeve shtetërore për forcimin e lidhjeve me partitë revizioniste në vendet ku këto janë në fuqi dhe që kanë kontradikta me Bashkimin Sovjetik dhe me partinë revizioniste të Bashkimit Sovjetik. **Njëkohësisht me të gjitha këto që bën, dhe pikërisht për t'i maskuar qëllimet e vërteta taktike e strategjike të këtyre veprimeve revizioniste e oportuniste, Partia Komuniste e Kinës «mban lidhje», afishon e trumbeton se «me Partinë e Punës të Shqipërisë është në një vijë, është në unitet të plotë marksist-leninist» dhe lë të kuptohet, duke na mbështetur ne, se «edhe ne qenkemi dakord me shumë veprime të saj». Kjo është një taktikë mjaft djallëzore.**

Këtë e vërteton më së miri, gjithashtu, çështja se një nga arsyet që na thanë për mosardhjen në Kongresin tonë të 6-të, ishte «pjesëmarrja e madhe në të e partive marksiste-leniniste». Telegrami që na dërguan për Kongres, si dhe për 30-vjetorin e themelimit të Partisë, e ngrë në qiell këtë internacionalizëm të Partisë sonë dhe përkrahjen që ne u japim partive marksiste-leniniste. Por, sapo mbaroi ky Kongres, lëshuan komunikatën që pritën Karriljon e Ibarrurit, e cila, në Mbledhjen e Moskës, kur ne mbrojtëm marksizëm-leninizmin, kur ne sulmuam revizionizmin sovjetik dhe Hrushovin, na quajti «trockistë».

Grupi revizionist i Karriljos e grupi socialist i Pietro Nenit priten haptazi në Kinë dhe botohen menjëherë komunikata të përbashkëta, kurse delegacionin e Partisë Komuniste të Polonisë (marksiste-leniniste) që vajti në Kinë shumë më përpara se këta, jo vetëm që Çu En Lai mezi e priti ndonjë orë, por edhe komunikatën e përbashkët që propozuan vetë kinezët, dhe për të cilën ranë dakord ta botonin, as e botuan fare. Kjo, përveç mungesës së sinjeritetit, tregon, gjithashtu, atë që thashë më lart:

kinezët sakrifikojnë Partinë Komuniste të Polonisë (marksiste-leniniste) për t'u lidhur me partinë revizioniste të Gierekut dhe me shtetin polak, gjoja pse kanë kontradikta me Bashkimin Sovjetik dhe me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Pritja e grupit revizionist të Karriljos në Pekin do ta dëmtojë Partinë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste), e cila është e re dhe do t'i sjellë shumë pengesa. Kjo gjë do ta pengojë atë në zhvillimin dhe në konsolidimin e mëtejshëm të pozitave të saj. Në të njëjtën kohë, një gjë e tillë do ta detyrojë Partinë Komuniste të Spanjës (marksiste-leniniste) të mbajë qëndrim, qoftë brendapërbrenda në parti, qoftë në propagandën e saj, për lidhjet e Partisë Komuniste të Kinës me partinë revizioniste të Pasionares, sepse partia revizioniste e Spanjës, në shtypin e saj, do ta vërë mirë në dukje në favor të saj këtë sukses që korri në Kinë. Ajo patjetër do të thotë me këtë rast se «u hodh ura e unitetit të lëvizjes komuniste»; se «nuk ekzistojnë mosmarrëveshje themelore në mes saj dhe Partisë Komuniste të Kinës»; se «u lanë mënjanë ato gjëra të pakta që na ndajnë dhe u vunë në themel të bashkëpunimit marksist-leninist ato që na bashkojnë»; se «u vendos që të mos zhvillohet polemikë në mes të dy partive tona» e me radhë do të zbrazet gjithë bagazhi revizionist.

Por edhe komunikata e lëshuar nga Pekini, pavarësisht se nuk i thotë këto, ajo i lë të kuptohen. Komunikata kineze vetëm thotë që të dyja palët parashtuan pikëpamjet e tyre. Është e natyrshme që të parashtrohen pikëpamjet, por cilat janë këto pikëpamje? Ku jeni dhe ku s'jeni dakord?! Supozohet se kanë qenë dakord, dhe në qoftë se nuk kanë qenë dakord me disa, ato kanë qenë aq të parëndësishme, sa nuk ishte nevoja të viheshin në dukje. I rrumbullakos, pra, fort bukur Karriljoja me Pasionaren.

Po e njëjta situatë do të krijohet për të gjitha ato parti komuniste (marksiste-leniniste), kur në Kinë do të venë delegacione të partive revizioniste të vendeve të tyre.

Pra, një rrezik i ri konkret, minues, i kërcënon veçanërisht partitë e reja marksiste-leniniste, të cilat ende nuk janë forcuar dhe konsoliduar brendapërbrenda. Ky është, natyrisht, një rrezik i madh, në radhë të parë për lëvizjen komuniste ndërkombëtare, prandaj Partisë sonë veçanërisht, i bie barra që, në bashkëpunim e në unitet me partitë e tjera marksiste-leniniste, ta neutralizojë këtë rrezik dhe të bëjë që të triumfojë mbi të.

Ne do të luftojmë për të mbrojtur parimet, për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, për të mbrojtur partitë motra marksiste-leniniste, të cilat duhet të jenë koshtente për rrezikun, të jenë vigjilente, të matura, parimore dhe revolucionare, të forcohen brenda organizativisht, ideologjikisht dhe politikisht; të ruajnë unitetin marksist-leninist brenda në parti, pse në këto situata, dhe sidomos kur partitë janë të pakalitura, kurdoherë ai rrezikohet.

E HËNË

22 NËNTOR 1971*

KINA, VIETNAMI DHE TRATATIVAT E FSHEHTA ME SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Çdo gjë në këtë drejtim duhet ta supozojmë, duhet të punojmë me imagjinatë, duke nxjerrë ca deduksione nga disa lajme lakonike të agjencive të huaja, nga disa deklarata të Niksonit, nga ca udhëtime të udhëheqësve verivietnamezë dhe nga ndonjë komunikatë kineze që në fakt nuk të thotë gjë.

Kinezët nuk na thonë asgjë jo vetëm për tratativat me SHBA-në, por për asnjë veprim të tyre politik në arenën ndërkombëtare. Ne duhet ta ndërtojmë vetë me imagjinatë «puzlin» kinez të politikës së tyre të jashtme. Shumë herë çështja komplikohet, dhe disa herë, duke mos pasur të dhëna të sakta, mundet edhe të gabojmë.

Pra, nga zhvillimi i ngjarjeve dhe nga të dhënat që kemi, mendoj se konferenca vietnamezo-amerikane e Parisit, kur verivietnamezët kishin vënë shpresa për «fitore politike», ka rënë në gjumë të rëndë dhe nga Parisi ajo është transferuar në Pekin, e nga legale tash është kthyer në ilegale.

Që kur u deklarua se Niksoni do të shkonte për t'u takuar me Mao Ce Dunin në Pekin, zjarri u fik në Paris dhe atij i doli tymi në Kinë. Ky dush i ftohtë kësaj konference, me sa duket, iu dha pa konsultim dhe pa pëlqimin e vietnamezëve, të cilët u zemëruan fort dhe këtë zemërim ndaj kinezëve e lanë të dukej qartë.

Vietnamezët, siç duket, nuk donin të bëhej një gjë e tillë pa u pyetur ata, të bëhej mbi kokën e tyre, prapa kraheve të tyre dhe pa u dukur, sidomos që «kur është çështja për Vietnamin, janë vetëm ata që vendosin». Ndihma kineze në këtë drejtim, sipas vietnamezëve, është e dorës së dytë dhe jo e vetmja, jo e njëanshmja, por krahas saj në atë nivel, në mos më lart, duhet të jetë edhe ajo e sovjetikëve. Prandaj vietnamezët duan të kenë jo një krah, por dy krahë të njëlojtë, të barabartë, miq të tyre dhe të amerikanëve.

Kinezët, siç duket, u detyruan «të ulin flamurin» para tyre dhe «të ndreqin gabimet», pse gjatë kësaj kohe brenda në Kinë na ndodhën «gjëra të rënda në udhëheqje» që Çusë i zunë këmbët, por njëkohësisht i dhanë dorë që të ashtuquajturat gabime ndaj Vietnamit t'ua hidhte «ultramajtistëve, komplotistëve».

Shpejt e shpejt Li Hsien Nieni u dërgua në Hanoi, përpara se të shkonte Podgorni. Li Hsien Nieni bëri autokritikë dhe shkoi me duar plot, me ndihma e me sigurime se me amerikanët do të bisedojnë për Vietnamin, ashtu siç do të urdhëronin vietnamezët. Kjo i kënaqi këta dhe miqtë e tyre sovjetikë, të cilët, si iniciatorë dhe lëvrues të zellshëm të kompromisit tradhtar me amerikanët për të shuar luftën në Vietnam, nuk mbetën jashtë vales që hidhet në kurrizin e popullit vietnamez.

Kështu që, sipas këtyre të dhënave, duhet të konkludojmë se për këto çështje nuk do të bisedohet me Niksonin vetëm në Pekin, por edhe në Moskë. Niksoni ua ka hipur të dy kuaqje për kursin e tij të luftës në Vietnam. Në qoftë se «çalon» njëri, e tërheq tjetri karrocën e imperializmit amerikan.

Pasi është siguruar kjo gjendje në prapaskenë, kanë filluar pazarllëqet. Thuhet se kur Kisingeri, i dërguari i Niksonit, ishte në Pekin për herë të dytë, ka shkuar atje edhe verivietnamezi Le Duk Tho. Thuhet, gjithashtu, se

në mënyrë shumë sekrete, dhe nën patronazhin e Çu En Lait, është bërë takimi Kisinger-Le Duk Tho. Ç'është përfunduar, nuk dihet.

Tash së fundi Niksoni, në një konferencë shtypi, deklaroi se «do të tërheqë edhe një kontingjent trupash» nga Vietnami. Sigurisht ky është «krimbi në majë të grepit» që ka lidhje me tratativat e fshehta: më jep, të të jap; sa më lëshon, të lëshoj. Në këtë kohë në Tajlandën e sunduar nga amerikanët ndodhi një grusht shteti ushtarak. Kryeministër u bë një mareshal, ndërsa anëtarë të qeverisë dhjetë gjeneralë, që të gjithë agjentë të Pentagonit. Prandaj «në qoftë se arrijmë një kompromis në Vietnam, — thotë Niksoni, — ne do të vazhdojmë luftën në Kamboxhia, në Laos dhe me baza të sigurta në Tajlandë».

Në këto situata «të shkëlqyera» që i hapi Vietnamit politika e kompromisit, si edhe ajo e revizionistëve sovjetikë e kinezë, Fam Van Dongu shkoi këtë javë në Pekin. Përse ka shkuar? Nuk e dimë, po mund ta marrim me mend.

Çu En Lai, siç po duket për të qetësuar vietnamezët, për të siguruar sovjetikët dhe për t'u thënë amerikanëve se «nuk kam ç'u bëj më shumë se kaq vietnamezëve», deklaroi në komunikatën e përbashkët me Fam Van Dongun se «vietnamezët janë vetë ata që vendosin për veten e tyre».

Siç duket, në «ajër» është edhe një takim tjetër me Kisingerin në Pekin, gjoja për të rregulluar nga ana teknike «udhëtimin e Niksonit», udhëtim që agjencitë e lajmeve e parashikojnë aty nga mars-prilli. Pra, mjaft kohë ka për dallavere e kompromise.

Të gjitha këto i kuptuam. Tash si gjithmonë na bie detyra që vazhdimisht të ndjekim ngjarjet, t'i studiojmë, të nxjerrim vetë deduksione dhe të ndërtojmë vijën dhe qëndrimet tona, se askush nga këta nuk do të thotë diçka dhe sidomos diçka të vërtetë.

E SHTUNE
11 DHJETOR 1971

TAKIM ME DELEGACIONIN QEVERTAR EKONOMIK TË RP TË KINËS

Sot paradite prita delegacionin qeveritar ekonomik të RP të Kinës¹ që kryesohet nga Fan Ji.

Shokët më raportuan për bisedimet përfundimtare që patën me shokun Fan Ji dhe me shokët e tjerë kinezë të delegacionit qeveritar ekonomik kinez. Bisedimi shkoi mirë dhe Fan Jia u tregua i afërt e pozitiv dhe duket se kinezët do të na ndihmojnë.

¹ Shih: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern (Përmbledhje veprash) 1971-1975», f. 164.

NDIHMJA KOSOVËS — NJË VIJË POLITIKE ME RËNDËSI TË MADHE KOMBËTARE

Shoku Ramiz më raportoi mbi konkluzionet e kënaqshme të bisedimeve të arritura në mes shokëve tanë dhe përfaqësuesve të Universitetit të Prishtinës. Ndihma nga ana jonë për universitetin e Kosovës është e mirë, por në drejtimet e tjera, që i kam thënë me kohë Ramizit, kjo ndihmë nuk ecën si duhet. Ne nuk inkurajojmë si duhet dhe në mënyrë të organizuar zhvillimin e letërsisë, të arteve, të muzikës dhe të teatrit kosovar, flasim dhe botojmë shumë rrallë, për të mos thënë hiç, në radion tonë, në gazetatat tona, nuk shfaqim dhe nuk luajmë pjesë të tyre në skenat tona. Ne nuk përgatitim materiale propagandistike dhe të përshtatshme për ata, dhe, kur përgatitim për vete, as që na shkon në mend të mendojmë edhe për Kosovën.

Për ne duhet të kuptohet drejt se kjo ndihmë që duhet t'i japim Kosovës nuk është «diçka e rastit», por një vijë politike me rëndësi të madhe kombëtare. Ajo duhet të jepet sa më e plotë, në rrugën legale dhe brenda marrëdhënieve ekzistuese. Ne duhet të përfitojmë nga këto situata, pse në kufi janë vëllezër të një gjaku që kanë nevojë për ndihmën e Republikës Popullore të Shqipërisë.

POZITË E DOBËT E UDHËHEQËSVE TË PAKISTANIT

Sipas njoftimit të agjencive të lajmeve, ushtria borgjeze e Kënit të Pakistanit po tregohet e papërgatitur, e lëkundur dhe vetë Ajub Kani është i gatshëm të bëjë kompromise me borgjezinë indiane, e cila ka një ushtri të krimbur, por ndihmohet fuqimisht nga revizionizmi sovjetik që ka synime të gjera dhe dëshiron të sundojë në Indi kundër Kinës. Imperializmi amerikan është i alarmuar nga kjo shtrirje e sovjetikëve dhe po bën presione mbi Indinë, duke qenë shaluar mbi Ajub Kanin.

PAKISTANEZËT KAPITULLUAN

Daka, kryeqyteti i Pakistanit Lindor, sipas Delhit, ra në dorë të indianëve. Kështu që pakistanezët e Jahja Ajub Kanit kapitulluan dhe do të bien sigurisht në kompromise në dëm të tyre dhe në favorin e indianëve. Ky agresion indiano-sovjetik do të përfundojë me njohjen e qeverisë demokratike të Bangladeshit nga ana e sovjetikëve dhe e satelitëve të tyre. Sovjetikët forcojnë pozitat imperialiste të tyre në Indi dhe në Oqeanin Indian kundër shteteve të pavarura dhe, në radhë të parë, kundër Republikës Popullore të Kinës. Në Indi sovjetikët po përgatitin një trampolinë të re lufte agresive.

TURBULLIRAT NË KROACI DHE KOSOVA

Shënime

Në Kroaci, si pasojë e tradhtisë titiste kundër marksizëm-leninizmit dhe socializmit në Jugosllavi, si pasojë e vendosjes në këtë Federatë të kapitalizmit, në format dhe në stadin më anarkist dhe më kaotik, në Kroacinë e ustasheve të rinj, ka javë, për të mos u ngjitur më lart, që po zhvillohen greva të studentëve, greva politike, që u kthyen dhe vazhdojnë në demonstrata dhe në përlëshje me policinë e armatosur me shkopinj, me gaz lotsjellës dhe me armë të tjera që i vë në veprim klika e Titos.

Kanë filluar arrestimet në masë. Titoja ka kohë që kërcënon hapur, po pa adresë. Ai kërkoi më në fund, që të ashtuqajturit e pabindur të japin dorëheqjen vetë nga postet udhëheqëse. Më në fund e më në bisht udhëheqësit kroatë si Tripallo, Konçar e ndonjë duzinë të tjerë dhanë dorëheqjen dhe u «vetakuzuan» si gjoja qorra, që lanë nacionalistët kroatë të organizoheshin, të rrezikonin partinë e famshme të Titos dhe po aq të famshmin vet-administrim.

Asgjë nuk rregulloi kjo, veçse acaroi më shumë atë që është e acaruar në palcë. Sistemi i vendosur në Jugosllavi dhe ideologjia e këtij sistemi, struktura dhe superstruktura e Jugosllavisë aktuale nuk pjell dhe nuk do të pjellë edhe paskëtaj veçse situata të tilla akoma më të

egra të theksuara me një shovinizëm të shfrenuar e të shumëllojtë, goftë kroat, goftë serb, sidomos.

Titoja, «si magjistari i përrallës që lëshoi ligështinë», tash po përpiqet të mbyllë djallin në shishe. Por më kot, kjo është gjë që s'bëhet, vetë ai është djalli më i madh që duhet futur në shishe, pse ai dhe tradhtia e tij krijuan një gjendje të atillë që terreni pjell vazhdimisht tradhtarë dhe në këto situata e me këto masa, edhe pse dhanë dorëheqjen Rankoviçi ose Tripalloja, s'del gjë. Kjo i përngjet fjalës: «Ngordhi një dhi në Velabisht, mbeti Berati pa dhallë». Dha dorëheqjen Tripalloja dhe mbeti shovinizmi kroat pa kokë e pa krahë!

Shovinizmi lulëzon kudo në Jugosllavi, po acarohen kontradiktat në mes serbëve dhe kroatëve. Titoja përpiqet të luajë rolin e centristit, të ndërmjetësit, të moderatorit, të tradhtarit, të një borgjezie të re, pak a shumë të stabilizuar në kurrizin e dy rrymave ekstremiste, që ballafaqohen me dhunë dhe që përgatiten dhe organizohen haptazi dhe në ilegalitet për të marrë fuqinë pas vdekjes së tij. Kjo borgjezi në fuqi, me Titon në krye, që orvatet të bëjë një politikë oportuniste të balancës, mbështetet, siç duket, në ushtrinë dhe në udhën aktuale dhe tash, sa nuk është vonë për të, duke u fshehur nën parulla marksiste, nën forma pune të kohës së luftës, duke grumbulluar për paradë rreth vetes veteranë, do t'i likuidojë politikisht dhe fizikisht këto grupime kërcënuese. Do t'ia arrijë qëllimit? Është e zorshme. Borgjezia titiste është e mbarsur me shovinizmin serbomadhe dhe kroatomadhe ustash. Imperializmi amerikan dhe revizionizmi sovjetik janë brenda kudo sot, do të jenë edhe nesër; ata lëvizin fijet e «miqësisë» dhe të kërcënimeve si te Titoja, si te kroatët, si te serbët, si te malazeztë, edhe te maqedonasit.

Vetëm te populli shqiptar i Kosovës ata nuk kanë kredi dhe unë besoj se as që i frikësojnë dot kosovarët,

të cilët kanë qenë dhe po bëhen çdo ditë e më shumë të ndërgjegjshëm për rreziqet që i presin.

Titistët turbullirave kroate u vunë etiketën «ustasho-fashiste». Ky titull i vë më poshtë e më rëndë nga «informbyroistët» e Rankoviçit e kompani. Kur goditen kroatët, delegacioni sovjetik me në krye agjentë si Bajbakov bredhin nëpër Serbi e Mal të Zi për të dhënë kredi etj., për të aktivizuar tendencat proserbe. Titoja në këtë situatë të turbullt nga Skupshtina federale, si nga «Olimpi», flet për politikën e famshme të tij të jashtme, për pjekjet me Brezhnjevët, Niksonët, shahët e Persisë e të tjerë. Ai do të japë brenda dhe jashtë përshtypjen se «asgjë nuk ngjet në Jugosllavi, se çdo gjë ecën normalisht, se në Zagreb janë disa studentë që turbullojnë qetësinë». Asnjëri nuk i ha gënjeshttrat e Titos, të gjithë e njohin këtë mashtrues të madh profesionist.

Në këtë situatë serbomëdhenjtë fërkojnë duart dhe ata që janë në fuqi, që gjoja përkrahin rrymën e Titos, gëzohen, forcojnë pozitat, vënë mirë në dukje me këtë rast rrymën «e rrezikshme» shoviniste kroate për të fshehur rrezikshmërinë e rrymës së tyre serbe, kurse të tjerë serbomëdhenj më pak të zgjuar dhe më «impulsivë e dinamikë» me këtë rast përpigën të marrin «revanshin» kundër shqiptarëve në Kosovë. Studentët serbo-malazez në Universitetin e Prishtinës, të nxitur dhe në unitet me pedagogët serbë, u futën në garë me studentët kroatë për të rivendosur të drejtën e «paritetit» dhe jo të «shumicës» në zgjedhjet e universitetit dhe këndeje të kalonin në gjithë jetën e Kosovës. Kjo donte të thoshte që serbo-malazeztë të rifillonin sundimin si në kohën e Dushan Mugoshës, i cili pikërisht tani, në revistën serbomadhe «Nin» ka filluar të shkruajë «kujtimit e tij» kundër nesh.

Çështja kroate, natyrisht, nuk është një çështje e thjeshtë kroate, ajo ka karakteristikat e shovinizmit kroat, por, pa folur për Serbinë, ku qëndron çibani më i

rrezikshëm i këtij shovinizmi të tërbuar pansllav dhe antishqiptar, në Maqedoni, sido që akoma nuk pipëtin gjë, për arsye të dobësisë së vetë shovinizmit maqedonas, në krahasim me dy të parët, filluan prapë akuzat kundër Cervenkovskit, «i lidhur me ustashët kroatë». Akuzat bëhen nga grupi i Kolishevskit, sigurisht proserb dhe tash i lënë në hije, si gjithë të tjerët: Tempo, Mugosha, Rankoviç, që shkruajnë kujtimet.

Deri tash po bëhen sulme kundër shqiptarëve në Kosovë dhe për gjënë më të vogël ata akuzohen për «shovinizmin shqiptar». Këto sulme, ç'është e vërteta, dy vjetët e fundit janë më të frenuara, për arsye të politikës oportuniste të Titos, por kjo nuk është e thënë se do të vazhdojë një situatë e tillë. Që të vazhdojë kjo situatë duhet që shqiptarët e Kosovës të vazhdojnë të forcojnë me kurajë e pa ngurrim pozitat e tyre brenda të drejtave që u jep kushtetuta. Duhet që për këtë gjë ata të forcojnë unitetin në mes tyre dhe udhëheqësve shqiptarë të Kosovës t'u imponohet nga masat nevoja e domosdoshme e këtij uniteti.

Udhëheqësit shqiptarë të Kosovës aktualisht po i rezistojnë më mirë presionit serb, por kurdoherë janë të varur në buzëqeshjen dhe në humorin e Titos, të cilit sot i duhet ndihma e shqiptarëve, nesër i sakrifikon këta në altarin e serbit. Udhëheqësit shqiptarë të Kosovës duhet të kuptojnë mirë një gjë, që forcën ata e kanë vetëm në popull dhe jo në «famën personale». Popullin ka frikë Titoja dhe jo personin me tituj e me nishane. Udhëheqësit shqiptarë të Kosovës duhet të jenë të kujdesshëm që të mos bien në provokacionet e serbëve, por të mbrojnë të drejtat e tyre dhe këto t'i mbrojnë tok me masat, tok me popullin. Të mos lejohet ndarje dhe izolim nga masat, të mos lejohen armiqtë të akuzojnë masat për «shovinizëm» kur ato janë në rrugë të drejtë dhe këta të mos e heqin veten si «prudentë e të zgjuar», kur tërhiqen nga frika

dhe lënë popullin në baltë të akuzohet dhe të merren masa kundër tij. Një udhëheqës i tillë nuk është i popullit, po i regjimit titist, ai sot është, nesër hidhet në baltë nga serbët si një leckë pa vlerë.

Intelektualët dhe rinia në Kosovë luajnë dhe do të luajnë një rol të madh në mbajtjen gjallë të patriotizmit të kulluar shqiptar. Prandaj këtu duhet të përqendrohen aktualisht përpjekjet, që kjo forcë e gjallë jetike të mos degjenerojë dhe të bëhet aleate dhe ndihmëse e një klase punëtore kosovare, që po ngrihet dhe po kalitet në luftë me titizmin revizionist dhe me shovinizmin serbomadh.

Udhëheqësit shqiptarë të Kosovës aktualisht po i rezistojnë më mirë presionit serb, por kurdoherë janë të varur në buzëqeshjen dhe në humorin e Titos, të cilit sot i duhet ndihma e shqiptarëve, nesër i sakrifikon këta në altarin e serbit. Udhëheqësit shqiptarë të Kosovës duhet të kuptojnë mirë një gjë, që forcën ata e kanë vetëm në popull dhe jo në «famën personale». Popullin ka frikë Titoja dhe jo personin me tituj e me nishane. Udhëheqësit shqiptarë të Kosovës duhet të jenë të kujdesshëm që të mos bien në provokacionet e serbëve, por të mbrojnë të drejtat e tyre dhe këto t'i mbrojnë tok me masat, tok me popullin. Të mos lejohet ndarje dhe izolim nga masat, të mos lejohen armiqtë të akuzojnë masat për «shovinizëm» kur ato janë në rrugë të drejtë dhe këta të mos e heqin veten si «prudentë e të zgjuar», kur tërhiqen nga frika

**PËRKRAHIM KANDIDATURËN
E KURT VALDHAJMIT PËR SEKRETAR
TË PËRGJITHSHËM TË OKB-SË**

Mendoj që të përkrahim në OKB, për Sekretar të saj të Përgjithshëm, kandidatin austriak Kurt Valdhajm, se mund të jetë më demokrat. Të vëmë në dijeni edhe austriakët se ne e mbështetim kandidatin e tyre.

**ABCESI REVIZIONIST JUGOSLLAV SHPËRTHEU
HAPTAZI**

Shënime

Titoja s'mund të fshehë më katastrofën ku e çoi Jugosllavinë me tradhtinë e tij. Në Kroaci doli kalbësira sheshit. Ustashët, fashistët ishin në fuqi. Këta ishin dje miqtë e shokët e Titos dhe ai i dinte, i njihte, i lejonte. Sot këta e kaluan «kufirin», po shkojnë drejt «shkëputjes». Titoja kërkoi prej tyre të japin dorëheqjen nga postet kryesore dhe ata e dhanë, po natyrisht nuk hoqën dorë nga idetë dhe nga qëllimet e tyre.

Titoja shikon se po kërcënohet pushteti i tij kapitalist vetadministrues nga të katër anët nga forca kapitaliste, ustashe, serbomadhe etj. Ç'thotë Titoja në fjalimet e njëpasnjëshme që po mban? As më shumë dhe as më pak këto gjëra të ilustruara: Partia ose Lidhja është degjeneruar, sindikatat janë degjeneruar, fronti socialist është zëvendësuar me organizata shoviniste, nëpunësit janë pasuruar pa masë, shtypi plot pornografi po degjeneron masat, armiku i klasës ka ngritur krye kudo, shovinizmi ka ngritur krye në çdo republikë. Çdo gjë shkon keq, veçse në ushtri, thotë ai, «punët janë mirë», prandaj ka ardhur koha të merren «masa revolucionare». Kjo do të thotë, «të vendosim terrorin fashist, ushtria të vijë në fuqi dhe të likujdijmë fizikisht kundërshtarët». «Ishim»,

tha Titoja, «në pragun e luftës civile. Këtë nuk e lejova dhe tash do të marrim masa», partinë e tradhtisë do ta kthejë përsëri në një UDB të re me tiparet e vjetra.

Regjimi i krimbur jugosllav po përpiqet të forcojë terrorin fashist me anën e masave shtrënguese. Çdo parashikim i Partisë sonë u vërtetua pikë për pikë dhe Titoja i pohon këto tash me gojën e vet. Duke «goditur kroatët» Titoja kërkon të fitojë influencën serbe të tronditur dhe me tendencë proruse. Tito perëndimori përpiqet të luajë politikën e «balancës», duke menduar ta «neutralizojë ose ta largojë hëpërhë kërcënimin revizionist rusomadh» që synon Serbinë, Malin e Zi, Maqedoninë dhe gjithë Federatën, pa Titon. Titoja dhe rryma e tij proamerikane janë në vështirësi të mëdha. Nga frika ai mund të godasë edhe shqiptarët e Kosovës, duke i akuzuar si «shovinistë shqiptaromëdhenj, irredentistë etj.», për t'i bërë qejfin Serbisë.

Prandaj situata është mjaft e ndjeshme, e nderë dhe duhet ta ndjekim me kujdes e me vëgjilencë të madhe.

E MARTË
28 DHJETOR 1971*

BOMBARDIMET MASIVE AMERIKANE MBI VIETNAMIN E VERIUT

Ka veçanërisht 6-7 ditë rresht që aviacioni amerikan po bombardon në mënyrë të furishme (250 inkursione në ditë) Vietnamin e Veriut, stacionet e radarit, aerodromet e fshatrat. Bombardimet i janë afruar edhe Hanoi, por këtë hala nuk e kanë goditur. Radioja e Vietnamit lajmëron se ka të vrarë në popull, ndërsa komanda amerikane në Sajgon thotë se bombardimet bëhen me urdhër të vetë presidentit Nikson.

Niksoni dhe imperializmi amerikan kurrë nuk do të heqin dorë nga agresioni dhe nga bombardimet mbi Vietnam, në rast se atyre nuk ua presin dorën. Në Vietnam po luhet një tragjedi e madhe që i kalon kufijtë e këtij vendi. Vietnamezët po aktivizojnë luftën që e kishin vënë ca në surdinë për arsye «të politikës së madhe» që po bënin në mbledhjet e Parisit. Mirëpo mbledhjet në Paris nuk u dhanë «bukë».

Në mënyrë të fshehtë po përgatitej vajtja e Niksonit në Pekin. Kjo «bombë» u hodh, dhe vietnamezët, siç u duk, ashtu si edhe ne, nuk ishin pyetur, prandaj nuk u pëlqeu dhe bënë zhurmë të brendshme. Lexuam deklarata solemne nga ana e Kinës se çështja e Vietnamit nuk do të bisedohej me Niksonin; ndoqëm vajtje-ardhje delegacionesh kino-vietnameze në Hanoi e në Pekin; u lëshuan deklarata, u mbajtën fjalime: «Kina është kurdoherë pra-

pavija e Vietnamit», «Kina mendon se vetë Vietnami duhet të vendosë për fatet e tij» etj.

Nga ana tjetër, Kisingeri vjen në Kinë për të dytën herë, bën biseda të gjata me Çunë dhe deklarata solemne se «në bisedimet me Niksonin nuk do të flitet për vende të treta». Me fjalë të tjera, Çu En Lai, me gojën e Kisingerit, e thotë botërisht (sepse kinezët nga ana e tyre nuk thonë asgjë çfarë bisedojnë me amerikanët) se nuk preokupohet për problemin e luftës së amerikanëve në Vietnam. Kinezët mund ta mohojnë dhe duhet ta përgënjeshtrojnë absolutisht këtë gjë, po kjo kështu rezulton. Një gjë e tillë po bëhet shumë e rrezikshme për kinezët.

Situata aktuale, pra, është kështu: nga një anë venë e vijnë delegacionet zyrtare amerikane në Pekin dhe përgatitin në qetësi, në miqësi, me dashamirësi, udhëtimin e presidentit Nikson, deri në detajet më të vogla, nga ana tjetër, me qindra e me mijëra bombardues amerikanë shkojnë çdo ditë në Vietnamin e Veriut, shkarkojnë bombat dhe vrasin popullin, në emër të atij presidenti kriminel të tërbuar, i cili do të pritët me lule e me popull në Pekin.

Ky është një krim politik, ky është skandal i paparë dhe i padëgjuar kurrë. Pekini shkruan ndonjë artikull, po kjo punë nuk ka asnjë vlerë, më sa kanë vlerë artikujt «e zjarrtë antiamerikanë» të «Pravdës». Demagogii!!

Pekini as gjestin minimal nuk bën, që të marrë shkas dhe të pezullojë të paktën pritjen e Niksonit në Pekin, duke u vënë kushte amerikanëve për pushimin e bombardimeve në Vietnamin e Veriut. Por Pekini nuk e ka të lehtë ta bëjë as këtë akt politik. Niksoni e ka zënë për gryke dhe i bën shantazh.

Kinezët janë angazhuar botërisht se nuk do të bisedojnë për çështjen e Vietnamit kur të vejë Niksoni në Pekin. Kjo është një gjë, **po më e madhja është vetë vajtja e Niksonit në Pekin, çështja e politikës, e strategjisë së re kineze.** Për këtë pati reagim brenda, një gjë e tillë

u solli telashe të mëdha, prandaj morën dhe masa radikale, bënë spastrime. Tash nuk mund të tërhiqen dot, se tërheqja ka pasoja katastrofike për politikanët që ndër-tuan strategjinë e re. Dhe këtë e di mirë Niksoni, e dinë sovjetikët, vietnamezët, e di gjithë bota.

Rezultatet: Vietnamezët do të vazhdojnë sulmet (tërthorazi vietnamezët me një të shtënë vrasin dy zogj, vënë në vështirësi edhe kinezët që do të presin Niksonin). Niksoni bombardon egërsisht Vietnamin dhe përgatitet për të vajtur në Kinë, armiqëson Kinën me popullin vietnamez, diskrediton prestigjin e saj dhe bën lojën e sovjetikëve me të cilët është në ujdi.

Sovjetikët demaskojnë kinezët për «duetin» me amerikanët në një kohë kur bombardohet Vietnami. Por klika hrushoviane «demaskon» edhe amerikanët, «përkrah» miqtë revizionistë vietnamezë, dhe ka mundësi që, kur Niksoni ta ketë konsumuar vizitën në Kinë, sovjetikët ta pezullojnë vizitën e tij edhe në Moskë, për shkak të bombardimeve mbi Vietnam. E gjithë kjo për të demaskuar në opinionin botëror Kinën që pret Niksonin, në një kohë kur bombardohet Vietnami, kurse për veten e tyre të krijojnë përshtypjen se «ne, sovjetikët, e refuzojmë ardhjen e Niksonit në Moskë, sikurse refuzuam takimin me Ajzenhauerin, pas incidentit të avionit U-2»!!

Kjo është një lojë dinake shumë e rrezikshme të cilën mund ta luajnë sovjeto-amerikanët. Ne, në njëfarë mënyre, duhet t'ua futim këtë mendim kinezëve në vesh. Mundet që kinezët e parashikojnë një gjë të tillë, mundet që e largojnë këtë eventualitet, për të gënjyer veten se gjoja sovjetikët nuk e bëjnë këtë, se kanë frikë se mos Shtetet e Bashkuara dhe Kina... etj.

Të gjitha këto janë ëndrra në diell për të arsyetuar dobësinë që «ti, Kinë, nuk kthehesh dot nga ky qorrso-kak», por nga qorrso-kaku duhet dalë medoemos, se ndryshe bëhesh helaq.

LUFTA INDO-PAKISTANEZE DHE KINA

Popujt e Indisë dhe të Pakistanit vuajnë dhe do të vazhdojnë të vuajnë nga politika imperialiste angleze, nga shtypja e egër e borgjezisë kapitaliste vendëse dhe nga intrigat imperialiste të revizionistëve sovjetikë dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Imperializmi anglez i dha gjoja lirinë Indisë, por, në fakt, për interesat e tij, ai krijoi në mënyrë artificiale shtetin e Indisë dhe atë të Pakistanit. Pakistani u krijua në bazë të fesë myslimane dhe territori i tij shtetëror u nda në dy pjesë: në Pakistanin Lindor dhe në atë Perëndimor, të ndarë njëri nga tjetri pothuaj nga një kontinent i tërë, nga India, e përbërë nga shumë popuj, që besojnë fe të ndryshme.

Sigurisht Indisë iu imponua ekzistenca e shtetit të Pakistanit, sepse ajo donte ta gllabëronte të tërë nën sundimin e maharaxhave, por në pamundësi t'ia arrinte këtij qëllimi, u kënaq me aneksimin e Kashmirit, i cili, në qoftë se pranojmë ndarjen fetare dhe të tjera tradita, i përkiste Pakistanit. Ky i fundit, kuptohet, nuk e pranoi kurrë këtë zgjidhje të padrejtë të imperializmit anglez në favor të Indisë.

Prandaj, gjatë gjithë jetës së tyre «të lirë dhe të pavarur» të dy shtetet borgjeze kapitaliste qëndronin me thikë të zhveshur. Imperializmi anglez në të dy shtetet, «të lira dhe të pavarura», kishte interesa të mëdhenj, pra-

ndaj vazhdonte t'i zhvillonte marrëdhëniet me to në interes të vet, pa formën e «zëvendësbretit», ai bënte atje ligjin dhe këto vende bënë pjesë në Komonuelthin Britanik, në zonën e sterlinës etj. Dhe kuadrot e shtetit e të ushtrisë, si të Indisë ashtu edhe të Pakistanit, stërviteshin dhe edukoheshin në Angli.

Në këto dy vende «të lira» sundonte thundra e egër e feudalëve maharaxha dhe e kapitalistëve të mëdhenj të mbështetur nga Siti i Londrës. Populli indian dhe ai i Pakistanit vuanin nën zgjedhë të dyfishtë mesjetare; atje mizerja, uria dhe sëmundjet nuk mund të përshkruheshin. Indianët dhe pakistanezët janë nga popujt më të mjeruar të botës nga çdo pikëpamje. Në të tillë gjendje vazhdojnë të jenë ata edhe sot e kësaj dite, pavarësisht nga reklama që borgjezia kapitaliste botërore përpiqet t'u bëjë të dyja qeverive, asaj indiane dhe asaj pakistaneze. Xhina, Aga Kani dhe të tjerë Kanë nga ana e Pakistanit, Gandi, Nehru, Shastri apo Indira Gandi dhe të tjerë maharaxha të Indisë, që shëtitin lakuriq, duke mbajtur pranë një dhi, apo udhëtojnë të hipur mbi elefantë të stolisur me xhevahire, të gjithë këta ua kishin dhe ua kanë hipur në zverk popullit pakistanez dhe atij indian.

Të dy këto vende, me popullsi të shumtë e me rëndësi të madhe në sferat politike botërore, patën një zhvillim në kuadrin borgjezo-kapitalist. Shtetet e ndryshme imperialiste, në radhë të parë, Anglia e Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe tash revizionistët sovjetikë, i kanë përdorur këto për interesat e politikës së tyre hegjemoniste botërore. Këto dy shtete gjoja të pavarura kanë bërë herë politikën e Anglisë, herë atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke qenë të lidhura me to me traktate ushtarake agresive. Kështu, për shembull, Pakistani është i lidhur me ta nëpërmjet SENTO-s, ose qeveria e Nehrusë, si kampione e «bllokut të tretë», arriti të marrë nga SHBA miliarda dollarë kredi, bile të bëjë

dhe politikën e tyre, duke e provokuar Kinën me armë, e të kthehet në një miqësi të hapët me hrushovianët. Tash Indira Gandhi ka arritur deri aty sa të lidhet edhe me traktat ushtarak me Bashkimin Sovjetik.

Imperializmi amerikan zëvendësoi atë anglez në këto vende dhe për vite të tëra u përpoq që influenca e monopoleve amerikane dhe e Pentagonit të ishte dominuese. Shtetet e Bashkuara të Amerikës synonin që të gjithë këtë zonë ta kishin nën influencën e tyre për të fuqizuar imperializmin e tyre në Azi dhe në Lindjen e Largme dhe veçanërisht për të përgatitur rrethimin ushtarak dhe agresionin kundër Republikës Popullore të Kinës dhe popujve të tjerë të Azisë. Imperializmi amerikan, në luftë të hapët me popujt e Vietnamit, e nxiti Indinë kundër Kinës, dhe jo vetëm kaq. Ai nxiste edhe flakët e armiqësisë indo-pakistaneze, për t'i mbajtur kështu nën mëshirën e tij këto dy shtete, për të ndërhyrë më lehtë pastaj në punët e tyre të brendshme etj.

Tri herë deri tash Pakistani dhe India janë ndeshur me armë me njëri-tjetrin për çështje territori dhe vazhdimisht «janë ndihmuar» me armë e «me këshilla» të vriten, të bëjnë armëpushim dhe prapë të vriten. Në këtë lojë të poshtër prej imperialistësh u futën edhe hrushovianët, të cilët morën hapur anën e Indisë reaksionare dhe agresive dhe tash, duke u lidhur edhe me traktat, janë nxitësit e indianëve kundër Pakistanit.

Konflikti aktual në mes Indisë dhe Pakistanit nuk ka për qëllim vetëm zgjidhjen me anën e luftës të mosmarrëveshjeve në mes të dy shteteve, por njëkohësisht ai ka karakter agresiv strategjik më të gjerë, se në të janë implikuar hapur dhe në mënyrë gjoja «më pak të hapët» Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

India është agresori, dhe për këtë nuk ka asnjë dyshim, dhe ajo as që e merr mundimin ta maskojë një gjë të tillë. India sulmoi e para kufijtë e Pakistanit Lindor

dhe ndërhyri në punët e brendshme të një shteti tjetër. Preteksti është i përgatitur, i gjetur: çështja e Bangladeshit dhe e Bengalit.

Në Pakistanin Lindor, siç dihet, u bënë zgjedhjet, ashtu siç u bënë dhe siç mund të bëhen në vendet ku sundojnë diktaturat ushtarake të feudalëve. Zgjedhje të tilla dhe se si përfundojnë ato janë të njëllota si për Pakistanin, ashtu edhe për Indinë. Kështu që në Pakistan partia e Muxhibur Rahmanit në Bangladesh fitoi shumicën në parlament. Natyrisht, presidenti Jahja Kan mori masa, sepse Muxhibur Rahmani deklaroi «Republikën e lirë popullore të Bengalit», me qëllim që ta shkëpuste nga Pakistani. Rahmani u arrestua dhe çdo gjë u likuidua.

India që kishte dorë në këtë komplot, e shtyrë dhe e përkrahur nga sovjetikët, me të cilët nuk kishte veçse disa javë që kishte nënshkruar traktatin, dha urdhër dhe kështu filloi emigrimi i bengalezëve në Indi. Thonë se atje kanë shkuar 10 milionë refugjatë. I bënë ndonjë muaj tamtam kësaj shpërnguljeje në masë, duke vënë në dukje «barbarizmat» e Kanëve pakistanezë, dhe, pasi përgatitën terrenin, indianët lëshuan ushtritë «për të mbrojtur të drejtat e bengalezëve», «për të mbrojtur Republikën e Bengalit» dhe, për ta përligjur këtë disi nga ana zyrtare, e njohën qeverinë kuislinge që formuan indianët, duke e shpallur Bangladeshin «Republikë».

Taktika e indianëve është e njohur. U arratis nga Tibeti Dalai Lama dhe një grusht kulakësh e feudalësh tok me të. Qeveria indiane grumbulloi, nga ishin, nga nuk ishin, tibetianët e arratisur nëpër Indi, i organizoi rreth Dalai Lamës dhe filloi tamtamin kundër Republikës Popullore të Kinës. Kjo ishte përgatitja e terrenit për agresionin me armë që ndërmori kundër Kinës, por morën një grusht nga ushtria e Mao Ce Dunit. Në atë kohë Hrushovi mbajti qëndrim të hapët kundër Kinës dhe mbrojti agresorët indianë. Po këtë qëndrim po mbajnë

edhe këtë herë revizionistët sovjetikë. Gjithashtu në konfliktin indo-pakistanez ata mbajnë hapur anën e Indisë, të agresorit. Këtë e shpjegojnë gjoja se janë aleatë me Indinë, se India është shtet «paqësor progresist» dhe «socialist», bile arrijnë të thonë se India «mbron lirinë dhe pavarësinë e popujve të shtypur» etj. Pra, Bashkimi Sovjetik «mbron luftërat nacionalçlirimtare të popujve», «mbron lirinë dhe pavarësinë e popujve». Të tilla janë profkat, demagogjitë. E tillë është tradhtia e tyre dhe kjo zbulon sheshit qëllimet e revizionistëve dhe të socialimperializmit sovjetik.

Plani sovjeto-amerikano-indian është më i thellë. Qëllimi është për të diskredituar Kinën politikisht dhe për ta ngatërruar atë në intrigat e tyre të mëdha ndërkombëtare dhe më në fund ta provokojnë, që të futet në një konflikt të armatosur.

Fakt është se Republika Popullore e Kinës ka marrëdhënie miqësore me Pakistanin, i jep këtij kredi ekonomike, e ndihmon me armatime, është lidhur me të nëpërmjet Himalajës me një rrugë strategjike, rrugë që ka një rëndësi të madhe për Kinën dhe për Pakistanin. Kështu ndaj politikës armiqësore, provokuese dhe antikineze të qeverisë indiane, miqësia kino-pakistaneze është një gjë e mirë, pozitive, progresiste, pavarësisht nga forma e regjimit që ekziston atje. Në Indi, në Afganistan, në Indonezi e gjetkë, përveç që regjimet janë të njëjlojta dhe më të këqija se ai i Pakistanit, por ato të gjitha janë edhe antikineze aktive në kulm.

Është e natyrshme që në konfliktin aktual Kina të jetë në anën e Pakistanit, jo vetëm se në mes tyre ekzistojnë marrëdhënie miqësore, por edhe sepse në fakt agresori dhe ndërhyrësi në punët e brendshme të një shteti tjetër të lirë dhe të pavarur është India. Prandaj qëndrimi i Kinës në konfliktin në fjalë është i drejtë.

Politikisht dhe nga ana diplomatike Kina duhet ta

ndihmojë fuqimisht Pakistanin. Ne do të jemi krah për krah me të, sepse duhet të demaskojmë agresionin dhe komplotin lokal dhe ndërkombëtar të Indisë, të Bashkimit Sovjetik dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kina u ka dhënë pakistanezëve armë, ajo mundet edhe t'u japë prapë, në rast se i kërkojnë. Këtë Kina, sipas mendimit tim, mund ta bëjë, por, që të ndërlikohet vetë në këtë konflikt të armatosur, një gjë të tillë ajo s'duhet ta bëjë. Kina duhet t'i ruhet këtij provokacioni, sepse ky është pikërisht qëllimi kryesor i sovjetikëve, i amerikanëve dhe i indianëve, që ta ndërlikojnë Kinën në luftë, të shpërthejë «unaza e zjarrtë» e kurdisur rreth saj.

Provokacioni, në qoftë se ndodh, do të shkaktohet nga India, tamam atje ku u zhvilluan luftimet në provokacionin e parë. Objektivi imediat do të jetë Tibeti. Ky provokacion do të shoqërohet me provokacione sovjetike gjatë kufirit sovjeto-kinez, ku revizionistët sovjetikë kanë grumbulluar, sipas të dhënave kineze, një milion e gjysmë ushtarë. Sovjetikët e njohin situatën brenda në Kinë, masat që janë marrë kundër Lin Biaos dhe marsshalëve të tjerë (për të cilët ne nuk dimë gjë zyrtarisht) dhe është rrezik që të krijojnë situata të rënda e të vështira në kufijtë e Kinës. Prandaj Partia Komuniste e Kinës duhet të jetë vigjilente në kulm, të luftojë sa më parë dhe sa më mirë për unitetin marksist-leninist të partisë dhe të partisë me popullin, si dhe për kompaktësinë e ushtrisë. Një politikë liberale, pa lëre revizioniste, në kushtet aktuale në Kinë do të ketë pasoja të rënda dhe të pariparueshme.

Revizionistët sovjetikë janë angazhuar në bllok me Indinë, pra kundër Kinës në radhë të parë, por edhe njëfarë presioni serioz po i bëjnë influencës amerikane në këtë nënkontinent. Lufta pakistano-indiane është përgatitja politike, ideologjike dhe më vonë, mundet, me armë e konfliktit sovjeto-kinez.

Imperializmi amerikan në këtë konflikt luan rolin e «të moderuarit», «të paqësorit», paraqitet gjoja kundër Indisë dhe pro Pakistanit, por pa u angazhuar në asnjë anë. Ai hiqet sikur ka në plan një «strategji paqësore», «bisedime e mirëkuptime me Kinën», «bisedime e mirëkuptime me Bashkimin Sovjetik», nga Vietnami bën përpjekje dhe po tërhiqet gjoja dalngadalë, ndërsa lufta vazhdon dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës e pëlqejnë këtë konflikt të ri në Azi, sepse heq vëmendjen e botës nga Vietnami dhe dëmton kundërshtarët e tij: Kinën dhe sovjetikët. Amerikanët luftojnë për një gjë të tillë që të acarohen deri në luftë kontradiktat në mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës tash «mbajnë ekulibrin» në politikë dhe në këtë konflikt në mes Kinës dhe Bashkimit Sovjetik, në mes Pakistanit dhe Indisë. Kurse propaganda e revizionistëve sovjetikë i bie çekanit se në këtë konflikt Kina po afrohet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pra, Kina me «botën e tretë», siç e deklaroi delegacioni i saj zyrtar në OKB, është kundër një pjesëtareje të kësaj «bote», Indisë, e cila, siç dihet, është bile një nga shtetet që «udhëheqin» «botën e tretë». Titoja, po ashtu lideri i «botës së tretë», po mban anën e Indisë dhe këtë herë «në dukje» kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por në fakt kundër Kinës dhe pro sovjetikëve, të cilët, kur të duan, me anë të bullgarëve, mund të krijojnë një qeveri kuislinge maqedonase, si ajo e Bangladeshit dhe ta sulmojnë Jugosllavinë. Tito tradhtari, siç duket, u matufos ose, si agjent i amerikanëve, do që të jetë brenda në stanin indo-sovjetik për të parë e për të vëzhguar.

Sidoqoftë, Kina duhet të tregojë kujdes shumë të madh në arenën ndërkombëtare dhe brenda, asaj i duhet të forcojë pozitat marksiste-leniniste të partisë, anën or-

ganizative, anën e pushtetit, anën ushtarake. Sa i ka forcuar këto? As që mund të prononcohem.

Revolucioni Kulturor thuhet se ka mbaruar, por del që nuk ka mbaruar. Thuhet se ai likuidoi grupin e Liu Shao Çisë, por thonë se gjatë këtij revolucioni u bënë gabime të rënda sektare. Ç'janë këto gabime sektare?! Në ç'drejtime?! Kush i bëri?! Asgjë nuk dimë. Thuhej se u riorganizua partia, u krijuan komitetet revolucionare, u spastruan të ligjtë, u zgjodhën deputetët për në asamble, ku do të formohej qeveria e do të vendosej kushtetuta e re. Kur, bam! Ra përsëri një bombë e madhe e padeklaruar, që për lau pjesën më të madhe të Byrosë Politike me Lin Biao dhe oficerët e lartë në krye. Por kushedi sa qindra mijë janë pas tyre, sa gjëra duhen ndryshuar, sa njerëz duhen zëvendësuar, sa të pakënaqur, sa të pabindur, sa të paqartë! Çdo gjë ecën. Por, si ecën?! Këtu është çështja. Ky është problem i madh në mes të problemeve të mëdha.

Politika e theksuar liberalo-oportuniste kineze e këtyre kohëve të fundit u ndërmor nga grupi i Çu En Lait në një eufori të madhe (në bazë të thënieve të Çu En Lait kur na njoftoi për ftesën që i bënë Niksonit për të shkuar në Kinë). Mirëpo nuk mund të dilte dhe nuk del ashtu. Duket sikur ngjarjet ndërkombëtare të jenë kurdisur për ta dobësuar Kinën. Takimet e ardhshme të Niksonit po propagandohen nga imperializmi si «shpresëdhënëse paqësore» dhe Kina shkon në këtë takim jo «e fortë brenda», por as edhe e përgatitur në arenën ndërkombëtare për të përballuar problemet e mëdha.

Tash Kina u bë anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe e Këshillit të Sigurimit, problemet duhet t'i përballojë drejtpërdrejt dhe jo tërthorazi nga jashtë. Kina nuk e priste të pranohej që sivjet në OKB, ajo nuk ishte e përgatitur. Këtë e pohoi me gojën e tij Çu En Lai. Shtetet e Bashkuara të Amerikës pësuan një disfatë.

Edhe këtyre iu duk, sikurse edhe e lanë të kuptohej, se u erdhi e papritur dhe e pallogaritur një gjë e tillë. Vallë, a mund të ishte kështu? Apo mos ishte diçka e përgatitur nga amerikano-sovjetikët për ta futur përnjëherësh Kinën në qorrsokaqe, sepse, sapo ajo hyri në OKB, filloi konflikti indo-pakistanez, ku Kina, në mos qoftë e implikuar drejtpërdrejt, për të gjitha ato që thamë, ajo është e angazhuar me Pakistanin.

Imperialisto-revizionistët e kanë vënë Kinën në një darë, nga njëra anë e kërcënojnë me provokacione, me luftë, nga ana tjetër, me «degën e ullirit», «me bisedime», «me sqarime». Të dy do të tatojnë si rreh pulsi i brendshëm i Kinës, të dy do të punojnë, do të provokojnë, do të premtojnë, do të kërcënojnë, do të buzëqeshin për interesat e tyre të veçantë dhe për interesat e tyre të përbashkët kundërrevolucionarë.

Në qoftë se në Kinë nuk ekzistojnë dhe nuk krijohen ato situata të shëndosha, të forta, të qarta marksiste-leniniste, që thamë, atje ka rreziqe të mëdha. Vetëm një qartësi e madhe politike, ideologjike, një organizim i hekurt, një politikë marksiste-leniniste dhe një unitet i çeliktë u bëjnë ballë rreziqeve të brendshme e të jashtme.

Sigurisht, sovjetikët dhe amerikanët do të veprojnë dhe do të reagojnë në bazë të veprimeve dhe të reagimeve të Kinës. Në rast se Kina u qëndron si duhet të dy këtyre armiqve të egër të socializmit, të komunizmit dhe të popujve, atëherë ne do të shohim ndryshime themelore në taktikat dhe në strategjinë e të dyja fuqive imperialiste. Kina nuk duhet t'u lërë atyre as më të voglin iluzion, nuk duhet t'u bënë as më të voglin koncesion politik. Në këtë rast Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk mund të rrinë me duar lidhur dhe të kënaqen me ëndrra, kur sovjetikët e bëjnë Indinë një Egjipt të dytë dhe Oqeanin Indian një oqean për flotën e tyre. Kina duhet të nxitë e të thellojë kontradiktat amerikano-sov-

jetike dhe jo Shtetet e Bashkuara të Amerikës të nxitin dhe të shfrytëzojnë kontradiktat sovjeto-kineze.

E keqja për ne është se këto mendime që kemi për këto probleme ndërkombëtare, as nuk kemi rastin t'i bisedojmë e t'i diskutojmë me shokët kinezë. Ambasadori i tyre këtu, dhe cilido që të jetë përveç Çu En Lait, po t'i thuash, vetëm i regjistron dhe nuk thotë asnjë mendim të vetin. Por, sidoqoftë, edhe kështu do të gjej rastin dhe do t'ua them pikëpamjen tonë.

Vështirësia tjetër është ajo që situatën e brendshme të Kinës ne nuk e njohim realisht, atë e njohim vetëm në platformën propagandistike. Por ç'të bëjmë?

Vështirësia e tretë është çështja e kursit kinez drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Qëndrimi ynë dhe ai i tyre ndaj këtij problemi, për të cilin nuk jemi të një mendimi, nuk ka ndryshuar. Ata as që kanë marrë mundimin më të vogël të na japin një përgjigje sado të shkurtër, qoftë edhe për letrën që u bëmë.

SHËNIM

Porosita të shkruhet një artikull në mbrojtje të Kinës, duke demaskuar revizionistët sovjetikë në çështjen indo-pakistaneze. Dhashë drejtimet kryesore të problemeve që do të trajtojë artikulli.

TREGUESIT



TREGUESI I LËNDËS

A

Aleanca, bashkëpunimi dhe kontradiktat sovjeto-amerikane

— 102-103, 105-106, 162, 164, 180-181, 204-205, 221, 353-354, 406, 412, 546, 550-551

Ambasadat e huaja në RPSH

— e Kinës. Takim me ambasadorin kinez — 130, 138, 191, 207, 209, 259, 271, 273, 317, 456, 485, 514, 551

— takim me ambasadorin e RD të Vietnamit — 341

— e RDP të Koresë — 345

Anglia, imperializmi anglez —

46, 88-89, 172, 182, 184-185, 204, 221-223, 418, 451, 542-544

Aristokracia punëtore —

23-24, 45-46, 49

B

Ballkani — planet kino-rumune për Ballkanin — 148-150, 432-437

Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik

— gjendja e brendshme në BS. Degjenerimi i partisë,

i shtetit dhe i jetës politiko-shoqërore në BS — 48-49, 97, 102-109, 179-180, 290-291, 464-465

— revizionistët sovjetikë-tradhtarë të parimeve marksiste-leniniste; veprimtaria përçarëse dhe minuese e tyre në lëvizjen nacionalçlirimtare e revolucionare të popujve — 27, 59, 60, 71, 78, 106-109, 163, 214, 263, 313, 361-362, 420, 545-546

— politika socialimperialiste e BS në marrëdhëniet me vendet e tjera. Bashkëpunimi me imperializmin dhe reaksionin — 36-37, 105-106, 114-115, 162-163, 179-185, 186, 353-354, 427-431, 449-453, 543-544, 547

— presionet, ndërhyrjet dhe diktati sovjetik ndaj vendeve revizioniste — 15, 61, 74, 75, 101, 152, 166, 182-183, 266, 274-275, 286-292, 325-326, 353-354, 415, 435-436, 462-463, 532

— marrëdhëniet, kontradiktat me Kinën — 25, 37-38, 58, 70, 115, 550-551

— qëndrimet demagogjike armiqësore ndaj RPSH — 21, 245

Shih edhe: Aleanca, bashkëpunimi dhe kontradiktat sovjetiko-amerikane

Borgjezia, partitë borgjeze — 31-34, 45-50, 78, 89-90, 131, 135, 179, 200-201, 532

Bullgaria

— gjendja e brendshme në Bullgari; politika e jashtme e revizionistëve bullgarë — 12, 14-15, 61, 85, 169, 254, 274-275, 319-320, 324-325

— qëndrimi armiqësor i revizionistëve bullgarë ndaj PPSH e RPSH — 14-15, 319, 326-327

Ç

Cekoslovakia — gjendja e brendshme, lufta për pushtet në Cekoslovakia; politika e jashtme — 220, 275, 291-293, 298, 299

D

Demokracia borgjezo-revizioniste — 45-47, 200-201

E

Egjipti (Republika Arabe e Bashkuar) — gjendja e brendshme në Egjipt dhe politika kapitulluese, tradhtarë e borgje-

zisë egjiptiane — 26-27, 59, 71, 171, 210-211, 214, 223-224, 242, 312-316, 360-363, 550

Evropa — «Sigurimi Evropian» — 163-164, 184-185, 286, 384, 450-451

F

Fashizmi. Terrori fashist në vende borgjezo-revizioniste — 12, 124, 182, 201-202, 538

Franca, imperializmi francez

— gjendja e brendshme në Francë — 46-47

— politika e jashtme e imperializmit francez — 87-93, 184-185, 219-220, 221-224, 418, 451

G

Greqia — marrëdhëniet e saj me Shqipërinë dhe me vendet e tjera — 29, 65-67, 76, 264, 284, 342, 434

Grevat në vende imperialisto-revizioniste — 200-202, 265-266, 299

GJ

Gjermania

— para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore — 88-89, 182, 353, 418

— Republika Demokratike Gjermane. Revizionistët gjermano-lindorë — 101, 169, 183, 220, 268, 275, 287-288, 352-353, 450, 452

— Republika Federale Gjermane

— degjenerimi i jetës politiko-ideologjike dhe ekonomiko-shoqërore në Jugosllavi. Konfliktet nacionale — 14, 18, 49-50, 124-125, 320-321, 322-323, 346-351, 389-391, 531-535, 537-538

H

Hungaria — marrëdhëniet e saj me vendet e tjera — 169, 220, 259

I

Imperializmi — strategjia globale e tij, krizat, kontradiktat, aleancat e imperializmit. Kapitali monopolist shtetëror — 20, 31-34, 45-50, 87-93, 102-103, 181-182, 406, 430, 434, 550

India — marrëdhëniet e saj me vendet imperialiste e revizioniste — 38, 412, 427-431, 542-548

Italia — gjendja e brendshme dhe politika e jashtme e imperializmit italian. Marrëdhëniet me RPSH — 84, 98, 99, 222-223

Izraeli — vegël e imperializmit amerikan; politika dhe veprimet agresive të tij kundër vendeve arabe — 26, 71, 163, 172-174, 212-214, 314-315, 361

J

Japonia, imperializmi japonez — 36-39, 172-173, 403, 411, 431

Jugosllavia, revizionizmi jugosllav

— degjenerimi i jetës politiko-ideologjike dhe ekonomiko-shoqërore në Jugosllavi. Konfliktet nacionale — 14, 18, 49-50, 124-125, 320-321, 322-323, 346-351, 389-391, 531-535, 537-538

— marrëdhëniet e revizionistëve jugosllavë me vendet imperialiste e revizioniste — 10, 61, 81, 124, 149-150, 166-167, 169-170, 313, 319-326, 377-378, 385-387, 415, 433-437, 442-444, 488-489, 532, 538, 548

— revizionistët jugosllavë — agjentë të imperializmit, armiq të lëvizjeve nacionalçlirimtare e revolucionare në botë — 41, 78, 126, 217-220, 433, 443, 488-489, 532, 548

— qëndrimi armiqësor ndaj PPSH dhe RPSH — 14-15, 41, 62, 83, 124-127, 145-146, 149, 231, 319-320, 322-323, 538

Shih edhe: Kosova dhe trojet e tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi

K

Kamboxhia — gjendja e brendshme dhe e jashtme e saj — 100, 117-119, 120, 136, 139-140, 225, 302, 304-307

Klasa punëtore — vendi dhe roli i saj në jetën politiko-shoqërore — 31-34, 47-55

Kina — Republika Popullore e Kinës

- gjendja e brendshme, konfuzioni politik, ideologjik e shoqëror në Kinë. Lufta e grupeve për pushtet. Revolucioni Kulturor Kinëz - 20, 114, 281-282, 308-311, 398-399, 414, 508, 516, 549
- politika oportunisto-revizioniste në marrëdhëniet me SHBA dhe me vendet e tjera imperialiste e revizioniste - 17, 36-39, 149-150, 153-154, 176-177, 207, 259, 269, 271, 337-339, 367-368, 382, 385-386, 398-407, 409-413, 414-418, 429-430, 489, 524, 542, 546-551
- marrëdhëniet dhe kontradiktat me revizionistët sovjetikë - 25, 58, 70, 125, 150, 259, 338, 385, 414-415, 550-551
- afrimi dhe bashkëpunimi me Jugosllavinë - 10, 154, 166, 169-170, 259, 377, 379, 383-386, 388, 415-418
- afrimi dhe bashkëpunimi me Rumaninë - 152-155, 165-167, 190-191, 255, 259, 366-368, 372-375, 377-379, 387, 415-418
- qëndrimi ndaj luftës së popullit vietnamez dhe luftërave nacionalçlirimtare e revolucionare - 107, 420-424, 524-526, 539-541
- marrëdhëniet, kontradiktat me RDP të Koresë - 112-116
- marrëdhëniet me RPSH - 58, 165, 176-177, 190-191,

215, 224, 261-262, 311, 338, 384, 398, 410-411, 432, 441, 472, 524, 527

Kina - Partia Komuniste e Kinës

- konfuzioni politik e ideologjik në jetën e brendshme dhe në politikën e jashtme të saj - 20, 281-282, 308-311, 380-382, 454, 470-471, 508, 548

- qëndrimet joparimore ndaj marksizëm-leninizmit, ndaj lëvizjes marksiste-leniniste ndërkombëtare dhe ndaj luftës kundër imperializmit, revizionizmit e reaksionit - 149-150, 154, 175, 177, 259, 271, 339, 365-367, 398-407, 414, 472-473, 497, 520-522

- marrëdhëniet dhe qëndrimet joparimore të saj ndaj PPSH - 177, 224, 271, 392-394, 469-474, 476, 485, 489, 491-492, 498, 499, 504-507, 512, 516, 521

Koreja - pozitrat oportunisto-revizioniste të udhëheqjes koreane. Marrëdhëniet me PPSH dhe RPSH - 73, 112-116, 155, 345, 374-375, 420, 423-424, 494

Kosova dhe trojet e tjera me popullsi shqiptare në Jugosllavi

- gjendja e rëndë në Kosovë. Politika shoviniste dhe shkombëtarizuese e revizionistëve jugosllavë ndaj popullsisë shqiptare në Jugosllavi. Lufta e kosovarëve për liri e të drejta de-

mokratike - 15, 62, 79, 83, 145, 348-351, 364, 532-535

- marrëdhëniet, bashkëpunimi i Kosovës me RPSH - 96, 234, 237, 371, 528

Kreditë e fuqive imperialisto-revizioniste - 91, 201, 219, 222, 287, 292, 324-325, 367-368, 433, 543-544

L

Laosi - gjendja e brendshme dhe e jashtme e Laosit - 100, 117-119, 136, 225, 302, 304-307

Lëvizja marksiste-leniniste ndërkombëtare

- zgjerimi, forcimi dhe kalitja revolucionare e saj. Lufta kundër imperializmit, revizionizmit e reaksionit - 271, 474, 496-497, 522

- solidariteti e përkrahja e partive m-l për PPSH - 490-494, 496-497, 498-499, 500-501, 503, 504, 510

- Partia Komuniste e Polonisë; marrëdhëniet me PPSH - 6-7, 258, 303, 470, 480, 491, 496, 500, 521-522

- Partia Komuniste e Indonezisë; marrëdhëniet me PPSH - 470, 492, 494

- Partia Komuniste e Italisë (marksiste-leniniste); marrëdhëniet me PPSH - 24, 56, 168, 492, 494

- Partia Komuniste (m-l) e Francës; marrëdhëniet me PPSH - 44, 68, 72, 496

- Partia Komuniste e Malajës; marrëdhëniet me PPSH - 492, 494

- Partia Komuniste e Birmanisë; marrëdhëniet me PPSH - 477, 496

- Partia Komuniste e Tajlandës; marrëdhëniet me PPSH - 477, 496

- Partia Komuniste e Zelandës së Re; marrëdhëniet me PPSH - 496, 501

Lindja e Mesme - ndërhyrjet e fuqive imperialisto-revizioniste në këtë zonë - 163, 173, 210-211, 221-224, 257, 268, 313-316, 354, 360-362

Lufta e klasave - 23-24

M

Marksizëm-leninizmi - 16, 31-34, 54-55, 131-132, 489, 522

N

NATO (Pakti i Atlantikut Verior) - 90, 105-106, 201-205, 221-222, 231, 287, 314, 320-321, 326, 362-363, 434, 450-451

O

Organizata e Kombeve të Bashkuara

- manipulimi i saj nga superfuqitë - 481-483, 549-550

- qëndrimi parimor e revolucionar i RPSH në të; roli i RPSH për pranimin e RP të Kinës në OKB -

120, 193, 240, 242, 446, 455, 481, 482-484, 487, 511, 519, 536

P

Pakistani — gjendja e brendshme dhe marrëdhëniet e Pakistanit me vendet e tjera — 137, 248, 411, 412, 427, 529, 530, 542-551

Palestina — gjendja e rëndë e popullit palestinez dhe lufta e tij kundër sionistëve izraelitë, imperializmit e reaksionit — 26-27, 30, 60, 172-173, 192-193, 212-214, 295

Partia e Punës e Shqipërisë — lufta e saj kundër:

— revizionizmit modern — 49, 78, 266, 319

— revizionizmit sovjetik — 49-50, 78, 86, 110, 275, 327, 330, 332, 371, 404, 447, 448, 452, 547

— revizionizmit jugosllav — 49-50, 78, 126-127, 217-218, 232, 249, 252, 296, 319-327

Partia e Punës e Shqipërisë — politika e jashtme, marrëdhëniet me partitë marksiste-leniniste

— vija e drejtë marksiste-leniniste në politikën e jashtme — 94, 155-156, 170, 405-406, 421, 472, 506-507, 516-517, 522, 547

— ndihma, solidariteti dhe përkrahja internacionaliste ndaj lëvizjeve marksiste-leniniste, revolucionare e nacionalçlirimtare — 30, 94,

161-162, 171, 172-174, 193-194, 242, 295, 315-316, 439, 474, 489, 490-493, 496-497, 502-506, 522

— marrëdhëniet, kontradiktat me PK të Kinës — 311, 338-339, 398-402, 418-419, 425, 469-474, 483-484, 506, 514-515, 516-517

— qëndrimi ndaj pozitës revizioniste të udhëheqjes koreane — 112-116, 155, 387, 423-424

— qëndrimi ndaj Partisë Komuniste të Rumanisë dhe deviacioneve revizioniste të saj — 152-154, 157-159, 166-167, 250, 268, 365-368, 373-374, 393-394, 430, 463, 464-466

— takime, pritje, biseda me përfaqësues të partive komuniste marksiste-leniniste dhe të lëvizjes sindikale — 246, 357, 395, 490, 495

Politika e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të RPSH

— qëndrimet parimore marksiste-leniniste në marrëdhëniet me vendet e tjera; lufta kundër imperializmit, revizionizmit e reaksionit — 8, 12, 93, 99, 136, 137, 155-156, 170, 184-185, 186, 242, 433-434, 448, 453, 455, 516-517, 519, 522, 547

— marrëdhëniet, kontradiktat me Kinën — 28, 39, 95, 175, 177, 239, 283, 338-339, 373-374, 408, 418-419, 421-422, 432, 440, 441, 467, 481-484, 485, 487, 518, 547, 551

— marrëdhëniet me Rumaninë — 137, 157-159, 188-191, 367-368, 371, 466

— përkrahja dhe mbrojtja për RD Gjermane — 9, 22, 43, 354-355

— qëndrimi parimor marksist-leninist në marrëdhëniet me Jugosllavinë — 14-15, 83, 110, 124-126, 155-156, 323-324, 468

— marrëdhëniet me RD të Vietnimit — 161-164

— marrëdhëniet me Frontin Kombëtar të Çlirimit të Vietnimit të Jugut — 140, 195-198, 247, 493

— përkrahja dhe mbrojtja e luftës së popullit kambodxhian — 117-119, 120, 128, 136, 141

— qëndrimet parimore dhe përkrahja e luftës së popullit egjiptian dhe popujve të Lindjes së Mesme kundër imperializmit, sionizmit e reaksionit — 11, 30, 171, 172-174, 192-194, 216, 242, 295, 315-316, 547

— qëndrimet parimore dhe solidariteti i RPSH ndaj Kosovës dhe popullsisë shqiptare në trevat e tjera të Jugosllavisë. Ndihma për Kosovën — 80, 83, 124, 145-146, 234, 251, 272, 277, 296, 301, 335, 364, 460, 528, 534-535

— takime, biseda, pritje vizitorësh dhe miqsh e dashamirës të Shqipërisë — 28, 142, 161, 178, 227, 228,

229, 343, 396, 438

Polonia

— gjendja e brendshme në Poloni. Demonstratat, konfliktet e brendshme dhe lufta për pushtet — 6, 38, 169, 265-266, 267-269, 278, 297-300

— marrëdhëniet, kontradiktat e revizionistëve polakë me vendet imperialiste e revizioniste — 219-220, 278

R

Revizionistët francezë — 46-47, 64

Revizionistët italianë — 23-24, 84

Revizionistët spanjollë — 520-521

Revizionizmi modern

— revizionistët modernë, tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe agjentë të imperializmit. Qëndrimi përçarës e minues ndaj lëvizjeve revolucionare — 48-49, 78, 105, 275, 379, 406, 473, 516, 550

— marrëdhëniet, kontradiktat ndërmjet vendeve revizioniste — 8, 74, 75, 78, 101, 105, 182-183, 266, 274-276, 286-293, 325, 353, 406, 415-416, 436, 462-463, 516, 532

— lufta e marksistë-leninistëve dhe e popujve kundër revizionistëve modernë — 162-163, 327, 413

Rumania

— gjendja e brendshme dhe

politika oportunisto-revizioniste e udhëheqjes rumune — 152-154, 157, 165-167, 169, 188-190, 274-275, 365-368, 372-375, 385, 388, 392-394, 403, 418, 433-436, 463, 464-466, 488-489

— marrëdhëniet, kontradiktat me PPSH e RPSH — 8, 157-159, 166, 188-191, 250, 358, 374-375, 465-466

S

Sindikatat, lëvizja sindikale — 23-24, 295

Socialdemokracia, socialdemokratët — 48, 78, 179

SH

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, imperializmi amerikan

— strategjia globale e imperializmit amerikan, politika e luftës dhe e agresionit. Gjendja e brendshme në SHBA — 36-37, 45-46, 105-106, 183, 197, 200, 204, 212-213, 225, 263, 302, 304-306, 314-315, 404-405, 420, 453, 529, 539, 543, 548

— marrëdhëniet, kontradiktat me shtetet imperialiste e revizioniste — 18, 87-93, 103, 114-115, 163, 180-181, 200-205, 209, 219, 221-224, 360-363, 403-404

— afrimi, marrëdhëniet me RP të Kinës — 337-339, 398-407, 409-411, 548

Shih edhe: Aleanca, bash-

këpunimi dhe kontradiktat sovjetiko-amerikane

T

Teori borgjezo-revizioniste — 48-50, 131-132, 218-219

Traktati i Varshavës — shndërrimi i tij në një armë presioni dhe agresioni nga socialshovinizistët sovjetikë — 74, 81, 105-106, 287, 320-321, 324, 416, 433

Tregu i Përbashkët Evropian — 90-91, 180, 220, 418

V

Vendet arabe, popujt arabë — 26-27, 171, 172-174, 192-194, 210-211, 312-316

Vietnami i Jugut. Lufta e popullit jugvietnamez kundër agresorëve amerikanë dhe reaksionit të brendshëm — 195-198, 225-226, 263, 304-305, 420, 477

Vietnami. Republika Demokratike e Vietnamit

— lufta e popullit vietnamez kundër agresionit amerikan. Kompromisi me SHBA — 140, 161-163, 225-226, 263, 305-307, 374-375, 420-424, 524-526, 539-541

— marrëdhëniet me PPSH e RPSH — 161-162, 478, 492

Vigjilenca revolucionare — 14-15, 81, 127, 155-156, 175, 176-177, 209, 342, 437, 453

TREGUESI I EMRAVE

A

Abu, Xhihad — 178
Adenauer, Konrad — 182
Ajzenhauer, Duajt — 403, 441
Alenbi, Edmund — 192
Alia, Ramiz — 6, 39, 63, 66, 68, 72, 94, 129, 143, 147, 151, 160, 187, 194, 234, 241, 244, 252, 258, 270, 296, 301, 329, 330, 371, 395, 408, 458, 460, 480, 496, 528
Aloiz, Mudileno — Masengo — 277
Arafat, Jaser — 60, 172, 194
Asad, Hafëz — 257
Atas, Nuredin — 257
Axhitorop, Josuf — 494

B

Baholli, Sami — 264, 284-285, 333, 334, 336
Bajbakov, Nikolai — 533
Balluku, Beqir — 434
Batifol, Pjerr — 458
Berzhëron, Revis — 44
Betankur, Andre — 163
Bicios, Dhimitrios — 284-285, 333, 334, 336, 342,
Bodnarash, Emil — 8, 148, 154, 159, 166-167, 188-191
Brand, Vili — 9, 43, 181-182,

268, 288-289, 363, 366, 448, 449-452

Brezhnjev, Leonid — 18, 41, 97, 189, 288, 293, 313, 353, 363, 373, 404, 417, 442-444, 449-450, 462-463

Budo, Halim — 29
Bumedien, Huari — 211

C

Cedenbal, Jumzhagin — 373
Cervenkovski, Gerste — 534
Ciriankieviç, Jozef — 298

Ç

Çami, Foto — 496
Çan Çun Çiao — 130
Çan Kai Shi — 487
Çao Kua Huan — 511
Çarçani, Adil — 491, 494
Çausheku, Nikolae — 149, 152-154, 157-159, 166-167, 250, 255, 268, 289, 365-368, 372-374, 377-379, 382, 387, 392-394, 416-417, 424, 430, 463, 489, 521
Çen Po Ta — 130, 308-311, 317, 380-381
Çërçill, Uinston — 189
Çu En Lai — 58, 112-116, 148-150, 167-168, 224, 235, 337-339, 372-373, 377-378, 380-381,

385-386, 398, 403, 407, 409-411, 425, 426, 434, 461, 471, 486-488, 505, 509, 514, 540, 549-551

Gosh, Axhoi — 246
Gromiko, Andrei — 211, 427, 449

D

Dalai Lama — 545
Dange, Shpirad — 428
Dapçeviç, Peko — 41
Dezh, George Georgiu — 158
Dë Gol, Sharl — 90-92, 184, 221, 366, 418
Dënëlake, Florian — 157-158
Dimitrov, Gjergj — 327, 391
Dinuçi, Fosko — 56, 492, 494
Dubçek, Aleksandër — 291
Dun Bi U — 485

E

Eftimiu, Viktor — 336, 396
Engels, Frederik — 253
Fam Van Dong — 526
Fanfani, Amintore — 23
Fan Ji — 518, 527
Faruk (mbret i Egjiptit) — 210
Franko, Françesko — 200-202
Frashëri, Naim — 251, 272

G

Garodi, Rozhe — 64
Gandi, Indira — 412, 543-544
Gandi, Mahatma — 543
Gën Biao — 28, 271, 273, 292, 469, 520
Gierek, Eduard — 267-268, 291-293, 299-300, 522
Gomulka, Vladislav — 6, 18, 38, 265, 266-267, 269, 270, 274, 288, 291, 297-300

H

Habash, Xhorxh — 192,
Hanku, Rahman — 261-262, 479
Hazbiu, Kadri — 99, 148
Hill, Eduard — 494
Hitler, Adolf — 182
Hoang Van Hoan — 161
Honeker, Enrik — 352, 355, 362
Ho Shi Min — 162
Hoxha, Fadil — 359
Hrushov, Nikita — 112, 218, 267, 319, 327, 352, 360, 410, 427, 447, 545
Huan Jun Shen — 130
Husak, Gustav — 291
Hysejn, Abdullah — 173, 192-193, 212-214, 257

I

Ibarruri, Dolores — 499, 520-522

J

Jaring, Gunar — 312
Jonica, Jan — 190-191
Jue Çi Çien — 228

K

Kan, Aga — 428, 543
Kan, Ajub — 412, 428-429, 431, 529, 530
Kan, Jahja — 412, 428-429, 431, 530, 545
Kan Shen — 148-149, 154-155, 309

Kan, Xhina — 543
Kao Ki — 195
Kapo, Hysni — 28, 72, 160, 258, 408, 514
Kardel, Eduard — 346-347
Karriljo, Santiago — 499, 520-522
Kastrati, Skënder — 232
Kastro, Fidel — 114, 521
Kaza, Raimond — 68
Kazhimiezh, Mijal — 6-7, 258, 303-304, 329, 331, 480, 496-497, 500
Kim Ir Sen — 73, 112-116, 155, 373, 388, 422-424
Kisinger, Henri — 405, 410-411, 422, 459, 486-487, 525-526, 540-541
Koleka, Spiro — 216
Kolishevski, Lazër — 534
Kolombo, Emilio — 201
Kombë, Klod — 44, 68
Konçar, Rode — 531
Kondi, Pirro — 491
Kosigin, Aleksei — 58, 97, 130, 182, 268, 288, 353, 428, 444, 449
Kostallari, Androkli — 277
Kuznjecov, Vasili — 17

L

Lenin, Vladimir Iliç — 20, 78, 104, 123, 129, 130, 243, 290-291, 413, 424, 501, 504
Le Duk Tho — 525-526
Li De Shen — 130, 432, 438
Lin Biao — 20, 167, 308-310, 372, 385, 454, 471-472, 485, 509, 516, 547
Lin Haj Jun — 28

Li Hsien Nien — 10, 130, 228, 283, 310, 384-385, 392, 470, 525
Liu Shao Çi — 114, 155, 308-310, 374, 380-381, 549
Liu Xhen Hua — 317
Lon Nol — 117-119, 128, 140, 197
Lourens, Tomas — 112

M

Majani, Zahari — 328
Malile, Reiz — 519
Malo, Javer — 207
Mao Ce Dun — 20, 154, 158, 167, 224, 235, 281-282, 308-311, 317, 372-374, 377, 380-382, 409-413, 417, 431, 471, 486, 488, 501, 505, 524, 545
Marko, Rita — 157-158, 238, 250, 260, 275
Marks, Karl — 16, 32-33, 49, 78, 132, 253, 497, 504
Marti, Fransua — 44, 68
Mazurov, Kirill — 97
Mikado (Hiro-Hito) — 116
Mikojan, Anastas — 353
Moçar, Mjeçisllav — 267
Molier, Poklë Zh. B. — 417
Molotov, Viaçeslav — 182, 360-361
Moro, Aldo — 23
Monari, Rudi — 147
Mugosha, Dushan — 533-534
Muxhibur, Rahman — 429, 545
Myftiu, Manush — 112
Myri, Zhilber — 495

N

Nase, Nesti — 446, 455, 475, 485
Naser, Abdel Gamal — 26-27,

59, 60, 163, 171, 173-174, 192,
206, 210-211, 212-214, 215, 242
Nehru, Khavaharlal - 427, 428,
429, 543
Neni, Pietro - 521
Nguyen Thi Bin - 195
Nikolla (car i Malit të Zi) -
174

Nikson, Riçard - 115, 139-140,
195-196, 200-204, 207, 208, 209,
217-218, 220, 221-223, 225-226,
306, 363, 366, 372, 397, 398-
-403, 406, 409-410, 420-423,
425, 430, 441, 461, 486, 524,
540-541, 549
Novotni, Antonin - 291
Nushi, Ksenofon - 133, 513

P

Pan Shi Gao - 343
Papa Pavli II, Xhovani - 201,
278
Papa Pavli VI - 278
Patoliçev, Nikolai - 278
Peristeri, Pilo - 500
Peshe, Osvalto - 56, 68
Peten, Filip - 90
Pik, Vilhelm - 352
Pin De Huai - 308-310
Podgorni, Nikolai - 116, 444
Poljanski, Dimitri - 97
Pompidu, Zhorzh - 92, 221-
-224, 418

R

Rakoshi, Matias - 318
Rankoviç, Aleksandër - 41, 96,
322, 348-349, 532-534
Ribiçiç, Mita - 189, 191

Robo, Xhoxhi - 130, 175, 425,
426
Roxhers, Uiliam - 173, 211,
212, 242, 360-361
Ruzvelt, Franklin Delano - 90,
189

S

Sabri, Ali - 216, 360-361
Sadat, Anvar - 312-313, 360-
-361, 363
Saragat, Xhuzepe - 200-201
Sazanov, Sergei - 174
Seiti, Lik - 359, 370
Sihanuk, Norodom - 100, 117-
-119, 120, 128, 141, 155, 197,
422
Sing, Suaran - 430
Snou, Edgar - 409
Spahiu, Xhafer - 96
Spihalski, Marian - 267
Stalin, Josif Visarionoviç - 78,
85, 181, 189, 191, 243, 266, 289
290, 327, 363, 384, 413, 424,
435, 501
Sukarno, Ahmed - 155
Suslov, Vasili - 97

SH

Shastri, Lal Bahadur - 429, 543
Shelepin, Aleksandër - 97
Shuteriqi, Dhimitër - 251, 272
Tempo, Vukmanoviç - 534
Ten Hsiao Pin - 374
Tepavac, Marko - 377, 382, 383,
384-387, 435
Tito, Josif Broz - 14, 41, 125-
-126, 152-154, 166-167, 169-170,
189-191, 200, 217-220, 320-324,
346-351, 378-379, 384-385, 389-

-391, 416-417, 433-437, 442-445,
521, 531-534, 537-538, 548
Tito, Jovanka - 378
Toska, Haki - 310, 440
Tripallo, Miha - 531-532
Truman, Harri - 90
Van Min - 308-310
Van Thieu - 195
Vishinski, Stefan - 299
Vokshi, Bije - 96
Vu Fa Hsien - 130

U

Uillkoks, Viliams - 496, 501
Ulbricht, Valter - 268, 288-289,
352-355

V

Valdhajm, Kurt - 536
Van Hun Ven - 142

XH

Xhan Mjao Y - 228
Xhonson, Lindon - 306, 403

ZH

Zhivkov, Teodor - 85, 274, 289,
327.
Zhyrke, Zhak - 44, 68

TREGUESI GJEOGRAFIK

- A**
- Abukir (Gjiri ~, Egjipt) - 202
 Afganistan - 546
 Afrikë - 89-90, 92, 137, 180, 215, 220, 222-223, 295, 314, 411
 Algjeri - 91, 143, 193, 211
 Aman - 212-213
 Amerika Latine - 257, 411
 Arabi (gadishulli ~) - 192
 Arabia Saudite - 26
 Athinë - 342, 356, 370
 Australi - 488, 494
 Azi - 36, 81, 114, 115, 180, 411, 430, 544, 548
- B**
- «Bajram Curri» (qyteti ~) - 145
 Baltik (zona ~) - 265, 267
 Bangladesh - 429, 530, 545, 548
 Belgjikë - 219, 363
 Bengal (gjiri ~) - 249, 545
 Beograd - 125, 189, 370, 371, 374, 417, 435, 442, 444, 462-463
 Berat - 458, 532
 Berlin - 449, 452
 Birmani - 19
 Boboshticë (Korçë) - 336, 396
 Bon - 43, 164
- Brioni (Jugosllavi) - 159, 350
 Budapest - 318
 Bukuresht - 41, 167, 417, 432
 Bushat (hidrocentrali ~, Shkodër) - 467, 468, 479, 518
- Ç**
- Çekosllovaki - 169, 220
- D**
- Daka - 530
 Dardanele (ngushtica ~) - 223
 Delhi - 427, 430, 530
 Deti i Kinës - 338
 Deti i Zi - 174, 314
 Dien Bien Fu (Vietnam) - 196
- E**
- Egjipt - 26-27, 59, 71, 108, 210-211, 214, 219-220, 242, 257, 312-316, 360-362, 550
 Erfurt (RD Gjermane) - 101
 Evropë - 81, 90, 163-164, 174, 179-181, 184-185, 209, 215, 221-222, 286, 348, 354-355, 363, 378, 385, 411, 430, 434-435, 444, 450-453

F

Fier — 542
Fierzë (hydrocentrali ~, Tro-
pojë) — 261-262, 467, 479

G

Gdansk (Dancig — Poloni) —
265, 267, 297

GJ

Gjakovë (Jugosllavi) — 62, 96
Gjeorgji — 363
Gjerdap (Jugosllavi) — 166-167
Gjirokastër — 82

H

Hanoi — 225, 423, 444, 488, 539
Himalaje (malet ~) — 546
Holandë — 219, 363

I

Indokinë — 100, 115, 139, 148,
411, 421
Indonezi — 546
Irak — 26, 193, 213

J

Jaltë (Krime, BS) — 189
Jordani — 26, 172-173, 192, 213-
214

K

Kajro — 206, 213
Kanada — 444
Kashmir (Indi) — 428
Kiansi (Kinë) — 343
Koman (hydrocentrali ~ Pukë)
— 518
Kongo (B) — 143, 227
Kotor (Jugosllavi) — 61
Krime (BS) — 431, 449-450
Kroaci (Jugosllavi) — 531-533,
537-538
Kukës — 364
Kunmin (Kinë) — 19
Kuvajt — 26

L

Liban — 26, 172, 211
Libi — 84, 312, 405
Lindja e Afërt — 38, 92, 108,
192-193
Lindja e Largme — 35-37, 410-
411, 544
Lindja e Mesme — 222
Londër — 543
Luksemburg — 219, 223, 363
Lusakë — 418

M

Malajzi — 430
Mali i Zi — 62, 191, 277, 350,
468, 533, 538
Marok — 91, 143
Maqedoni (Jugosllavi) — 12, 15,
41, 83, 254, 277, 326, 350, 534,
538
Mesdhe (zona ~) — 92, 201-

-204, 209, 220, 222-224, 362
Milano (Itali) — 56
Mongoli — 69, 373, 378
Moskë — 60, 100, 125, 163, 182,
221-223, 268, 363, 373-374, 378-
379, 435, 525, 541

N

Nanterrë (Francë) — 64
Napoli (Itali) — 200
Nju-Jork — 29, 240, 455, 475,
511

O

Oder-Najse (kufiri ~) — 288
Oqeani Indian — 428, 530, 550
Oqeani Paqësor — 122, 428

P

Paris — 16, 29, 57, 77, 117, 186,
225, 256, 306, 421, 539
Pekin — 13, 17, 35, 40, 117, 130,
138, 141, 165, 176, 177, 215, 273,
338, 371, 383, 397, 398, 406-407,
417-418, 420, 425, 426, 459, 461,
471, 483, 486, 506, 508, 524,
539-540
Perpinjan (Francë) — 44
Prishtinë (Jugosllavi) — 80, 234,
237, 277, 460, 528, 533

R

Romë — 513

S

Sajgon — 195-197
Sarajevë (Jugosllavi) — 389

Serbi — 174, 326, 348, 350-351,
533-534, 538
Siberi (BS) — 115
Sinkiang (Kinë) — 37
Siri — 143, 172, 193, 210, 213,
257, 312, 362
Sofje — 231
Spanjë — 200, 223
Stamboll — 236
Sudan — 312
Suez (kanali ~) — 26, 210, 312-
316

SH

Shangai (Kinë) — 142, 383
Shkodër — 174, 468

T

Tajlandë — 304
Tajvan (ishulli ~) — 13, 115,
400-401, 405, 411, 455, 484,
488
Teheran — 365
Tel-Aviv — 26, 361
Tibet (Kinë) — 428, 545, 547
Tiranë — 80, 98, 125, 138, 159,
191, 273, 342, 356, 398, 432,
435, 485, 503
Tokio — 116
Trafalgar (Kepi ~, Spanjë) —
202
Trieste (Itali) — 325
Tropojë — 145
Tunizi — 91, 211
Turqi — 223, 434

U

Uashington — 163, 361, 365, 417,
435

Ulqin (Jugosllavi) - 62
Usuri (lumi ~) - 115

Vlorë - 192

Z

Zagreb (Jugosllavi) - 217, 533
Zopot (Poloni) - 265
Zvicër - 363

V

Varshavë - 6, 13, 17, 265, 278,
299, 402

Vatikan - 84, 278, 299

Velabisht (Berat) - 532

Vendet skandinave - 137

Vishi (Francë) - 90

Xhakartë - 430

XH

LËNDA

1970

	Faqe
1. — 1 janar 1970. Montekatini duhet të përfundojë kontratën me ne	5
2. — 3 janar 1970. Kujdes në punën me PK të Polonisë	6
3. — 3 janar 1970. Një deklaratë e Bodnarashit	8
4. — 4 janar 1970. Shënim	9
5. — 5 janar 1970. Diplomacia kineze po lëviz	10
6. — 5 janar 1970. Kurrë nuk do ta pakësojmë ndihmën tonë për popujt arabë	11
7. — 5 janar 1970. Lojë e ndyrë e revizionistëve sovjetikë e bullgarë	12
8. — 6 janar 1970. S'ka tym pa zjarr	13
9. — 6 janar 1970. Ujët fle, armiku nuk fle. Të ndjekim me vigjilencë zhvillimin e ngjarjeve në Jugosllavi	14
10. — 6 janar 1970. Mësimet e Komunës (V. I. Lenin)	16
11. — 7 janar 1970. Bisedime kino-amerikane në rang ambasadorësh	17
12. — 8 janar 1970. Tito tradhtari ndodhet në hall	18
13. — 9 janar 1970. Shënim	19
14. — 9 janar 1970. Një analizë që Maoja duhet ta bëjë	20
15. — 9 janar 1970. Simitet e Radio Moskës	21
16. — 10 janar 1970. Të shpartallohen komple-	

	Faqe
tet kriminale kundër interesave sovranë të RD Gjermane	22
17. — 12 janar 1970. Rruga e vetme për të shpëtuar nga thundra e kapitalit është lufta e klasave	23
18. — 13 janar 1970. Veprime të drejta vetëmbrojtëse të kinezëve	25
19. — 16 janar 1970. «Al Fatahu» nuk duhet të bjerë në kurthin e sovjetikëve	26
20. — 19 janar 1970. Takim me delegacionin tregtar qeveritar kinez	28
21. — 20 janar 1970. Takim i parë i përfaqësuesve të dhomave të tregtisë të Shqipërisë dhe të Greqisë	29
22. — 20 janar 1970. Lufta e armatosur e popullit palestinez është e pamposhtur	30
23. — 23 janar 1970. Probleme të klasës punëtore dhe të kapitalit monopolist	31
24. — 25 janar 1970. Kinezët po punojnë për riorganizimin e partisë së tyre	35
25. — 26 janar 1970. Hapja e politikës së jashtme kineze	36
26. — 30 janar 1970. Për artikullin «Politika e RP të Kinës për mbrojtjen e atdheut dhe përgatitjet për rast lufte — politikë e drejtë revolucionare»	39
27. — 30 janar 1970. Njoftim lakonik i kinezëve	40
28. — 31 janar 1970. Kujdes nga provokatorët rankoviçianë	41
29. — 31 janar 1970. Montekatini i uli pendët	42
30. — 31 janar 1970. Artikujt tanë në mbrojtje të RD Gjermane bënë efektin e duhur	43
31. — 1 shkurt 1970. PK e Francës (m-l) kërcënohet nga përçarja	44

	Faqe
32. — 1 shkurt 1970. Probleme të klasës punëtore dhe të kapitalit monopolist	45
33. — 3 shkurt 1970. Edhe Partia Komuniste e Italisë (m-l) ndodhet përpara fraksionit të Peshes	56
34. — 6 shkurt 1970. Libra të shkruhen për popullin, për Partinë dhe për atdheun socialist	57
35. — 7 shkurt 1970. Ç'diskutohet në mbledhjet kino-sovjetike	58
36. — 7 shkurt 1970. Sovjetikët po e kthejnë Egjiptin në një koloni	59
37. — 10 shkurt 1970. Revizionistët po infiltrojnë në gjirin e «Al Fatahut»	60
38. — 10 shkurt 1970. Anije të flotës detare sovjetike në portet jugosllave	61
39. — 11 shkurt 1970. Shqiptarët në Kosovë e në Mal të Zi e manifestojnë hapur dashurinë e tyre për Shqipërinë	62
40. — 12 shkurt 1970. Shënim	63
41. — 12 shkurt 1970. Revizionistët francezë iu nënshtruan plotësisht revizionistëve sovjetikë	64
42. — 13 shkurt 1970. Kurdoherë kemi dashur marrëdhënie të fqinjësisë së mirë me popullin grek	65
43. — 13 shkurt 1970. Mbi gjendjen në PK të Francës (m-l) dhe të Italisë (m-l)	68
44. — 17 shkurt 1970. Greqëve u përket të marrin iniciativa për marrëdhëniet diplomatike me ne	69
45. — 17 shkurt 1970. Për marrëdhëniet sovjetiko-kineze	70

46. — 18 shkurt 1970. Izraeli po diskrediton Bashkimin Sovjetik	71
47. — 18 shkurt 1970. Grindjet në gjirin e PK të Francës (m-l) mund të zgjidhen vetëm duke zbatuar rregullat organizative	72
48. — 19 shkurt 1970. Politikë revizioniste	73
49. — 19 shkurt 1970. Revizionistët sovjetikë përpiqen të krijojnë njësi të mëdha mikste ushtarake me satelitët e tyre	74
50. — 20 shkurt 1970. Hallkë e re e zinxhirit të robërisë sovjetike	75
51. — 21 shkurt 1970. Grekët na falënderojnë	76
52. — 22 shkurt 1970. Shënim	77
53. — 22 shkurt 1970. Të demaskojmë përçarësit e lëvizjes revolucionare	78
54. — 25 shkurt 1970. Ashpërsohet veprimtaria shoviniste e titistëve ndaj shqiptarëve të Kosovës	79
55. — 26 shkurt 1970. Të përshëndetim krijimin e Universitetit të Prishtinës	80
56. — 26 shkurt 1970. Traktati i Varshavës krijon «repartet speciale ushtarake të për-bashkëta»	81
57. — 27 shkurt 1970. Të sigurohen nevojat materiale të shtypshkronjës në gjuhën greke në Gjirokastrë	82
58. — 28 shkurt 1970. Titistët përpiqen të ndalojnë kalimin e librave tanë në Kosovë	83
59. — 28 shkurt 1970. Italia në krizë	84
60. — 1 mars 1970. Pakënaqësi në Bullgari ndaj klikës së Zhivkovit	85
61. — 4 mars 1970. Shënim	86
62. — 4 mars 1970. Mbi kontradiktat franko-amerikane	87

63. — 8 mars 1970. Si ta kuptojmë e si ta organizojmë punën tonë me partitë (m-l) dhe me grupet revolucionare	94
64. — 10 mars 1970. Vërejtje për listat e materialeve që do të kërkojmë nga Kina	95
65. — 10 mars 1970. Bisedë e përzemërt me partizanen e vjetër Bije Vokshi	96
66. — 11 mars 1970. Rreth zërave për një krizë politike midis krerëve të Kremlinit	97
67. — 12 mars 1970. Shënim	98
68. — 13 mars 1970. Punonjësit e ambasadave tona të jenë njerëz politikë e shumë të kujdesshëm	99
69. — 22 mars 1970. Situata në Kamboxhia po keqësohet	100
70. — 23 mars 1970. Çfarë do të sjellë takimi midis përfaqësuesve të të dy shteteve gjermane	101
71. — 24 mars 1970. Kriza në udhëheqjen revizioniste sovjetike	102
72. — 4 prill 1970. Rëndësia e luftës nacional-çlirimtare në historinë e popujve të Jugosllavisë	110
73. — 6 prill 1970. Çu En Lai viziton Korenë	111
74. — 8 prill 1970. Vizita e Çu En Lait në Kore	112
75. — 11 prill 1970. Shënime për Kamboxhian	117
76. — 13 prill 1970. Sihanuku çmon përkrahjen që ne i japim luftës së popullit kamboxhian	120
77. — 14 prill 1970. Defekt në anijen kozmike «Apolo - 13»	121
78. — 15 prill 1970. «Apolo - 13» po kthehet në Tokë	122
79. — 16 prill 1970. Shënime	123
80. — 20 prill 1970. Synimet e titistëve	124

81. — 21 prill 1970. Shënim	128
82. — 21 prill 1970. Mbledhje solemne kushtuar 100-vjetorit të lindjes së V. I. Leninit	129
83. — 22 prill 1970. Ne jemi marksistë-leninistë të singertë	130
84. — 23 prill 1970. Mbi burimin kryesor të tek- nokratizmit	131
85. — 24 prill 1970. Shënim	133
86. — 25 prill 1970. Kina hodhi satelitin e parë të Tokës	134
87. — 28 prill 1970. Sateliti i parë kinez dhe je- hona në botë	135
88. — 29 prill 1970. Mbështetim deklaratën e për- bashkët të konferencës së nivelit të lartë të popujve të Indokinës	136
89. — 29 prill 1970. Shënim	137
90. — 30 prill 1970. Shenjë e mirë e palës kineze	138
91. — 1 maj 1970. Fashisti Nikson sulmoi Kam- boxhian	139
92. — 3 maj 1970. Sihanuku kërkon mbështetjen tonë	141
93. — 5 maj 1970. Takim me delegacionin e punëtorëve kinezë	142
94. — 14 maj 1970. Shënim	143
95. — 14 maj 1970. Revizionistët sovjetikë në lëmshin e kontradiktave të pazgjidhshme	144
96. — 30 maj 1970. Politika dhe qëndrimet tona në marrëdhëniet shtetërore me Jugoslla- vinë dhe në mbrojtje të vëllezërve tanë kosovarë janë parimore, të vendosura dhe të pandryshueshme	145
97. — 10 qershor 1970. Shënim	147
98. — 22 qershor 1970. Kinezët bisedojnë mbi «planet rumune në Ballkan»	148

99. — 27 qershor 1970. Shënim	151
100. — 7 korrik 1970. Ne nuk e futim atdheun në gracka revizioniste	152
101. — 15 korrik 1970. Një përpjekje rumune që nuk kaloi	157
102. — 20 korrik 1970. Bisedë për çështjen e Kosovës	160
103. — 21 korrik 1970. Takim me delegacionin e Asamblesë Kombëtare të Vietnamit të Veriut	161
104. — 24 korrik 1970. Sot aleancë kino-rumune, më vonë mundet edhe aleancë kineze me Titon	165
105. — 26 korrik 1970. Titoja e luan bukur kartën e tij «prokineze»	169
106. — 28 korrik 1970. Të vazhdojë politika jonë e drejtë për Lindjen e Mesme	171
107. — 29 korrik 1970. Ne kemi simpati dhe res- pekt për popullin arab të Palestinës	172
108. — 29 korrik 1970. Vigjilent ndaj politikës kineze	175
109. — 31 korrik 1970. Kinezët bëjnë dashuri me revizionistët. Vigjilencë!	176
110. — 3 gusht 1970. Takim me delegacionin e «Al Fatahut»	178
111. — 11 gusht 1970. Miqësia midis revizionis- tëve sovjetikë dhe militaristëve gjermanë nën patronazhin e imperializmit amerikan	179
112. — 21 gusht 1970. Traktati sovjeto-gjerman — një komplot i rrezikshëm kundër po- pujve të Evropës dhe gjithë botës	186
113. — 10 shtator 1970. Shënim	187
114. — 11 shtator 1970. Kujdes, shokë kinezë, mos bini në kurthet e armiqve!	188

	Faqe
115. — 21 shtator 1970. Komplot i madh kundër popullit palestinez dhe revolucionit të popujve arabë	192
116. — 21 shtator 1970. Nuk mbështetim kapitullimin dhe kompromiset e revizionistëve vietnamezë me imperialistët amerikanë	195
117. — 23 shtator 1970. Shënim	199
118. — 27 shtator 1970. Ardhja e Niksonit në Evropë	200
119. — 28 shtator 1970. Vdiq Naseri	206
120. — 29 shtator 1970. Kinezët janë të një mendjeje me kapitulluesit vietnamezë	207
121. — 29 shtator 1970. Shënim	208
122. — 30 shtator 1970. Në pritjen e dhënë nga ambasada kineze	209
123. — 30 shtator 1970. Vdekja e Naserit	210
124. — 1 tetor 1970. Reaksioni botëror punon për likuidimin e lëvizjes palestineze	212
125. — 3 tetor 1970. Çu En Lai dëshiron të vijë në vendin tonë	215
126. — 4 tetor 1970. Delegacioni ynë, që mori pjesë në varrimin e Naserit, u kthye në atdhe	216
127. — 5 tetor 1970. Titoja ambasador shëtitës i imperializmit	217
128. — 5 tetor 1970. Ç'fshihet prapa vizitës së Pompidusë në Moskë	221
129. — 10 tetor 1970. Plan djallëzor i Niksonit	225
130. — 11 tetor 1970. Një delegacion i RP të Kongos në vendin tonë	227
131. — 13 tetor 1970. Takim me delegacione kineze	228
132. — 17 tetor 1970. Takim me delegacionin e Republikës Popullore të Kongos (Brazavil)	229

	Faqe
133. — 17 tetor 1970. Shënim	230
134. — 19 tetor 1970. Sajime tendencioze të tivistëve	231
135. — 19 tetor 1970. Shënim	232
136. — 19 tetor 1970. Kina na akordoi kredinë për vitet 1971-1975	233
137. — 20 tetor 1970. Të studiohen kërkesat e delegacionit të Universitetit të Prishtinës	234
138. — 20 tetor 1970. Shënim	235
139. — 21 tetor 1970. Shënim	236
140. — 25 tetor 1970. Profesorët kosovarë janë shumë të kënaqur nga vizita në vendin tonë	237
141. — 29 tetor 1970. Shënime	238
142. — 30 tetor 1970. Shënim	239
143. — 2 nëntor 1970. Rritet autoriteti i vendit tonë	240
144. — 3 nëntor 1970. Të shkruajmë për fiaskon e vetadministrimit jugosllav	241
145. — 4 nëntor 1970. Shqipëria socialiste i urren shantazhierët	242
146. — 7 nëntor 1970. Shënim	243
147. — 9 nëntor 1970. Shënim	244
148. — 13 nëntor 1970. Përpyetje të kota të një ambasadori sovjetik	245
149. — 14 nëntor 1970. Takim me një udhëheqës komunist indian	246
150. — 16 nëntor 1970. Të ndihmojmë popullin e Vietnamit të Jugut	247
151. — 17 nëntor 1970. Të ndihmojmë popullin pakistanez	248
152. — 19 nëntor 1970. Dëshmi të falimentimit të plotë të vijës revizioniste të vetadministrimit jugosllav	249

	Faqe
153. — 20 nëntor 1970. Bisedë me shokun Rita Marko për vizitën e tij në Rumani	250
154. — 25 nëntor 1970. Do të dërgojmë një delegacion të Lidhjes së Shkrimtarëve në Kosovë	251
155. — 25 nëntor 1970. Në Jugosllavi çdo gjë ecën drejt greminës	252
156. — 26 nëntor 1970. Përkujtojmë 150-vjetorin e lindjes së Engelsit	253
157. — 26 nëntor 1970. Lodër e revizionistëve sovjetikë	254
158. — 27 nëntor 1970. Politikë prorumune me dy faqe e kinezëve	255
159. — 29 nëntor 1970. Lë Mond boton pjesë nga fjalimi i mbajtur në Mbledhjen e Moskës të vitit 1960	256
160. — 30 nëntor 1970. Mbi qeverinë e re të Sirisë	257
161. — 4 dhjetor 1970. Shënim	258
162. — 6 dhjetor 1970. Shenja «të fitores» së revizionizmit modern në Kinë	259
163. — 8 dhjetor 1970. Shënim	260
164. — 9 dhjetor 1970. Një orvatje e dënueshme për të penguar ndërtimin e Hidrocentralit të Fierzës	261
165. — 11 dhjetor 1970. SHBA rifilluan bombardimet në Vietnamin e Veriut	263
166. — 14 dhjetor 1970. Deklaratë pozitive e qeverisë greke	264
167. — 17 dhjetor 1970. Shprehje e kalbëzimit të regjimit revizionist polak	265
168. — 20 dhjetor 1970. Klikën revizioniste të Gomulkës e rrëzuan	267
169. — 22 dhjetor 1970. Shënim	270

	Faqe
170. — 22 dhjetor 1970. Ç'tha Gën Biaoja kur u largua nga Tirana?	271
171. — 25 dhjetor 1970. Mbi gjendjen shpirtërore në Kosovë	272
172. — 26 dhjetor 1970. Takim me ambasadorin kinez	273
173. — 26 dhjetor 1970. Shqetësim i madh në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera revizioniste	274
174. — 30 dhjetor 1970. Sukses i profesorëve tanë në Kosovë	277
175. — 31 dhjetor 1970. Situata në Poloni është e errët	278
1971	
1. — 1 janar 1971. Në Kinë po riorganizohet Partia	281
2. — 4 janar 1971. Shënim	283
3. — 8 janar 1971. Mbi marrëdhëniet tona me Greqinë	284
4. — 12 janar 1971. Disa mendime për gjendjen në vendet revizioniste	286
5. — 13 janar 1971. Të dënojmë krimin e reaksionit jordanëz kundër popullit palestinez	294
6. — 22 janar 1971. Të shfaqim qëndrimin tonë të drejtë pa u prishur me miqtë egjiptianë	295
7. — 31 janar 1971. Propaganda jonë të jetë më aktive në ndjekjen e zhvillimeve politike në Kosovë e në Jugosllavi	296
8. — 1 shkurt 1971. Rrëzimi i Gomulkës	297
9. — 3 shkurt 1971. Të mbrojmë tezat e kosovarëve rreth ndryshimit të kushtetutës	301

	Faqe
10. — 5 shkurt 1971. Dy kozmonautë amerikanë zbritën përsëri në hënë	302
11. — 10 shkurt 1971. Takim me Kazhimiezh Mijalin	303
12. — 11 shkurt 1971. Invadimi i Laosit nga amerikano-sajgonezët, rezultat i politikës tradhtare të revizionistëve sovjetikë e vietnamezë	304
13. — 17 shkurt 1971. Çen Po Taja dënohet si tradhtar	308
14. — 21 shkurt 1971. Rihapja e kanalit të Suezit	312
15. — 23 shkurt 1971. Takim me ambasadorin e ri kinez	317
16. — 27 shkurt 1971. Matias Rakoshi — revolucionar e komunist i shquar	318
17. — 1 mars 1971. Buzëqeshjet politike të Jugosllavisë dhe të Bullgarisë ndaj nesh	319
18. — 2 mars 1971. Mbi librin «Fundi i misterit etrusk»	328
19. — 15 mars 1971. Shënim	329
20. — 19 mars 1971. Shënim	330
21. — 22 mars 1971. Shënim	331
22. — 24 mars 1971. Kongres revizionist	332
23. — 25 mars 1971. Formula greke për lidhjen e marrëdhënieve diplomatike me vendin tonë	333
24. — 2 prill 1971. Të mos bëjmë asnjë lëshim	334
25. — 3 prill 1971. Të zgjerojmë shkëmbimet kulturore, sidomos me Kosovën	335
26. — 12 prill 1971. Shënime	336
27. — 15 prill 1971. «Politika e pingpongut»	337
28. — 15 prill 1971. Shënim	340
29. — 17 prill 1971. Takim me ambasadorin e RD të Vietnamit	341

	Faqe
30. — 29 prill 1971. Po vendosen marrëdhëniet diplomatike me Greqinë	342
31. — 30 prill 1971. Takim me delegacionin e punëtorëve kinezë	343
32. — 30 prill 1971. Shënim	344
33. — 30 prill 1971. Qëndrim koniunktural i koreanëve	345
34. — 2 maj 1971. Kriza e brendshme jugosllave	346
35. — 4 maj 1971. Rrëzimi i Valter Ulbrihit	352
36. — 6 maj 1971. U shpall vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Greqinë	356
37. — 6 maj 1971. Takim me delegacione të huaja sindikale	357
38. — 10 maj 1971. Shënim	358
39. — 13 maj 1971. Rreth një takimi të të ngarkuarit tonë me punë në Beograd me Fadil Hoxhën	359
40. — 13 maj 1971. Krizë në Egjipt	360
41. — 23 maj 1971. Si t'i ndihmojmë kosovarët për të luftuar hakmarrjen, kriminalitetin dhe degjenerimin e rinisë	364
42. — 23 maj 1971. Çaushesku do të vizitojë Kinën	365
43. — 26 maj 1971. Shënim	369
44. — 28 maj 1971. Shënim	370
45. — 31 maj 1971. Shënime	371
46. — 2 qershor 1971. Kinezët dhe Çaushesku	372
47. — 4 qershor 1971. Shënim	376
48. — 7 qershor 1971. Kinezët pas Çausheskut presin edhe jugosllavin Tepavac	377
49. — 8 qershor 1971. Çen Po Taja akuzohet për të gjitha gjynahet	380
50. — 12 qershor 1971. Çu En Lai priti ngroh-tësisht Tepavacin	383

	Faqe
51. — 12 qershor 1971. Në Kinë pritet ministri i Jashtëm titist	384
52. — 13 qershor 1971. Çaushesku në Kore	388
53. — 19 qershor 1971. Titoja ka lëshuar SOS-in	389
54. — 22 qershor 1971. Shokët kinezë na «informojnë» mbi bisedimet me Çausheskun	392
55. — 23 qershor 1971. Shënim	395
56. — 2 korrik 1971. Takim me Viktor Eftimiun	396
57. — 16 korrik 1971. Niksoni ftohet të vizitojë Kinën	397
58. — 24 korrik 1971. Pritja e Niksonit në Kinë është një gabim i madh oportunist	398
59. — 24 korrik 1971. T'u dërgohet letër kinezëve lidhur me ftesën që i bënë Niksonit të shkojë në Kinë	408
60. — 26 korrik 1971. Revizionizëm me brirë	409
61. — 27 korrik 1971. Radhitje antimarksiste	414
62. — 28 korrik 1971. Kina, Vietnami, Koreja dhe vajtja e Niksonit në Pekin	420
63. — 2 gusht 1971. Mbledhje e Byrosë Politike lidhur me çështjen e vizitës së Niksonit në Pekin	425
64. — 12 gusht 1971. Kinezëve ua dorëzuam letrën tonë lidhur me vizitën e Niksonit në Pekin	426
65. — 13 gusht 1971. Traktati sovjeto-indian dhe Kina	427
66. — 15 gusht 1971. Manovrat e kinezëve në Ballkan	432
67. — 20 gusht 1971. Bisedë me delegacionin ushtarak kinez	438
68. — 1 shtator 1971. Shënim	439
69. — 4 shtator 1971. Delegacioni ynë i bujqësisë është pritur mirë në Kinë	440

	Faqe
70. — 7 shtator 1971. Kinezët na presin mirë por letrës sonë për Niksonin ende nuk i përgjigjen	441
71. — 11 shtator 1971. Brezhnjevi te Titoja	442
72. — 11 shtator 1971. Vdiq renegati Hrushov	445
73. — 13 shtator 1971. Për fjalimin tonë në OKB	446
74. — 16 shtator 1971. Renegati Hrushov	447
75. — 18 shtator 1971. Të demaskojmë qëllimet e afrimit midis Bashkimit Sovjetik e Gjermanisë Federale	448
76. — 19 shtator 1971. Vili Brandi në Bashkimin Sovjetik	449
77. — 24 shtator 1971. Ç'thonë agjencitë e lajmeve për Kinën	454
78. — 25 shtator 1971. Shënim	455
79. — 30 shtator 1971. Në pritjen e ambasadës kineze	456
80. — 2 tetor 1971. Takim me trupën e baletit të RP të Kinës	457
81. — 3 tetor 1971. Zbulohet një dokument me vlerë të madhe shkencore	458
82. — 3 tetor 1971. Kisingeri do të shkojë në Kinë	459
83. — 6 tetor 1971. Shënim	460
84. — 7 tetor 1971. Kisingeri përgatit udhëtimin e Niksonit në Kinë	461
85. — 8 tetor 1971. Brezhnjevi në Beograd	462
86. — 8 tetor 1971. Pse nuk duhet ftuar në Kongresin tonë Partia Komuniste e Rumanisë	464
87. — 10 tetor 1971. Shënim	467
88. — 11 tetor 1971. Shënim	468

	Faqe
89. — 14 tetor 1971. Partia Komuniste e Kinës nuk dërgon delegacion në Kongresin e 6-të të Partisë së Punës të Shqipërisë	469
90. — 14 tetor 1971. Shënim	475
91. — 19 tetor 1971. Çfarë qëndron pas këtij vendimi të kinezëve	476
92. — 20 tetor 1971. Shënime	477
93. — 21 tetor 1971. Shënim	478
94. — 22 tetor 1971. Kinezët nuk duan të bisedojnë për Hidrocentralin e Bushatit	479
95. — 25 tetor 1971. Kazhimiezh Mijali shfaq pakënaqësi ndaj kinezëve	480
96. — 26 tetor 1971. Pranimi i Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara	481
97. — 26 tetor 1971. Urimet tona për pranimin e Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara	485
98. — 28 tetor 1971. Bisedimet e Çu En Lait me Henri Kisingerin	486
99. — 31 tetor 1971. Takim me përfaqësuesit e delegacioneve të huaja	490
100. — 2 nëntor 1971. Shënime nga salla e Kongresit të 6-të të Partisë	491
101. — 3 nëntor 1971. Në Kongres vazhdojnë të përshëndetin delegatët e huaj	494
102. — 4 nëntor 1971. Kongresi aprovon rezolutën në përkrahje të luftës çlirimtare të popullit vietnamez	496
103. — 5 nëntor 1971. Kinezët heshtin për Kongresin tonë	498
104. — 6 nëntor 1971. Kongresin e 6-të e përshëndetën gati të gjitha delegacionet e huaja	500
105. — 7 nëntor 1971. Kongresi i 6-të u dha fund punimeve	502

	Faqe
106. — 8 nëntor 1971. Miting i madh i popullit të Tiranës	503
107. — 9 nëntor 1971. Shokët kinezë dhe Kongresi i 6-të i Partisë sonë	504
108. — 10 nëntor 1971. Një «diçka» sensacionale	508
109. — 11 nëntor 1971. Çu En Lai drejton edhe ushtrinë	509
110. — 12 nëntor 1971. Shënim	510
111. — 12 nëntor 1971. Në OKB të bashkëpunojmë me kinezët, por të ruajmë pavarësinë dhe personalitetin e vendit tonë	511
112. — 13 nëntor 1971. Qëndrimi ynë i matur i detyron kinezët të ndryshojnë qëndrimin e tyre	512
113. — 13 nëntor 1971. Shënim	513
114. — 15 nëntor 1971. Për një takim të shokut Hysni me ambasadorin kinez	514
115. — 15 nëntor 1971. Shënime për Kinën	516
116. — 16 nëntor 1971. Çfarë problemesh të diskutohen me delegacionin qeveritar ekonomik kinez	518
117. — 17 nëntor 1971. Shënim	519
118. — 19 nëntor 1971. Karriljoja në Kinë	520
119. — 22 nëntor 1971. Kina, Vietnami dhe tratativat e fshehta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës	524
120. — 11 dhjetor 1971. Takim me delegacionin qeveritar ekonomik të RP të Kinës	527
121. — 14 dhjetor 1971. Ndihma Kosovës — një vijë politike me rëndësi të madhe kombëtare	528
122. — 14 dhjetor 1971. Pozitë e dobët e udhëheqësve të Pakistanit	529
123. — 17 dhjetor 1971. Pakistanezët kapitulluan	530

	Faqe
124. — 18 dhjetor 1971. Turbullirat në Kroaci dhe Kosova	531
125. — 18 dhjetor 1971. Përkrahim kandidaturën e Kurt Valdhajmit për sekretar të përgjithshëm të OKB-së	536
126. — 23 dhjetor 1971. Abcesi revizionist jugosllav shpërtheu haptazi	537
127. — 28 dhjetor 1971. Bombardimet masive amerikane mbi Vietnamin e Veriut	539
128. — 30 dhjetor 1971. Lufta indo-pakistaneze dhe Kina	542
129. — 30 dhjetor 1971. Shënim	552
Treguesi tematik i lëndës	555
Treguesi i emrave	563
Treguesi gjeografik	569